

THJESHT Krishterim

Clive Staples Lewis (1898-1963) ishte një nga intelektualët më të mëdhenj të shekullit XX dhe pa diskutim shkrimtari më me ndikim i kohës. Ai ishte pedagog dhe udhëheqës shkencor për letërsinë angleze në universitetin e Oksfordit deri në vitin 1954, kur edhe u zgjodh njëzëri përgjegjës i departamentit të anglishtes së Mesjetës dhe Rilindjes në universitetin e Kembrixhit, post ku qëndroi derisa doli në pension. Shkroi mbi 30 libra, duke bërë për vete një publik të larmishëm dhe duke vazhduar të tërheqë mijëra lexues të rinj çdo vit, edhe sot e kësaj dite. Ndër veprat e tij më të spikatura dhe më të njohura janë *Kronikat e Narnias*, *Trilogjia kozmike*, *Katër dashuritë*, *Letrat e Hirziut* dhe *Thjesht krishterim*.

THJESHT
Krishterim

— *C. S. Lewis.* —

Titulli original i veprës:
Mere Christianity by CS Lewis © C. S. Lewis Pte Ltd. 1942, 1943, 1944, 1952
Published by Shigjeta Publishing House under license from
The CS Lewis Company Ltd.

Faqja e internetit të autorit: www.cslewis.com

Titulli i përkthimit në shqip:
Thjesht krishterim
C. S. Lewis

Botuar nga shtëpia botuese “Shigjeta”.
© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Ndalohet ribotimi i këtij libri pa marrë
më parë lejen me shkrim nga botuesi, tërësisht apo pjesërisht,
si dhe fotokopjimi apo shumëfishimi në çfarëdo lloj mënyre.

Përktheu: Sergej Meçe
Redaktoi: Blerta Myrteza
Rishikoi: Zefjan Nikolla

ISBN:

Shtëpia Botuese “Shigjeta”
Rr. Niko Dodona, nr. 6, Korçë, 7001
Albania

Email: shtepiabotueseshigjeta@gmail.com

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE
PARAFJALA

VII
XVII

LIBRI NJË

E DREJTA DHE E GABUARA SI ÇELËSI PËR TË KUPTUAR GJITHËSINË

1	Ligji i natyrës njerëzore	3
2	Disa kundërshtime	9
3	Realiteti i ligjit	16
4	Çfarë gjendet pas ligjit	21
5	Kemi shkak për të mos qenë rehat	28

LIBRI DY

ÇFARË BESOJNË TË KRISHTERËT

1	Koncepte rivale për Perëndinë	35
2	Pushtimi	40
3	Alternativa tronditëse	47
4	I penduari i përsosur	53
5	Përfundimi praktik	60

LIBRI TRE

SJELLJA E KRISHTERË

1	Tri pjesët e moralit	69
2	Virtytet “themeltare”	76
3	Morali shoqëror	82
4	Morali dhe psikanaliza	88
5	Morali seksual	94
6	Martesa e krishterë	104

7	Falja	115
8	Mëkati i madh	121
9	Dashuria	129
10	Shpresa	134
11	Besimi	138
12	Besimi	144

LIBRI KATËR

PËRTEJ PERSONALITETIT DHE HAPAT E PARË NË DOKTRINËN E TRINISË

1	Bërje dhe lindje	153
2	Perëndia tri-personal	160
3	Koha dhe përtej kohës	166
4	Infeksioni i mirë	172
5	Ushtarët kokëfortë prej lodre	178
6	Dy qartësime	183
7	Le të bëjmë sikur	187
8	Krishterimi: i lehtë, apo i vështirë?	195
9	Llogaritja e çmimit	201
10	Njerëz të mirë apo njerëz të rinj	207
11	Njerëzit e rinj	218

PARATHËNIE

Përmbajtja e këtij libri u tejçua fillimisht nëpërmjet radios, e më pas u botua në tre pjesë të veçanta me tituj *Biseda në radio* (1942), *Sjellja e krishterë* (1943) dhe *Përtej personalitetit* (1944). Në variantet e printuara unë shtova disa gjëra nga ajo që kisha thënë para mikrofonit, por përveç kësaj nuk i ndryshova tekstit asgjë. Unë mendoj që një “bisedë” në radio duhet t’i ngjajë sa më shumë të jetë e mundur një bisede normale, dhe nuk duhet të tingëllojë sikur po lexohet me zë të lartë një ese. Prandaj unë kam përdorur në bisedat e mia gjithë shkurtime dhe zhargonet që përdor zakonisht. Këtë e ruajta edhe në variantin e printuar, duke ruajtur shprehjet *s’është* apo *ç’gjë* në vend të *nuk është* dhe *çfarë gjëje*. Dhe në çdo rast që e kam theksuar me zë një fjalë në radio, jam kujdesur ta printoj atë me të pjerrëta. Tani më duket se ky ishte një gabim—një përzierje e padëshiruar e artit të të folurit me artin e të shkruarit. Folësi duhet t’i përdorë tonalitetet e zërit për të theksuar pasi mjeti i tij i komunikimit ia mundëson natyrshëm këtë gjë: por shkrimtari nuk duhet t’i përdorë të pjerrëtat për të njëjtën arsye. Ai ka mjetet e tij të ndryshme për ta vënë në pah fjalën kyç dhe duhet t’i përdorë këto. Në këtë vëllim i kam zgjeruar shkurtime dhe e kam zëvendësuar shumicën e të pjerrëtave duke i rishkruar fjalitë ku gjendeshin ato: por shpresoj pa e cënuar tonin “familjar” dhe “popullor” të cilin kam pasur qëllim të përdor gjatë gjithë kohës. Gjithashtu kam shtuar dhe hequr pjesë atje ku mendova se e kuptoj temën më

mirë tani sesa dhjetë vjet më parë, apo ku e dija se varianti fillestar ishte keqkuptuar nga të tjerët.

Lexuesi duhet të paralajmërohet që unë nuk po ofroj asnjë ndihmë për dikë që po heziton midis dy “denominacioneve” të krishtera. Nuk do të mësoni prej meje nëse duhet të bëheni anglikanë, katolikë, metodistë apo presbiterianë. Kjo mungesë e ndihmës është e qëllimshme (madje dhe rendi i listës më lart është alfabetik). Pozita ime nuk është e fshehtë. Unë jam një besimtar shumë i zakonshëm i kishës anglikane; as veçanërisht “i lartë” as veçanërisht “i ulët”, as veçanërisht diçka tjetër. Por në këtë libër nuk po përpiqem të konvertoj njeri në pozitën time. Që kur u bëra i krishterë kam menduar se shërbimi më i mirë, e mbase i vetmi, që mund t’iu bëj fqinjëve të mi jobesimtarë, është t’iu shpjegoj dhe të mbroj besimin që kanë pasur zakonisht pothuajse gjithë të krishterët në të gjitha kohërat. E mendoj këtë për më shumë se një arsye. Në radhë të parë, çështjet që i ndajnë të krishterët nga njëri-tjetri përfshijnë shpesh pika të teologjisë së lartë apo edhe të historisë kishtare, të cilat nuk duhet të trajtohen përveçse nga ekspertë të vërtetë. Në ujëra të tilla unë nuk mund të notoj dot: kam më shumë nevojë për vete sesa mundësi t’i ndihmoj të tjerët. Dhe në radhë të dytë, mendoj se na duhet ta pranojmë që debati i këtyre pikave të diskutueshme nuk ka të ngjarë ta sjellë një të jashtëm brenda vathës së krishterimit. Ne, duke shkruar apo folur për to, kemi më shumë gjasa t’i pengojmë ata të hyjnë në cilëndo bashkësi të krishterë sesa t’i tërheqim në tonën. Ndasitë tona nuk duhet të diskutohen kurrë përveçse në praninë e atyre që tashmë kanë besuar se ka një Perëndi dhe se Jezu Krishti është Biri i Tij i vetëm. Dhe së fundmi, m’u krijua përshtypja që shumë më tepër shkrimtarë, shumë më tepër të talentuar se unë, tashmë ishin të përfshirë

në trajtimin e çështjeve të tilla të diskutueshme, në vend të mbrojtjes së asaj që Baxter-i e quan “thjesht” krishterim. Ajo vijë e frontit ku unë mendova se mund të shërbeja më mirë ishte edhe me më pak njerëz. Ndaj unë natyrshëm shkova aty.

Këto ishin motivet e mia të vetme, mesa mund të them unë, dhe do të isha shumë i gëzuar sikur njerëzit të mos nxirrnin nënkuptime të pabazuara nga heshtja ime për disa çështje të caktuara të diskutueshme.

Për shembull, kjo heshtje nuk do të thotë patjetër që unë nuk jam as këtej, as andej. Ndonjëherë jam. Ka çështje të diskutueshme midis të krishterëve për të cilat nuk mendoj se na është dhënë përgjigja. Ka disa për të cilat mund të mos e di kurrë përgjigjen: nëse i pyes ato, edhe në një botë më të mirë, mund të marr si përgjigje (ku i dihet) përgjigjen që mori një pyetës shumë më i madh: “Ty ç’të duhet? Ti më ndiq.”. Por ka pyetje të tjera për të cilat padyshim e kam një bindje, e megjithatë nuk i përmend. Sepse unë nuk po shkruaj për të shpjeguar diçka që mund ta quaj “feja ime”, por për të shpjeguar “thjesht” krishterimin, që është ai që është dhe ishte ai që ishte shumë kohë para se unë të lindja, më pëlqen apo jo mua.

Disa nxjerrin përfundime të pabaza nga fakti se nuk flas kurrë për Virgjëreshën e Bekuar Mari më tepër sesa ka të bëjë me Lindjen e Virgjër të Krishtit. Por a nuk është e dukshme arsyeja përse nuk e bëj këtë? Të folurit më shumë do të më çonte menjëherë në rajone tejet të diskutueshme. Dhe asnjë diskutim midis të krishterëve nuk duhet prekur me aq delikatesë sa ky. Besimi katolik mbi këtë çështje mbahet jo vetëm me zellin e zakonshëm që shoqëron çdo besim të sinqertë fetar, por (shumë natyrshëm) edhe me ndjeshmërinë e veçantë, dhe disi kalorësiake, që njeriu ndien kur rrezikohet

nderi i së ëmës apo i të dashurës. Është e vështirë të mos biesh dakord me ta për këtë çështje, pa u dukur maskara po aq sa edhe heretik. Dhe nga ana tjetër, besimet e kundërta protestante mbi këtë çështje nxiten nga ndjenja që burojnë nga vetë rrënjët e monoteizmit. Për protestantin radikal duket sikur rrezikohet dallimi midis Krijuesit dhe krijesës (sado e shenjtë të jetë): se po rikthehet politeizmi. Ndjë është e vështirë të diskutosh për këtë me ta dhe të mos dukesh më keq se heretik - idhujtar, pagan. Në ka temë që do ta shkatërronin një libër për “thjesht” krishterimin—në ka temë që do ta bënte krejt të padobishëm leximin e këtij libri për ata që ende nuk besojnë se biri i Virgjëreshës është Perëndi—padyshim që është kjo.

Dhe sado e çuditshme, nga heshtja ime për çështjet e diskutueshme nuk mundesh as të arrish në përfundimin nëse unë i mendoj ato si të rëndësishme apo të parëndësishme. Sepse kjo në vetvete është çështje debati. Një nga gjërat për të cilat të krishterët nuk bien dakord është për rëndësinë e mosmarrëveshjeve të tyre. Zakonisht, kur debatojnë dy të krishterë të denominacioneve të ndryshme, nuk zgjat shumë derisa njëri pyet nëse kjo apo ajo çështje është “vërtet e rëndësishme” dhe tjetri përgjigjet: “E rëndësishme? Përkundrazi, është absolutisht thelbësore”.

Të gjithë këtë e them për ta bërë të qartë se çfarë libri jam përpjekur të shkruaj; pa iu fshehur apo shmangur aspak përgjegjësisë për besimet e mia. Ato, siç edhe e thashë, nuk janë aspak të fshehta. Siç thotë xha Tobi: “Janë të shkruara në Librin e Lutjeve të Përbashkëta”.

Rreziku qartazi qëndronte në rastin se mos paraqisja si krishterim të përbashkët ndonjë gjë që është veçanti e kishës anglikane, apo (akoma më keq) e vetes sime. U përpoqa të

mbrohem nga kjo duke ua dërguar dorëshkrimin original të asaj që tani është Libri II katër klerikëve (anglikan, katolik, metodist, presbiterian) dhe u kërkova ta kritikonin. Metodisti mendonte se nuk kisha thënë sa duhet për Besimin dhe katoliku mendonte se e kisha tepruar me parëndësinë relative të teorive në shpjegimin e Shlyerjes. Përveç këtyre, për të tjerat të pestë ishim dakord. Librat e tjerë nuk i futa në këtë lloj “vetingu” ngaqë në ta, ndonëse mund të ketë ndryshime midis të krishterëve të ndryshëm, janë ndryshime që u përkasin individëve ose shkollave të mendimit, jo denominacioneve.

Për aq sa mund të gjykoj nga komentet dhe letrat e shumta që më janë shkruar, libri, sado i metë në aspektet e tjera, ia doli të paktën të paraqesë një krishterim të një mendjeje, të përbashkët ose qendror, ose “të thjeshtë”. Në këtë mënyrë bëhet e mundur hedhja poshtë e pikëpamjes, sipas të cilës heqja e çështjeve të diskutueshme lë vetëm një PMP (pjesëtuesi më i madh i përbashkët) të mjegullt e ngordhalaqe. Mirëpo PMP-ja na del të jetë diçka, jo vetëm e mirëqenë, por shumë e fortë; e ndarë nga çdo besim jo-i krishterë nga një humnerë aq e gjerë, sa i bën edhe ndarjet më të mëdha brenda krishterimit të duken si asgjë. Edhe nëse nuk e kam ndihmuar drejtpërsëdrejti çështjen e ribashkimit, e kam bërë mbase të qartë arsyen përse duhet të ribashkohemi. Padyshim që kam takuar pak vetë nga odium theologicum¹-i proverbial i anëtarëve të bindur të grupimeve teologjike ndryshe nga i imi. Armiqësia ka ardhur më shumë nga njerëz, që janë në periferi, si brenda edhe jashtë kishës anglikane,; që nuk i binden saktësisht asnjë grupimi teologjik. Për çudi, kjo më ngushëllon. Çdo grupim teologjik është vërtet më afër

1 Lat.: urrejtje teologjike. (shën. i përkth.)

me secilën prej të tjerëve, nëse jo në doktrinë, të paktën në frymë, në qendrën e tij, atje ku banojnë fëmijët e tij të vërtetë. Nga ky fakt kuptojmë që në qendër të secilit prej tyre qëndron diçka, ose Dikush, i cili flet me të njëjtin zë, përkundrejt gjithë dallimeve në besim, gjithë ndryshimeve në temperament, gjithë kujtimeve të përndjekjeve reciproke.

Kaq pra në lidhje me gjërat që mungojnë mbi doktrinën. Kam lënë në heshtje disa gjëra edhe në Librin III, ku trajtoj moralin; por për një arsye tjetër. Qëkur kam shërbyer si këmbësor në Luftën I Botërore, më kanë bezdisur gjithnjë ata që, duke qenë vetë të qetë e të sigurt, u dërgojnë inkurajime njerëzve në frontin e parë të luftës. Si pasojë e kësaj kam hezituar të flas për tundimet ndaj të cilave nuk jam i ekspozuar. Besoj se nuk ka njeri që të jetë i tunduar nga çdo mëkat. Rastisi pra që impulsi, i cili i shtyn njerëzit të luajnë bixhoz, nuk ka qenë pjesë e personalitetit tim; dhe këtë e paguaj me siguri duke mos patur pjesën e mirë të këtij impulsi, para se ai të teprohej apo të shthurej në këtë formë. Prandaj nuk u ndieva i kualifikuar për të dhënë këshilla për bixhozin e lejueshëm e të palejueshëm: nëse ka të lejueshëm, pasi nuk di as nëse mund të ketë të tillë. Gjithashtu nuk kam thënë asgjë në lidhje me kontrollin e lindjeve. Unë nuk jam as grua, as burrë i martuar, as prift. Mendoj se do të ishte e pavend prej meje të mbaja qëndrim të fortë për dhimbjet, rreziqet dhe shpenzimet prej të cilave unë vetë jam i mbrojtur; duke mos pasur një ofiq pastoral që do të m'i impononte këto.

Ka pasur ndjenja më të forta—të cilat edhe janë shprehur—kundër përdorimit prej meje të fjalës i krishterë për të përkufizuar dikë i cili i pranon doktrinat e përbashkëta të krishterimit. Njerëzit pyesin: “Kush je ti për të parashtruar se cili është dhe cili nuk është i krishterë?” ose “A nuk është

e mundur që shumë njerëz, të cilët nuk mund t'i besojnë këto doktrina, të jenë më shumë të krishterë të vërtetë, shumë më afër me shpirtin e Krishtit, sesa disa që i besojnë ato?”. Ky kundërshtim është në një kuptim të caktuar mjaft i drejtë, mjaft i dashur, mjaft shpirtëror, mjaft i ndjeshëm. Ka çdo cilësi të mundshme, përveç të qenit i dobishëm. Është e pamundur ta përdorim gjuhën e folur në mënyrën që duan këta kundërshtues, pa shkaktuar një katastrofë. Do të përpiqem ta bëj të qartë këtë duke treguar historinë e një fjale tjetër, shumë më pak të rëndësishme.

Fjala xhentëlmen ka pasur fillimisht një kuptim të qartë; dikush nga një familje fisnike që kishte një stemë familjare dhe disa prona. Kur e quaje dikë “xhentëlmen”, ti nuk i bëje kompliment, por thjesht po thoshe një fakt. Nëse thoshe se dikush nuk është “xhentëlmen”, nuk po e fyeje, thjesht po jepje informacion. Nuk kishte asnjë kontradiktë në të thënit se Gjoni është gënjeshtar dhe xhentëlmen; si të thuash sot se Jakobi është budalla dhe ka një diplomë masteri. Por më pas erdhën disa njerëz që thanë—me shumë të drejtë, me shumë dashuri, me shumë ideale, me shumë ndjeshmëri, me gjithçka përveç dobisë—“Ah, por a nuk është më me rëndësi për xhentëlmenin, jo familja fisnike dhe pronat, por sjellja? Patjetër që xhentëlmen i vërtetë është ai që sillet si i tillë? A nuk është Eduardi në këtë kuptim shumë më xhentëlmen sesa Gjoni?”. Dëshira e tyre ishte e mirë. Patjetër që të jesh i ndershëm, i sjellshëm dhe trim është diçka shumë më e mirë se të kesh një prejardhje fisnike. Por këto nuk janë e njëjta gjë. Ta quash dikë “xhentëlmen” në këtë kuptim të ri e të rafinuar, në fakt nuk jep asnjë informacion për të, por thjesht e lëvdon atë: ta mohosh që dikush është “xhentëlmen” bëhet thjesht një fyerje ndaj tij. Kur një fjalë resht së qeni një term

përshkrues dhe bëhet thjesht një term lavdërimi, ajo nuk të tregon më fakte për objektin; tregon vetëm qëndrimin e folësit ndaj këtij objekti. (Një vakt “i mirë” do të thotë thjesht që folësi e pëlqen atë.) Fjala xhentëlmen, pasi është bërë shpirtërore dhe e rafinuar përtej kuptimit të saj bazë, objektiv, ka kuptimin thjesht të diçkaje që folësi e pëlqen. Si pasojë, fjala xhentëlmen tani është e padobishme. Ne kishim terma për të bërë qejfin me bollëk, ndaj ajo nuk ishte e domosdoshme për këtë qëllim; nga ana tjetër, nëse dikush kërkon (për një punim historik, le të themi) ta përdorë atë në kuptimin e vjetër, ai e ka të pamundur ta bëjë këtë pa e shpjeguar. Sepse fjala e ka humbur tashmë atë kuptim.

Tani nëse i lejojmë njerëzit të fillojnë ta rafinojnë apo ta bëjnë shpirtërore apo ta “thellojnë”, siç do të thoshin ata, kuptimin e fjalës i krishterë, ajo pa humbur kohë do të bëhet një fjalë e padobishme. Në radhë të parë, vetë të krishterët do ta kenë të pamundur ta zbatojnë atë për dikë. Nuk na takon neve të themi se kush, në kuptimin më të thellë, është më afër apo jo me shpirtin e Krishtit. Ne nuk mund të shohim brenda zemrave të njerëzve. Ne nuk mund të gjykojmë, madje e kemi të ndaluar ta bëjmë këtë. Do të ishte një arrogancë dashakeqe të thoshe se dikush është, apo nuk është i krishterë në këtë kuptim të rafinuar. Dhe pa diskutim që një fjalë të cilën nuk mund ta zbatojmë kurrë nuk mund të jetë një fjalë aq e dobishme. Përsa u përket jobesimtarëve, padyshim që ata do ta përdorin tërë qejf fjalën në kuptimin e rafinuar. Në gojët e tyre ai do të bëhet thjesht një term lavdërimi. Duke e quajtur dikë të krishterë, ata do ta mendojnë atë një njeri të mirë. Por kjo mënyrë e të përdorurit të fjalës nuk e pasuron në asnjë mënyrë fjalorin, pasi ne tashmë e kemi fjalën i mirë. Ndërsa fjala i krishterë do të jetë prishur përsa i përket qëllimit

shumë të dobishëm që mund t'i shërbente.

Prandaj na duhet t'i qëndrojmë kuptimit fillestar e të dukshëm. Termi të krishterë u përdor për herë të parë në Antioki (Veprat 11:26) për “dishepujt”, ata të cilët e kishin pranuar mësimin e apostujve. Nuk ka kufizime vetëm për ata që përfituan nga këto mësimë maksimalisht. Nuk ka liri për të përfshirë ata që ishin, në ndonjë formë të rafinuar, shpirtërore apo të brendshme “shumë më afër shpirtit të Krishtit” sesa më i dobëti nga dishepujt. Çështja nuk është as teologjike, as morale. Është thjesht çështje e përdorimit të fjalëve në mënyrë që të gjithë të dimë se çfarë po thuhet. Kur dikush e pranon doktrinën e krishterë, por jeton si i padenjë për të, është shumë më e qartë të thuash se ai është një i krishterë i keq sesa të thuash se nuk është i krishterë.

Shpresoj se asnjë lexues nuk do të gabojë duke menduar se “thjesht” krishterimi paraqitet këtu si një alternativë ndaj kredove të grupimeve teologjike ekzistuese—sikur dikush ta preferonte atë përkundrejt kishës Kongregacionale ose asaj Orthodhokse apo çfarëdo gjëje tjetër. Ai i ngjan më shumë një korridorit dyert e të cilit të çojnë në dhoma të ndryshme. Nëse mund ta sjell dikë brenda këtij korridorit, e kam realizuar qëllimin tim. Por zjarri, karriget dhe ushqimi janë nëpër dhoma, jo në korridor. Korridorit është vend pritjeje, vend nga ku provojmë dyer të ndryshme, jo një vend për të jetuar. Për këtë qëllim, edhe më e keqja ndër dhomat (cilado qoftë ajo) do të ishte më e mirë, për mendimin tim. Është e vërtetë që disa njerëzve u duhet të presin për njëfarë kohe të gjatë në korridor, ndërsa të tjerë e dinë pothuajse menjëherë se në cilën derë duhet të trokasin. Nuk e di përse ndodh ky ndryshim, por jam i sigurt që Perëndia nuk lë njeri në pritje, nëse Ai nuk mendon që pritja është më e mira për të. Kur

arrin të hysh më në fund, kupton që pritja e gjatë të ka bërë një të mirë që nuk do të mund ta kishe në të kundërt. Por duhet ta cilësosh si pritje, jo si kamping. Duhet të vazhdosh të lutesh për dritë: dhe duhet sigurisht të përpiqesh t'u bindesh rregullave të përbashkëta të të gjithë shtëpisë. E mbi të gjitha duhet të pyesësh se cila derë është e sakta; jo cila të kënaq më shumë me ngjyrën dhe veshjet anësore. Për ta thënë troç, pyetja nuk duhet të jetë asnjëherë: “A më pëlqen shërbesa e këtij lloji?”, por “A janë këto doktrina të vërteta: A ka shenjtëri këtu? A po më shtyn ndërgjegjja në këtë drejtim? A po hezitoj të trokas nga krenaria, apo nga shijet e mia personale, apo nga mospëlqimi personal i rojës së derës?”

Pasi të kesh arritur në dhomën tënde, ji i sjellshëm me ata që kanë zgjedhur dyer të ndryshme dhe me ata që janë ende në korridor. Nëse janë në gabim, kanë akoma më shumë nevojë për lutjet e tua; dhe nëse janë armiq të tu, atëherë ti je i urdhëruar të lutesh për ta. Ky është një nga rregullat e përgjithshme për të gjithë shtëpinë.

PARAFJALË

Këtë libër lipset ta shohësh në kontekstin historik si një akt i guximshëm rrëfimi dhe shërimi në një botë të luajtur mendsh. Më 1942, vetëm njëzet e katër vjet pas përfundimit të një lufte të përgjakshme që rrënoi një brez të tërë të rinisë së saj, Britania e Madhe ishte sërish në luftë. Tanimë ishin qytetarët e zakonshëm që vuanin, teksa vendi i tyre i vogël ishullor bombardohej nga katërqind avionë përnatë, në “blitz”-in famëkeq që i ndryshoi fytyrën luftës, duke i kthyer civilët dhe qytetet e tyre në fushëbeteja.

Kur ishte djalosh i ri, C. S. Lewis-i shërbeu në aradhet e tmerrshme të Luftës I Botërore dhe, më 1940, kur nisi bombardimi i Britanisë, ai mori përsipër detyrën e kujdestarit ndaj sulmeve ajrore dhe u foli njerëzve në Forcat Ajrore Mbretërore të Britanisë, të cilët e dinin se, pas vetëm trembëdhjetë misionesh bombardimi, shumica prej tyre do të shpalleshin të vdekur ose të humbur. Situata e tyre e shtyu Lewis-in të fliste për problemet e vuajtjes, dhimbjes dhe të së keqes, punë e cila çoi në ftesën që stacioni i radios BBC i bëri për të folur disa herë gjatë kohës së luftës mbi besimin e krishterë. Këto fjalime, të transmetuara në radio nga viti 1942 deri më 1944, dalëngadalë u përmbledhën në librin që sot e njohim si Thjesht krishterim.

Domethënë ky libër nuk konsiston në mendime filozofike akademike. Përkundrazi, është një vepër letërsie gojore,

drejtuar njerëzve që ishin në luftë. Sa e habitshme duhet t'u ishte dukur të hapnin radion, e cila çdo ditë u lajmëronte për vdekje dhe shkatërrime të pakrahasueshme, për të dëgjuar dikë duke folur me një ton hulumtues, inteligjent dhe me humor të mirë për sjelljen e denjësishme dhe humane, për drejtësinë dhe rëndësinë e njohjes të së drejtës dhe të gabuarës. I lutur nga BBC-ja t'u shpjegonte britanikëve të tjerë se çfarë besojnë të krishterët, C. S. Lewis-i e kreu këtë detyrë sikur të ishte gjëja më e thjeshtë në botë, dhe gjithashtu më e rëndësishmja.

Na mbetet veçse të mahnitemi me metaforat që e prekën aq thellë auditorin fillestar të librit; imazhe të botës sonë si territor i pushuar prej armikut, i pushtuar nga ligësi të mëdha të vendosura për të shkatërruar gjithçka që është e mirë, të cilat janë ende të vlefshme sot. Gjithë nocionet tona për modernizëm dhe përparim e gjithë arritjet tona në ekspertizën teknologjike nuk kanë bërë gjë për t'i dhënë fund luftës. Dhe përgjigjet e thjeshta: fajësimi i teknologjisë, apo edhe i feve të botës, nuk e kanë zgjidhur problemin. Problemi, këmbëngul C. S. Lewis, jemi ne. Dhe brezi i poshtër dhe i shthurur, për të cilin folën psalmistët dhe profetët mijëra vjet më parë, është i ynë në çdo çast që u nënshtrohemi ligësive sistematike dhe individuale, sikur kjo të ishte e vetmja alternativë që kemi.

C. S. Lewis-i, dikur i përshkruar nga një mik si njeri i dashuruar me imagjinatën, besonte se pranimi i heshtur i status quo-së tregon më tepër sesa thjesht që nuk jemi nevrikë. Në Thjesht krishterim, po aq sa në veprat e tij fantastike, historitë e Narnias dhe romanet fantastiko-shkencorë, Lewis-i zbulon një besim të thellë në fuqinë e imagjinatës së njeriut për të shpalosur të vërtetën e gjendjes sonë dhe për të na dhënë shpresë. "Rruga më e gjatë është ajo që të çon

në shtëpi më shpejt” është logjika si e fabulës edhe e besimit.

Duke folur pa asnjë autoritet tjetër veç eksperiencës së tij, si anëtar i thjeshtë i kishës dhe ish-ateist, C. S. Lewis-i i tha auditorit të tij në radio se ishte përzgjedhur për detyrën e përshkrimit të krishterimit për një brez të ri, pikërisht ngaqë nuk ishte një specialist por “një amator. . . një fillestar, jo një dorë e vjetër”. Miqve të tij u tha se e kishte pranuar detyrën pasi besonte se Anglia, e cila e konsideronte veten pjesë të një bote “post-kristiane”, në fakt nuk e kishte mësuar asnjëherë në terma bazë se për çfarë bën fjalë kjo fe. Ashtu si Søren Kierkegaard-i para tij dhe bashkëkohësi i tij Dietrich Bonhoeffer, Lewis-i kërkon të na ndihmojë përmes librit Thjesht krishterim ta shohim këtë fe me sy të freskët, si një besim radikal, ndjekësit e të cilit i përngjajnë një mbledhjeje nëntokë të një grupi në zonën e luftës, në një vend ku duket sikur e keqja po triumfon; që të dëgjojmë mesazhin e shpresës nga ana tjetër.

Krishterimi “i thjeshtë” i C.S.Lewis-it nuk është një filozofi, madje as një teologji, që mund të shqyrtohet, diskutohet dhe vendoset diku në një raft. Ai është një mënyrë jete, i cili na sfidon të kujtojmë gjithnjë që, siç tha dikur Lewis-i, “nuk ka njerëz të zakonshëm”, që “me të pavdekshëm ne bëjmë shaka, punojmë, martohe mi, mohojmë dhe shfrytëzojmë”. Sapo intonohemi me këtë realitet, Lewis-i beson se ne bëhemi të hapur për ta shndërruar jetën tonë në mënyrë aq kreative sa ligësia zbehet dhe e mira ngadhënjën. Këtë na kërkoi Krishti duke u veshur me njerëzimin tonë, duke shenjtëruar mishin tonë, duke na kërkuar nga ana tjetër t’ia shfaqim Perëndinë njëri-tjetrit.

Nëse bota e bën këtë detyrë të duket e pashpresë, Lewis-i këmbëngul që ajo nuk është e tillë. Edhe dikush, që ai i

PARAFJALË

jep pamjen “i helmuar nga një rritje e keqe në një shtëpi xhelozish vulgare dhe sherresh pa kuptim”, mund të jetë i sigurt se Perëndia e di mjaft mirë se “ç’mjet të shkatërruar po përpiqesh të vozitësh”, duke të thënë vetëm “vazhdo, bëj ç’të mundesh”. Krishterimi i ndjekur prej Lewis-it është human, por jo i lehtë: ai na kërkon ta pranojmë se lufta e madhe fetare nuk luftohet në një fushëbetejë spektakolare, por në zemrën e zakonshme njerëzore, në çdo mëngjes kur zgjohemi dhe ndiejmë presionet e ditës të na përmbysin dhe na duhet të vendosim se çfarë lloj të pavdekshmish duam të jemi. Mbase ai na ndihmon, siç ndihmoi me siguri britanikët e lodhur nga lufta që i dëgjuan fillimisht këto fjalime, të kujtojmë që Perëndia tallet me të madhe me ata që kërkojnë pushtetin me çdo kusht. Siç na kujton Lewis-i me humorin dhe mprehtësinë e tij karakteristike: “Sa të ngjashëm deri në monotoni janë të gjithë tiranët dhe pushtuesit e mëdhenj: sa lavdishëm dallojnë shenjtoret.”

Kathleen Norris

**THJESHT
KRISHTERIM**

LIBRI NJË

**E DREJTA DHE E GABUARA
SI ÇELËSI PËR TË KUPTUAR
GJITHËSINË**

LIGJI I NATYRËS NJERËZORE

Të gjithë i kanë dëgjuar njerëzit duke u zënë. Disa herë duket qesharake dhe disa herë thjesht e pakëndshme. Por, sido që të tingëllojë, unë besoj se mund të mësojmë diçka mjaft të rëndësishme duke dëgjuar me kujdes se çfarë thonë ata që zihen. Ata thonë gjëra të tilla si: “Po ti si do të ndiheshe nëse do të ta bënin ty kështu?”—“Ai është vendi im, unë u ula i pari”—“Lëre të qetë, ai nuk po të bënte asgjë”—“Përse duhet të futesh ti i pari”—“Jepmë pak nga portokalli yt, unë të dhashë nga i imi”—“Hë pra, ti më premtove”. Njerëzit thonë gjëra të tilla çdo ditë; njerëzit e arsimuar si edhe të paarsimuar, fëmijët si edhe të rriturit.

Ajo çka më duket interesante për të gjitha këto pohime është se, njeriu që i bën ato, nuk thotë thjesht se sjellja e tjetrit rastisi të mos i pëlqejë në këtë rast. Ai po i apelohet një standardi të sjelljes, të cilin pret që edhe tjetri ta njohë mirë. Dhe rrallëherë tjetri përgjigjet: “Në djall vaftë standardi yt”. Gati gjithmonë, ai përpiket të tregojë se në fakt veprimi i tij nuk bie ndesh me standardin, ose në rast se bie ndesh, ka një justifikim të veçantë për këtë. Ai ka pretendimin që ekziston një arsye e veçantë në këtë rast se pse personi që u ul i pari duhet të ngrihet, apo se gjërat ishin ndryshe kur atij

iu dha fillimisht nga portokalli, apo se diçka ka ndodhur që e ka liruar atë nga detyrimi për të mbajtur premtimin. Duket, dhe qartazi madje, sikur të dyja palët kanë rënë dakord për një lloj Ligji apo Rregulli për *fair play* ose sjellje të drejtë ose morale, apo sido që kërkon ta quash. Dhe vërtet kanë rënë dakord. Po të mos kishin rënë dakord, do të mund të luftonin pa problem si kafshët, por nuk do të ishin në gjendje të *grindeshin*, në kuptimin njerëzor të fjalës. Grindja është një përpjekje për të treguar që personi tjetër e ka gabim. Dhe do të ishte pa kuptim të përpiqeshe ta bëje këtë, nëse nuk ka njëfarë dakordësie se çfarë është e Drejtë dhe e Gabuar; ashtu siç do të ishte pa kuptim të thoshe se një futbollist bëri faull, nëse nuk do të kishte një dakordësi për rregullat e futbollit.

Tani ky Ligj apo Rregull për të Drejtën dhe të Gabuarën quhej dikur Ligji i Natyrës. Në ditët e sotme, kur flasim për “ligjet e natyrës”, zakonisht e kemi fjalën për gjëra si graviteti apo gjenetika apo ligjet e kimisë. Por, kur mendimtarët e vjetër e quanin Ligjin e së Drejtës dhe të Gabuarës “Ligji i Natyrës”, në të vërtetë po nënkuptonin Ligji i Natyrës Njerëzore. Ideja qëndronte këtu: ashtu si të gjithë trupat qeverisen nga ligji i gravitetit dhe organizmat nga ligjet biologjike, kështu edhe krijesa e quajtur njeri kishte ligjin e tij—me një ndryshim të madh: që trupi nuk mund të zgjedhë nëse do t’i bindet ligjit të gravitetit apo jo, kurse njeriu mund të zgjedhë t’i bindet Ligjit të Natyrës Njerëzore, ose të mos i bindet atij.

Mund ta themi edhe në një mënyrë tjetër. Çdo njeri është në çdo çast duke iu nënshtruar një sërë ligjesh të ndryshme, por vetëm njërit prej tyre ai është i lirë të mos i bindet. Si trup, ai i nënshtrohet gravitetit dhe nuk mund të mos i bindet; nëse e lë të pambështetur në ajër, ai nuk mund të zgjedhë të bjerë apo jo, më shumë sesa mund të zgjedhë një gur. Si organizëm,

LIGJI I NATYRËS NJERËZORE

ai u nënshtrohet ligjeve të ndryshme biologjike që nuk mund të mos u bindet, më shumë sesa një kafshë. Pra, ai nuk mund të mos u bindet atyre ligjeve që i ka të përbashkët me gjërat e tjera, por ligjit që është i veçantë për natyrën e tij njerëzore, ligjit që ai nuk e ndan me kafshët apo perimet apo gjërat inorganike, ai mund të zgjedhë të mos i bindet.

Quhej Ligji i Natyrës, pasi njerëzit mendonin se të gjithë e dinin atë nga natyra dhe nuk kishin nevojë t'iu mësohej. Sigurisht, nuk po thoshin se s'mund të gjendej asnjë individ diku i cili nuk e dinte; siç mund të gjenden disa njerëz që janë daltonikë ose pa vesh për muzikë. Por, duke marrë racën njerëzore në tërësi, ata mendonin se ideja e njeriut mbi sjelljen e duhur ishte e qartë për të gjithë. Dhe unë besoj se kishin të drejtë. Po të mos kishin të drejtë, gjithçka që kemi thënë për luftën do të ishin e pakuptimtë. Çfarë kuptimi do të kishte të thoshim se armiku e kishte gabim, nëse e Drejta nuk do të ishte diçka reale, diçka të cilën nazistët thellë-thellë e njihnin po aq mirë sa ne dhe duhej ta kishin praktikuar? Nëse nuk do të kishin as idenë më të vogël të asaj që ne e cilësojmë si të drejtë, edhe pse do të na duhej t'i luftonim prapëseprapë, nuk do të mund t'i fajësonim ata për këtë gjë më shumë sesa për ngjyrën e tyre të flokëve.

E di që disa thonë se ideja e një Ligji të Natyrës apo e sjelljes së duhur të njohur nga të gjithë njerëzit, është pa themel, pasi qytetërime dhe epoka të ndryshme kanë pasur morale mjaft të ndryshme.

Por kjo nuk është e vërtetë. Ka pasur dallime midis moraleve të tyre, por ato dallime as nuk i janë afruar një ndryshimi total. Nëse dikush do të merrte mundimin të krahasonte mësimet morale të, le të themi, egjiptianëve, babilonasve, indianëve, kinezëve, grekëve dhe romakëve të

lashtë, do të dalë në pah se sa të ngjashme në fakt janë ato me njëra-tjetrën, si dhe me tonën. Një pjesë të provave për këtë e kam vendosur si shtojcë në një libër tjetër, të quajtur “The Abolition of Man” (*Rënia e njeriut*); por për qëllimin tonë aktual më duhet thjesht t’i kërkoj lexuesit të mendojë se çfarë pamje ka një moral totalisht ndryshe. Mendo për një komb ku njerëzit admiroheshin që e braktisnin betejën, apo ku dikush ndihet krenar se mashtroi njerëzit që e trajtuan më mirë se kushdo. Është njësoj si të imagjinosh një komb ku dy dhe dy bëjnë pesë. Njerëzit kanë pasur mendime të ndryshme për gjërat që duhet të jesh vetëmohues—nëse është vetëm për familjen tënde, apo për bashkëkombësit e tu, apo për të gjithë. Por ata gjithnjë kanë rënë dakord se nuk duhet ta vendosësh veten të parin. Egoizmi kurrë nuk është admiruar. Njerëzit nuk kanë rënë dakord nëse duhet të kesh një grua apo katër. Por gjithnjë kanë rënë dakord që nuk mund thjesht të kesh çdo grua që të pëlqen.

Por gjëja më e mahnitshme është kjo. Sa herë që dikush thotë se nuk beson vërtet në të Drejtën dhe të Gabuarën, i njëjti person do ta gjejë veten duke iu referuar asaj një çast më pas. Ai mund të ta shkelë premtimin ty, por nëse ti përpiqesh t’ia shkelësh atij, ai do të ankohej: “Nuk është e drejtë!” sa të hapësh e të mbyllësh sytë. Një komb mund të thotë që traktatet janë të parëndësishme; por, një minutë më vonë, i njëjti komb e hedh poshtë argumentin e tij duke thënë se traktati i caktuar që ata duan të shkelin ishte i padrejtë. Por, nëse traktatet nuk kanë rëndësi, dhe nëse nuk ka diçka të tillë si e Drejta dhe e Gabuara—me fjalë të tjera, nëse nuk ka një Ligj të Natyrës—çfarë ndryshimi ka midis një traktati të drejtë dhe një të padrejtë? A nuk i kanë nxjerrë tashmë të palarat duke treguar që, çfarëdo që të thonë, edhe ata e

njohin vërtet Ligjin e Natyrës si gjithë të tjerët?

Pra qenkemi të detyruar të besojmë në një të Drejtë dhe të Gabuar. Njerëzit mund të gabohen hera-herës për to, ashtu siç njerëzit hera-herës gabohen në mbledhjen e numrave; por ato nuk janë thjesht çështje shijesh apo opiniononi personal më shumë sesa është e tillë tabela e shumëzimit. Tani, nëse biem dakord për këtë, unë mund të vazhdoj në pikën time të radhës, që është kjo: asnjë nga ne nuk e mban vërtet Ligjin e Natyrës. Nëse ka ndonjë përjashtim midis jush, atyre ju kërkoj ndjesë. Ata më mirë të lexojnë ndonjë libër tjetër, pasi asgjë nga ato që do të them nuk ka të bëjë me ta. Dhe tani, drejtuar qenieve njerëzore të zakonshme që kanë mbetur:

Shpresoj të mos e keqkuptoni atë që po them. Unë nuk po bëj moral, dhe një Zot e di se nuk po pretendoj që jam më i mirë se ndonjë tjetër. Thjesht po përpiqem të vë në dukje një fakt: faktin që këtë vit, ose këtë muaj, ose me shumë gjasë, pikërisht sot, ne vetë nuk e kemi zbatuar sjelljen që presim prej të tjerëve. Mund të gjejmë gjithfarësoj justifikimesh nga më të ndryshmet. Çasti kur u tregove i padrejtë ndaj fëmijëve ndodhi kur ishe tepër i lodhur. Ajo puna disi e dyshimtë me paratë—të cilën pothuajse e kishe harruar—ndodhi kur kishe probleme të mëdha financiare. Dhe ajo që premtove të bëje për të gjorin Filan Fistëk, por nuk e bërë—epo, sikur ta dije sa tmerrësisht i zënë do të ishe, nuk do t'i kishe premtuar kurrë. Dhe sa për sjelljen tënde ndaj gruas (ose burrit) ose motrës (ose vëllait), po ta dija sa acarues janë, nuk do të habitesh—dhe kush dreqin jam unë, gjithsesi? Edhe unë jam njësoj. Domethënë, unë nuk ia dal dot ta zbatoj Ligjin e Natyrës aq mirë dhe, në çastin që dikush më thotë se nuk po e mbaj, në mendjen time fillon një varg justifikimesh i gjatë sa krahu yt. Pyetja në këtë çast nuk është nëse justifikimet janë të mira apo

THJESHT KRISHTËRIM

jo. Ideja është që ato vetë janë thjesht një provë më tepër se sa thellësisht e besojmë Ligjin e Natyrës, na pëlqen apo jo. Nëse nuk besojmë në sjellje të duhur, përse vihem i kaq në ankth për të nxjerrë justifikime për sjelljen jo të duhur? E vërteta është se ne besojmë kaq shumë në të duhurën—e ndiejmë kaq shumë peshën e Sundimit të Ligjit—sa që nuk mund ta përballojmë faktin që e kemi shkelur dhe, rrjedhimisht, përpiqemi ta kalojmë përgjegjësinë tjetërkund. Ju e vini re se gjithë këto shpjegime ne i gjejmë vetëm për sjelljen e keqe. Vetëm për sjelljen e keqe ne përpiqemi të themi shkaqet, si të qenit i lodhur apo i shqetësuar apo i uritur; shkaku i sjelljes së mirë jemi ne vetë.

Këto pra janë dy pikat që doja të nxirrja. E para, që qeniet njerëzore në gjithë rruzullin tokësor, kanë çuditërisht idenë se duhet të sillen në një mënyrë të caktuar, dhe nuk mund ta heqin qafe atë. E dyta, që ata në fakt nuk sillen në atë mënyrë. Ata e njohin Ligjin e Natyrës; ata e shkelin atë. Këto dy fakte janë themeli i çdo mendimi të kthjellët për veten tonë dhe universin ku jetojmë.

DISA KUNDËRSHTIME

Nëse këto fakte janë themeli, bëj mirë t'i përforcoj ato përpara se të vazhdoj më tej. Më kanë mbërritur letra nga një numër i madh njerëzish që, si duket, e kanë të vështirë ta kuptojnë se çfarë thotë saktësisht ky Ligj i Natyrës Njerëzore, apo Ligj Moral, apo Rregull i Sjelljes së Duhur.

Për shembull, disa njerëz më shkruajnë duke thënë: “A nuk është ajo, që ti e quan Ligji Moral, thjesht instinkti ynë i tufës, dhe a nuk është zhvilluar ai njëloj si instinktet tona të tjera?”. Tani, nuk e mohoj që ne mund të kemi një instinkt tufe: por kur flas për Ligjin Moral nuk e kam fjalën për të. Ne të gjithë e dimë se si është të jesh i shtyrë nga një instinkt—nga dashuria e nënës, nga instinkti seksual, nga instinkti për ushqim. Kuptimi i tij është të ndiesh një dëshirë ose nevojë të fortë për të vepruar në një mënyrë të caktuar. Dhe sigurisht që ne ndiejmë ndonjëherë një dëshirë të tillë për të ndihmuar një person tjetër: dhe padyshim që kjo dëshirë vjen nga instinkti i tufës. Le të themi se dëgjon një thirrje për ndihmë nga një njeri në rrezik. Ti me siguri do të ndiesh dy dëshira—një dëshirë për të ndihmuar (për shkak të instinktit të tufës) dhe një tjetër për të qëndruar larg rrezikut (për shkak të instinktit për të mbrojtur veten). Por, përveç këtyre dy impulseve, brenda teje do të gjesh

diçka të tretë që të thotë se duhet të ndjekësh impulsin për të ndihmuar dhe të shtypësh atë për të ndenjur larg. Tani, kjo gjë e cila gjykon midis dy instinkteve, që vendos se cili duhet inkurajuar, nuk mund të jetë vetë një i tillë. Është si të thuash se fleta muzikore, e cila të tregon se cilën notë muzikore duhet të luash në piano në një çast të caktuar, është vetë një nga notat në tastierë. Ligji Moral na tregon tingullin që duhet të luajmë: instinktet tona janë thjesht tastat e pianos.

Një tjetër mënyrë për të parë se Ligji Moral nuk është thjesht një instinkt i yni është kjo. Nëse dy instinkte janë në konflikt dhe krijesa nuk ka asgjë tjetër në mendje përveç atyre dy instinkteve, sigurisht që më i forti prej tyre duhet të fitojë. Por, në çastet që jemi më të ndërgjegjshëm për Ligjin Moral, ai zakonisht na thotë të ndjekim më të dobëtin e dy impulseve. Ti me siguri që *do më shumë* të jesh i sigurt, sesa të ndihmosh atë që po mbytet: por Ligji Moral të kërkon që ta ndihmosh gjithsesi. Dhe a nuk na shtyn ai që ta bëjmë më të fortë nga sa është natyrshëm impulsin e duhur? Dua të them, shpesh ne e ndiejmë si detyrë ta stimulojmë instinktin e tufës, duke zgjuar imagjinatat dhe duke ngacmuar mëshirën tonë, e kështu me radhë, për të marrë më shumë fuqi që të bëjmë gjënë e duhur. Por është e qartë që nuk veprojmë *nga* instinkti, kur nisemi për ta bërë një instinkt më të fortë sesa është. Gjëja që të thotë ty: “Instinkti i tufës është në gjumë, zgjoje.” nuk mund të jetë në vetvete instinkti i tufës. Gjëja, që të thotë se njëra nga notat e pianos duhet luajtur më fort, nuk mund të jetë vetë ajo notë.

Ja dhe një mënyrë e tretë për ta parë këtë. Nëse Ligji Moral do të ishte një nga instinktet tona, ne do të duhej të ishim në gjendje t'i drejtoheshim një impulsi brenda nesh i cili do

të ishte gjithnjë “i mirë”, gjithnjë në përputhje me rregullin e sjelljes së drejtë. Por nuk jemi. Ligji Moral mund të na kërkojë të shtypim cilindo impuls tonin qoftë, dhe mund të na thotë ta nxitim cilindo prej tyre. Është gabim të mendosh se disa nga impulset tona—si për shembull dashuria e nënës apo patriotizmi—janë të mira kurse të tjera, si seksi apo instinkti për të luftuar, janë të këqija. Ajo që duam të themi vërtet kur flasim për to është se rastet kur instinkti për të luftuar apo ai i dëshirës seksuale duhen përmbajtur, janë më të shpeshta sesa rastet kur duhen përmbajtur dashuria e nënës apo patriotizmi. Por ka situata në të cilat burri i martuar e ka për detyrë të inkurajojë impulsin e tij seksual dhe një ushtar impulsin e tij për të luftuar. Ka edhe raste kur dashuria e nënës për fëmijët e saj apo e një burri për kombin e tij duhet të shtypen, në të kundërt do të çojnë në padrejtësi ndaj fëmijëve apo kombeve të tjerë. Për ta thënë rreptësisht, nuk ka diçka të tillë si një impuls i mirë apo i keq. Kujtoni sërish pianon. Ajo nuk ka dy lloje notash, të sakta dhe të gabuarat. Çdo notë është e saktë në një çast dhe e gabuar në një tjetër. Ligji Moral nuk është as instinkt as një sërë instinktesh: është diçka që krijon një lloj melodie (atë që ne e quajmë sjellje të mirë dhe të drejtë) duke i drejtuar instinktët tona.

Ky fakt ka pasoja të rëndësishme praktike, meqë ra fjala. Gjëja më e rrezikshme që mund të bësh, është të marrësh cilindo prej impulseve të natyrës sate dhe ta bësh atë gjënë që duhet ndjekur me çdo kusht. Ndjekja e cilitdo në këtë mënyrë do të na shndërronte në djaj, po ta bënim qëllim absolut. Ti mund të mendosh se dashuria për njerëzimin në përgjithësi është e sigurt, por nuk është ashtu. Nëse lë jashtë drejtësinë, do ta gjesh veten “për hir të njerëzimit” duke

shkelur marrëveshje dhe duke falsifikuar prova në gjyqe dhe do të përfundoje një njeri mizor dhe tradhtar.

Njerëz të tjerë më kanë shkruar, duke thënë: “A nuk është ajo, që ti e quan Ligj Moral, thjesht një marrëveshje sociale, diçka që na është vendosur me anë të arsimit?”. Mendoj se këtu ka një keqkuptim. Njerëzit që e bëjnë këtë pyetje po e marrin të mirëqenë se, nëse diçka e kemi mësuar nga prindërit apo mësuesit, atëherë ajo gjë duhet të jetë thjesht një shpikje njerëzore. Por sigurisht që nuk është e vërtetë. Ne të gjithë e mësojmë tabelën e shumëzimit në shkollë. Një fëmijë që rritet i vetëm në një ishull të braktisur nuk do ta dinte. Por sigurisht që kjo nuk do të thotë se tabela e shumëzimit është thjesht një marrëveshje njerëzore, diçka që njerëzit e kanë krijuar për vete dhe që mund ta bënin ndryshe po të dëshironin. Jam plotësisht dakord që ne e mësojmë rregullin e sjelljes së duhur nga prindërit dhe mësuesit dhe miqtë dhe librat, siç e mësojmë gjithçka tjetër. Por vetëm disa nga gjërat që mësojmë janë thjesht marrëveshje, të cilat mund të ishin ndryshe—ne mësojmë të ecim në të majtë të rrugës, ndërkohë që fare mirë rregulli mund të ishte që të mbanim krahun e djathtë—kurse disa të tjera, si matematika, janë të vërteta reale. Pyetja është se cilës klase i përket Ligji i Natyrës Njerëzore.

Ka dy arsye për të thënë se i përket të njëjtës klasë me matematikën. E para, siç thashë në kapitullin e parë, megjithëse ka dallime midis ideve morale të kohëve dhe vendeve të ndryshme, dallimet nuk janë aq të mëdha—assesit aq sa mendojnë shumica e njerëzve—dhe është lehtësisht e dallueshme që në to rrjedh i njëjti ligj. Kurse marrëveshjet e thjeshta, si rregulli i qarkullimit apo veshjet e njerëzve, mund të ndryshojnë pa kufizime. Arsyeja tjetër

është kjo. Kur mendon për dallimet midis moralit të një populli me një tjetër, a mendon se morali i njërit është më i mirë apo më i keq se i tjetrit? A kanë qenë disa nga ndryshimet përmirësime? Progresi nuk është thjesht ndryshim, por ndryshim për mirë. Nëse një set i caktuar idesh morale nuk do të ishte më i vërtetë apo më i mirë se një tjetër, do të ishte pa kuptim ta preferojë moralin e qytetëruar kundrejt atij primitiv, apo moralin e krishterë kundrejt atij nazist. Ne faktikisht besojmë pa diskutim se disa morale janë më të mirë se të tjerët. Ne besojmë se disa nga njerëzit që u përpoqën të ndryshonin idetë morale të kohës së tyre, cilësohen reformatorë dhe pionierë—njerëz që e kuptuan moralin më mirë se fqinjët e tyre. Shumë mirë pra. Sapo thua se një sërë idesh morale mund të jetë më i mirë se një tjetër, ti në fakt je duke i matur ata të dy në bazë të një standardi, duke thënë se njëri prej tyre përputhet më shumë me këtë standard sesa tjetri. Por standardi, me të cilin maten dy gjëra, është diçka ndryshe nga secila prej tyre. Ti në fakt je duke i krahasuar ato me një Moral të Vërtetë, duke pranuar se ka diçka të tillë si e Drejta e vërtetë, e pavarur nga ajo që mendojnë njerëzit, dhe se disa nga idetë e njerëzve i afrohen më shumë Asaj se të tjerat. Ose le ta themi kështu. Nëse idetë e tua morale mund të jenë më të vërteta, kurse ato të nazistëve më pak të vërteta, duhet të ketë diçka ndaj të cilit ato të jenë më të vërteta ose më pak të vërteta—një moral të vërtetë. Arsyeja pse ideja jote e Nju Jorkut mund të jetë më shumë ose më pak e vërtetë se e imja, është se Nju Jorku është një vend real, i cili ekziston pavarësisht asaj që mendon secili prej nesh. Nëse fjalët “Nju Jork” do të kishin thjesht kuptimin “qyteti që po imagjinoj unë në kokën time”, si do të mundej njëri prej

nesh të kishte ide më të vërteta se tjetri për të? Diskutimi për të vërtetën apo të rremen do të ishte i pamundur. Në të njëjtën mënyrë, nëse Rregulli i Sjelljes së Drejtë do të kishte kuptimin thjesht “ajo gjë që secili komb rastisi të miratojë”, do të ishte e pakuptimtë të thoshe se njëri komb ishte më korrekt në miratimin e tij sesa një tjetër; do të ishte e pakuptimtë të thoshe se bota mund të bëhet moralisht më mirë apo më keq.

Kështu pra, unë po e përmbyll duke thënë që, megjithëse dallimi midis ideve të njerëzve për sjelljen e duhur shpesh të bën të dyshosh se nuk ka Ligj të vërtetë dhe natyral të Sjelljes, gjërat që jemi të detyruar të mendojmë për këto dallime, vërtetojnë pikërisht të kundërtën. Por edhe diçka e fundit përpara se ta mbyll. Kam takuar njerëz që i ekzagjerojnë këto dallime, për shkak se nuk e kanë kuptuar dallimin midis besimeve të ndryshme në lidhje me faktet. Për shembull, një burrë më tha: “Treqind vjet më parë, njerëzit në Angli po i dënonin shtrigat me vdekje. A ishte kjo ajo, që ti e quan Ligji i Natyrës Njerëzore apo i Sjelljes së Duhur?” Por, sigurisht, arsyeja pse ne nuk i ekzekutojmë shtrigat është pasi nuk besojmë se ka të tilla. Po ta besonim këtë—po të mendonim se ka njerëz realisht të cilët ia kanë shitur veten djallit dhe kanë marrë fuqi të mbinatyrshme prej tij, për t’i përdorur për të vrarë të tjerët, për t’i çmendur apo për të prishur motin—sigurisht që, nëse do ta meritonte dikush dënimin me vdekje, a nuk do të ishin këta tradhtarë? Këtu nuk ka ndryshim në parimin moral: ndryshimi është thjesht midis fakteve. Mund të jetë një përparim i madh në njohuri të mos besosh në shtriga: nuk ka asnjë përparim moral duke mos i ekzekutuar ato, kur ti nuk mendon se ekzistojnë të tilla. Nuk mund ta cilësosh

DISA KUNDËRSHTIME

dikë si human ngaqë nuk vë çark minjsh, pasi nuk beson se ka minj në shtëpi.

REALITETI I LIGJIT

Tani do t'i kthehem asaj që thashë në fund të kapitullit të parë; se raca njerëzore ka dy gjëra të çuditshme. E para, ajo përndiqet nga ideja se i duhet të praktikojë një lloj sjelljeje të caktuar: mund ta quash *fair play* apo sjellje të duhur, apo moralitet, apo Ligji i Natyrës. E dyta, ajo në fakt nuk e praktikon atë. Disa prej jush mund të pyesin veten përse e quaj të çuditshme këtë. Për ju mund të tingëllojë gjëja më e natyrshme në botë. Mund t'ju duket në veçanti se po tregohem i ashpër ndaj racës njerëzore. Në fund të fundit, thoni ju, ajo çka unë e quaj shkelje të Ligjit të së Drejtës dhe të Gabuarës, ose të Natyrës, është thjesht një tregues se njerëzit nuk janë të përsosur. Dhe përse vallë pritkam unë që të jenë të tillë? Kjo do të ishte përgjigje e mirë, nëse po përpiquesha të caktoja sasinë ekzakte të fajit që na takon meqë nuk sillemi siç presim që të sillen të tjerët. Por kjo nuk është aspak puna ime. Tani për tani nuk jam i merakosur për fajin; unë po përpiqem të zbuloj të vërtetën. Dhe, e parë nga kjo pikëpamje, vetë ideja se diçka është e papërsosur, se nuk është siç duhet të jetë, ka disa rrjedhoja.

Nëse marrim diçka si një gur, apo një pemë, ajo është ashtu siç është dhe duket e pakuptimtë të thuash se duhet të kishte qenë ndryshe. Sigurisht që ti mund të thuash se një gur

ka “formë të gabuar”, nëse dëshiron ta përdorësh për dekor, apo se një pemë është e keqe, sepse nuk të jep aq hije sa do të doje. Por, me këtë, ti thjesht po thua se ai gur apo ajo pemë rastis të mos jetë e dobishme për qëllimin tënd të caktuar. Ti nuk po thua, veçse si shaka, se ata janë fajtorë për këtë. Ti në të vërtetë e di se, duke pasur parasysh motin dhe tokën, pema nuk mund të ishte ndryshe nga si është. Ajo, që për ne është një pemë “e keqe”, i bindet ligjit të natyrës së saj po aq sa një pemë “e mirë”.

E vutë re tani se çfarë rrjedh nga kjo? Ato që zakonisht i quajmë ligje të natyrës—si ndikimi i motit në një pemë, për shembull—mund të mos jenë vërtet *ligje* në kuptimin e parë të fjalës, por thjesht një mënyrë të shprehuri. Kur ti thua se gurët që bien i binden gjithnjë ligjit të gravitetit, a nuk je duke thënë se ligji ka kuptimin thjesht “ajo që gurët bëjnë gjithmonë”? Ti nuk mendon vërtet se, kur e lëshon një gur, ai befas kujtohet se është urdhëruar të bjerë në tokë. Ti thjesht po thua faktin se ai bie në tokë. E thënë ndryshe, ti nuk mund të jesh i sigurt se ka diçka tjetër përmbi faktet vetë, një ligj se çfarë duhet të ndodhë, jashtë asaj që ndodh vërtet. Ligjet e natyrës, siç janë të vlefshme për gurët dhe pemët, mund të kenë vetëm kuptimin “ajo që Natyra në fakt bën”. Por ligji i Natyrës Njerëzore, Ligji i Sjelljes së Duhur, është tjetër gjë. Ky ligj nuk ka aspak kuptimin e “asaj që qeniet njerëzore në fakt bëjnë”; pasi, siç e kam thënë më parë, shumë prej tyre nuk i binden asnjë pike të tij, dhe asnjë prej tyre nuk i bindet atij në të gjitha. Ligji i gravitetit të tregon se çfarë bëjnë gurët nëse i lëshon ata; mirëpo ligji i Natyrës Njerëzore të tregon se çfarë njerëzit duhet të bëjnë, por nuk e bëjnë. Me fjalë të tjera, kur flasim për njerëzit, diçka tjetër hyn që është përmbi vetë faktet. Kemi faktet (si sillen njerëzit) dhe kemi gjithashtu diçka tjetër (si duhet të sillen

ata). Pjesa tjetër e universit nuk ka nevojë për diçka tjetër përveç fakteve. Elektronet dhe molekulat sillen në një mënyrë të caktuar dhe japin pasoja të caktuara, dhe kjo mund të jetë e gjithë historia². Por njerëzit sillen në një mënyrë të caktuar dhe kjo nuk është e gjithë historia, sepse ne e dimë gjatë gjithë kohës që duhet të sillen ndryshe.

Kjo faktikisht është diçka aq e pazakontë, saqë tundohemi ta shpjegojmë pa e menduar mirë. Mund të tentojmë, për shembull, të konkludojmë që, thënia se një njeri nuk sillet në mënyrën e duhur, ka thjesht kuptimin që ka thënia se guri është në formën e gabuar; pra, që sjellja e tij qëllon të jetë e pavolitshme për ty. Mirëpo kjo është thjesht e pavërtetë. Dikush që e zë ndenjësën e qoshes në tren sepse hyri i pari, dhe dikush që ma zë atë fshehtazi sa kthej kurrizin dhe ma heq çantën, janë njësoj të pavolitshëm për mua. Por unë e fajësoj të dytin dhe jo të parin. Unë nuk inatosem—veçse për momentin, para se të vij në vete—me atë që më pengon aksidentalisht; por inatosem me atë që përpiket të më pengojë edhe nëse nuk ia del mbanë. Megjithatë, i pari më dëmtoi dhe i dyti jo. Ndonjëherë, sjellja që unë e quaj të keqe nuk është e pavolitshme për mua, madje e kundërta. Në luftë, për secilën palë mund të jetë shumë i dobishëm një tradhtar në anën tjetër. Por, ndonëse e përdorin dhe e paguajnë, ata e cilësojnë atë fundërrinë njerëzore. Pra, nuk mund të thuash se sjellja e duhur e të tjerëve quhet ajo që na bëhet mirë neve. Dhe, sa për sjelljen e duhur në veten tonë, besoj se është mëse e dukshme se ajo nuk është sjellja që na shpërblen më mirë. Ajo përfshin gjëra si të qenit i kënaqur me tridhjetë shilinga kur mund të fitoje tre sterlina, bërjen e detyrave të shkollës kur

2 Unë nuk mendoj se kjo është e gjithë historia, siç do ta shihni më vonë. Ajo që dua të them është se, deri këtu ku ka arritur argumenti, mund të jetë.

do të ishte e lehtë të kopjoje, lënien e një vajzë të qetë kur do të doje t'i vardiseshe, qëndrimin në vende të rrezikshme kur do të doje të shkoje në një vend më të sigurt, mbajtjen e premtimeve që nuk do të doje t'i mbaje dhe thënien e së vërtetës kur të bën të dukesh budalla.

Disa thonë se, megjithëse sjellja e duhur nuk do të thotë ajo që shpërblen çdo person të caktuar në një çast të caktuar, përsëri, do të thotë ajo që shpërblen racën njerëzore në tërësi; e rrjedhimisht nuk ka diçka misterioze këtu. Fundja, qeniet njerëzore janë të logjikshme; ato e kuptojnë se nuk mund të kesh siguri apo lumturi të vërtetë pa një shoqëri ku të gjithë luajnë sipas rregullave, e për shkak se e kuptojnë këtë ata përpiqen të sillen në mënyrën e duhur. Tani, është padyshim e vërtetë që siguria dhe lumturia mund të vijnë vetëm nga individë, klasa dhe kombe që janë të ndershëm, të drejtë dhe të mirë me njëri-tjetrin. Kjo është një nga të vërtetat më të rëndësishme në botë. Por, si shpjegim për arsyen pse ndihemi në këtë mënyrë për të Drejtën dhe të Gabuarën, thjesht nuk ia arrin qëllimit. Nëse pyesim: “Përse duhet të jem altruist?” dhe ju përgjigjeni: “Sepse është mirë për shoqërinë”, ne mund të pyesim, “Përse duhet të më interesojë e mira e shoqërisë nëse nuk më shpërblen *mua* personalisht?” atëherë ju duhet të përgjigjeni: “Sepse duhet të jesh altruist”—gjë që thjesht na kthen në pikënisje. Ti po thua të vërtetën, por nuk po shkon më larg se kaq. Nëse dikush pyetet se cila është arsyeja e të luajturit futboll, nuk do të kishte dobi përgjigja “për të shënuar gola”, sepse shënimi i golave është vetë loja, jo arsyeja për lojën. Ju do të ishit duke thënë thjesht se futboli është futboll—thënie e vërtetë, por pa vlerë. Në të njëjtën mënyrë, nëse dikush pyet cila është arsyeja për t’u sjellë në mënyrën e duhur, nuk ka kuptim përgjigja “për të mirën e shoqërisë”, pasi e mira e

shoqërisë, që është të qenit altruist (sepse “shoqëri” në fund të fundit ka kuptimin “njerëz të tjerë”), është një nga gjërat në të cilat konsiston sjellja e duhur. Gjithçka po thoni është se sjellja e duhur është sjellje e duhur. Nuk jeni duke thënë më shumë sesa fjalìa: “Njerëzit duhet të jenë altruistë”.

Dhe unë nuk po them më shumë. Njerëzit duhet të jenë altruistë, duhet të jenë të drejtë. Jo që njerëzit janë altruistë, apo iu pëlqen të jenë altruistë, por që ata duhet të jenë të tillë. Ligji Moral, apo ligji i Natyrës Njerëzore, nuk është thjesht një fakt për sjelljen njerëzore siç është, ose mund të jetë, Ligji i Gravitetit thjesht një fakt për mënyrën si sillen objektet e rëndë. Nga ana tjetër, nuk është thjesht një trill, pasi ne nuk mund ta heqim qafe këtë ide, madje shumica e gjërave që themi dhe mendojmë për njeriun do të mbeteshin gjepura nëse do ta bënim këtë. Dhe nuk është thjesht një pohim për mënyrën se si duam ne të sillen njerëzit për dobinë tonë; pasi sjellja që e quajmë të gabuar dhe të padrejtë nuk është saktësisht e njëjtë me sjelljen që na duket e pavolitshme, madje mund të jetë edhe e kundërta. Rrjedhimisht, ky rregull i të Drejtës dhe të Gabuarës, ose ligj i Natyrës Njerëzore, apo sido që ta quash, duhet të jetë, në një mënyrë apo një tjetër, diçka reale—diçka që është vërtet aty, e pakrijuar nga ne. Dhe megjithatë nuk është një fakt në kuptimin e zakonshëm, ashtu siç është fakt sjellja jonë reale. Po fillon të duket sikur na duhet të pranojmë që ekziston më shumë se një lloj realiteti; që, në rastin konkret, ekziston diçka përmbi dhe përtej fakteve të zakonshme të sjelljes së njerëzve, e megjithatë padyshim reale—një ligj real, të cilin asnjë nga ne nuk e bëri, por që kuptojmë se na imponohet.

ÇFARË GJENDET PAS LIGJIT

Le të përmbledhim çfarë kemi thënë deri tani. Në rastin e gurëve, pemëve dhe gjërave të tilla, ato që ne i quajmë Ligjet e Natyrës mund të mos jenë gjë tjetër veçse një mënyrë të shprehuri. Kur thua se natyra qeveriset nga ligje të caktuara, kjo mund të ketë kuptimin thjesht se natyra, në fakt, sillet në një mënyrë të caktuar. Ato çka i quajmë ligje mund të mos jenë diçka reale—diçka përmbi dhe përtej fakteve reale që ne vëzhgojmë. Por në rastin e Njeriut, ne e pamë që kjo nuk funksionon. Ligji i Natyrës Njerëzore, ose i të Drejtës dhe të Gabuarës, duhet të jetë diçka përmbi dhe përtej fakteve reale të sjelljes njerëzore. Në këtë rast, përveç fakteve reale, ne hasim diçka tjetër—një ligj real, të cilin nuk e kemi shpikur dhe të cilit e dimë se duhet t'i bindemi.

Tani dua të shqyrtojmë se çfarë na tregon kjo për universin ku jetojmë. Qëkur njerëzit ishin të aftë të mendonin, ata kanë pyetur veten çfarë është vërtet ky univers dhe si erdhi këtu. Dhe, në vija shumë të trasha, dy kanë qenë pikëpamjet për këtë. Së pari, është ajo që quhet pikëpamja materialiste. Njerëzit që e kanë atë, mendojnë se materia dhe hapësira thjesht rastisën të ekzistojnë e kanë ekzistuar gjithnjë, askush nuk e di përse; dhe që materia, duke u sjellë në mënyra fikse të caktuara, thjesht rastisi që, me njëfarë shansi, të prodhojë krijesa si ne

që janë në gjendje të mendojnë. Me shanset një në njëmijë, diçka e goditi diellin tonë dhe e bëri të prodhojë planetë; dhe me një tjetër shans në njëmijë, kimikatet e domosdoshme për jetën, bashkë me temperaturën e duhur, ndodhën në një nga këta planetë, e kështu një pjesë e materies këtu në tokë u bë e gjallë; e më pas, përmes një serie të gjatë shansesh, krijesat e gjalla u zhvilluan në gjërat si ne. Pikëpamja tjetër është ajo fetare. Sipas kësaj, ajo gjë pas universit i ngjan, më tepër se çdo gjëje tjetër që njohim ne, një mendjeje. Domethënë, ajo është e vetëdijshme dhe ka qëllime dhe preferon një gjë në vend të një gjëje tjetër. Dhe me këtë ide ajo bëri universin, pjesërisht për qëllime që nuk i dimë, por pjesërisht, në çfarëdo mase qoftë, për të prodhuar krijesa si vetja e saj—dua të them, si vetja në tiparin e të paturit të mendjes. Ju lutem mos mendoni se njëra nga këto pikëpamje mbahej kohë më parë dhe tjetra ia ka zënë vendin gradualisht. Kudo ku ka pasur njerëz që mendonin, të dyja pikëpamjet janë shfaqur. E vini re edhe këtë. Nuk mund të zbulohet se cila pikëpamje është e sakta me anë të shkencës, në kuptimin e zakonshëm të fjalës. Shkenca funksionon me eksperimente. Ajo vëzhgon mënyrën si sillen gjërat. Përfundimisht, çdo pohim shkencor, sado i ndërlikuar të duket, në fakt ka kuptimin e diçkaje si: “E drejtova teleskopin në këtë pjesë të qiellit në orën 2:20 të mëngjesit më 15 janar dhe pashë këtë dhe atë gjë”, ose, “Vendosa ca nga kjo gjëja në poç dhe e nxeha në këtë temperaturë dhe u bë kështu”. Mos mendoni se po them diçka kundër shkencës: jam thjesht duke thënë se cila është puna e saj. Dhe sa më shkencor të jetë dikush, aq më shumë (besoj unë) do të binte dakord me mua se kjo është puna e shkencës—një punë shumë e dobishme dhe e domosdoshme gjithashtu. Por pyetjet përse diçka ka ardhur në ekzistencë

dhe a ka diçka përtej gjërave që vëzhgon shkenca—diçka të një lloji tjetër—nuk janë pyetje shkencore. Nëse ekziston “Diçka Përtej”, atëherë ose do të mbetet tërësisht e panjohur për njerëzit, ose do ta bëjë veten të njohur në një mënyrë tjetër. Pohimi që diçka e tillë ekziston, edhe pohimi që diçka e tillë nuk ekziston, janë pohime që shkenca nuk mund t’i bëjë. Dhe shkencëtarët e vërtetë nuk i bëjnë këto zakonisht. Zakonisht janë gazetarët dhe romancierët që kërkojnë famë të cilët kanë kapur një mishmash shkence të papërfunduar nga librat shkollorë që e përdorin atë. Në fund të fundit, kjo është diçka logjike. Le të supozojmë që shkenca arrin të bëhet e plotë aq sa mëson çdo gjë në të gjithë universin. A nuk është e qartë se pyetjet: “Pse ekziston universi?”, “Pse është në këtë mënyrë”, “A ka ndonjë kuptim?” do të mbeteshin po njëlloj?

Tani kjo pozitë do të ishte mjaft e pashpresë, po të mos ishte për këtë gjë. Ka një, dhe vetëm një gjë në të gjithë universin, për të cilën ne dimë më shumë nga sa do të mund të mësonim prej vëzhgimit të jashtëm. Kjo një gjë është Njeriu. Ne jo vetëm i vëzhgojmë njerëzit; ne *jemi* njerëz. Në këtë rast ne kemi, si të thuash, të dhëna të brendshme; jemi të informuar. Dhe për shkak të kësaj, e dimë se njerëzit gjenden nën një ligj moral, të cilin nuk e kanë bërë dhe nuk mund ta harrojnë edhe nëse përpiqen, dhe të cilit e dinë se duhet t’i binden. Vëreni situatën në vazhdim. Kushdo që do të studiointe Njeriun nga jashtë, siç ne studiojmë elektricitetin apo lakrën, pa e ditur gjuhën tonë dhe rrjedhimisht pa mundur të ketë njohuri të brendshme prej nesh, por thjesht duke vëzhguar atë që ne bëjmë, nuk do të shihte kurrë as provën më të vogël që ne e kemi këtë ligj moral. Si do të mundte valle? Sepse vëzhgimet e tij do t’i tregonin vetëm çfarë ne bëjmë, kurse ligji moral bën fjalë për atë që duhet të bëjmë. Po ashtu, nëse

do të kishte diçka mbi dhe pas fakteve të vëzhguara për gurët apo motin, ne, duke i studiuar ato nga jashtë, nuk do të mund të shpresonim kurrë se do t'i zbulonim.

Pyetja, pra, ndodhet në një pozitë të tillë. Duam të dimë nëse universi thjesht rastisi të jetë kështu siç është pa arsye, apo nëse ka një fuqi pas tij që e bën atë që është. Meqenëse kjo fuqi, nëse ekziston, nuk do të ishte një nga faktet e vëzhguara, por një realitet që i bën ato, ajo nuk mund të gjendet vetëm me një vëzhgim faktesh. Ka vetëm një rast ku ne kemi mundësinë të zbulojmë nëse ekziston diçka më tepër apo jo; pikërisht rasti ynë. Dhe në këtë rast ne zbulojmë se diçka e tillë ekziston. Ose, le ta shohim nga ana tjetër. Nëse do të kishte një fuqi kontrolluese jashtë universit, ajo nuk do të mund të na e zbulonte veten si një nga faktet brenda universit—jo më shumë sesa arkitekti i një shtëpie do të mund të ishte një mur apo shkallë apo oxhak në atë shtëpi. E vetmja mënyrë që ne do të mund ta shihnim ta shfaqte veten do të ishte brenda nesh si një ndikim, ose urdhër që përpiket të na bëjë të sillemi në një mënyrë të caktuar. Dhe pikërisht këtë zbulojmë brenda vetes sonë. Sigurisht, a nuk na ngjall dyshime kjo? Në të vetmin rast ku mund të marrim një përgjigje, ajo përgjigje duket se është po. Në rastet e tjera, nuk mund të marrim përgjigje dhe e shohim se pse jo. Të supozojmë se dikush më pyet, kur shoh një njeri në uniformë blu që ecën rrugës duke lënë paketa të vogla letre në çdo shtëpi, pse supozoj që ato përmbajnë letra? Unë do të përgjigjesha: “Sepse kur ai lë një paketë të ngjashme për mua, unë zbuloj se ajo përmban në fakt një letër”. Dhe nëse ai kundërshton: “Por ti nuk i ke parë kurrë të gjitha ato letra që mendon se po marrin njerëzit e tjerë”, unë do të përgjigjesha: “Sigurisht që jo, dhe nuk pres ta bëj këtë, pasi ato nuk vijnë në adresën time. Unë po i shpjegoj paketat

që nuk më lejohet t'i hap përmes atyre që më lejohet t'i hap". Është e njëjta gjë edhe me këtë pyetje. E vetmja paketë që më lejohet të hap është Njeriu. Kur e hap, veçanërisht atë njeri të caktuar të quajtur Vetvetja, unë zbuloj që nuk ekzistoj i vetëm, që jam nën një ligj; që dikush ose diçka kërkon që të sillem në një mënyrë të caktuar. Sigurisht që unë nuk pres që do të zbuloja të njëjtën gjë nëse do të hyja brenda një guri ose peme, ashtu siç nuk pres që të gjithë njerëzit në rrugë të marrin të njëjtat letra si unë. Unë pres të zbuloj që, për shembull, guri është i detyruar t'i bindet ligjit të gravitetit—që, ndërsa dërguesi i letrave të mia vetëm më thotë t'u bindem ligjeve të natyrës njerëzore, ai i detyron gurët t'iu binden ligjeve të natyrës gurore. Por në të dyja rastet, unë pres të gjej se ka pasur në fakt, si të thuash, një dërgues të letrave, një fuqi pas fakteve, një drejtues, një udhëzues.

Mos mendoni se po ec më shpejt nga sa jam duke ecur vërtet. Ende nuk i jam afruar as njëqind milje Perëndisë së teologjisë së krishterë. E vetmja gjë që kam zbuluar deri tani është që ekziston Diçka që po e drejton universin, që shfaqet në mua si një ligj që më nxit të bëj të drejtën dhe më bën të ndihem përgjegjës dhe pa rehat kur bëj të gabuarën. Dhe duhet të supozojmë që kjo i afrohet një mendjeje, më shumë se gjithçka tjetër që njohim ne—pasi, në fund të fundit, e vetmja gjë tjetër që njohim është materia dhe vështirë të imagjinosh një copë materie të japë udhëzime. Por, sigurisht, nuk ka pse të jetë shumë e ngjashme me një mendje, aq më tepër me një person. Në kapitullin e radhës do të shohim nëse mund të zbulojmë më shumë për të. Por kini kujdes për një gjë. Janë thënë shumë lajka sa për të larë duart për Perëndinë këto njëqind vitet e fundit. Nuk është kjo ajo që unë po ofroj. Atë mund ta hidhni tutje krejt.

SHËNIM-Për ta mbajtur këtë sesion të shkurtër mjaftueshëm kur u transmetua në radio, unë përmenda vetëm pikëpamjen materialiste dhe atë fetare. Por, për të qenë i gjithanshëm më duhet të përmend pikëpamjen e Ndërmjetme të quajtur filozofia e Forcës Jetësore, ose e Evolucionit Kreativ, ose e Evolucionit të Papritur. Shpjegimet më të mprehta të saj vijnë në punimet e Bernard Shaw-t, por ato më të thellat në të Bergsonit. Njerëzit që e mbajnë këtë pikëpamje thonë se variacionet e vogla me anë të Burgosnit cilave jeta në këtë planet “evoluoi”, nga format më të ulëta te Njeriu nuk ishin të rastësishme por ishin nga “qëllimshmëria” apo “përpyekjet” e një Force Jetësore. Kur njerëzit e thonë këtë, duhet t’i pyesim nëse kur thonë Forcë Jetësore po flasin për diçka me një mendje apo jo. Nëse po, atëherë “një mendje që e bën jetën të ekzistojë dhe e çon në përsosmëri” është në fakt një Perëndi, dhe rrjedhimisht pikëpamja e tyre është identike me atë fetare. Nëse jo, çfarë kuptimi ka të thuash se diçka pa një mendje ka “përpyekje” dhe “qëllimshmëri”? Kjo më duket të jetë fatale për pikëpamjen e tyre. Arsyeja pse shumë njerëzve iu pëlqen Evolucioni Kreativ është për shkak se iu jep shumë nga ngushëllimi emocional i besimit në Perëndi dhe asnjë nga rrjedhojat jo aq të pëlqyeshme. Kur je në formë të mirë dhe dielli shkëlqen dhe nuk dëshiron të besosh se i gjithë universi është thjesht një vallëzim mekanik atomesh, është bukur të mund të mendosh se kjo Forcë e madhe misterioze rrokulliset përmes shekujve dhe të mban në majë të valës së saj. Nëse, nga ana tjetër, ti dëshiron të bësh diçka disi të pandershme, Forca Jetësore, duke qenë thjesht një forcë e verbër, pa morale dhe pa mendje, nuk do të ndërhyjë kurrë në punën tënde ashtu si ai Perëndia i bezdisshëm për të cilin kemi mësuar kur ishim fëmijë. Forca Jetësore është njëfarë Perëndie i zbutur. Mund

ÇFARË GJENDET PAS LIGJIT

ta ndezësh kur dëshiron, por nuk do të të shqetësojë. Ka gjithë kënaqësitë e fesë dhe asnjë nga kostot. A është vallë Forca Jetësore arritja më e madhe e ëndrrave me sy hapur që kjo botë ka parë deri më tani?

KEMI SHKAK PËR TË MOS QENË REHAT

Kapitullin e mëparshëm e mbylla me idenë se në ligjin Moral dikush ose diçka nga përtej universit material po na ngacmon. Dhe besoj se kur arrita në këtë pikë disa prej jush ndien njëfarë bezdie. Ju mund edhe të keni menduar se ju kam mashtruar—se kam mbështjellë në formën e filozofisë atë që doli të jetë një tjetër “muhabet fetar”. Ju mund të jeni gati të më dëgjoni për sa kohë kam diçka të re për të thënë; por nëse del të jetë thjesht feja, epo, bota e ka provuar tashmë atë dhe nuk mund ta kthejmë orën pas. Nëse ka ndonjë që ndihet në këtë mënyrë, do të doja t’i thosha tre gjëra.

E para, në lidhje me kthimin e orës pas. A do t’ju dukej shaka po t’ju thosha se është e mundur ta kthesh orën dhe, nëse ora është gabim kjo është gjëja më e arsyeshme për t’u bërë? Megjithatë, le ta lëmë mënjanë idenë e orës. Ne të gjithë duam progres. Por progres do të thotë t’i afrohesh vendit ku dëshiron të jesh. Dhe, nëse ke marrë kthesë të gabuar, atëherë të vazhdosh të ecësh përpara nuk të çon afër këtij vendi. Nëse je në rrugën e gabuar, progresi ka kuptimin të bësh një kthim pas dhe të ecësh në drejtim të rrugës së duhur; dhe personi që kthehet më shpejt është ai më progresiv. Ne të gjithë e kemi vënë re këtë duke bërë aritmetikë. Kur unë e nis

një ushtrim gabim, sa më shpejt e pranoj këtë dhe ia nis nga fillimi, aq më shpejt arrij në rezultat. Nuk ka asgjë progresive në të qenit kokëmushkë dhe në refuzimin për të pranuar një gabim. Dhe mendoj se, duke e parë gjendjen aktuale të botës, është mjaft e qartë që kemi bërë një gabim të madh. Jemi në rrugën e gabuar. Dhe, nëse është kështu, duhet të kthehemi pas. Kthimi pas është rruga më e shpejtë.

Dhe, së dyti, kjo ende nuk është kthyer saktësisht në një “muhabet fetar”. Ne nuk i jemi afruar ende Perëndisë së ndonjë feje reale, aq më pak Perëndisë së asaj feje të quajtur krishterim. Ne kemi shkuar vetëm tek Dikush ose Diçka pas ligjit Moral. Ne nuk po marrim asgjë nga Bibla apo kishat; ne po përpiqemi të shohim çfarë mund të zbulojmë për këtë Dikë vetëm me forcat tona. Dhe dua ta bëj të qartë se ajo që zbulojmë me forcat tona na trondit. Ne kemi dy prova për këtë Dikushin. Njëra është universi që Ai ka bërë. Nëse do ta përdornim këtë si gjurmën tonë të vetme, atëherë besoj se do të dilnim në përfundimin se Ai është një artist i shkëlqyer (pasi universi është një vend shumë i bukur), por edhe se Ai është mjaft i pamëshirshëm dhe nuk është mik për njeriun (pasi universi është një vend shumë i rrezikshëm dhe i tmerrshëm). Prova tjetër është ligji Moral që Ai ka vendosur në mendjet tona. Dhe kjo është një provë më e mirë se e para, sepse përmban informacion të brendshëm. Mund të zbulosh më shumë për Perëndinë nga ligji Moral sesa nga universi në përgjithësi, siç mund të zbulosh më shumë për një njeri duke e dëgjuar atë të flasë sesa duke parë shtëpinë që ai ka ndërtuar. Tani, nga kjo provë e dytë, ne dalim në përfundimin që Qenia pas universit është tejet e interesuar në sjellje të drejtë—në *fair play*, në altruizëm, kurajë, besueshmëri, ndershmëri dhe vërtetësi. Në bazë të kësaj, duhet të biem dakord me pohimin

e bërë nga krishterimi dhe disa fe të tjera, që Perëndia është “i mirë”. Por le të mos nxitohemi. Ligji Moral nuk na jep bazë për të menduar se Perëndia është “i mirë” në kuptimin e të qenit tolerant, i butë apo i dhembshur. Ligji Moral nuk ka asgjë tolerante; madje është i sertë. Ai të thotë të bësh gjënë e drejtë dhe duket se nuk i intereson sa e dhimbshme, e rrezikshme apo e vështirë është kjo gjë. Nëse Perëndia është si ligji Moral, atëherë Ai nuk është i butë. Nuk ka kuptim, në këtë fazë, të thuash se një Perëndi “i mirë” është një Perëndi që mund të falë. Jeni duke ecur shumë shpejt. Vetëm një Person mund të falë. Dhe ende nuk i jemi afruar një Perëndie personal—vetëm një fuqie, pas ligjit Moral, që ngjan më shumë me një mendje sesa me çdo gjë tjetër. Por ende mund të jetë e ndryshme nga një Person. Nëse është thjesht një mendje jopersonale, është e pakuptimtë t’i kërkoj për tolerime apo falje, siç është e pakuptimtë t’i kërkoj tabelës së shumëzimit të të tolerojë kur të del shumëzimi gabim. Je i destinuar të marrësh përgjigjen e gabuar. Dhe është e pakuptimtë nga ana tjetër të thuash se nëse ka një Perëndi të këtij lloji—një mirësi absolute jopersonale—ty nuk të pëlqen Ai dhe nuk do ta vrasësh mendjen për Të. Problemi është që njëra anë e jotja është me Të dhe vërtet e pranon mosaprovimin e tij të lakmisë dhe mashtrimit dhe shfrytëzimit njerëzor. Ti mund të duash që Ai të bëjë një përjashtim në rastin tënd dhe të ta falë këtë herë. Por ti e di në fund se, nëse kësaj fuqie pas botës nuk i neveritet realisht dhe në mënyrë të pandryshueshme një sjellje e tillë, atëherë Ai nuk mund të jetë i mirë. Nga ana tjetër, ne e dimë se, nëse ekziston një mirësi absolute, ajo duhet ta urrejë shumicën e gjërave që ne bëjmë. Kjo është dilema e tmerrshme në të cilën ndodhemi. Nëse Universi nuk qeveriset nga një mirësi absolute, atëherë gjithë përpjekjet

tona janë përfundimisht të pashpresa. Por nëse diçka e tillë e qeveris vërtet universin, ne e bëjmë veten armiq me këtë mirësi çdo ditë dhe nuk ka gjasa që nesër do të jemi më mirë, ndaj mbetemi të pashpresë. Nuk bëjmë dot pa të, e nuk bëjmë dot me Të. Perëndia është ngushëllimi i vetëm, është gjithashtu tmerri suprem: gjëja që kemi më shumë nevojë dhe gjëja që duam më shumë t'i fshihemi. Ai është i vetmi aleat që mund të kemi, dhe ne e kemi bërë veten armiq të Tij. Disa flasin sikur të takonin vështrimin e mirësisë absolute do të ishte diçka argëtuese. Këta duhet të mendohen sërish. Janë ende thjesht duke luajtur lojëra me fenë. Mirësia është ose siguria më madhështore, ose rreziku më i tmerrshëm—në varësi të mënyrës se si reagon ndaj saj. Dhe ne kemi reaguar në mënyrën e gabuar.

Dhe tani së treti. Kur zgjodha të arrij në temën reale që dua të trajtoj përmes kësaj rruge rreth e qark, nuk po përpiquesha t'ju manipuloja në ndonjëfarë mënyre. Kisha një arsye tjetër. Arsyeja ime ishte që krishterimi thjesht nuk ka kuptim derisa të jesh përballur me faktet që kam përshkruar deri tani. Krishterimi u kërkon njerëzve të pendohen dhe u premtim falje. Prandaj nuk ka asgjë (mesa di unë) për t'u thënë njerëzve që nuk dinë të kenë bërë diçka për të cilën duhet të pendohen dhe që nuk ndiejnë se kanë nevojë t'u falet diçka. Vetëm pasi e ke kuptuar se ka vërtet një ligj Moral dhe një Fuqi pas këtij ligji dhe se ti e ke shkelur këtë ligj dhe ke gabuar ndaj kësaj Fuqie—vetëm pas gjithë kësaj, e asnjë moment më herët, krishterimi nis të të flasë. Kur e di se je i sëmurë, ti do ta dëgjosh mjekun. Kur e ke kuptuar se pozita jonë është thuajse e pashpresë, ti do të fillosh të kuptosh se për çfarë po flasin të krishterët. Ata ofrojnë një shpjegim për mënyrën se si arritëm në këtë gjendje ku edhe e urrejmë

mirësinë, edhe e duam atë. Ata ofrojnë një shpjegim se si Perëndia mund të jetë një mendje jopersonale pas ligjit Moral, e njëkohësisht një Person. Ata të thonë se si kërkesat e këtij ligji, të cilat unë e ti nuk i përmbushim dot, janë përmbushur për ne nga dikush tjetër, se si Perëndia vetë u bë njeri për ta shpëtuar njeriun nga mosmiratimi i Perëndisë. Është një histori e vjetër dhe, për t'u zhytur në të, padyshim që duhet të konsultohesh me njerëz që kanë më shumë autoritet të flasin për këtë sesa unë. Unë thjesht po u kërkoj njerëzve të përballen me faktet—të kuptojnë pyetjet që krishterimi pretendon t'u përgjigjet. Dhe këto janë fakte të tmerrshme. Do të doja të mund të thosha diçka më të pranueshme. Por duhet të them atë që mendoj se është e vërtetë. Sigurisht që jam dakord se feja e krishterë, në fund, ofron një ngushëllim të papërshkrueshëm. Por ajo nuk nis në ngushëllim; nis në dëshpërimin që po përshkruaja, dhe është e kotë të përpiqesh të arrish te ngushëllimi pa përjetuar fillimisht dëshpërimin. Në fe, ashtu si në luftë dhe në gjithçka tjetër, ngushëllimi është e vetmja gjë që nuk mund ta gjesht duke kërkuar për të. Nëse kërkon të vërtetën, mund ta marrësh ngushëllimin në fund: nëse kërkon për ngushëllimin nuk do të marrësh as ngushëllimin, as të vërtetën—thjesht do kesh fjalë të bukura dhe ëndrra me sy hapur në fillim dhe, në fund, dëshpërim. Shumica prej nesh i kemi lënë pas ëndrrat me sy hapur të paraluftës në lidhje me politikën ndërkombëtare. Është koha të bëjmë të njëjtën gjë edhe me fenë.

LIBRI DY

ÇFARË BESOJNË TË KRISHTERËT

KONCEPTE RIVALE PËR PERËNDINË

Më është kërkuar t'ju tregoj se çfarë besojnë të krishterët dhe do t'ia nis duke ju thënë një gjë që të krishterët nuk kanë nevojë ta besojnë. Nëse je i krishterë, nuk ke nevojë të besosh që të gjitha fetë e tjera janë krejtësisht në gabim. Nëse je ateist, je i detyruar të besosh se ideja kryesore e të gjitha feve në gjithë botën është thjesht një gabim i madh. Nëse je i krishterë, je i lirë të mendosh se të gjitha ato fe, edhe më të çuditshmet, përmbajnë të paktën një fije të së vërtetës. Kur unë isha ateist, më duhej të përpiqesha ta bindja veten se pjesa më e madhe e racës njerëzore e ka pasur gjithnjë gabim për pyetjen që kishte më shumë rëndësi për të. Kur u bëra i krishterë, pata mundësi të kem një pikëpamje më liberale. Por, sigurisht që të qenit i krishterë do të thotë vërtet se, aty ku krishterimi dallon nga fetë e tjera, krishterimi ka të drejtë dhe të tjerat e kanë gabim. Ashtu si në aritmetikë—ka vetëm një përgjigje të saktë të ushtrimit; çdo përgjigje tjetër është e gabuar; por disa përgjigje të gabuara i afrohen më shumë të saktës nga të tjerat.

Ndarja e parë madhore e njerëzimit është midis shumicës, që beson në një lloj Perëndie apo perëndish dhe pakicës që nuk e beson këtë. Këtu, krishterimi është me shumicën—me grekët dhe romakët e lashtë, indigjenët e sotëm, stoikët, pla-

tonistët, hindutë, muhamedanët, etj, përkundrejt materialistëve modernë evropiano-perëndimorë.

Tani mund të vazhdoj me ndarjen madhore të radhës. Të gjithë njerëzit që besojnë në Perëndi mund të ndahen në bazë të llojit të Perëndisë në të cilin besojnë. Janë dy ide shumë të ndryshme mbi këtë temë. Njëra prej tyre është ideja që Ai është përtej të mirës dhe të keqes. Ne njerëzit e quajmë diçka të mirë dhe diçka tjetër të keqe. Por, sipas disa njerëzve, ky është thjesht këndvështrimi ynë. Këta njerëz do të thoshin se sa më i urtë të bëhesh, aq më pak do të duash ta quash diçka të mirë apo të keqe; dhe aq më qartë do ta shohësh që gjithçka është e mirë në një mënyrë dhe e keqe në një tjetër, dhe se asgjë nuk mund të kishte qenë ndryshe. Rrjedhimisht, këta njerëz mendojnë që, para se t'i afrohesh sadopak këndvështrimit hyjnor, ky dallim do të ishte zhdukur krejtësisht. Ne e quajmë kancerin të keq, do të thoshin këta, sepse e vret një njeri; por edhe një kirurg të suksesshëm mund ta quash të keq, sepse ai vret një kancer. Gjithçka varet nga këndvështrimi. Ideja tjetër dhe e kundërt me këtë, është që Perëndia është pa asnjë dyshim “i mirë” ose “i drejtë”, një Perëndi i cili mban një anë, që e do dashurinë dhe e urren urrejtjen, i cili do që ne të sillemi në një mënyrë dhe jo në një tjetër. E para e këtyre pikëpamjeve—ajo që mendon se Perëndia është përtej të mirës dhe së keqes—quhet panteizëm. Ajo besohet nga filozofi i madh prusian Hegel dhe, për aq sa i kuptoj unë, nga hindutë. Pikëpamja tjetër besohet nga judenjtë, muhamedanët dhe të krishterët.

Dhe, bashkë me këtë dallim të madh midis Panteizmit dhe idesë së krishterë për Perëndinë, vjen zakonisht edhe një tjetër. Panteistët zakonisht besojnë se Perëndia e lëviz universin, si me thënë, ashtu siç ti e lëviz trupin tënd: se

universi pothuajse *është* Perëndia, ndaj, po të mos ekzistonte universi, nuk do të ekzistonte as Perëndia, dhe gjithçka që gjendet në univers është pjesë e Perëndisë. Ideja e krishterë është mjaft ndryshe. Të krishterët mendojnë se Perëndia e shpiku dhe e bëri universin—si dikush që pikturon një pikturë apo kompozon një tingull. Piktori nuk është piktura dhe ai nuk vdes nëse piktura e tij shkatërrohet. Ti mund të thuash: “Ai e derdhi veten e tij në të”, por me këtë thjesht je duke thënë që bukuria e saj dhe interesi për të vjen nga koka e tij. Aftësia e tij nuk qëndron në pikturë në të njëjtën mënyrë siç qëndron në kokën, apo edhe duart e tij. Besoj se e shihni që ky dallim midis të krishterëve dhe panteistëve është i lidhur me të parin. Nëse nuk e merr aq seriozisht dallimin midis të mirës dhe të keqes, atëherë është e lehtë të thuash se gjithçka që gjendet në këtë botë është pjesë e Perëndisë. Përkundrazi, nëse mendon se disa gjëra janë vërtet keq dhe Perëndia vërtet i mirë, atëherë nuk mund të flasësh në këtë mënyrë. Ti duhet të besosh që Perëndia është i ndarë nga kjo botë dhe që disa nga gjërat që shohim janë në kundërshtim me vullnetin e tij. I përballur me një kancer ose një lagje varfërie ekstreme, panteisti mund të thotë: “Po ta shihje nga pikëpamja hyjnore, do ta kuptoje se edhe kjo është Perëndia”. I krishteri do të përgjigjej: “Mos fol gjepura të mallkuara”³. Pasi krishterimi është një fe luftarake. Ai mendon se Perëndia e bëri botën—se hapësira dhe koha, i nxehti dhe i ftohti dhe të gjitha ngjyrat dhe shijet dhe të gjitha kafshët dhe perimet janë gjëra që Perëndia i “krijoi në kokën e Tij” siç krijon njeriu një histori.

3 Një dëgjues u ankua se fjala të mallkuara është një fyerje mendjelehtë. Por unë e kam shumë seriozisht atë që thashë—gjepurat, që janë të mallkuara, janë të nëmura prej Perëndisë dhe (pa hirin e Perëndisë) i drejtojnë ata që besojnë në to në vdekje të përhjetshme.

Por ai gjithashtu mendon se në botën që bëri Perëndia shumë gjëra kanë shkuar keq dhe se Ai këmbëngul, me shumë forcë, për t'i kthyer ato siç duhet.

Dhe kjo sigurisht ngre një pyetje mjaft të rëndësishme. Nëse botën e krijoi një Perëndi i mirë, pse gjërat kanë shkuar keq? Dhe për shumë vite, thjesht nuk doja t'i dëgjoja përgjigjet e krishtera për këtë pyetje, sepse më dukej sikur “çfarëdo që ti thua, e sado të zgjuara argumentet e tua, a nuk është më e thjeshtë dhe e lehtë të thuash se bota nuk u krijua nga një fuqi inteligjente? A nuk janë të gjitha argumentet e tua thjesht një përpjekje e ndërlikuar për të shmangur të dukshmen?”. Por kjo më hodhi në një vështirësi tjetër.

Argumenti im kundër Perëndisë ishte që universi dukej tepër mizor dhe i padrejtë. Po nga më erdhi mua kjo ide e të drejtës dhe të padrejtës? Njeriu nuk mund ta quajë një vijë të shtrembër, nëse nuk ka një ide se si duket një vijë e drejtë. Me çfarë po e krahasoja unë universin kur po e quaja të padrejtë? Nëse e gjithë shfaqja ishte e keqe dhe e pakuptimtë, si me thënë, nga A-ja te Zh-ja, përse vallë unë, që supozohet të isha pjesë e shfaqjes, e gjeja veten duke reaguar kaq ashpër kundër saj? Njeriu e ndien veten të lagur kur bie në ujë, pasi njeriu nuk është kafshë ujore: peshku nuk do të ndihej i lagur. Sigurisht që unë mund të kisha hequr dorë nga ideja ime e drejtësisë, duke thënë se ishte thjesht një ide private e imja. Por, nëse e bëja këtë, edhe argumenti im kundër Perëndisë do të binte poshtë—pasi argumenti varej nga thënia se bota ishte vërtet e padrejtë, jo se thjesht rastisi të mos më pëlqejë mua. Kështu, në vetë përpjekjen për të vërtetuar se Perëndia nuk ekzistonte—e thënë ndryshe, se i gjithë realiteti ishte i pakuptimtë—unë zbulova se isha i detyruar të supozoja që një pjesë e realitetit—ideja ime e drejtësisë—ishte, në fakt,

kuptimplotë. Si rrjedhim, ateizmi rezulton tepër i thjeshtë. Nëse i gjithë universi është i pakuptimtë, ne nuk duhet ta kishim zbuluar kurrë që ai është i pakuptimtë: ashtu si nuk do ta njihnim kurrë errësirën, nëse nuk do të kishte dritë në univers, e si rrjedhojë, as krijesa me sy. *Errësira* do të ishte një fjalë pa kuptim.

PUSHTIMI

Shumë mirë pra, ateizmi është tepër i thjeshtë. Dhe unë do t'ju tregoj një tjetër pikëpamje që është gjithashtu tepër e thjeshtë. Është ajo të cilën e quaj krishterim-dhe-ujë, pikëpamja që thotë thjesht se ka një Perëndi të mirë në Qiell dhe çdo gjë është në rregull—duke lënë jashtë të gjitha doktrinat e vështira dhe të tmerrshme për mëkatin dhe ferrin dhe djallin dhe shpengimin. Të dyja këto janë filozofi djaloshare.

Është e kotë të kërkojsh një fe të thjeshtë. Fundja, gjërat reale nuk janë të thjeshta. Ato duken të thjeshta, por nuk janë të tilla. Tryeza ku jam ulur duket e thjeshtë: por pyet një shkencëtar se nga çfarë përbëhet ajo vërtet—për atomet dhe se si valët e dritës përplasen me to dhe godasin syrin tim dhe çfarë i bëjnë nervit optik dhe çfarë ky i bën trurit tim—dhe do të zbulosh me siguri që “shikimi i një tryeze” të fut në mistere dhe ndërlikime, nga të cilat vështirë se mund të dalësh. Një fëmijë që bën një lutje fëminore duket diçka e thjeshtë. Nëse je i kënaqur ta lësh me kaq, mirë. Por nëse nuk e lë me kaq — dhe bota moderne zakonisht nuk e lë—nëse do të vazhdosh e të pyesësh se ç’po ndodh vërtet, atëherë duhet të përgatitesh për diçka të vështirë. Nëse kërkojmë për diçka më shumë se thjeshtësia, është e kotë të ankohesh se pse gjëja më shumë

nuk është e thjeshtë.

Megjithatë, kjo procedurë qesharake zbatohet shpesh nga njerëz që nuk janë qesharakë por që, me a pa vetëdije, kërkojnë ta shkatërrojnë krishterimin. Këta njerëz marrin një variant të krishterimit, të përshtatshëm për një fëmijë gjashtë-vjeçar, dhe e kthejnë në objekt sulmi. Kur përpiqesh t'u shpjegosh doktrinën e krishterë, siç mbahet prej një të rrituri të mësuar, ata ankohen se po ua bën kokën lëmsh dhe se e gjithë kjo është tepër e ndërlikuar dhe, nëse do të kishte vërtet Perëndi, ata janë të sigurt se ai do ta kishte bërë “fenë” të thjeshtë, sepse thjeshtësia është kaq e bukur, etj. Duhet të ruheni kundër këtyre njerëzve pasi ata e ndryshojnë pozitën e tyre çdo minutë dhe thjesht të humbin kohën. Vëreni, gjithashtu, idenë e tyre të “bërjes së fesë të thjeshtë” prej Perëndisë; a thua se “feja” ishte diçka që Perëndia e shpiku, dhe jo pohimi i Tij për ne i disa fakteve mëse të pandryshueshme për vetë natyrën e Tij.

Përveçse i ndërlikuar, në eksperiencën time realiteti është edhe i çuditshëm zakonisht. Është jo i rregullt, jo i dukshëm, jo siç e pret. Për shembull, kur e kupton idenë se toka dhe planetët e tjerë rrotullohen rreth diellit, ti natyrshëm pret që të gjithë planetët të kenë njëfarë përputhshmërie. Pret, të themi, të jenë në distanca të barabarta nga njëri-tjetri, ose në distanca që rriten në mënyrë të rregullt, ose të gjithë në të njëjtën përmasë, ose të bëhen më të mëdhenj apo më të vegjël sa më larg të jenë nga dielli. Në fakt, nuk ka asnjë arsye (të dukshme) as për përmasat apo distancat; dhe disa prej tyre kanë një hënë, njëri ka katër, njëri ka dy, ca asnjë dhe njëri ka një unazë.

Realiteti në fakt është zakonisht diçka për të cilën nuk do të të shkonte mendja. Kjo është një nga arsyet pse e besoj

krishterimin. Është një fe për të cilën nuk do të të shkonte mendja. Nëse do të na ofronte pikërisht gjithësinë që gjithnjë e prisnim, do të ndihesha se e kishim shpikur ne. Por faktikisht nuk është diçka që mund të ishte shpikur nga ndonjë prej nesh. Ka po atë të papritur të çuditshme që kanë gjërat reale. Prandaj, t'i lëmë pas të gjitha filozofitë fëminore—ato përgjigjet tepër-të-thjeshta. Problemi nuk është i thjeshtë dhe as përgjigja nuk ka për të qenë e thjeshtë.

Cili është problemi? Një univers që përmban një masë të madhe të asaj që është dukshëm e keqe dhe në dukje e pakuptimtë, por edhe krijesa si ne që e dimë se është e keqe dhe e pakuptimtë. Ka vetëm dy pikëpamje që përballen me të gjitha faktet. Njëra është pikëpamja e krishterë se kjo është një botë e mirë që është bërë e keqe, por ende përmban një kujtesë të mënyrës se si gjërat duhet të ishin. Tjetra është pikëpamja e quajtur dualizëm. Dualizmi është besimi se ka dy fuqi të barabarta dhe të pavarura pas gjithçkaje, njëra e mirë dhe tjetra e keqe, dhe se gjithësia është një fushëbetejë ku ato luftojnë një luftë pa fund. Personalisht mendoj se, pas krishterimit, dualizmi është besimi më burrëror dhe logjik në treg. Por ka një kleçkë në të.

Dy fuqitë, ose frymërat, ose perënditë—i miri dhe i keqi—supozohet të jenë mjaft të pavarur. Të dy kanë ekzistuar nga gjithë përjetësia. Asnjëri prej tyre nuk e bëri tjetrin, asnjëri nuk ka më shumë të drejtë se tjetri ta quajë veten Perëndia. Secili, supozohet, e mendon veten të mirë dhe tjetrin të keq. Njëri prej tyre pëlqen urrejtjen dhe mizorinë, tjetri dashurinë dhe mëshirën, dhe secili përkrah pikëpamjen e tij. Tani, çfarë ndodh kur e quajmë njërin prej tyre Fuqia e Mirë dhe tjetrën Fuqia e Keqe? Ose jemi duke thënë thjesht se preferojmë njërin përkundrejt tjetrit—si të preferosh birrën përkundrejt

mushtit—ose po themi se, sido që të mendojnë dy fuqitë për këtë, e cilëndo që ne njerëzit preferojmë për çastin, njëri prej tyre e ka vërtet gabim dhe e quan vërtet pa të drejtë veten të mirë. Tani, nëse po themi se thjesht preferojmë të parin, atëherë duhet të heqim dorë fare nga e folura për të mirën dhe të keqen. Sepse e mirë ka kuptimin se çfarë duhet të preferosh, pavarësisht se çfarë preferon në një çast të caktuar. Nëse “të jesh i mirë” ka kuptimin thjesht të bashkohesh me palën që rastis të preferosh, pa arsye reale, atëherë e mira nuk meriton të quhet e mirë. Prandaj, duhet të jetë që njëra nga dy fuqitë është vërtet e gabuar dhe tjetra e drejtë.

Por në çastin që e thua këtë, ti po vendos në gjithësi një gjë të tretë përveç dy Fuqive: një ligj ose standard ose rregull të së mirës, me të cilin njëra nga fuqitë po pajtohet ndërsa tjetra jo. Por, meqë dy fuqitë gjykohen nga ky standard, atëherë ky standard, ose Qenia që e bëri këtë standard, qëndron përtej dhe përmbi secilën prej tyre dhe do të jetë Perëndia i vërtetë. Në fakt, ajo që donim të thoshim duke i quajtur e mirë dhe e keqe rezulton të jetë që njëra prej tyre është në marrëdhënien e duhur me Perëndinë real suprem dhe tjetra në marrëdhënien e gabuar me të.

I njëjti përfundim mund të arrihet në një rrugë tjetër. Nëse dualizmi do të ishte i vërtetë, atëherë Fuqia e keqe duhet të jetë një qenie që i pëlqen e keqja në vetvete. Por ne në realitet nuk kemi asnjë eksperiencë të dikujt që i pëlqen e keqja thjesht sepse është e keqe. Gjëja më e afërt me këtë është në mizorinë. Por njerëzit në jetën reale janë mizorë për një nga dy arsytë—ose ngaqë janë sadistë: pra, ngaqë kanë një çoroditje seksuale që e bën mizorinë shkak kënaqësie sensuale për ta; ose për shkak të diçkaje që ata përfitojnë prej saj—para, pushtet apo siguri. Por kënaqësia, paraja, pushteti dhe siguria janë të

gjitha, në vetvete, gjëra të mira. E keqja qëndron në ndjekjen e tyre me metodën e gabuar, ose në rrugën e gabuar, ose më shumë sesa duhet. Sigurisht, nuk po them se njerëzit që i bëjnë këto nuk janë dëshpërimisht të ligj. Po them se ligësia, e shqyrtuar nga afër, rezulton të jetë ndjekja e një gjëje të mirë në mënyrën e gabuar. Ti mund të jesh i mirë thjesht për hir të mirësisë: nuk mund të jesh i keq thjesht për hir të së keqes. Ti mund të bësh një veprim të mirë kur nuk ndihesh i mirë dhe kur nuk të jep asnjë kënaqësi, thjesht sepse mirësia është e drejtë; por askush nuk ka bërë një veprim mizor thjesht sepse mizoria është e gabuar—por sepse mizoria ishte e kënaqshme ose e dobishme për të. E thënë ndryshe, e keqja nuk arrin dot as të jetë e keqe në të njëjtën mënyrë siç është mirësia e mirë. Mirësia është, si me thënë, vetvetja: e keqja është vetëm mirësi e prishur. Dhe fillimisht duhet të ketë diçka të mirë, përpara se të mund të prishet. Ne e quajmë sadizmin çoroditje seksuale; por fillimisht duhet të kesh një ide për seksualizëm normal, përpara se të flasësh për çoroditjen e tij; dhe mund ta dallosh cila është çoroditja, sepse mund ta shpjegosh çoroditjen përmes normales dhe nuk mund ta shpjegosh normalen përmes çoroditjes. Rrjedhimisht, kjo Fuqi e Keqe, që supozohet të jetë në pozitë të barabartë me Fuqinë e Mirë dhe që e do të keqen në të njëjtën mënyrë që Fuqia e mirë do të mirën, është thjesht një frymë e ligë. Për të qenë i keq, atij i duhet të ketë impulse që fillimisht ishin të mira, në mënyrë që t'i çorodisë ato. Por, nëse është i keq, ai nuk mundet as ta furnizojë veten me gjëra të mira për të dëshiruar as me impulse të mira për të çoroditur. Të dyja duhet të jetë duke i marrë prej Fuqisë së Mirë. Dhe, nëse është kështu, atëherë ai nuk është i pavarur. Ai është pjesë e botës së Fuqisë së Mirë: ose është krijuar nga Fuqia e Mirë, ose nga një fuqi përmbi të

dy ata.

Ose e thënë akoma më thjesht. Për të qenë i keq, ai duhet të ekzistojë dhe të ketë inteligjencë dhe vullnet. Por ekzistenca, inteligjenca dhe vullneti janë në vetvete të mira. Prandaj ai duhet t'i ketë marrë ato nga Fuqia e Mirë: edhe për të qenë i keq ai ka nevojë të marrë ose vjedhë nga kundërshtari i tij. A e shihni tani se pse krishterimi ka thënë gjithnjë që djalli është një engjëll i rënë? Kjo nuk është thjesht një histori për fëmijë. Është një njohje reale e faktit që e keqja është diçka parazitare, jo diçka origjinale. Fuqitë që e mundësojnë të keqen të vazhdojë janë në vetvete gjëra të mira—vendosmëria, zgjuarsia, pamja e jashtme, ekzistenca vetë. Për këtë arsye dualizmi, në kuptimin strikt të fjalës, nuk do të funksionojë.

Por e pranoj lirisht se krishterimi i vërtetë (ndryshe nga krishterimi-dhe-ujë) i afrohet dualizmit më shumë sesa mendojnë njerëzit. Një nga gjërat që më habiti kur e lexova seriozisht Besëlidhjen e Re për herë të parë, ishte se sa shumë fliste për një Fuqi të Errët në gjithësi—një frymë të ligë të fuqishme, që mbahet si Fuqia pas vdekjes, sëmundjes dhe mëkatit. Dallimi është që krishterimi mendon se kjo Fuqi e Errët u krijua nga Perëndia dhe ishte i mirë kur u krijua, por u bë i keq. Krishterimi është në një mendje me dualizmin që ky univers është në luftë. Por ai nuk mendon se kjo është një luftë midis fuqive të pavarura. E mendon një luftë civile, një rebelim, dhe se ne jemi duke jetuar në një pjesë të universit të pushtuar prej rebelit.

Territor i zaptuar nga armiku—ja se çfarë është kjo botë. Krishterimi është historia se si zbarkoi mbreti legjitim; mund të thuash se zbarkoi i maskuar, dhe po na thërret të gjithëve ne të marrim pjesë në një fushatë të madhe sabotazhi. Duke shkuar në kishë, ti në fakt je duke dëgjuar transmetimin

sekret të miqve tanë: për këtë arsye armiku është kaq në ankth të na pengojë për të mos vajtur. Ai e bën këtë duke luajtur me krenarinë, përtacinë dhe arrogancën intelektuale. E di se është dikush aty që do të më pyesë: “Seriozisht që ke për qëllim, në këtë kohë të ditës, të prezantosh sërish mikun tonë të vjetër, djallin—me gjithë thundra e brirë?” Epo, se çfarë ka të bëjë koha e ditës, nuk e di. Dhe nuk jam aq i dhënë pas thundrave e brirëve. Por, në aspektet e tjera, përgjigja ime është, “Po, këtë qëllim kam”. Nuk pretendoj të di diçka në lidhje me paraqitjen e tij personale. Nëse ndokush do vërtet ta njohë atë më mirë, do t’i thosha, “Mos u shqetëso. Nëse do vërtet, ke për ta parë. A do të të pëlqejë apo jo është pyetje tjetër”.

ALTERNATIVA TRONDIËSE

Të krishterët, pra, besojnë se një fuqi e ligë e ka bërë veten për momentin Princin e kësaj Bote. Dhe kjo gjë sigurisht që ngre probleme. A është kjo gjendje në përputhje me vullnetin e Perëndisë apo jo? Nëse është, Ai është një Perëndi i çuditshëm, do të thuash ti: dhe nëse nuk është, si mund të ndodhë diçka kundër vullnetit të një qenieje me fuqi absolute?

Por kushdo që ka pasur autoritet e di se diçka mund të jetë në përputhje me vullnetin tënd në një mënyrë të caktuar dhe kundër tij në një mënyrë tjetër. Mund të jetë mëse e arsyeshme që një nënë t'u thotë fëmijëve: "Nuk do të vij çdo natë t'ju detyroj që ta rregulloni dhomën e studimit. Duhet të mësoni ta bëni këtë vetë". Dhe një natë ajo ngjitet e gjen një arush pelushi bashkë me bojën dhe librin e Gramatikës së Frëngjishtes në vatrën e oxhakut. Kjo është kundër vullnetit të saj. Ajo do të preferonte që fëmijët të ishin të rregullt. Mirëpo nga ana tjetër, vullneti i saj i ka lënë fëmijët të jenë të lirë për të qenë të çrregullt. E njëjta gjë ndodh në çdo repart, sindikatë apo shkollë. E lë diçka të bëhet në mënyrë vullnetare dhe gjysma e njerëzve nuk e bëjnë. Kjo nuk është vullneti yt, mirëpo është bërë e mundur prej tij.

Me shumë gjasë, e njëjta gjë vlen edhe për gjithësinë. Perëndia krijoi gjëra që kishin vullnet të lirë. Kjo nënkupton

krijesa të cilat mund të shkojnë në rrugën e drejtë ose të gabuar. Disa mendojnë se janë në gjendje të imagjinojnë një krijesë të lirë, por që nuk ka mundësi të bëjë diçka të gabuar. Unë nuk mundem. Nëse diçka është e lirë që të jetë e mirë, është e lirë të jetë edhe e keqe. Dhe vullneti i lirë është ai që e bëri të keqen të mundur. Përse, atëherë, Perëndia iu dha vullnet të lirë? Sepse vullneti i lirë, ndonëse e bën të mundur të ligën, është njëherësh e vetmja gjë që bën të mundur çdo dashuri, apo mirësi, apo gëzim me vlerë. Një botë robotësh—krijesash që funksionojnë si makineri—nuk do t’ia vlente ta krijoje. Lumturia, që Perëndia dizajnon për krijesat e Tij më të larta, është ajo e të qenit lirisht dhe vullnetarisht të bashkuar me Të dhe me njëri-tjetrin në një ngazëllim dashurie dhe gëzimi, në krahasim me të cilin, dashuria më e rrëmbyer midis një burri dhe gruaje në tokë do të dukej hiç. Dhe për këtë, ata duhet të jenë të lirë.

Sigurisht që Perëndia e dinte çfarë do të ndodhte nëse ata do ta përdornin lirinë e tyre në mënyrë të gabuar: mesa duket, Ai mendoi se ia vlente barra qiranë. Ndoshta ndihemi të shtyrë të mos biem dakord me të. Ai është burimi prej nga rrjedh gjithë fuqia jote e arsytimit: ti nuk mund të kesh të drejtë dhe ai ta ketë gabim, ashtu si rrëkeja nuk mund të ngrihet më lart se burimi i saj. Duke argumentuar me të, ti po argumenton me vetë fuqinë që të bën të aftë të argumentosh: është si të presësh degën mbi të cilën je ulur. Nëse Perëndia e mendon këtë gjendje lufte një çmim që ia vlen të paguhet për vullnetin e lirë—domethënë, për të bërë një botë të gjallë me krijesa që mund të bëjnë të mirë dhe të keqe reale dhe ku mund të ndodhë diçka vërtet me rëndësi, në vend të një bote lodër e cila lëviz vetëm kur ai manovron fijet—atëherë mund ta pranojmë edhe ne se ia vlen të paguhet.

Kur ta kemi kuptuar vullnetin e lirë, do të shohim se sa qesharake është të pyesësh, siç më pyeti njëherë dikush: “Pse Perëndia e bëri një krijesë me kaq material të kalbur sa shkoi keq?”. Sa më i mirë materiali me të cilin është bërë një krijesë—sa më e zgjuar dhe e fortë dhe e lirë është—aq më e mirë do të jetë nëse shkon në drejtimin e duhur, mirëpo aq më e keqe do të jetë nëse shkon në drejtimin e gabuar. Një lopë nuk mund të jetë shumë e mirë apo shumë e keqe; një qen mund të jetë edhe më i mirë, edhe më i keq; një fëmijë akoma më i mirë dhe më i keq; një njeri i zakonshëm, akoma më shumë; një gjeni, edhe më shumë; një frymë mbinjerëzore mund të jetë më e mira—ose më e keqja—nga të gjitha.

Si shkoi Fuqia e Errët në rrugën e gabuar? Kjo është, pa dyshim, një pyetje të cilës qeniet njerëzore nuk mund t'i japin një përgjigje të sigurt. Por një mendim i arsyeshëm (dhe tradicional) mund të ofrohet, i bazuar në eksperiencat tona të ecjes në rrugë të gabuar. Kur ti ke një vete, ke mundësinë ta vendosësh veten tënde të parën—të dëshirosh të jesh qendra—të dëshirosh, në fakt, të jesh Perëndia. Ky ishte mëkati i Satanit: dhe ky ishte mëkati që ai i mësoi racës njerëzore. Ca mendojnë se rënia e njeriut ka të bëjë me seksin, por kjo është e gabuar. (Historia e librit të “Zanafillës” sugjeron në fakt se rënia u pasua nga një prishje në natyrën tonë seksuale dhe kjo prishje ishte rezultat i ,Rënies jo shkak i saj.) Ajo që Satani vendosi në kokën e të parëve tanë të lashtë ishte ideja se mund të “ishin si perëndi”—mund të dilyn më vete, sikur ta kishin krijuar ata veten—të ishin zotër të vetes—të shpiknin njëfarë lumturie për veten jashtë Perëndisë, të ndarë prej Tij. E prej kësaj tentative të pashpresë ka lindur thujtë e gjithë ajo që e quajmë historia e njerëzimit—paratë, varfëria, ambicia, lufta, prostitucioni, klasat, perandoritë, skllavëria—historia e gjatë

dhe e tmerrshme e njeriut që përpiqet të gjejë diçka tjetër veç Perëndisë për ta bërë atë të lumtur.

Arsyeja pse ajo gjithnjë do të dështojë është kjo. Perëndia na bëri: na shpiku si njeriu që shpik një motor. Vetura është bërë të funksionojë me benzinë, dhe nuk do të funksiononte siç duhet me diçka tjetër. Tani, Perëndia e dizajnoi makinerinë e njeriut të funksionojë me Vetën e Tij. Ai Vetë është karburanti që shpirtrat tanë janë krijuar të përdorin, ose ushqimi me të cilin shpirtrat tanë duhet të ushqehen. Nuk ka tjetër. Prandaj është e pakuptimtë t'i kërkojmë Perëndisë të na bëjë të lumtur në mënyrën tonë pa e vrarë mendjen për fenë. Perëndia nuk mund të na japë lumturi dhe paqe jashtë Vetes së Tij, sepse nuk ka diçka të tillë. Kjo thjesht nuk ekziston.

Çelësi i historisë ky është. Shpenzohet energji jashtë mase e madhe— lartësohen qytetërime— krijohen institucione të shkëlqyera; por, çdo herë, diçka shkon keq. Një e metë fatale gjithnjë çon në majë njerëzit mizorë dhe egoistë dhe gjithçka shembet përsëri në mjerim dhe rrënim. Makineria, në fakt, ngec. Duket sikur ndizet dhe funksionon për disa metra, por më pas prishet. Ata po përpiqen ta bëjnë të punojë me lëngun e gabuar. Këtë na ka bërë Satani në njerëzve.

Po Perëndia çfarë bëri? Së pari, na la ndërgjegjen, ndjesinë ndaj të mirës dhe së keqes. Gjatë gjithë historisë njerëzore, ne jemi përpjekur (disa me shumë zell) për t'iu bindur asaj. Asnjë nuk ia ka dalë mbanë. Së dyti, Ai i dërgoi racës njerëzore ato që unë i quaj ëndrra të mira: e kam fjalën për ato historitë e çuditshme në fetë pagane për një perëndi i cili vdes dhe kthehet në jetë, dhe që, me anë të vdekjes së tij u ka dhënë njerëzve jetë të re. Së treti, Ai zgjodhi një popull të caktuar dhe kaloi disa shekuj me radhë duke ua ngulitur në kokë se çfarë Perëndie ishte ai—se ka vetëm një të tillë dhe se ai do

sjellje të drejtë. Këta ishin judenjtë dhe “Besëlidhja e Vjetër” na jep një përmbledhje të procesit të ngulitjes.

Më pas vjen tronditja. Midis judenjve ia beh një burrë, i cili flet sikur Ai vetë të ishte Perëndia. Ai shpall se fal mëkatet. Ai thotë se ka ekzistuar gjithnjë. Ai thotë se do të vijë ta gjykojë botën në fundin e kohës. Tani, që të jemi të qartë: midis panteistëve, siç janë indianët, kushdo mund të thotë se është një pjesë e Perëndisë, ose një me Perëndinë. Nuk do të kishte asgjë të çuditshme me këtë. Por ky njeri, meqë ishte jude, nuk mund ta ketë pasur fjalën për diçka të tillë. Perëndia, në gjuhën e tyre, ka kuptimin Qenia jashtë botës, i cili e bëri dhe është pafundësisht ndryshe nga gjithçka tjetër. Dhe, pasi ke kuptuar këtë, do të shohësh se fjalët e këtij njeriu nuk janë tjetër veçse gjëja më tronditëse që kanë dalë ndonjëherë prej buzëve të dikujt.

Njëra pjesë e deklaratës zakonisht anashkalohet prej nesh pasi e dëgjojmë aq shpesh sa që nuk e mendojmë më seriozisht domethënien e saj. Po flas për deklaratën e faljes së mëkateve: të gjitha mëkateve. Diçka e tillë është qesharake, në mos komike, nëse folësi është dikush tjetër veç Perëndisë. Ne të gjithë e kuptojmë se një njeri mund të falë fyerjet që i janë bërë atij personalisht. Ti më shkel në këmbë dhe unë të fal, ti më vjedh paratë dhe unë të fal. Por si duhet ta kuptojmë një njeri që, i pavjedhur dhe i pashkelur vetë, thotë se mund të të falë për shkeljen dhe vjedhjen që u ke bërë të tjerëve? “Budalla me brirë” është përshkrimi më dashamirës që mund t’i japim atij. Por Jezui këtë tha. Ai u tha njerëzve se mëkatet e tyre ishin falur dhe nuk priti kurrë të konsultohet me të dëmtuarit nga mëkatet e atyre. Ai, pa hezitim, u soll sikur të ishte ai pala kryesore e dëmtuar, personi i fyer nga çdo fyerje. Kjo ka kuptim vetëm nëse Ai është vërtet Perëndia, ligjet e

të cilit janë shkelur dhe dashuria e të cilit lëndohet nga çdo mëkat. Të dala nga goja e kujtdo tjetër veç Perëndisë, këto fjalë do të nënkuptonin një budallallëk dhe mendjemadhësi të parivalizuar nga ndonjë tjetër në histori.

Megjithëkëtë, (dhe kjo është gjëja e habitshme), edhe armiqtë e Tij kur lexojnë Ungjijtë, zakonisht nuk vënë re budallallëk apo mendjemadhësi. Aq më pak lexuesit e paanshëm. Krishti thotë se është “i përlurur dhe zemërbutë” dhe ne e besojmë atë; pa e vënë re që, nëse Ai do të ishte thjesht njeri, përlësia dhe zemërbutësia do të ishin gjërat e fundit që do të përshkruanin disa nga shprehjet e tij.

Këtu po përpiqem të parandaloj dikë që mund të thotë atë budallallëk të madh, që njerëzit thonë shpesh në lidhje me të: “Unë jam gati ta pranoj Jezuin si një mësues të madh morali, por nuk e pranoj deklaratën se ai është Perëndi.” Kjo është e vetmja gjë që nuk mund të themi për të. Nëse dikush do të ishte thjesht njeri dhe do të thoshte gjërat që thoshte Jezui, ky person nuk mund të ishte një mësues i madh morali. Ai do të ishte o luajtur mendsh—aq sa dikush që thotë se është vezë e zier—ose do të ishte vetë Djalli i Ferrit. Duhet të bësh zgjedhjen tënde. Ose ky njeri ishte, dhe është, Biri i Perëndisë: ose ishte një i çmendur apo më keq. Mund t’ia mbyllësh gojën si të çmendur, mund ta pështysh dhe ta vrasësh si një demon; ose mund t’i biesh ndër këmbë dhe ta quash Zot dhe Perëndi. Por le ta lëmë mënjanë këtë budallallëk “dashamirës” që Ai është një mësues i madh njerëzor. Ai nuk na e ka lënë këtë mundësi. As që e kishte ndërmend.

I PENDUARI I PËRSOSUR

Kemi përpara, pra, një alternativë të frikshme. Ky burrë, për të cilin po flasim, ose ishte (dhe është) ai që tha se është, ose ishte një i çmendur apo diçka më keq. Tani mua më duket shumë e qartë që Ai nuk është as i çmendur as i djallëzuar: rrjedhimisht, sado e çuditshme apo e tmerrshme apo e padëgjuar të jetë, më duhet të pranoj pikëpamjen se Ai ishte dhe është Perëndi. Perëndia zbarkoi në këtë botë armike në formën e një njeriu.

Dhe tani, cili ishte qëllimi i gjithë kësaj? Përse erdhi Ai? Sigurisht që për të mësuar të tjerët; mirëpo, sapo lexon Besëlidhjen e Re, apo çfarëdo shkrimi tjetër të krishterë, ti zbulon se ata flasin për diçka krejt ndryshe—për vdekjen e Tij dhe për kthimin e Tij në jetë. Është e dukshme që të krishterët mendojnë se këtu qëndron thelbi i historisë. Për ta, qëllimi kryesor i ardhjes së Tij në tokë ishte të vuante dhe të vritej.

Para se të bëhesha i krishterë, më dukej sikur gjëja e parë që të krishterët duhej të besonin ishte një teori e caktuar mbi qëllimin e vdekjes. Kjo teori ishte që Perëndia kërkonte t'i ndëshkonte njerëzit, ngaqë e lanë dhe iu bashkuan Rebelit të Madh, por Krishti doli vullnetar të ndëshkohej në vendin e tyre, ndaj Perëndia ua fali. Tani e pranoj që edhe një teori e tillë nuk më duket aq imorale dhe qesharake sa ç'më dukej

dikur; por nuk dua të dal këtu. Ajo që pashë më vonë ishte se krishterimi nuk është as kjo teori dhe as ndonjë tjetër. Në qendër të krishterimit është besimi se vdekja e Krishtit në një farë mënyre na ka pajtuar me Perëndinë dhe na dhënë një fillim të ri. Teoritë për mënyrën se si e ka arritur këtë janë çështje tjetër. Ka pasur teori boll për mënyrën se si kjo funksionon; ajo që të gjithë të krishterët bien dakord është fakti se funksionon. Po jua them se si mendoj unë se është kjo çështje. Çdo njeri me mend e di se, nëse je i lodhur dhe i uritur, një vakt ushqimi të bën mirë. Por teoria moderne e ushqyerjes—me vitaminat dhe proteinat—është diçka tjetër. Njerëzit hanin darka dhe ndiheshin mirë edhe përpara se të dëgjohej teoria e vitaminave: edhe nëse teoria e vitaminave braktiset një ditë, ata do të vazhdojnë të hanë darkat e tyre njësoj. Teoritë për vdekjen e Krishtit nuk janë krishterimi: ato janë shpjegime për mënyrën se si kjo funksionon. Të krishterët nuk bien të gjithë dakord se sa të rëndësishme janë këto teori. Vetë kisha ime, ajo anglikane, nuk parashtroon ndonjërin prej tyre si të vetmen të saktë. Kisha katolike e çon edhe më larg. Por unë mendoj se të gjitha ato bien dakord se gjëja vetë është pafundësisht më shumë e rëndësishme sesa çfarëdo shpjegimi që mund të japin teologët. Besoj se ata do ta pranonin që asnjë shpjegim nuk do të jetë krejtësisht në përputhje me realitetin. Por, siç them në parafjalën e këtij libri, unë nuk jam klerik, kurse tani po futemi në ujëra të thella. E vetmja gjë që mund të bëj, dhe nuk e di sa do t'ju ndihmojë, është të tregoj se si i shoh gjërat unë personalisht.

Për mendimin tim, nuk janë teoritë vetë gjëja që të kërkohet të pranosh. Pa dyshim që shumë prej jush kanë lexuar Jeans-in dhe Eddington-in. Ajo që ata bëjnë, kur duan të shpjegojnë atomin apo diçka të këtij lloji, është të të japin një përshkrim

prej të cilit ti krijon një imazh në mendjen tënde. Por më pas ata të paralajmërojnë se ky imazh nuk është ajo që besojnë shkencëtarët. Ajo që besojnë shkencëtarët është formula matematikore. Imazhet janë aty thjesht për të të ndihmuar të kuptosh formulën. Ato nuk janë reale në të njëjtën mënyrë siç është formula. Ato nuk të japin të vërtetën, por vetëm diçka pak a shumë si ajo. Qëllimi i tyre është të të ndihmojnë dhe, nëse nuk të ndihmojnë, mund t'i lësh. Vetë gjëja nuk mund të krijohet si imazh; mund të shprehet vetëm matematikisht. Edhe ne ndodhemi në të njëjtën situatë. Ne besojmë se vdekja e Krishtit është ai çast në histori kur diçka absolutisht e paimagjinueshme nga jashtë shfaqet në botën tonë. Dhe, nëse nuk arrijmë dot të përfytyrojmë as atomet prej të cilave ndërtohet bota jonë, patjetër që nuk mund ta përfytyrojmë as këtë. Përkundrazi, sikur të zbulonim se mund ta kuptojmë atë krejtësisht, vetë ky fakt do të tregonte se kjo nuk është ajo që thotë se është—e paperceptueshmja, e pakrijuara, gjëja përtej natyrës, e cila hyn në natyrë si vetëtimë. Ti mund të thuash, e ç'dobi ka për ne nëse nuk e kuptojmë. Por kjo e merr përgjigjen lehtë. Njeriu mund ta hajë darkën e tij pa e kuptuar saktësisht se si gatimi e ushqen trupin e tij. Dikush mund ta pranojë atë që Krishti ka bërë për të pa e ditur si funksionon: dhe në të vërtetë, ai nuk mund ta dijë si funksionon, nëse nuk e ka pranuar atë.

Na thuhet se Krishti u vra për ne, se vdekja e tij lau mëkatet tona dhe se, duke vdekur, ai zhbëri vdekjen vetë. Kjo është formula. Ky është krishterimi. Kjo është ajo që duhet besuar. Çdo teori për mënyrën se si vdekja e Krishtit e arriti këtë është, për mendimin tim, dytësore. Ato janë thjesht plane ose diagrame për t'u lënë mënjanë nëse nuk na ndihmojnë; madje, edhe nëse ndihmojnë, nuk duhen ngatërruar me gjënë

vetë. Sidoqoftë, disa prej këtyre teorive ia vlen t'i hedhim një sy.

Më e njohura nga njerëzit është ajo që përmenda më lart; ajo që ne ia hedhim pasi Krishti e mbajti vullnetarisht ndëshkimin në vendin tonë. Tani, kjo në sipërfaqe duket si një teori vërtet qesharake. Nëse Perëndia ishte gati të na falte, përse vallë nuk e bëri këtë? E cili mund të ishte qëllimi i ndëshkimit të një njeriu të pafajshëm në vendin tonë? Unë nuk mendoj se ka ndonjë, në kuptimin e ndëshkimit të një gjykate. Por nga ana tjetër, nëse mendon për një borxh, ka shumë kuptim që dikush, i cili ka pasuri, të paguajë për dikë i cili nuk ka. Ose, nëse e mendon “vuajtjen e dënimit”, jo si ndëshkim, por në kuptimin më të përgjithshëm të “larjes së borxheve” apo “shlyerjes së taksave”, sigurisht që në këtë rast eksperiencia e zakonshme tregon se, kur dikush bie në një gropë të tillë, telashi për ta nxjerrë bie shpesh mbi një mik të mirë.

Por në çfarë “gropë” ka rënë njeriu? Ai është përpjekur të veprojë me kokën e tij, të sillet sikur i përket vetes. E thënë ndryshe, rënia e njeriut nuk e bën atë thjesht një krijesë të papërsosur që ka nevojë për përmirësim: ai është një rebel që duhet të ulë armët. Ulja e armëve, dorëzimi, kërkimi i faljes, të kuptuarit se ke qenë në rrugë të gabuar dhe përgatitja për ta nisur jetën sërish nga e para: kjo është rrugëdalja nga “gropa” jonë. Ky proces i dorëzimit—kjo kthesë me shpejtësi të lartë—quhet nga të krishterët pendim. Pendimi nuk është fare i këndshëm. Është diçka shumë më e vështirë sesa thjesht përrulja. Pendimi do të thotë të çmësojmë gjithë krenarinë dhe arrogancën që i kemi mësuar vetes për mijëra vjet. Do të thotë të vrasësh një pjesë të vetes, për përjetosh njëfarë vdekjeje. Në fakt, duhet të jesh njeri i mirë, që të pendohesh.

Mirëpo puna është kështu: Vetëm një njeri i keq ka nevojë të pendohet: vetëm një njeri i mirë mund të pendohet në mënyrë të përsosur. Sa më i keq të jesh, aq më shumë ke nevojë të pendohesh dhe aq më pak ke mundësi të pendohesh. I vetmi person që do të mund të pendohej në mënyrë të përsosur do të ishte një njeri i përsosur—dhe ky nuk do të kishte nevojë të pendohej.

Mos harroni se ky pendim, ky nënshtrim vullnetar ndaj poshtërimit dhe një farë vdekjeje, nuk është diçka që Perëndia ta kërkon para se të të pranojë dhe nga e cila mund të të përjashtojë nëse do. Është thjesht një përshkrim se ç’pamje ka të kthehesh tek Ai. Nëse i kërkon Perëndisë të të pranojë pa këtë, në fakt je duke i thënë të të lejojë të kthehesh pa u kthyer. Është diçka që s’mund të ndodhë. Pra, ne duhet të bëjmë atë që duhet bërë. Por ajo e keqe që na krijon nevojën për pendim, është e njëjta që nuk na lejon të pendohemi. A mund të pendohemi nëse Perëndia na ndihmon? Po, por çfarë nënkupton kjo? Nënkupton që Ai, si të thuash, të na japë neve një pjesë nga vetja e Tij. Ai na huan një pjesë nga fuqia e Tij e arsytimit dhe ne mund të mendojmë: Ai vendos pak nga dashuria e Tij në ne dhe kështu ne e duam njëri-tjetrin. Kur i mëson shkrimin një fëmijë, ti ia mban dorën teksa formon shkronjat. Domethënë, ai i formon shkronjat sepse ti po i formon ato. Ne duam dhe arsyetojmë sepse Perëndia do dhe arsyeton, dhe na mban dorën ndërkohë që e bëjmë këtë. Po të mos kishim rënë, do ta kishim shumë të lehtë. Por tani, fatkeqësisht, na duhet ndihma e Perëndisë për diçka të cilën Perëndia në natyrën e Tij nuk ka kurrë nevojë ta bëjë—të dorëzohemi, të vuajmë, të nënshtrohemi, të vdesim. Asgjë në natyrën e Perëndisë nuk përputhet me këtë proces. Kështu pra, ajo rrugë për të cilën na nevojitet doemos udhëheqja e

Perëndisë, është ajo të cilën Perëndia, në natyrën e tij, nuk e ka përshkuar kurrë. Perëndia mund të ndajë vetëm atë që Ai ka: këtë gjë, në natyrën e Tij, Ai nuk e ka.

Por sikur Perëndia të bëhej njeri—sikur natyra jonë njerëzore, e cila mund të vuajë dhe të vdesë, të amalgamohej me atë të Perëndisë në një person—atëherë ky person mund të na ndihmonte. Ai mund ta dorëzonte vullnetin e tij, të vuante dhe të vdiste, pasi do të ishte njeri. Dhe mund ta bënte këtë përsosmërisht, pasi do të ishte Perëndi. Unë e ti mund të kalojmë në këtë proces vetëm nëse Perëndia e bën atë në ne. Por Perëndia mund ta bëjë vetëm nëse bëhet njeri. Përpjekjet tona për një vdekje të tillë mund ta arrijnë qëllimin vetëm nëse ne, njerëzit, marrim pjesë në vdekjen e Perëndisë, ashtu si të menduarit tonë ka sukses thjesht sepse është një pikë e oqeanit të inteligjencës së Tij. Por nuk mund të kemi pjesë në vdekjen e Perëndisë, nëse Ai nuk vdes; dhe Ai nuk mund të vdesë nëse nuk është njeri. Në këtë kuptim Ai paguan borxhin tonë dhe vuan për ne atë që Ai vetë nuk ka pasur kurrë pse ta vuante.

Kam dëgjuar disa të ankohen se, meqë Jezui ishte edhe Perëndi përveçse njeri, vuajtjet dhe vdekja e Tij e humbin gjithë vlerën pasi, në sytë e tyre, “duhet të kenë qenë shumë të lehta për Të”. Të tjerë mund ta qortojnë (me shumë të drejtë) mosmirënjohjen dhe paturpësinë e këtij kundërshtimi; ajo që më habit mua është keqkuptimi që ky kundërshtim nxjerr në pah. Patjetër që, në njëfarë kuptimi, këta persona kanë të drejtë. Madje po e zbutin çështjen e tyre. Nënshtrimi i përsosur, vuajtja e përsosur, vdekja e përsosur nuk ishin thjesht më të lehta ngaqë Jezui ishte Perëndi, por ishin edhe të mundshme vetëm për këtë arsye. Por a nuk është kjo një arsye e çuditshme për të mos i pranuar ato? Mësuesi mund

t'ia formojë shkronjat fëmijës ngaqë është i rritur dhe di të shkruajë. Patjetër që ai e ka më të lehtë; pikërisht ngaqë e ka më të lehtë mund ta ndihmojë fëmijën. Nëse fëmija e mohon ngaqë “është shumë e lehtë për të rriturit” dhe pret të mësojë nga një fëmijë tjetër, i cili nuk di të shkruajë vetë (për të mos pasur avantazh “të padrejtë”), ai nuk do të arrinte gjë. Nëse unë do të isha duke u mbytur në një lumë të rrëmbyer, dikush që e mban njërën këmbë në breg mund të zgjatet të më shpëtojë. A duhet të thërras: “Jo, kjo është e padrejtë! Ti ke një avantazh! Ti po e mban njërën këmbë në breg”? Ky avantazh—po deshe quaje “të padrejtë”—është arsyeja e vetme pse ai mund të jetë i dobishëm për mua. Te kush mund të kërkosë ndihmë, nëse nuk kërkon tek ajo që është më e fortë se ti?

Kjo është mënyra se si unë e shoh atë që të krishterët e quajnë Shlyerje. Por mos harroni se kjo është thjesht një tjetër imazh. Mos e ngatërroni me vetë gjënë: dhe nëse nuk ju ndihmon, lëreni.

PËRFUNDIMI PRAKTIK

Dorëzimi dhe poshtërimi i përsosur u bënë nga Krishti. I përsosur, pasi ishte Perëndi, dorëzim dhe poshtërim, pasi ishte njeri. Tani, bindja e krishterë është që, nëse ne, në njëfarë mënyre, marrim pjesë në poshtërimin dhe vuajtjen e Krishtit, do të marrim pjesë edhe në fitoren e Tij mbi vdekjen dhe do të gjejmë një jetë të re pasi të vdesim dhe në atë jetë do të bëhemi krijesa të përsosura, përsosmërisht të lumtura. Kjo nënkupton shumë më tepër sesa përpjekjet tona për të ndjekur mësimet e Tij. Njerëzit pyesin shpesh se kur do të ndodhë hapi i radhës në evolucion—hapi i diçkaje përtej njeriut. Por, sipas pikëpamjes së krishterë, ky tashmë ka ndodhur. Në Krishtin është shfaqur një njeri i ri: dhe jeta e re që filloi në Të duhet të vendoset në ne.

Si mund të bëhet kjo? Kujtoni, ju lutem, mënyrën si e morëm jetën e vjetër, të zakonshmen. E trashëguam nga të tjerët, nga ati dhe nëna dhe gjithë paraardhësit tanë, pa miratimin tonë—dhe me anë të një procesi të çuditshëm, i cili përfshin kënaqësi, dhimbje dhe rrezik. Një proces për të cilin nuk do të të kishte shkuar mendja. Shumë prej nesh kalojnë vite të tëra të fëmijërisë duke u përpjekur ta marrim me mend se si: dhe disa fëmijë, kur dëgjojnë për herë të parë për

të, nuk e besojnë—dhe nuk mendoj se mund t'u vihet faj, se është vërtet i çuditshëm. Tani, Perëndia që krijoi këtë proces, është i njëjti i cili krijon edhe mënyrën se si përhapet lloji i ri i jetës—jeta e krishterë. Duhet të jemi të përgatitur që edhe ky do të jetë i çuditshëm. Ai nuk na mori mendim neve kur shpiku seksin: nuk na mori mendim as kur shpiku këtë.

Tre janë gjërat që e përhapin jetën e Krishtit tek ne: pagëzimi, besimi dhe ai veprim misterioz që të krishterët i venë emra të ndryshëm—Kungim, Meshë, Darka e Zotit. Këto të treja janë metodat më të zakonshme. Nuk po e mohoj se ka raste të veçanta kur kjo jetë shpërndahet pa njërin apo më shumë se këto të treja. Nuk kam kohë të shqyrtoj rastet e veçanta dhe nuk kam mjaftueshëm informacion për to. Nëse po përpiqesh në pak minuta t'i tregosh një njeriu si të shkojë në Edinburg, do t'i thuash për trenat. Sigurisht që ai mund të shkojë atje me anije apo aeroplan, por ka pak gjasa që do ta përmendje këtë. Dhe nuk po them se cila nga të treja është më thelbësore. Një miku im metodist do të parapëlqente të flisja më shumë për besimin dhe më pak (në krahasim me të) për dy të tjerat. Por nuk do t'i futem kësaj. Kushdo që pretendon se po të mëson ty doktrinën e krishterë, nuk do t'i lërë pa përmendur të treja ato, dhe kaq na mjafton për qëllimin tonë tani.

Unë vetë nuk e kuptoj se si këto gjëra mund të jenë përçuesit e llojit të ri të jetës. Megjithatë, po të mos e kisha ditur, nuk do ta bëja kurrë lidhjen midis një kënaqësie të caktuar fizike dhe shfaqjes së një qenieje njerëzore të re në botë. Duhet ta pranojmë realitetin siç na paraqitet: nuk ka vlerë të llogotit se si duhej të ishte, apo se si prisnim ne të ishte. Por, edhe pse nuk mund ta kuptoj pse duhej të ishte kështu, mund t'ju tregoj pse besoj unë se është kështu. E kam

shpjeguar pse mendoj se Jezui ishte (dhe është) Perëndi. Dhe duket historikisht e qartë që Ai u mësoi ndjekësve të tij se jeta e re komunikohet në këtë mënyrë. Domethënë, e besoj në bazë të autoritetit të Tij. Mos u trembni nga fjala autoritet. Ta besosh diçka mbi bazën e autoritetit ka thjesht kuptimin se të është thënë nga një person që ti e mendon të besueshëm. Nëntëdhjetenëntë përqind të gjërave që ti beson, i beson mbi bazën e autoritetit. Unë besoj se ekziston një vend i quajtur Nju Jork. Vetë nuk e kam parë. Nuk mund ta vërtetoj me anë arsyetimi abstrakt që duhet të ketë një vend të tillë. Unë e besoj sepse njerëz të besueshëm ma kanë thënë atë. Njeriu i zakonshëm beson në sistemin diellor, në atome, në evolucion dhe në qarkullimin e gjakut mbi bazën e autoritetit—se kështu kanë thënë shkencëtarët. Çdo pohim historik në botë besohet mbi bazën e autoritetit. Asnjë nga ne nuk e ka parë Pushtimin Norman apo Disfatën e Armadës. Askush nuk mund t'i vërtetojë ato me anë të logjikës, siç vërtetohet diçka në matematikë. Ne i besojmë thjesht sepse njerëz që i panë ato, lanë shkrime ku flitet për to: pra, mbi bazën e autoritetit. Dikush që e refuzon autoritetin në gjërat e tjera, siç bëjnë disa me fenë, do t'i duhet të kënaqej duke mos ditur asgjë gjithë jetën e tij.

Mos mendoni se po i vendos pagëzimin, besimin dhe kungimin si gjëra që e zëvendësojnë përpjekjen tënde për të kopjuar Krishtin. Jeta jote natyrore vjen nga ajo e prindërve të tu. Kjo nuk do të thotë se do të qëndrojnë aty nëse ti nuk kujdesesh për të. Ti mund ta humbësh atë duke e neglizhuar, ose mund ta largosh duke kryer vetëvrasje. Ty të duhet ta ushqesh dhe të kujdesesh për të: por kurrë mos harro se ti nuk po e krijon atë, thjesht po kujdesesh për një jetë që e more nga dikush tjetër. Në të njëjtën mënyrë, një i krishterë

mund ta humbë jetën e Krishtit që është vënë në të dhe duhet të përpiqet të kujdeset për të. Por, edhe i krishteri më i mirë që ka jetuar ndonjëherë, nuk vepron me fuqinë e tij—ai thjesht po ushqen dhe mbron një jetë që nuk do të mund ta fitonte kurrë me forcat e tij. Dhe kjo ka rrjedhoja praktike. Për aq kohë sa jeta natyrore është në trupin tënd, do të bëjë shumë për ta riparuar atë. Preje dhe, deri njëfarë mase, do të shërohet, gjë që nuk mund ta bëjë një trup i vdekur. Një trup i gjallë nuk mund të ruhet pa u lënduar kurrë, por mund ta riparojë veten deri në njëfarë mase. Në të njëjtën mënyrë, një i krishterë nuk është dikush që nuk gabon kurrë, por një që mund të pendohet dhe ta marrë veten për ta nisur sërish pas çdo pengimi—sepse jeta e Krishtit është në të, duke e riparuar tërë kohës, duke i mundësuar të përsërisë (deri diku) atë vdekje të vullnetshme që kaloi Krishti vetë.

Për këtë arsye, një i krishterë është në një pozitë të ndryshme nga njerëzit e tjerë që përpiqen të jenë të mirë. Këta shpresojnë se, duke qenë të mirë, do ta kënaqin Perëndinë, nëse ka një të tillë; ose—nëse nuk mendojnë se ka—të paktën shpresojnë të marrin miratim nga njerëz të mirë. Por i krishteri mendon se çfarëdo e mirë që ai bën, vjen nga jeta e Krishtit brenda tij. Ai nuk mendon se Perëndia do të na dojë për shkak se jemi të mirë, por që Perëndia do të na bëjë të mirë sepse Ai na do; dielli nuk e shkëlqen një serrë ngaqë kjo është e shndritshme vetë; ajo bëhet e shndritshme për shkak se dielli shkëlqen mbi të.

Dhe, që të jem i qartë, të krishterët nuk flasin për diçka mendore apo morale kur thonë se jeta e Krishtit është në ta. Kur thonë se Krishti është “në ta” ose ata “në Krishtin”, kjo nuk është thjesht një mënyrë të thëni se po mendojnë për Krishtin apo po e imitojnë atë. Ata duan të thonë se Krishti po

vepron realisht përmes tyre; se e gjithë masa e të krishterëve është organizmi fizik me anë të të cilit Krishti vepron—se ne jemi gishtërinjtë dhe muskujt e Tij, qelizat e trupit të Tij. Mbase kjo shpjegon një a dy gjëra. E shpjegon se përse kjo jetë e re përhapet, jo vetëm me veprime mendore, si besimi, por me veprime trupore si pagëzimi dhe kungimi. Nuk është thjesht përhapje e një ideje. Është e ngjashme me një evolucion—një fakt biologjik ose superbiologjik. Është e kotë të tentosh të jesh më shpirtëror se Perëndia. Perëndia vetë asnjëherë nuk kërkoi që njeriu të ishte krijesë thjesht shpirtërore. Prandaj ai përdor gjërat materiale si buka dhe vera për ta vendosur këtë jetë të re në ne. Kjo mund të na duket primitive dhe joshpirtërore. Por jo Perëndisë. Të ngrënit e shpiku Ai. Atij i pëlqen materia. Ai e shpiku vetë.

Edhe diçka tjetër, që dikur më habiste. A nuk është tmerrësisht e padrejtë që kjo jetë e re kufizohet vetëm për njerëzit që kanë dëgjuar për Krishtin dhe kanë mundur të besojnë në Të? Por e vërteta është se Perëndia nuk na i ka thënë planet e tij për njerëzit e tjerë. Ne e dimë se askush nuk mund të shpëtohet pa Krishtin; ne nuk e dimë nëse vetëm ata që e njohin Atë mund të shpëtohen përmes Tij. Mirëpo, në të njëjtën kohë, nëse shqetësohesh për njerëzit jashtë, gjëja më e paarsyeshme që mund të bësh është të qëndrosh jashtë vetë. Të krishterët janë trupi i Krishtit, organizmi përmes të cilit ai punon. Çdo shtesë e këtij trupi i mundëson atij të bëjë më shumë. Nëse do të ndihmosh ata jashtë, duhet t'ia shtosh qelizën tënde trupit të Krishtit, të vetmit që mund t'i ndihmojë. Do të ishte e çuditshme ta bëje dikë të punonte më shumë duke ia prerë gishtërinjtë.

Një tjetër kundërshtim mund të jetë ky. Pse Perëndia po zbret në këtë botë të pushtuar prej armikut i maskuar dhe po

nis një lloj shoqërie sekrete për ta sabotuar djallin? Pse nuk po zbret me forcë, ta zaptojë atë? A mos nuk është mjaftueshëm i fortë? Në fakt të krishterët besojnë se Ai do të zbresë vërtet me forcë; kur, nuk e dimë. Por mund ta marrim me mend se përse po vonohet. Ai kërkon të na japë mundësinë t'i bashkohemi lirisht. Nuk besoj se do të të linte mbresë një francez i cili do të priste sa të hynin forcat aleate në Gjermani e pastaj të thoshte se është në krahun tonë. Perëndia do të pushtojë. Por nuk e di nëse njerëzit, që i kërkojnë Perëndisë të ndërhyjë në mënyrë të hapur dhe të drejtpërdrejtë në botën tonë, e kuptojnë vërtet se çfarë do të ndodhë kur Ai ta bëjë këtë. Ajo që do të ndodhë është fundi i botës. Kur autori hyn në skenë, drama përfundon. Perëndia do të pushtojë, të mos merakoset njeri për këtë. Por ç'vlerë ka të thuash se je në krahun e Perëndisë atëherë, kur të shohësh krejt universin natyror të tretet si një ëndërr dhe diçka tjetër—e cila kurrë nuk do të të kishte shkuar ndër mend—të të bjerë mbi kokë; diçka, kaq e bukur për disa prej nesh dhe kaq e llahtarshme për të tjerët, sa që asnjërit nuk do t'i ngelet zgjedhje? Pasi, këtë herë, Perëndia do të jetë i pamaskuar; diçka kaq e papërballueshme sa do të shkaktonte ose një dashuri të parezistueshme, ose një tmerr të parezistueshëm, në çdo krijesë. Do të jetë tepër vonë atëherë për të zgjedhur krahun. Nuk ka kuptim të thuash se po zgjedh të qëndrosh shtrirë kur nuk mund të ngrihesh dot. Nuk do të jetë kjo koha për të bërë zgjedhjen; do të jetë koha për të zbuluar cilin krah kemi zgjedhur, edhe nëse nuk e kishim kuptuar më përpara. Tani, sot, ky moment, është mundësia jonë për të zgjedhur anën e duhur. Perëndia po vonon që të na e japë këtë mundësi. Por kjo nuk do të zgjasë përgjithmonë. Duhet ta marrim, ose ta lëmë.

LIBRI TRE

SJELLJA E KRISHTERË

TRI PJESËT E MORALIT

E pyetën një herë një nxënës shkolle se si mendonte ai se ishte Perëndia. Ai u përgjigj se Perëndia, me sa mund të kuptonte ai, ishte “një lloj personi që vjen vërdallë për të parë nëse dikush po kënaqet dhe përpiqet ta ndalojë”. Dhe kam frikë se kjo është ideja, që u krijohet në kokë shumë njerëzve, kur dëgjojnë fjalën *Moral*: diçka që ndërhyr, që nuk të lejon t’ia kalosh mirë. Në fakt, rregullat e moralit janë udhëzime për mirëfunksionimin e makinerisë njerëzore. Çdo rregull moral ekziston për të parandaluar një fikje, një dëmtim apo një keqfunksionim të operimit të kësaj makinerie. Për këtë arsye, në fillim duket sikur rregullat po ndërhyjnë vazhdimisht në prirjet tona të natyrshme. Kur mëson të përdorësh një makineri, instruktori vazhdimisht thotë: “Jo, mos e bëj ashtu!”. Kjo pasi ka padyshim gjëra që duken si mënyra të rregullta dhe të natyrshme për ta trajtuar makinerinë; mirëpo, në të vërtetë, nuk funksionojnë.

Disa njerëzve u pëlqen të flasin më shumë për “ideale” morale në vend të rregullave morale; për “idealizmin” moral në vend të bindjes morale. Tani, sigurisht që përsosmëria morale është vërtet një “ideal”, në kuptimin që atë nuk mund ta arrijmë dot. Në këtë kuptim, çdo lloj përsosmërie është

ideale për ne njerëzit; ne nuk mund t'ia dalim të jemi shoferë të përsosur apo lojtarë tenisi të përsosur apo të vizatojmë vija përsosmërisht të drejta. Por ka një kuptim tjetër të cilësimit “ideale” të përsosmërisë morale, i cili rezulton çorientues. Kur dikush thotë se një femër, apo një shtëpi, një anije apo një kopsht i caktuar janë “ideali i tij”, ai nuk po thotë (nëse nuk është pa mend) se të gjithë të tjerët duhet të kenë të njëjtin ideal. Në çështje të tilla secili ka të drejtën të ketë shije, si edhe ideale, të ndryshëm. Mirëpo është e rrezikshme ta përshkruash atë që përpiqet fort të zbatojë ligjin moral, si “njeri me ideale të lartë”; pasi kjo mund të të çojë në mendimin se përsosmëria morale është një shije private e tij dhe ne të tjerët nuk jemi të detyruar ta ndajmë me të. Ky do të ishte një gabim katastrofik. Sjellja e përsosur mund të jetë po aq e paarritshme për ne sa edhe ndërrimi i përsosur i marsheve, por mbetet një ideal i domosdoshëm që është i detyruar për të gjithë njerëzit; ashtu si ndërrimi i përsosur i marsheve është një ideal i detyruar për të gjithë shoferët nga vetë natyra e automjeteve. Gjithashtu, do të ishte edhe më e rrezikshme nëse dikush e mendon veten si person me “ideale të lartë” ngaqë përpiqet të mos thotë asnjë gënjeshtër (dhe jo të thotë sa më pak) ose të mos e shkelë kurrë kurorën (jo thjesht në të rrallë), ose të mos keqtrajtojë të tjerët (jo thjesht ta bëjë sa më pak). Diçka e tillë mund të të bëjë të jesh arrogant dhe të mendosh se je një person i veçantë, i cili meriton të lavdërohet për “idealizmin” e tij. Kjo në të vërtetë është si të presësh të të lavdërojnë ngaqë përpiqesh ta nxjerrësh rezultatin saktë, kur bën një mbledhje numrash. Pa diskutim që aritmetika e përsosur është një “ideal”; sigurisht që disa gabime do t'i bësh në llogaritje. Por të përpiqesh të jesh sa më i saktë në çdo hap të mbledhjes nuk është aspak e

habitshme. Të mos veproje kështu do të ishte idiotësi, sepse çdo gabim të hap telashe në vazhdim. Në të njëjtën mënyrë, çdo dështim moral të hap telashe; me siguri për të tjerët dhe, pa diskutim, për veten tënde. Është mirë që, në vend të “idealeve” dhe “idealizmit”, të flasim për rregulla dhe bindje, që t’ia kujtojmë vetes këto fakte.

Tani të shkojmë një hap më tej. Dy janë mënyrat se si makineria njerëzore mund të prishet. Njëra është kur individët njerëzorë ndahen me njëri-tjetrin, përplasen me njëri-tjetrin dhe e dëmtojnë njëri-tjetrin, duke mashtruar apo keqtrajtuar. Mënyra tjetër ndodh kur gjërat shkojnë keq brenda individit—kur pjesët e ndryshme të tij (aftësitë, dëshirat, etj.) ose ndahen, ose kanë konflikt me njëra-tjetrën. Mendoni sikur jemi një flotë anijesh që lundrojnë në formacion. Udhëtimi do të jetë i suksesshëm nëse, në radhë të parë, anijet nuk përplasen apo pengojnë njëra-tjetrën; dhe, në radhë të dytë, nëse secila anije është në gjendje të mirë dhe i ka motorët në rregull. Këto të dyja faktikisht janë të lidhura me njëra-tjetrën. Nëse anijet përplasen vazhdimisht, nuk mund të mbeten në gjendje të mirë. Dhe nga ana tjetër, nëse nuk e kanë në rregull grupin e timonit, përplasjet do të jenë të pamundura të shmangen. Ose, nëse doni, mendojeni njerëzimin si një grup muzikor që duhet të luajë një melodi. Për të arritur rezultate të mira, ju duhen dy gjëra. Çdo instrument individual duhet të jetë i akorduar dhe, gjithashtu, duhet të luhet në çastin e duhur për t’u kombinuar me të gjithë të tjerët.

Mirëpo, nuk e kemi marrë ende në konsideratë edhe diçka tjetër. Ne nuk kemi pyetur se ku po përpiqet të shkojë flota, apo çfarë lloj muzike po përpiqet të luajë grupi. Instrumentet mund të jenë të gjithë të akorduar dhe të luhen në çastin e duhur, megjithatë performanca do të ishte sërish dështim,

nëse grupi duhej të luante muzikë vallëzimi, por luan vetëm marshe funebre. Dhe, sado mirë të ketë lundruar flota, lundrimi do të ishte dështim nëse ajo arrin në Kalkuta, kur në fakt duhej të mbërrinte në Nju Jork.

Morali pra, duket se përfshin tre gjëra. E para, drejtësi dhe harmoni midis individëve. E dyta, atë që mund ta quajmë rregullimin dhe harmonizimin e gjërave brenda çdo individi. E treta, qëllimin e përgjithshëm të jetës njerëzore në tërësi: për çfarë u krijua njeriu, në ç’kurs duhet të lundrojë flota, çfarë melodi i kërkon dirigjenti grupit të luajë.

Besoj se e keni vënë re që njerëzit sot mendojnë thuasjë gjithnjë për të parën, ndërsa dy të tjerat i harrojnë. Kur njerëzit thonë nëpër gazeta se po përpiqemi për standarde morale të krishtera, zakonisht nënkuptojnë se midis kombeve, klasave dhe individëve po punohet për mirësi dhe drejtësi. Pra, po mendojnë për gjënë e parë. Kur një njeri thotë për diçka që do të bëjë: “S’ka si të jetë gabim, sepse nuk i bën dëm kujt”, në mendje ka vetëm gjënë e parë. Ai po mendon se nuk ka rëndësi se si është anija e tij, për aq kohë sa nuk përplasat me anijen tjetër. Dhe është e natyrshme që, kur flasim për moralin, ta nisim me të parën: marrëdhëniet shoqërore. Pasi, pasojat e moralit të keq në këtë aspekt janë shumë të dukshme dhe na ndikojnë çdo ditë: luftëra, varfëri, rryshfete, gënjeshttra, punë të bëra shkel e shko. Gjithashtu, për moralin nuk ka aq mosmarrëveshje nëse qëndrojmë vetëm te gjëja e parë. Gati të gjithë njerëzit e të gjitha kohërave kanë rënë dakord (teorikisht) që njerëzit duhet të jenë të ndershëm dhe të mirë e ndihmues me njëri-tjetrin. Por, megjithëse është e natyrshme ta nisim aty, nëse mendimi ynë për moralin mbetet me kaq, është si të mos e kishim menduar fare. Nëse nuk kalojmë te gjëja e dytë—vënia në rregull nga brenda e çdo

qenieje njerëzore—jemi thjesht duke gënjyer veten.

Ç'dobi ka t'u kërkosh anijeve të lundrojnë duke shmangur përplasjet, kur në fakt ato janë hekurishte aq të vjetëruara sa nuk mund të drejtohen? Çfarë dobie ka të hartojmë, nëpër fletore, rregulla për sjelljen në shoqëri, kur e dimë se faktikisht lakmia, burracakëria, zemërimi i pavend dhe mendjemadhësia nuk do të na lejojnë t'i zbatojmë ato? Nuk po them as për një çast të vetëm se nuk na duhet të mendojmë, dhe mirë madje, për përmirësimin e sistemit tonë shoqëror-ekonomik. Ajo çka dua të them është se gjithë këto mendime do të ishin dokrra, po nuk e kuptuam se asnjë sistem nuk funksionon siç duhet pa kurajë dhe vetëmohim nga individët. Është e lehtë të heqësh rryshfetet dhe keqtrajtimin e sistemit aktual: por, nëse njerëzit vazhdojnë të jenë mashtrues dhe harbutë, do ta gjejnë një mënyrë të re për ta vazhduar lojën e vjetër edhe me ndryshimet e sistemit. Njerëzit nuk mund të bëhen të mirë prej ligjit: dhe pa njerëz të mirë nuk mund të kemi shoqëri të mirë. Prandaj na duhet të marrim parasysh gjënë e dytë: moralin brenda individit.

Por nuk mund ta lëmë as me kaq. Tani po arrijmë në pikën ku besimet e ndryshme për universin çojnë në sjellje të ndryshme. Në pamje të parë do të dukej mjaft e arsyeshme të ndalonim pa arritur në këtë pikë, duke u marrë thjesht me ato pjesë të moralit që pranojnë të gjithë njerëzit e logjikshëm. Por, a mund ta bëjmë këtë? Mos harroni se feja përfshin një sërë deklaratash në lidhje me faktet, të cilat mund të jenë të vërteta, ose të rreme. Nëse ato janë të vërteta, do të rezultojnë në një sërë përfundimesh për drejtimin e duhur të flotës njerëzore: nëse janë të rreme, në një sërë përfundimesh të tjera. Le t'i kthehemi, për shembull, personit që thotë se diçka nuk mund të jetë gabim nëse nuk e lëndon një qenie

tjetër njerëzore. Ai e kupton fare mirë se nuk duhet të dëmtojë anijet e tjera të karvanit, por çfarë bën me anijen e tij ai mendon sinqerisht se është vetëm puna e tij. Mirëpo a nuk varet kjo nëse anija është apo jo në pronësinë e tij? A nuk përbën një dallim të madh nëse unë nuk jam, si të thuash, pronari i mendjes dhe trupit tim, por një qiramarrës, i cili i jep llogari pronarit të vërtetë? Nëse më bëri dikush tjetër, për qëllimet e tij, atëherë unë duhet të kem shumë detyra të cilat nuk do t'i kisha, nëse thjesht do t'i përkisja vetvetes.

Sërish, krishterimi pohon se çdo individ njerëzor do të jetojë përgjithmonë, përjetësisht: gjë që është ose e vërtetë, ose e rreme. Tani, ka një numër të madh gjërash për të cilat nuk do të kishte vlerë të shqetësoheshim, nëse do të jetonim vetëm 70 vjet; por bëjmë mirë të shqetësohemi, madje shumë, nëse kemi për të jetuar përgjithmonë. Mbase temperamentimi i keq ose xhelozia ime po rriten gradualisht—aq gradualisht sa nuk mund të dallohet në 70 vjet. Por pas një milion vjetësh do të ishte një ferr absolut: në fakt, nëse krishterimi është i vërtetë, ferri është termi korrekt për këtë gjë nga ana teknike. Dhe, meqë ra fjala, pavdekshmëria përbën edhe një dallim tjetër që lidhet me dallimin mes totalitarizmit dhe demokracisë. Nëse individët jetojnë vetëm 70 vjet, atëherë një shtet, komb apo qytetërim, i cili mund të zgjasë një mijë vjet, është më i rëndësishëm se një individ. Por, nëse krishterimi është i vërtetë, atëherë individi nuk është thjesht më i rëndësishëm, por i rëndësishëm përtej masës, pasi ai është i përjetshëm. Jeta e një shteti apo një qytetërimi, është thjesht një çast, në krahasim me të.

Duket, prase, nëse mendojmë për moralin, duhet të mbajmë parasysh të tre departamentet e tij: marrëdhëniet e njeriut me njeriun, gjërat brenda njeriut dhe marrëdhëniet e njeriut

TRI PJESËT E MORALIT

me fuqinë që e krijoi atë. Të gjithë mund të bashkëpunojmë për të parën. Mosmarrëveshjet nisin me të dytën dhe bëhen serioze me të tretën. Tek e treta bëhen të dukshme dallimet midis moralit të krishterë dhe jo-të krishterë. Në vijim të librit, do të vazhdoj duke pranuar pikëpamjen e krishterë dhe duke e parë gjithë tablonë me supozimin se krishterimi është i vërtetë.

VIRTYTET “THEMELTARE”

Pjesa e mëparshme u krijua fillimisht si një bisedë e transmetuar në radio.

Nëse ke vetëm dhjetë minuta kohë për të folur, kufizimi të detyron të flijosh thuajse gjithçka tjetër. Një nga shkaqet kryesore pse, me imazhin tim të karvanit të anijeve, e paraqita moralin në tre pjesë, ishte pasi kjo dukej mënyra më e shkurtër për ta përmbledhur idenë kryesore. Tani dua t’ju paraqes një mënyrë tjetër se si është ndarë kjo çështje nga shkrimtarët e vjetër, e cila ishte tepër e gjatë për bisedat e mia në radio, por mbetet shumë e vlefshme.

Sipas kësaj skeme më të zgjeruar, ka shtatë “virtyte”. Katër prej tyre quhen virtyte “themeltare”, dhe tre të tjerat virtyte “teologjike”. “Themeltaret” janë ato të cilat njihen prej të gjithë njerëzve të qytetëruar: “teologjiket” janë ato që, si rregull, njihen vetëm prej të krishterëve. Me teologjiket do të merremi më vonë: në këtë çast po flas për katër virtytet themeltare.⁴ Quhen themeltare sepse, si të themi, gjërat varen prej tyre, ashtu si dera varet nga menteshat.) Ato janë: *maturia, vetëpërmbajtja, drejtësia dhe qëndrueshmëria*.

Maturia nënkupton logjikën praktike normale, të men-

4 Në anglisht, Cardinal. (shën. i përkth.)

duarin e asaj që do të bësh dhe çfarë do të ndodhë si pasojë e kësaj. Shumica e njerëzve sot vështirë se e mendojnë *maturinë* si një “virtut”. Në fakt, ngaqë Krishti tha se mund të hyjmë në botën e Tij duke u bërë si fëmijët, shumë të krishterëve u është krijuar ideja se, për aq kohë sa je “i mirë”, nuk ka rëndësi se je budalla. Ky është një keqkuptim. Së pari, shumica e fëmijëve tregojnë mjaft “maturi” në bërjen e gjërave që u interesojnë vërtet, dhe i mendojnë ato me kujdes. Së dyti, siç vë në dukje shën Pali, Krishti kurrë nuk donte të thoshte se duhet të mbetemi fëmijë në *inteligjencën* tonë: përkundrazi. Ai na tha të mos ishim thjesht “të pastër si pëllumbat”, por edhe “të mençur si gjarpërinjtë”. Ai kërkon zemrën e një fëmije, por mendjen e një të rrituri. Ai do që të jemi të thjeshtë, pa mëdyshje, të dashur dhe të mësueshëm, siç janë të gjithë fëmijët e mirë; por Ai do gjithashtu çdo pjesë të inteligjencës sonë në gjendje gatishmërie dhe në përgatitje luftarake të klasit të parë. Fakti që po jep para për një bamirësi, nuk nënkupton se nuk duhet të përpiqesh të kuptosh nëse bamirësia është e vërtetë apo një mashtrim. Fakti që ti po mendon për vetë Perëndinë (kur lutesh, për shembull), nuk nënkupton se mund të jesh i kënaqur me po ato ide fëminore që kishe në moshën pesë-vjeçare. Sigurisht që Perëndia nuk do të të dojë më pak për këtë, apo të të pranojë më pak nëse rastis të kesh lindur me një tru jo plotësisht të zhvilluar. Ai u bën vend edhe njerëzve me pak logjikë, por kërkon që secili ta përdorë logjikën që ka. Parimi i duhur nuk është “ji e mirë, zonjushë e dashur, dhe i zgjuar le të jetë kush të dojë”, por “Ji e mirë, zonjushë e dashur, dhe mos harro se kjo nënkupton të qenit sa më e zgjuar të mundesh”. Perëndia nuk i ka qejf përtacët, përfshirë përtacët intelektualë. Nëse po mendon të bëhesh i krishterë, të paralajmëroj se je duke i hyrë diçkaje që kërkon

gjithë qenien tënde, përfshirë mendjen. Por, fatmirësisht, funksionon edhe anasjellas. Personi, që po përpiket të jetë i krishterë, do të zbulojë se intelijenca e tij po kalitet. Një nga arsyt pse nuk nevojitet arsim i veçantë për të qenë i krishterë, është pasi krishterimi vetë është arsimim. Prandaj, një besimtar i paarsimuar si Bunyan-i, arriti të shkruante një libër që mahniti krejt botën.

Vetëpërmbajtja është një fjalë që, fatkeqësisht, i është ndryshuar kuptimi. Tani (në anglisht) zakonisht nënkupton heqjen dorë plotësisht nga pijet alkoolike. Por në ditët kur virtyti i dytë themeltar u pagëzua me emrin “vetëpërmbajtje”, nënkuptonte diçka krejt tjetër. Vetëpërmbajtja nuk lidhet vetëm me pijen, por me të gjitha kënaqësitë; dhe nuk nënkupton heqjen dorë prej tyre, por mbajtjen e tyre në masën e duhur dhe jo më tepër. Nuk është e vërtetë që të gjithë të krishterët duhet të mos pinë alkool; feja që e kërkon këtë është muhamedanizmi, jo krishterimi. Sigurisht që një i krishterë i caktuar, në një kohë të caktuar, mund ta ketë për detyrë të heqë dorë nga pija e fortë, qoftë për shkak se nuk pi dot pa e tepruar, qoftë sepse do t’ua japë ato para të varfërve, qoftë pasi është me njerëz të prirur për t’u dehur dhe nuk duhet t’i inkurajojë ata të pinë duke pirë vetë. Por e gjithë ideja qëndron në faktin se ai po heq dorë për një arsye të mirë, dhe prej diçkaje që ai nuk e dënon e që i pëlqen që të tjerët e shijojnë. Një prej treguesve të një lloji të caktuar njeriu të keq, është se ai nuk mund të heqë dorë nga diçka, pa kërkuar që edhe të gjithë të tjerët të heqin dorë prej saj. Udhë e krishterë nuk është e tillë. Një i krishterë mund të heqë dorë individualisht nga gjithfarë gjërash, për arsye të veçanta—nga martesë, mish, birra, kinemaja; por në çastin që ai nis të thotë se këto gjëra janë të këqija në vetvete, ose i

përçmon njerëzit e tjerë që i përdorin ato, ai ka marrë rrugën e gabuar.

Është bërë një dëm i madh me kufizimin modern të kuptimit të fjalës vetëpërmbytje për të nënkuptuar vetëm pijen. Ka bërë që njerëzit të harrojnë se mund të kenë mungesë vetëpërmbytjeje edhe për një sërë gjërash të tjera. Dikush që e bën lojën e golfit apo motoçikletën qendër të jetës së tij, ose një grua që ia kushton gjithë mendimet e saj veshjes apo lojës së letrave apo qenit të saj, ka po aq mungesë vetëpërmbytjeje sa dikush që dehet çdo mbrëmje. Patjetër që nuk është njësoj e dukshme nga jashtë: mania e lojës së letrave apo të golfit nuk të bën të biesh në mes të rrugës. Por Perëndia nuk mashtrohet nga pamja e jashtme.

Drejtësia përfshin më shumë se thjesht atë çka ndodh në sallat e gjyqit. Është fjala e vjetër (në anglisht) për të gjitha ato që tani i quajmë “gjëra të drejta”; duke përfshirë ndershmërinë, lëshimin dhe kompromisin, vërtetësinë, mbajtjen e premtimeve dhe gjëra të tilla të jetës. Dhe qëndrueshmëria përfshin kurajë të të dyja llojeve—të llojit që përballet me rrezikun, si edhe të llojit që reziston gjatë dhimbjes. Mbase fjala “guxim” është më e përafërta në gjuhën e sotme. Sigurisht do ta vini re se është e pamundur të praktikoni ndonjë nga virtytet e tjera për shumë kohë, pa e futur edhe këtë në lojë.

Ka edhe diçka tjetër në lidhje me virtytet që duhet vënë në pah. Ekziston një dallim midis bërjes së një veprimi të drejtë me vetëpërmbytje dhe të qenit një njeri i drejtë me vetëpërmbytje. Dikush që nuk është lojtar i mirë tenisi edhe mund të bëjë një gjuajtje të mirë, herë pas here. Kur themi “lojtar i mirë”, flasim për dikë, sytë dhe muskujt e nervat e të cilit janë trajnuar aq shumë nga gjuajtje të mira aq të

panumërta, sa tani mund të mbështetet i qetë në to. Ato kanë një ton dhe një cilësi, e cila është e pranishme edhe kur ai nuk po luan, ashtu si mendja e një matematicieni ka një zakon dhe këndvështrim të caktuar që është aty, edhe kur ai nuk po merret me matematikë. Në të njëjtën mënyrë, njeriu, që këmbëngul në bërjen vazhdimisht të veprimeve të drejta, fiton një lloj cilësie të karakterit. Tani këtë cilësi, jo veprimet e veçanta, kemi në mendje kur flasim për një “virtyt”.

Ky dallim është me rëndësi për këto arsye. Nëse mendojmë vetëm për veprimet e veçanta, rrezikojmë të inkurajojmë tre ide të gabuara.

(1) Mund të mendojmë se, për sa kohë që bën gjënë e drejtë, nuk ka rëndësi se si dhe pse e bën atë—nëse e bën vullnetarisht apo me detyrim, turivarur apo me gëzim, nga frika e opinionit publik apo ngaqë ishte gjëja e duhur. Mirëpo veprimet e drejta, të kryera për arsyet e gabuara, nuk ndihmojnë vërtet në krijimin e cilësisë apo karakterit të brendshëm të quajtur “virtyt”; dhe kjo është cilësia, apo karakteri, që ka vërtet rëndësi. (Nëse një lojtar i dobët tenisi gjuan fort, jo se duhej, por sepse iu ngritën nervat, mund të ndodhë që, për fat, goditja e tij e ndihmon të fitojë një lojë të caktuar. Por nuk e ndihmon të bëhet një lojtar i besueshëm.)

(2) Mund të mendojmë se Perëndia kërkon thjesht bindje ndaj një sërë rregullash të caktuara: në fakt ai kërkon njerëz të një lloji të caktuar.

(3) Mund të mendojmë se “virtytet” janë të nevojshme vetëm për këtë jetën tani—se në botën tjetër mund të pushojmë së qeni të drejtë, pasi nuk do të ketë gjë për të qenë të padrejtë, apo do të pushojmë së qeni guximtarë pasi nuk do të ketë rrezik. Faktikisht është e vërtetë se me siguri nuk do të ketë rast për vepra të drejta apo kurajoze në botën tjetër,

VIRTYTET “THEMELTARE”

por do të ketë çdo rast për të qenë ata lloj njerëzish që mund të bëhemi vetëm si rezultati bërjes së veprimeve të tilla këtu. Nuk është ideja që Perëndia nuk do të të pranojë në botën e Tij të përjetshme po nuk pate disa cilësi karakteri. Ideja është që, nëse njerëzit nuk kanë së paku fillimet e këtyre cilësive brenda tyre, as edhe një kusht i jashtëm nuk mund të bëjë për ta një “qiell” —domethënë, të mund t’i bëjë të lumtur me lumturinë e thellë, të fortë dhe të palëkundshme që Perëndia synon për ne.

MORALI SHOQËROR

Gjëja e parë, që duhet qartësuar për moralin e krishterë për marrëdhëniet midis njerëzve, është se në këtë ndarje Krishti nuk erdhi të predikojë një lloj morali të ri. Rregulli i artë i Besëlidhjes së Re, “bëju të tjerëve atë që dëshiron të ta bëjnë edhe ty,” është përmbledhje e asaj që të gjithë në thelb e kanë ditur se është gjëja e drejtë. Mësuesit vërtet të mëdhenj të moralit nuk prezantojnë asnjëherë morale të reja: këtë e bëjnë kokëboshët dhe sharlatanët. “Njerëzit kanë më shumë nevojë të kujtohen, sesa të udhëzohen”, thotë dr. Johnson-i. Detyra e vërtetë e çdo mësuesi moral është të na kthejë sërish, kohë pas kohe, te parimet e vjetra që kërkojmë si e si të mos i shohim. Është si kthimi i kalit te pengesa që refuzoi të kalojë, ose i fëmijës te mësimi që kërkon të mos e bëjë.

Gjëja e dytë, që duhet bërë e qartë, është se krishterimi nuk ka dhe nuk pretendon të ketë një program politik mbi zbatimin e rregullit “bëju të tjerëve atë që dëshiron të ta bëjnë edhe ty ” në një shoqëri të caktuar dhe në një moment të caktuar. Nuk mund të ketë. Ky rregull është për të gjithë njerëzit e të gjitha kohëve dhe, programi i caktuar që përshtatet me një vend dhe kohë të caktuar, nuk përshtatet me një tjetër. Për më tepër, krishterimi nuk funksionon në këtë mënyrë. Kur të thotë të ushqesh të uriturit, nuk të jep

mësime në gatim. Kur të thotë të lexosh Shkrimet, nuk të jep mësime në hebraisht e greqisht, e as në gramatikën e gjuhës sate. Qëllimi nuk ka qenë kurrë të zëvendësojë apo tejkalojë artet dhe shkencat e zakonshme humane. Ai është më tepër si një regjisor që do t'i vendosë të gjitha ato në punët e duhura; si një burim energjie që do t'u japë atyre jetë të re, nëse e vendosin veten në dispozicion të tij.

Njerëzit thonë: “Kisha duhet të jetë shembull”. Kjo është e vërtetë kur thuhet në kuptimin e duhur, por e rreme kur thuhet në kuptimin e gabuar. Kur thonë kisha, duhet të jenë duke folur për të gjithë trupin e të krishterëve. E kur thonë se kisha duhet të jetë shembull, duhet të jenë duke thënë se disa të krishterë—të cilët do të kenë talentet e duhura—duhet të jenë ekonomistë dhe shtetarë, dhe se të gjithë ekonomistët dhe shtetarët duhet të jenë të krishterë, dhe se gjithë përpjekjet e tyre në politikë dhe ekonomi duhet t'i shërbejnë zbatimit të rregullit “bëju të tjerëve atë që dëshiron të ta bëjnë edhe ty”. Po të ndodhte kjo dhe, po të ishim gati ne të tjerët ta prananim atë, zgjidhja e krishterë për problemet tona shoqërore do të gjendej shumë shpejt. Mirëpo, kur ata kërkojnë shembullin e kishës, sigurisht që shumica e njerëzve duan të thonë se klerikët duhet të paraqesin një program politik. Kjo është qesharake. Klerikët janë njerëz të caktuar brenda kishës, të trajnuar dhe ndarë mënjane veçanërisht për t'u kujdesur për gjërat dhe çështjet që na prekin si krijesa që do të jetojmë përgjithmonë. Duke u kërkuar të bëjnë një punë për të cilën nuk janë trajnuar, po u kërkojnë diçka shumë të vështirë. Në të vërtetë, këtë detyrë e kemi ne, joklerikët. Zbatimi i parimeve të krishtera tek arsimit apo sindikatat për shembull, duhet të vijë nga arsimtarë të krishterë dhe anëtarë të krishterë sindikatash. Letërsia e krishterë vjen

nga romancierë e dramaturgë të krishterë—jo nga peshkopë që ulen bashkë e përpiqen të shkruajnë drama e romane në kohën e tyre të lirë.

Në të njëjtën kohë, Besëlidhja e Re na jep një ide të qartë se ç’pamje ka një shoqëri krejtësisht e krishterë, pa hyrë në detaje. Mbase na jep më shumë se sa mund të përballojmë. Ajo na thotë se nuk mund të jemi pasagjerë apo parazitë: kush nuk punon, as të mos hajë. Njeriu duhet të punojë me duart e tij e, për më tepër, puna e secilit duhet të prodhojë diçka të mirë: pa prodhim të kotësive luksoze apo reklamave akoma më të kota që të na bindin t’i blejmë. Dhe nuk duhet të ketë as ndjekje të kotë të modës, mburrje boshe për t’u dukur. Deri në këtë masë, një shoqëri e krishterë në ditët e sotme do të cilësohej si e majtë. Nga ana tjetër, ajo gjithnjë këmbëngul në bindje—bindje (dhe shprehje e jashtme e respektit) nga të gjithë ne kundrejt gjyqtarëve të caktuar me ligjshmëri, nga fëmijët kundrejt prindërve dhe (kam frikë se kjo do të më tregojë si të prapambetur) nga gratë kundrejt burrave. Së treti, ajo duhet të jetë një shoqëri e gëzueshme: plot me këngë e hare, që shqetësimin dhe ankthin i cilëson si gabime. Mirësjellja është një nga virtytet e krishtera; dhe Besëlidhja e re i urren ata që merren me punët e të tjerëve.

Nëse do të ekzistonte një shoqëri e tillë dhe ti apo unë do ta vizitonim, mendoj se do të na linte përshtypje interesante. Do të ndiheshim sikur jeta e saj ekonomike ishte tepër socialiste dhe, në këtë kuptim, “e përparuar”, por që jeta familjare dhe kodi i sjelljes së saj ishin të vjetra—mbase edhe ceremoniale dhe aristokrate. Secilit prej nesh do t’i pëlqente një ose disa pjesë të saj, por kam frikë se shumë pak do ta pëlqenin të gjithën. Kjo është pritshmëria që dikush duhet të ketë për krishterimin, nëse është plani total për makinerinë njerëzore.

Në mënyra të ndryshme, të gjithë ne e kemi braktisur këtë plan total dhe secili kërkon ta modifikojë në mënyrën e tij, duke thënë se kështu është plani i vërtetë. Do ta hasni këtë çdo herë për çdo gjë që është vërtet e krishterë: të gjithë tërhiqen nga disa pjesë e saj dhe duan t'i marrin ato pjesë e të lënë të tjerat. Prandaj nuk mund të përparojmë: prandaj njerëzit që luftojnë për dy gjëra të kundërta mund të thonë se po luftojnë për krishterimin.

Edhe diçka tjetër. Ka një këshillë të vogël, e cila na është thënë nga grekët e lashtë paganë, judenjtë e Besëlidhjes së Vjetër dhe mësuesit e mëdhenj të krishterë të Mesjetës, të cilën sistemi ekonomik modern e ka shkelur krejtësisht. Të gjithë këta njerëz na thanë të mos japim para hua me interes: dhe huadhënia me interes—ajo që ne e quajmë investim—është baza e gjithë sistemit tonë. Kjo nuk do të thotë patjetër që e kemi gabim. Disa njerëz thonë se kur Moisiu dhe Aristoteli dhe të krishterët ishin në një mendje se interesi (ose “fajdet” siç i quanin ata) ishte i ndaluar, këta nuk mund ta parashikonin shoqërinë aksionere me përgjegjësi të kufizuar dhe po mendonin vetëm për huadhënësit privatë, ndaj nuk kemi pse shqetësohemi për këtë. Unë nuk mund të vendos për këtë çështje. Nuk jam ekonomist dhe e kam thjesht të pamundur ta them nëse sistemi i investimeve është përgjegjës apo jo për gjendjen ku jemi. Këtu do të na duhej ekonomisti i krishterë. Por, do të tregohesha i pandershëm nëse do ta fshihja faktin se tre qytetërime të mëdha ishin në një mendje (ose kështu duket në pamje të parë) për të dënuar pikërisht atë gjë mbi të cilën ne kemi bazuar gjithë jetën tonë.

Edhe diçka të fundit dhe mbaruam. Në pasazhin e Besëlidhjes së Re ku thuhet që secili duhet të punojë, jep një arsye për këtë: “që të ketë t’i japë atij që ka nevojë”. Bamirësia—

t'u japësh të varfërve—është një pjesë thelbësore e moralit të krishterë: në shëmbëlltyrën e frikshme të deleve dhe cjepeve duket se kjo është pika ku bëhet gjithë dallimi. Njerëzit e sotëm thonë se bamirësia duhet të jetë e panevojshme. Në vend që t'u japim të varfërve, duhet të prodhojmë një shoqëri ku të mos ketë të varfër. Këta mund të kenë shumë të drejtë për faktin se duhet të punojmë për të prodhuar një shoqëri të tillë. Por, nëse dikush mendon se, si pasojë e kësaj, mund të pushojë së dhëni, ky i ka kthyer shpinën moralit të krishterë. Nuk besoj se dikush mund ta vendosë se sa duhet të japim. Kam frikë se i vetmi rregull i sigurt është: të japim më shumë nga sa mund ta përballojmë. Domethënë, nëse shpenzojmë për argëtime, për luks e për rehati po aq sa është standardi për ata me të njëjtat të ardhura si ne, ka mundësi që po japim më pak nga sa duhet. Nëse bamirësia jonë nuk na ngushton fare, unë do të thoja se është shumë pak. Duhet të ketë gjëra që do të donim t'i bënim, por nuk do të mundeshim dot, për shkak të shpenzimit për bamirësi. Tani, po flas për “bamirësitë” në kuptimin e zakonshëm. Rastet e vështirësive midis të afërmeve, miqve, fqinjëve dhe punonjësve tanë që, si të thuash, Perëndia na i vë përpara syve, mund të kërkojnë shumë më tepër, madje deri në dëmtimin dhe rrezikimin e vetë pozitës tonë. Për shumë prej nesh, pengesa më e madhe ndaj bamirësisë qëndron, jo në jetën luksoze apo në dëshirën për më shumë para, por në frikë—frikë që vjen nga pasiguria. Kjo duhet dalluar shpesh si tundim. Ndonjëherë bamirësia jonë pengohet nga krenaria. Ne tundohe mi të shpenzojmë më shumë nga sa duhet në format më të dukshme të bujarisë (bakshishe, mikpritje) dhe më pak nga sa duhet për ata që kanë vërtet nevojë për ndihmën tonë.

Dhe tani, para se ta mbyll, po bëj një hamendësim për

mënyrën si i ka ndikuar kjo pjesë ata që e kanë lexuar. Besoj se ka disa njerëz të së majtës që janë shumë të nevrizuar se pse nuk shkoi edhe më tej në këtë drejtim, dhe njerëz të kundërt që janë të nevrizuar pasi mendojnë se ka shkuar më larg se ç'duhej. Nëse është kështu, kjo na vendos përballë pengesën reale të hartimeve të projekteve për një shoqëri të krishterë. Shumica prej nesh nuk i qasemi kësaj teme duke u përpjekur të zbulojmë se çfarë thotë krishterimi: i qasemi me shpresën se te krishterimi do të gjejmë mbështetje për pikëpamjet e partisë sonë. Po kërkojmë për një aleat, ndërsa na ofrohet ose një Zotëri ose... një Gjykatës. Edhe unë kështu jam. Ka gjëra në këtë pjesë të librit që doja t'i lija jashtë tij. Dhe prandaj këto biseda nuk do të arrijnë askund nëse nuk zgjedhim të ndjekim rrugën e gjatë. Shoqëria e krishterë nuk do të vijë, përderisa shumica prej nesh nuk e dëshiron atë vërtet. Dhe ne nuk do ta dëshirojmë atë derisa të bëhemi plotësisht të krishterë. Unë mund ta përsëris shprehjen: “Bëju të tjerëve atë që dëshiron të ta bëjnë edhe ty” derisa të më pushojë zëri, por nuk mund ta zbatoj atë derisa ta dua tjetrin si veten. Dhe unë nuk mund të mësoj ta dua tjetrin si veten derisa të mësoj të dua Perëndinë. Dhe nuk mund të mësoj ta dua Perëndinë nëse nuk mësoj t'i bindem Atij. Ndaj, siç të paralajmërova, jemi të detyruar të shkojmë te diçka më e thellë—nga çështjet sociale, te çështjet fetare. Pasi rruga më e gjatë është ajo që të çon në shtëpi më shpejt.

MORALI DHE PSIKANALIZA

Thashë se nuk do të kemi kurrë një shoqëri të krishterë nëse shumica prej nesh nuk bëhen individë të krishterë. Sigurisht, kjo nuk do të thotë që mund të rrimë pa bërë asgjë për shoqërinë, derisa të vijë një datë imagjinare në të ardhmen e largët. Do të thotë që duhet t'i nisim të dyja punët njëherësh—(1) punën e gjetjes se si zbatohet “Bëju të tjerëve atë që dëshiron të ta bëjnë edhe ty” në detajet e shoqërisë moderne, si edhe (2) punën e të qenit lloji i njerëzve që do ta zbatonim vërtet atë, nëse do ta gjenim mënyrën. Tani dua të filloj të shqyrtoj se cila është ideja e krishterë për një njeri të mirë—specifikimet e krishtera për makinerinë njerëzore.

Para se të arrij te detajet, janë edhe dy pika të përgjithshme që do të doja të parashtroja. Së pari, meqenëse morali i krishterë pretendon të jetë një teknikë për rregullimin e makinerisë njerëzore, mendoj se do t'ju interesonte të dini se si lidhet ajo me një teknikë tjetër, e cila duket se ka të njëjtin pretendim. Kjo është psikanaliza.

Tani, dua të ndaj qartë dy gjëra: teoritë dhe teknikat mjekësore të bazuara në fakte të psikanalistëve, dhe pikëpamjen e përgjithshme filozofike për botën që Frojdi e ca të tjerë ia kanë shtuar të parës. Gjëja e dytë, filozofia e Frojdit, është në kontradiktë të drejtpërdrejtë me krishterimin, dhe

në kontradiktë të drejtpërdrejtë me psikologun tjetër të madh, Jungun. E për më tepër, kur Frojdi flet për mënyrën e kurimit neurotikëve, ai flet si specialist i fushës, por, kur flet për filozofi të përgjithshme, ai flet si amator. Për këtë, është mëse e arsyeshme ta dëgjojmë me respekt në njërën fushë dhe jo në tjetrën: dhe unë këtë bëj. Unë jam edhe më i gatshëm ta bëj këtë pasi kam zbuluar se, kur ai flet jashtë fushës së tij e për një fushë ku unë di diçka (gjuha), ai është shumë injorant. Por psikanaliza vetë, e ndarë nga shtojcat e tjera që i kanë bërë Frojdi e të tjerët, nuk bie as në kontradiktën më të vogël me krishterimin. Teknika e saj përputhet në disa pika me moralin e krishterë; nuk do të ishte keq nëse të gjithë do të dinin diçka në lidhje me të. Por nuk përputhen në çdo gjë, pasi dy teknikat po bëjnë gjëra të ndryshme.

Kur dikush bën një zgjedhje morale, hyjnë në lojë dy gjëra. Njëra është akti i të zgjedhurit. Tjetra janë ndjenjat, impulset e ndryshme që i parashtron përbërja e tij psikologjike, të cilat janë materiali bazë i zgjedhjes së tij. Tani, ky material bazë mund të jetë i dy llojeve. Mund të jetë ajo që ne e quajmë normale: që konsiston në llojet e ndjenjave që janë të përbashkëta për të gjithë njerëzit. Ose mund të konsistojë në ndjenja tepër të panatyrshme për shkak të gjërave që kanë shkuar keq në nënndërgjegjen e tij. Kështu, një shembull i së parës do të ishte frika ndaj gjërave vërtet të rrezikshme. Një frikë e paarsyeshme nga macet ose merimangat do të ishte një shembull i së dytës. Dëshira e një burri për një grua do të ishte e llojit të parë: dëshira e përçudnuar e një burri për një burrë do të ishte e llojit të dytë. Tani, psikanaliza merr përsipër heqjen e ndjenjave jonormale: domethënë, t'i japë njeriut material bazë më të mirë për zgjedhjet e tij. Morali merret me aktet e zgjedhjes në vetvete.

Ta shohim në këtë mënyrë. Imagjinoni tre burra që shkojnë në luftë. Njëri ka një frikë natyrale të zakonshme për rrezikun siç ka çdo njeri, dhe e nënshton me përpjekje morale e bëhet një burrë trim. Le të supozojmë se dy të tjerët, si rezultat i gjërave në nënndërgjegjen e tyre, kanë frikëra të ekzagjeruara dhe të paarsyeshme, të cilat nuk mund të zgjidhen me përpjekje morale. Tani të supozojmë se vjen një psikanalist dhe i kuron këta të dy: domethënë, i kthen ata në pozitën e burrit të parë. Pikërisht në këtë çast problemi psikanalitik merr fund dhe nis problemi moral. Sepse, tani që janë të kuruar, këta dy burra mund të ndjekin dy udhë të ndryshme. I pari mund të thotë: “Shyqyr që i hoqa qafe gjithë ato gjëra. Tani më në fund mund të bëj atë që kam dashur të bëj gjithmonë: detyrën time ndaj atdheut.” Por tjetri mund të thotë: “Po, më bëhet shumë qejfi që tani ndihem relativisht gjakftohtë në situata të nxehta, por kjo sigurisht që nuk e ndryshon faktin se jam ende i vendosur si shkëmb për t’u kujdesur për Njëshin, për ta lënë tjetrin të bëjë punën e rrezikshme aty ku është e mundur. Vërtet, një nga të mirat e mos-patjes aq frikë është se tani mund të kujdesem në mënyrë më eficiente për veten dhe mund të jem më i zgjuar për ta fshehur këtë fakt nga të tjerët”. Tani ky dallim është krejtësisht moral dhe psikanaliza nuk bën dot asgjë për të. Sado që ta përmirësosh materialin bazë të njeriut, mbetet edhe diçka tjetër: zgjedhja reale, e lirë e njeriut për materialin që i paraqitet për ta vendosur avantazhin e tij në vend të parë, apo të fundit. Dhe kjo zgjedhje e lirë është e vetmja gjë që i intereson moralit.

Të kesh material psikologjik të keq nuk është mëkat, por sëmundje. Nuk është diçka për t’u penduar, por diçka për t’u kuruar. Dhe kjo, meqë ra fjala, është shumë e rëndësishme.

Qeniet njerëzore e gjykojnë njëri-tjetrin në bazë të veprimeve të jashtme. Perëndia i gjykon ata në bazë të zgjedhjeve të tyre morale. Kur një i sëmurë mendor, me një tmerr patologjik ndaj maceve, e detyron veten të ngrejë një mace për një arsye të mirë, është e mundur që, në sytë e Perëndisë, ai ka treguar më shumë kurajë sesa një njeri i shëndetshëm që ka fituar Kryqin e Viktorias (medalje trimërie). Kur një burrë, i shthurur që në të ritë e tij e i mësuar që mizoria është gjëja e duhur, bën një mirësi të vogël, ose pengon kryerjen prej tij të një akti mizor, duke rrezikuar të përçmohet nga shokët e tij, ka mundësi që në sytë e Perëndisë ai po bën më shumë sesa ti dhe unë kur japim vetë jetën tonë për një mik.

Po aq mirë mund ta shohim këtë nga ana tjetër. Ca nga ne, që në dukje janë aq njerëz të mirë, mund ta kemi përdorur aq pak një trashëgimi dhe edukim të mirë sa që jemi më të këqij se disa që i cilësojmë si dreqër. A mund të jemi të sigurt për sjelljen tonë, nëse do të ishim veshur me përbërjen psikologjike, edukimin e keq dhe pushtetin e dikujt si, për shembull, Himmler-it? Për këtë arsye të krishterëve u thuhet të mos gjykojnë. Ne shohim vetëm rezultatet që zgjedhjet e njeriut japin nga materiali i tij bazë. Por Perëndia nuk e gjykon aspak atë nga materiali bazë, por nga mënyra si ai ka vepruar me të. Pjesa më e madhe e përbërjes psikologjike të njeriut vjen me siguri si rezultat i trupit të tij. Kur trupi i tij vdes, e gjithë ajo i zhvishet dhe njeriu i vërtetë në qendër, gjëja që zgjodhi, që bëri më të mirën apo më të keqen sipas materialit të tij, do të qëndrojë lakuriq. Të gjitha gjërat e mira që mendonim se i kishim tonat, por që në fakt vinin nga një tretje e mirë e ushqimit, do të hiqen nga disa prej nesh. Të gjitha gjërat e këqija që ishin si rezultat i komplekseve dhe shëndetit të lig, do t'u hiqen të tjerëve. Atëherë do të

shohim, për herë të parë, kush është secili prej nesh. Do të ketë surpriza.

Kjo më çon te pika e dytë. Shpesh, njerëzit mendojnë se morali i krishterë është një lloj pazari ku Perëndia thotë: “Mbaji gjithë këta rregulla dhe unë do të të shpërblej; dhe po nuk e bërë këtë, do të bëj gjënë tjetër”. Nuk mendoj se kjo është mënyra më e mirë për ta parë këtë. Unë do ta përshkruaja më shumë në këtë mënyrë: sa herë që ti bën një zgjedhje, ti e kthen pjesën qendrore të vetes tënde, atë që zgjedh, në diçka pak më ndryshe nga ajo që ishte më parë. Dhe, duke e marrë jetën tënde në tërësi, me gjithë zgjedhjet e tua të panumërta, gjatë gjithë jetës sate, ti ngadalë po e kthen këtë gjë qendrore në një krijesë qiellore, ose në një krijesë të ferrit: në një krijesë që është në harmoni me Perëndinë, me krijesat e tjera dhe me veten, ose në një krijesë që është në gjendje lufte dhe urrejtjeje me Perëndinë, me krijesat e tjera dhe me veten. Të jesh krijesë e njërit lloj, është Qiell, Parajsë: është gëzim, paqe, njohuri dhe fuqi. Të jesh lloji tjetër është çmenduri, tmerr, idiotësi, tërbim, paaftësi dhe vetmi e përjetshme. Në çdo çast, secili prej nesh po ecën në drejtim ose të njërës, ose të tjetrës.

Kjo shpjegon atë që gjithnjë më habiste për shkrimtarët e krishterë. Ata shfaqeshin shumë striktë në një çast dhe shumë të lirë e të qetë në çastin tjetër. Ata flasin për mendimet mëkatore si gjëra jashtë mase të rëndësishme. Dhe flasin për vrasjet dhe tradhtitë më të frikshme sikur të duhet thjesht të pendohesh dhe e gjitha do të falet. Por arrita të kuptoj se ata kanë të drejtë. Ata kanë në mendje gjatë gjithë kohës shenjën që lë një veprim mbi veten e vogël qendrore, që askush nuk e sheh në këtë jetë, por që të gjithëve do t’u duhet ta durojnë—ose shijojnë—përjetë. Dikush mund të jetë në një

pozitë të tillë që inati i tij derdh gjakun e mijërave, ndërsa tjetri në pozitën që sado të inatoset vetëm sa do ta përqeshin. Por shenja e vogël në shpirtin e të dyve mund të jetë e njëjtë. Secili i ka bërë diçka vetes që, nëse nuk pendohet, do ta bëjë më të vështirë përmbajtjen e tërbimit në tundimin e radhës, duke e bërë edhe më të keq pasi ka rënë në tundim. Të dy ata, nëse kthehen seriozisht te Perëndia, mund ta rregullojnë këtë shtrembërim të njeriut qendror. Nëse nuk e bëjnë, të dy do të jenë të humbur në fund. Nuk është me shumë rëndësi se sa e madhe apo e vogël është diçka, e parë nga jashtë.

Edhe diçka të fundit. Ju kujtohet që thashë se drejtimi i duhur të çon, jo vetëm në paqe, por në njohuri. Kur njeriu përmirësohet, ai e kupton më mirë dhe më qartë të keqen që ka ngelur ende në të. Kur përkeqësohet, ai e kupton të keqen e tij sa vjen e më pak. Një njeri mesatarisht i keq e di se nuk është shumë i mirë. Një njeri krejtësisht i keq mendon se është i drejtë. Kjo është diçka logjike, në fakt. Gjumin e kupton kur je zgjuar, jo kur je duke fjetur. Gabimet në aritmetikë i sheh kur mendja jote funksionon siç duhet; kur je duke i bërë ato, nuk mund t'i shohësh. Natyrën e dehjes e kupton kur je esëll, jo kur je i dehur. Njerëzit e mirë kanë njohuri edhe për të mirën, edhe për të keqen. Të këqijtë nuk kanë njohuri për asnjërën.

MORALI SEKSUAL

Na duhet të shqyrtojmë tani moralin e krishterë në lidhje me seksin, i quajtur nga të krishterët virtyti i dëlirësisë. Rregulli i krishterë për dëlirësinë nuk duhet të ngatërrohet me rregullin shoqëror të “modestisë” (në atë kuptim të fjalës). Modestia nënkupton denjësinë, etikën. Rregulli shoqëror i etikës parashtron se sa nga trupi njerëzor duhet zbuluar dhe si duhen quajtur subjektet e me çfarë titujsh, sipas zakoneve të rrethit shoqëror. Kështu, rregulli i etikës ndryshon, ndërsa rregulli i dëlirësisë është i njëjtë për të gjithë të krishterët në të gjitha kohërat. Një vajzë në ishujt e Paqësorit, veshja e të cilës mezi i mbulon trupin, dhe një zonjë viktoriane krejtësisht e mbuluar me rroba mund të jenë baras “modeste”, dinjitoze dhe me etikë, sipas standardeve të shoqërive të tyre: dhe të dyja, për aq sa mund të gjykojmë nga veshja, mund të jenë baras të dëlira (ose baras të pacipa). Një pjesë e fjalorit që përdorej nga gra të dëlira në kohën e Shekspirit, do të përdorej në shek. XIX vetëm nga një grua krejt e papërmbajtur. Kur njerëzi e shkelin rregullin e etikës së kohës e vendit të tyre, me qëllim që të ngjallin epsh te vetja apo të tjerët, ata janë duke hedhur poshtë dëlirësinë. Por nëse e shkelin nga injoranca apo pakujdesia, janë fajtorë vetëm për sjellje të keqe. Kur e shkelin me guxim, për të

tronditur apo turpëruar të tjerët, siç ndodh shpesh, ata nuk po tregohen aq të pacipë sa tregohen të pamëshirshëm; të jesh i pamëshirshëm do të thotë të marrësh kënaqësi nga parehatia e të tjerëve. Nuk mendoj se një standard tepër strikt e irritues i etikës shërben si provë për dëlirësinë, apo ndihmë ndaj saj. Prandaj e cilësoj thjeshtësimin dhe lehtësimin e këtij rregulli, që ka ndodhur në kohën time, si diçka të mirë. Momentalisht, ka shkaktuar një ngatërresë ku njerëzit e moshave dhe llojeve të ndryshe nuk pranojnë të njëjtin standard, e si pasojë as që e dimë se ku po qëndrojmë. Për aq sa do të zgjasë kjo ngatërresë, mendoj se njerëzit e moshuar e me të vjetrën duhet të kenë kujdes të mos supozojnë se të rinjtë apo të “emancipuarit” janë prishur kur sillen në mënyrë të papërshtatshme (sipas standardit të vjetër). Nga ana tjetër, të rinjtë nuk duhet t’i quajnë pleqtë grindavecë e puritanë për shkak se nuk e pranojnë lehtësisht standardin e ri. Shumica e problemeve do të zgjidhen me një dëshirë reale për të besuar më të mirën e mundshme për të tjerët dhe për t’i bërë të ndihen sa më rehat.

Dëlirësia është virtyti i krishterë më i papëlqyer. Nuk shpëton dot prej tij; rregulli i krishterë është: “Ose martesë, me besnikëri të plotë ndaj partnerit, ose vetëpërmbytje”. Kjo është aq e vështirë dhe aq e kundërt me instinktet tona, saqë është e qartë se ose krishterimi e ka gabim, ose instinkti ynë seksual, kështu siç është tani, është gabim. Ose njëra, ose tjetra. Sigurisht, duke qenë i krishterë, unë mendoj se është instinkti ynë ai që e ka gabim.

Por kam edhe arsye të tjera pse mendoj kështu. Qëllimi biologjik i seksit janë fëmijët, ashtu si qëllimi biologjik i ngrënies është riparimi i trupit. Tani, nëse hamë sa herë kemi neps dhe aq sa dëshirojmë, është mëse e sigurt që shumica

prej nesh do të hanë më shumë sesa duhet. Por jo tmerrësisht shumë. Një njeri mund të hajë sa për dy vetë, por jo aq sa për dhjetë. Oreksi shkon pak më larg se qëllimi biologjik, por jo shumë larg. Por, nëse një i ri me shëndet të mirë, e kënaq oreksin e tij seksual sa herë i shkrepet, dhe me çdo akt krijon një foshnjë, ai pa frikë mund të popullojë një fshat të vogël për dhjetë vjet. Ky oreks mund të teprohet çmendurisht dhe jashtëzakonisht në krahasim me funksionin e tij.

Ose e shohim nga një anë tjetër. Një turmë e madhe njerëzish mund të mblidhet për një akt striptizmi—për të parë një vajzë të zhvishet në skenë. Tani, le të supozojmë se ti shkon në një vend, ku një teatër i tërë mund të mbushet thjesht nëse u paraqitet një pjatë e mbuluar në skenë, në të cilën ishte një copë mish deleje ose pak proshutë dhe të cilës i hiqet ngadalë kapaku, sa për ta parë të gjithë para se të fikeshin dritat. A nuk do të mendoje se diçka ka shkuar keq me oreksin e ushqimit në këtë vend? A nuk do të mendonte dikush, i rritur në një botë tjetër, se ka diçka po aq të çuditshme për gjendjen e instinktit të seksit midis nesh?

Një kritik tha se nëse do të gjente një vend ku aktet e striptizmit me ushqimin ishin të shpeshta, ai do të dilte në përfundimin se njerëzit e këtij vendi do të ishin duke vdekur urie. Me këtë, ai donte sigurisht të thoshte që gjërat e tilla si aktet e striptizmit vijnë nga uria seksuale, jo nga shthurja seksuale. Do të bija dakord me të se, po të gjenim akte të ngjashme me copën e mishit të deles në një tokë të huaj, zia e bukës do të ishte një shpjegim i mundshëm që do të më vinte në mendje. Por hapi i radhës do të ishte të verifikonim hipotezën tonë duke parë nëse në këtë vend konsumohet vërtet shumë apo pak ushqim. Nëse provat do të tregonin se konsumohej shumë ushqim, sigurisht që do të na duhej ta

braktisnim hipotezën e urisë dhe të mendonim një shpjegim tjetër. Në të njëjtën mënyrë, para se ta pranojmë urinë seksuale si shkak për striptizmin, duhet të kërkojmë për prova që në kohën tonë ka më shumë vetëpërmbytje seksuale sesa në kohën kur gjërat si striptizmi ishin të panjohura. Por, sigurisht, prova të tilla nuk ekzistojnë. Kontraceptivët e kanë bërë kënaqjen seksuale më pak të kushtueshme brenda martesës, si edhe më pak të rrezikshme jashtë saj se kurrë. Edhe opinioni publik është më pak armiqësor ndaj bashkimeve të paligjshme, madje edhe ndaj perversitetit, nga sa ka qenë qysh prej kohëve pagane. Dhe hipoteza e urisë nuk është e vetmja që mendojmë lehtësisht. Të gjithë e dinë se oreksi seksual, ashtu si orekset e tjerë, rritet më shumë kur ushqehet më shumë. Njerëzit e uritur mund të mendojnë shumë për ushqimin, por edhe grykësit gjithashtu. Eksitimën e pëlqejnë si të uriturit, edhe të ngopurit.

Dhe një pikë e tretë. Të paktë janë njerëzit që mund të duan të hanë gjëra që nuk janë ushqim, ose të bëjnë gjëra të tjera me ushqimin përveç ngrënies. E thënë ndryshe, shthurjet e oreksit ushqimor janë të rralla. Kurse shthurjet e instinktit seksual janë të shumta, të frikshme dhe të vështira për t'u kuruar. Më falni që po hyj në këto detaje, por jam i detyruar. Jam i detyruar sepse mua dhe ty, për njëzet vitet e fundit, na kanë ushqyer gjithë ditën e ditës mirë e bukur me gënjeshtër për seksin. Na është thënë, aq sa jemi lodhur duke e dëgjuar, se dëshira seksuale është në të njëjtin stad si dëshirat e tjera natyrale që kemi. Sikur të braktisnim idenë viktoriane të heshtjes në lidhje me të, gjithçka do të shkonte vaj. Nuk është e vërtetë. Në çastin që hedh sytë mbi faktet, larg propagandës, e sheh se nuk është ashtu.

Ata të thonë që çështja e seksit është bërë e ngatërruar

për shkak se është heshtur në lidhje me të. Por njëzet vitet e fundit nuk është heshtur aspak. Është përfolur gjithë ditën e ditës. E megjithatë mbetet e ngatërruar. Nëse problemi do të kishte qenë heshtja, e kujtuara e vazhdueshme do ta zgjidhte. Por nuk e ka bërë këtë. Mendoj se është e kundërta. Mendoj se njerëzimi e la në heshtje atë për shkak se ishte bërë e ngatërruar. Njerëzit modernë thonë gjatë gjithë kohës: “Seksi nuk është gjë turpi”. Duan të thonë dy gjëra me këtë. E para është: “Nuk ka asgjë për t’u turpëruar për faktin se raca njerëzore riprodhohet në një mënyrë të caktuar, e as për faktin se ky akt jep kënaqësi”. Kur nënkuptojnë këtë, kanë të drejtë. Edhe krishterimi thotë të njëjtën gjë. Problemi nuk qëndron as te akti, as te kënaqësia. Mësuesit e vjetër të krishterë thoshin se, sikur njeriu të mos kishte rënë kurrë, kënaqësia seksuale do të ishte, jo më e vogël, por në fakt më e madhe. E di, disa të krishterë të ngatërruar flasin sikur, sipas krishterimit, seksi, trupi apo kënaqësia janë të këqija në vetvete. E kanë gabim. Krishterimi me shumë gjasë është e vetmja nga fetë e mëdha që e miraton trupin tërësisht—që beson se materia është e mirë, që vetë Perëndia veshi trup njerëzor, që në Parajsë do të na jepet një lloj trupi dhe do të jetë pjesë thelbësore e lumturisë, bukurisë dhe energjisë sonë. Krishterimi e ka lavdëruar martesën më shumë se çdo fe tjetër: gati të gjitha poezitë më të mëdha të dashurisë në botë janë bërë nga të krishterë. Këdo që thotë se seksi është i keq në vetvete, krishterimi e kundërshton në çast. Mirëpo, natyrisht, kur thonë “Seksi nuk është gjë turpi” ata në fakt nënkuptojnë “gjendja ku është tani instinkti seksual nuk ka asgjë të turpshme në të”.

Nëse duan të thonë këtë, unë mendoj se e kanë gabim. Mendoj se kjo gjendje është e gjitha e turpshme. Nuk ka asgjë

të keqe të shijosh ushqimin tënd. Por gjithçka ka shkuar keq nëse gjysma e botës e bën ushqimin interesin kryesor të jetës së tyre, duke e kaluar kohën duke parë foto të ushqimit dhe me lëpirje të buzëve e thithje të jargëve. Nuk po them se unë e ti jemi përgjegjës për këtë situatë. Paraardhësit na kanë transmetuar organizmat që janë të dëmtuar në këtë mënyrë. Dhe ne rritemi të rrethuar nga propaganda në favor të shthurjes. Ka njerëz që duan ta mbajnë ndezur zjarrin e instinktit tonë seksual për të fituar para prej nesh. Sepse dihet se njeriu që ka një fiksim, nuk ka rezistencë ndaj shitësve. Perëndia e di situatën tonë. Ai nuk do të na gjykojë sikur nuk kemi vështirësi për të kaluar. Ajo që ka rëndësi është sinqeriteti dhe këmbëngulja e vullnetit tonë për t'i kaluar ato.

Duhet të duash të kurohesh, përpara se të mund të kurohesh. Ata që duan vërtet të ndihmohen do ta marrin ndihmën e nevojshme. Por, për njerëzit modernë, edhe dëshira është diçka e vështirë. Është e lehtë të mendojmë se e duam diçka, të cilën në fakt nuk e duam. Një i krishterë i famshëm na ka thënë shumë kohë më parë se, kur ishte i ri, lutej vazhdimisht për dëlirësi; por ai kuptoi vite më vonë se, ndërsa buzët e tij thoshin: “O Zot, më bëj të dëlirë”, zemra e tij fshehurazi shtonte, “Por, mos e bëj që tani”. Kjo mund të ndodhë edhe në lutjet për virtytet e tjera. Por ka tre arsye pse tani është veçanërisht e vështirë që të dëshirojmë—aq më tepër të arrijmë—dëlirësi të plotë.

Në radhë të parë, natyrat tona të dëmtuara, dajhtë që na tundojnë dhe e gjithë propaganda për epsh e kohës sonë, bashkohen për të na bërë të ndihemi sikur dëshirat, të cilave po u rezistojmë, janë aq të “natyrshme”, aq të “shëndetshme”, saqë është gati e mbrapshtë dhe anormale t'u rezistosh

atyre. Pllakat pas pllakati, film pas filmi, roman pas romani e shoqërojnë idenë e kënaqjes seksuale pa kufi bashkë me idenë e shëndetit, normalitetit, rinisë, sinqeritetit dhe humorit të mirë. Kjo lidhje është rrenë. Si të gjitha rrenat e fuqishme, bazohet në një të vërtetë—në të vërtetën e pranuar më lart, që seksi në vetvete është “normal”, “i shëndetshëm” e gjithë të tjerat (kur është i veçuar nga shpërdorimet dhe fiksime që janë rritur për qark tij). Gënjeshtër qendron në sugjerimin se çdo akt seksual që tundohesh të bësh në çdo çast të caktuar është po aq i shëndetshëm e normal. Kjo, sipas çdo këndvështrimi të mundshëm, edhe atyre larg krishterimit, duhet të jetë një marrëzi. T’i dorëzohesh të gjitha dëshirave të tua është diçka që sjell qartazi impotencë, sëmundje, xheloz, gënjeshtër, sekrete dhe gjithçka tjetër që është e kundërta e shëndetit, humorit të mirë dhe sinqeritetit. Për çdo lumturi, edhe në këtë botë, duhet një masë e madhe përmbajtjeje. Ndaj pretendimi i çdo dëshire, edhe më të fortës, se është e shëndetshme dhe e arsyeshme, nuk vlen për asgjë. Çdo njeri me mend e me kulturë duhet të ketë disa parime në bazë të të cilave ai zgjedh të mohojë disa nga dëshirat e tij dhe të lejojë disa të tjera. Njëri e bën këtë në bazë të parimeve të krishtera, tjetri në bazë të parimeve higjenike e tjetri të atyre sociologjike. Konflikti real nuk është mes krishterimit dhe “natyrës”, por mes parimeve të krishtera dhe parimeve të tjera që kontrollojnë “natyrën”. Pasi “natyra” (domethënë dëshira e natyrshme) duhet të kontrollohet sidoqoftë, që jeta jote të mos shkatërrohet. E pranoj, parimet e krishtera janë më strikte se të tjerat. Por ne mendojmë se do të keni ndihmë për t’iu bindur atyre, të cilën nuk do ta keni për t’iu bindur të tjerave.

Në radhë të dytë, shumë njerëz hezitojnë ta provojnë

seriozisht dëlirësinë e krishterë, sepse mendojnë (pa e provuar) se kjo është e pamundur. Por, kur një gjë duhet provuar, nuk duhet të mendosh kurrë për mundësinë apo pamundësinë. Kur ke një pyetje opsionale në një provim, mund të shqyrtosh nëse e bën dot apo jo: kur e ke të detyruar, duhet të bësh më të mirën që mundesh. Mund të marrësh disa pikë për një përgjigje jo të përkryer. Por është e sigurt se nuk do të marrësh asgjë nëse e lë përgjigjen bosh. Jo vetëm në provim, por edhe në luftë, në alpinizëm, në mësimin e patinazhit, apo notit, apo biçikletës, apo edhe në vendosjen e një kravate të kollarisur me gishta të ftohtë, njerëzit shpesh ia dalin të bëjnë gjëra që iu dukeshin të pamundura deri në atë çast. Është e habitshme se çfarë mund të bësh kur je i shtrënguar.

Mund të jemi vërtetë të sigurt se dëlirësia e përkryer—si edhe bamirësia e përkryer—janë të paarrtshme nga përpjekjet e vetme të njeriut. Duhet ndihma e Perëndisë. Edhe kur e kërkon atë, mund të të duket për një kohë të gjatë se të është dhënë më pak ndihmë nga sa të nevojitej (ose aspak). Mos e vrit mendjen për këtë. Pas çdo dështimi, kërko falje, mblidhe veten dhe provo përsëri. Shpeshherë, ndihma që Perëndia na jep nuk qëndron te virtyti vetë, por te kjo fuqi e të provuarit përsëri gjithmonë. Pasi, sado e rëndësishme të jetë dëlirësia (apo kuraja, vërtetësia dhe çdo virtyt tjetër), ky proces që formon zakonet e shpirtit tonë është më i rëndësishëm. Ai na kuron nga iluzionet për veten dhe na mëson të varemi te Perëndia. Nga njëra anë, ne mësojmë që nuk mund t'i besojmë vetes as në çastet tona më të mira dhe, nga ana tjetër, që të mos dëshpërohemi në më të këqijat, sepse dështimet tona janë falur. E vetmja gjë vdekjeprurëse është të ulesh i kënaqur me diçka më të vogël se përsosmëria.

Së treti, njerëzit shpesh e keqkuptojnë atë që mëson

psikologjia për “ndrydhjen”. Ajo na mëson se seksi “i ndrydhur” është i rrezikshëm. Por termi “i ndrydhur” këtu përdoret në aspektin teknik. Nuk është “i ndrydhur” në kuptimin “i mohuar” apo “i rezistuar”. Një dëshirë ose mendim i ndrydhur është ai që futet në nënvetëdije (zakonisht në moshë të hershme) dhe tani mund të kthehet në mendje vetë, në forma të fshehura e të padallueshme. Seksualiteti i ndrydhur nuk i shfaqet fare pacientit si seksualitet. Duke marrë përsipër t’i rezistojë një dëshirë të vetëdijshme, adoleshenti ose i rrituri nuk po përballet me ndrydhje, ose të paktën nuk është në rrezik për të krijuar ndrydhje. Përkundrazi, ata që përpiqen seriozisht të jenë të dëlirë dinë më shumë për seksualitetin e tyre sesa kushdo tjetër. Ata i njohin dëshirat e tyre siç njihte Wellington-i Napoleonin, ose siç e njihte Sherlok Holmesi Moriartin; siç i njeh minjtë një kapës minjsh apo hidrauliku tubat e shpuar. Virtyti—edhe përpjekja për të madje—sjell dritë; kënaqja pa kufi, teprimi, sjell mjegull.

Së fundmi, edhe pse m’u desh të flisja pak gjatë për seksin, dua ta bëj sa më të qartë të jetë e mundur se ai nuk është qendra e moralit të krishterë. Nëse dikush mendon se të krishterët e cilësojnë shthurjen si mëkatin më të keq, e ka gabim. Mëkatet e mishit janë të këqija, por janë më pak të këqijat e mëkateve. Më të këqijat janë ato krejtësisht shpirtëroret: kënaqësia e fajësimit të të tjerëve, e të qenit mbi të tjerët, e përbuzjes së të tjerëve, e prishjes së gëzimit të të tjerëve, futja e thikës pas shpine; kënaqësitë e pushtetit, e urrejtjes. Dy janë gjërat që brenda meje po konkurrojnë me unin njerëzor që duhet të përpiqem të bëhem. Ata janë uni kafshëror dhe uni djallëzor. Djallëzori është më i keqi nga të dy. Prandaj një moralist i ftohtë, i vetë-drejtë që

MORALI SEKSUAL

shkon rregullisht në kishë mund të jetë më afër ferrit se një prostitutë. Por, sigurisht, më e mira është të mos jesh asnjëri prej këtyre.

MARTESA E KRISHTERË

Kapitulli i fundit ishte përgjithësisht negativ. Unë diskutova çfarë shkonte keq me impulsin seksual të njeriut, por fola pak për funksionimi e duhur të tij—e thënë ndryshe, për martesën e krishterë. Kam dy arsye pse nuk kam shumë qejf ta trajtoj martesën. E para është se doktrinat e krishtera për këtë temë janë tejet të papëlqyera. E dyta është se unë vetë nuk jam martuar kurrë, ndaj mund të flas vetëm si vëzhgues. Por, pavarësisht kësaj, e kam të vështirë ta lë këtë temë jashtë diskutimit të moralit të krishterë.

Ideja e krishterë e martesës bazohet mbi fjalët e Krishtit se burri dhe gruaja cilësohen si një organizëm i vetëm—pasi kështu do të ktheheshin fjalët “një mish” në gjuhën moderne. Dhe të krishterët besojnë se kur e tha këtë, ai nuk po shprehte një mendim, por po thoshte një fakt: si ai që pohon fakte kur thotë se çelësi dhe brava janë një mekanizëm, apo violina dhe harku janë një instrument muzikor. Shpikësi i makinerisë njerëzore po na thoshte se dy gjysmat e saj, mashkulli dhe femra, janë bërë për t’u kombinuar në çifte, jo thjesht në nivelin seksual, por tërësisht. Marrëdhëniet seksuale jashtë martese janë të përbindshme për arsyen se, ata që i praktikojnë ato, po përpiqen të izolojnë njërin bashkim (atë seksual) nga të gjitha llojet e tjera të bashkimit, të krijuara për ta shoqëruar

atë për të formuar bashkimin e plotë. Qëndrimi i krishterë nuk është se diçka nuk shkon me kënaqësinë seksuale, siç nuk ka asgjë që s' shkon me kënaqësinë e ngrënies. Por nuk duhet ta izolosh atë kënaqësi dhe ta marrësh të vetme, sikurse nuk duhet ta marrësh kënaqësinë e shijes pa gëlltitjen dhe tretjen, thjesht duke i përtypur gjërat vetëm për t'i pështyrë më pas.

Si pasojë e kësaj, krishterimi mëson se martesë është për gjithë jetën. Sigurisht, ka disa dallime ndërmjet kishave. Disa nuk e pranojnë divorcin fare, disa e lejojnë me ngurrim në raste shumë të veçanta. Është shumë për të ardhur keq që të krishterët të mos jenë dakord për diçka të tillë. Por për një njeri të zakonshëm joklerik, gjëja që duhet të vërë re është se të gjitha kishat janë më shumë dakord me njëra-tjetrën sesa secila prej tyre me botën jashtë. Dua të them që të gjitha ato e cilësojnë divorcin si prerje e një pjese trupi të gjallë, si njëfarë operacioni. Disa prej tyre mendojnë se operacioni është aq i përgjakshëm saqë nuk mund të bëhet. Të tjerë e pranojnë si një alternativë të dëshpëruar për raste ekstreme. Janë dakord se diçka e tillë i ngjan më shumë prerjes së të dyja këmbëve të një njeriu, sesa thjesht shpërbërjes së një shoqërie tregtare apo dezertimit të një reparti. Dhe asnjë prej tyre nuk bie dakord me pikëpamjen moderne që divorci përfshin thjesht një ndryshim të partnerit, i lejueshëm nëse njerëzit nuk ndihen më të dashuruar, apo nëse njëri prej tyre dashurohet me dikë tjetër.

Para se ta shqyrtojmë pikëpamjen moderne në krahasim me dëlirësinë, të mos harrojmë ta shqyrtojmë atë krahas një virtyti tjetër: drejtësisë. Drejtësia, siç kam thënë më parë, përfshin mbajtjen e premtimeve. Kushdo që është martuar në kishë, ka bërë një premtim publik dhe solemn për të pasur vetëm partnerin e tij (ose saj) deri në vdekje. Detyra

e mbajtjes së këtij premtimi nuk ka ndonjë lidhje të veçantë me moralin seksual. Është njësoj si çdo premtim tjetër. Nëse impulsi seksual është si gjithë impulset e tjerë, sikurse na thonë tërë kohës njerëzit modernë, atëherë duhet trajtuar si gjithë impulset e tjerë. Ashtu si ato kontrollohen me anë të premtimeve tona, kështu duhet të jetë edhe me të. Nëse nuk është si impulset e tjera, por i përvëlur dhe i sëmurë, siç mendoj unë se është, atëherë duhet të kujdesemi akoma më shumë që të mos na bëjë të jemi të pandershëm.

Dikush mund t'i përgjigjet kësaj se premtimi i bërë në kishë ishte thjesht një formalitet, të cilin nuk pati asnjëherë qëllim për ta mbajtur. Kë, pra, po përpiquej të mashtronte ai kur e bëri këtë premtim? Perëndinë? Ky është veprim vërtet i pamend. Vetën? Edhe kjo nuk është gjë më e zgjuar. Nusen, dhëndrin, apo krushqinë? Kjo është tradhti. Më së shumti, unë mendoj se çifti (ose njëri prej tyre) shpresonte të mashtronte publikun. Ata kërkonin respektin që vjen me martesën pa menduar të paguajnë çmimin. Domethënë, ata ishin mashtrues, hileqarë. Nëse mbeten hileqarë të kënaqur me veten, nuk kam asgjë për t'u thënë. E kush mund t'i shtyjë njerëzit të kryejnë detyrën e lartë e të vështirë të dëlirësisë, kur ata nuk duan as të jenë thjesht të ndershëm? Nëse u kanë ardhur mendtë e duan të jenë të ndershëm, premtimi që tashmë kanë bërë i kufizon . Dhe kjo, siç e shihni, është në emër të drejtësisë, jo të dëlirësisë. Ndoshta është më mirë që njerëzit, të cilët nuk besojnë në martesë të përhershme, thjesht të bashkëjetojnë të pamartuar në vend që të bëjnë betime pa e pasur ndërmend t'i mbajnë. Është e vërtetë se duke jetuar bashkë pa martesë ata janë fajtorë (në sy të të krishterëve) për kurvëri. Por një faj nuk korrigjohet duke shtuar një tjetër. Shthurja nuk korrigjohet duke i shtuar

betimin e rremë.

Ideja, se e vetmja arsye për të mbetur në martesë është të qenit i “dashuruar”, nuk lë fare hapësirë për ta parë martesën si një kontratë apo një premtim. Nëse dashuria është gjithçka, premtimi nuk i shton asgjë. Nëse nuk i shton asgjë, nuk duhet të jepet. E çuditshmja është se të dashuruarit vetë e dinë këtë më mirë se ata që flasin për dashurinë, për aq kohë sa ata mbeten vërtet të dashuruar. Siç vë në dukje Chesterton-i, ata që janë të dashuruar priren natyrshëm të lidhen me njëri-tjetrin me anë të premtimeve. Këngët e dashurisë kudo në botë janë plot me betime për vazhdimësi të përhershme. Ligji i krishterë nuk po e detyron pasionin e dashurisë të bëjë diçka të huaj për natyrën e saj. Po u kërkon të dashuruarve ta marrin seriozisht atë që vetë pasioni i tyre i shtyn të bëjnë.

Dhe, patjetër që premtimi i bërë prej meje, kur jam i dashuruar dhe për shkak se jam i dashuruar, për t'i qëndruar besnik të dashurës sa të jem gjallë, më shtrëngon të jem besnik edhe kur nuk jam më i dashuruar. Premtimi duhet të bëhet për gjëra që mund t'i bëj, për veprime. Askush nuk mund të premtojë të ndihet përgjithmonë në një mënyrë të caktuar. Është si të premtojë se nuk do të ketë kurrë dhimbje koke apo se do të jetë gjithnjë i uritur. Por dikush mund të pyesë, cili është qëllimi për t'i mbajtur dy persona bashkë nëse nuk janë më të dashuruar? Ka disa arsye të shëndetshme shoqërore; për të siguruar një shtëpi për fëmijët, për të mbrojtur gruan (e cila duke u martuar me shumë mundësi ka sakrifikuar ose dëmtuar karrierën e saj) nga lënia prej burrit sapo ai të lodhet me të. Por ka dhe një arsye tjetër për të cilën jam shumë i sigurt, ndonëse e kam pak të vështirë ta shpjegoj.

E kam të vështirë pasi shumë njerëz e kanë të vështirë ta kuptojnë se, nëse B-ja është më e mirë se C-ja, A-ja mund të

jetë edhe më e mirë se B-ja. U pëlqen të mendojnë në termat si: “e mirë” dhe “e keqe”, jo: “e mirë”, “më e mirë” dhe “më e mira”; apo “e keqe”, “më e keqe” dhe “më e keqja”. Ata duan të dinë nëse ti mendon se patriotizmi është gjë e mirë. Nëse përgjigjesh se është sigurisht gjë më e mirë se egoizmi individual, por jo aq e mirë sa bamirësia universale dhe se bamirësia universale duhet të ketë epërsi në rast se të dy ndeshen, ata do të mendonin se po i shmangesh pyetjes. Të pyesin se çfarë mendon për duelin. Nëse përgjigjesh se është më mirë që ta falësh dikë sesa të duelosh me të, por se një duel mund të jetë më mirë sesa një armiqësi e përjetshme, e shprehur në përpjekje të fshehta për ta dëmtuar tjetrin, njerëzit do të ankoheshin se nuk po përgjigjesh haptazi. Shpresoj të mos e bëjë njeri këtë gabim me këtë që do të them.

E ashtuquajtura “rënie në dashuri” është një gjendje e lavdishme, e dobishme për ne në shumë mënyra. Na ndihmon të jemi bujarë dhe trima, na i hap sytë jo vetëm ndaj bukurisë së të dashurës, por bukurisë kudo. Ajo e tejkalon (sidomos fillimisht) seksualitetin tonë thjesht kafshëror. Në këtë kuptim, dashuria është mundësja më e fortë e epshit. Njeriu me mend në kokë nuk mund ta mohojë se dashuria është shumë më mirë se sensualizmi i zakonshëm apo egoizmi gjakftohtë. Por, siç thashë më parë: “gjëja më e rrezikshme që mund të bësh është ta marrësh një impuls të natyrës njerëzore dhe ta bësh gjënë që duhet ndjekur me çdo kusht”. Të jesh i dashuruar është gjë e mirë, por jo gjëja më e mirë. Ka gjëra më të ulëta, por ka edhe gjëra më të larta. Nuk mund ta përdorësh atë si bazën e gjithë jetës sate. Megjithatë një ndjenjë fisnike, është thjesht një ndjenjë. Asnjë ndjenje nuk i duhet besuar të zgjasë përgjithmonë me intensitetin e saj të plotë; madje as të zgjasë. Njohuria, parimet dhe zakonet mund të zgjasin,

kurse ndjenjat vijnë dhe ikin. Dhe në fakt, gjendja e të qenit “i dashuruar”, zakonisht nuk zgjat, pavarësisht asaj që thonë njerëzit. Nëse i marrim përmbylljet e famshme të përrallave: “Dhe ata jetuan të lumtur përgjithmonë”, me kuptimin: “Dhe u ndien si në ditën para martesës edhe për pesëdhjetë vitet e ardhshme”, atëherë përrallat na thonë atë që nuk ka ndodhur dhe nuk do të mund të ndodhte kurrë. Edhe sikur të ndodhte, nuk do të ishte gjëja më e pëlqyeshme. Kush mund të durojë të jetojë edhe pesë vjet me gjithë atë emocion? Ç’do të ndodhte me punën tënde, me oreksin, gjumin, me miqësitë e tua? Megjithatë, të pushosh së qeni “i dashuruar” nuk ka pse të nënkuptojë të pushosh së dashuruari. Dashuria në kuptimin e dytë, si diçka ndryshe nga të qenit i dashuruar, nuk është thjesht një ndjenjë. Është një bashkim i thellë, i mirëmbajtur përmes vullnetit dhe i forcuar në mënyrë të qëllimshme me anë të zakonit. Në martesat e krishtera veçanërisht, është i përforcuar nga hiri që të dy partnerët kërkojnë dhe marrin prej Perëndisë. Ata mund ta kenë këtë dashuri për njëri-tjetrin edhe në çastet kur nuk u pëlqen njëri-tjetri. Ti e do veten në të njëjtën mënyrë, në çastet kur nuk të pëlqen vetja. Ata mund ta ruajnë këtë dashuri edhe kur secili, nëse ia lejon vetes, mund të bjerë lehtësisht “në dashuri” me dikë tjetër. Rënia në dashuri i bëri të premtin për besnikëri në fillim: kjo dashuri më e qetë u mundëson ta mbajnë atë premtim. Ajo është karburanti që ushqen motorin e martesës: rënia në dashuri ishte thjesht shkëndija që e ndezi atë.

Jam i sigurt se, nëse nuk je dakord me mua, do të thuash: “Ku di gjë ai, ai nuk është i martuar.” Dhe ka mundësi të kesh të drejtë. Por, para se ta thuash këtë, sigurohu që po më gjykon në bazë të asaj që ti vetë e di nga eksperiencia jote dhe duke parë jetët e miqve të tu, jo nga idetë që ke marrë prej filmave

e romaneve. Kjo nuk është aq e lehtë sa ç'mendojnë njerëzit. Mënyra si ne i përjetojmë gjërat është e ngjyrosur fund e krye nga librat, teatrot dhe kinematë. Duhet durim dhe aftësi për t'i shkollavitur ato që i kemi mësuar vërtet nga jeta.

Njerëzve u krijohet ideja nga librat se, nëse martohesh me personin e duhur, mund të presësh se do të mbetesh i dashuruar përgjithmonë. Si rezultat i kësaj, kur zbulojnë se nuk mbeten të tillë, ata mendojnë se kanë bërë një gabim dhe kanë të drejtë të bëjnë një ndryshim. Ata nuk e kuptojnë se, pasi ta kenë bërë ndryshimin, shkëlqimi i dashurisë së re do të venitet si ai i të vjetrës. Siç ndodh në aspektet e tjera të jetës, edhe në të emocionet janë pjesë e fillimit e nuk zgjasin. Emocioni që një djalosh ka në fillim për idenë e fluturimit nuk do të vazhdojë pasi të jetë bërë pjesë e Forcave Ajrore Mbretërore, duke mësuar të fluturojë prej vërteti. Emocioni që ndien kur sheh për herë të parë një vend të mahnitshëm venitet kur shkon vërtet për të jetuar aty. A do të thotë kjo që më mirë të mos mësojmë të fluturojmë, të mos shkojmë të jetojmë në një vend të bukur? Assesi. Në të dy këta shembuj, nëse vazhdon deri në fund, venitja e emocionit fillestar do të kompensohet me një interes më të qetë e më të qëndrueshëm. Për më tepër (dhe nuk di si të gjej fjalët për t'ju shprehur sa e rëndësishme mendoj se është kjo), vetëm personat, të gatshëm t'i nënshtrohen humbjes së emocionit e pranimit të interesit më të kthjellët, kanë më shumë mundësi të hasin emocione të reja në drejtime krejt të ndryshme. Njeriu që mësoi të fluturojë e të bëhet pilot i aftë, befaz do të zbulojë muzikën. Ai që u vendos në një vend të bukur për të jetuar do të zbulojë kopshtarinë.

Mendoj se kjo është pjesërisht ajo që Krishti donte të thoshte, kur tha se diçka nuk mund të jetojë vërtet nëse

nuk vdes më parë. Është thjesht e kotë të mundohesh për ta mbajtur emocionin gjallë; madje është gjëja më e keqe që mund të bësh. Lëre emocionin të shkojë. Lëre të venitet. Kalo nga ajo periudhë e vdekjes së tij, në drejtim të interesit më të qetë dhe lumturisë që do të pasojë. Atëherë do të kuptosh se po jeton në një botë që ka emocione të reja gjatë gjithë kohës. Mirëpo, nëse vendos t'i bësh emocionet pjesë të rregullt të dietës sate, duke u përpjekur t'i zgjatësh ato artificialisht, do të bëhen sa vjen e më të dobëta, sa vjen e më të pakta; ti do të bëhesh një plak i mërzitur dhe i zhgënjyer deri në fund të jetës. Ngaqë shumë pak njerëz e kuptojnë këtë, gjen shumë burra e gra në moshën e mesme që murmuritin për rininë e tyre, pikërisht në moshën kur duket se dyer e horizonte të reja hapeshin kudo rreth tyre. Është më mirë të mësosh të notosh sesa të mundohesh pa fund (e pa shpresë) të rikthesh ndjenjën që pate kur ishte fëmijë duke u llapashitur në ujë.

Një tjetër koncept që na krijohet nga romanet e teatrot është që “rënia në dashuri” është diçka shumë e parëzistueshme; diçka që thjesht i ndodh njeriut, si fruthi. Duke e besuar këtë, disa të martuar kthejnë kurrizin e heqin dorë sapo tërhiqen nga një njohje e re. Por unë kam prirjen të mendoj se këto pasione kaq të parëzistueshme janë shumë më të rralla në jetën reale sesa në libra, të paktën për një të rritur. Kur takojmë dikë të bukur, të zgjuar dhe simpatik, patjetër që duhet t'i admirojmë dhe t'i duam, në njëfarë kuptimi, këto cilësi. Por a nuk e kemi së shumti vetë në dorë nëse e kthejmë apo jo këtë dashuri, në të ashtuquajturën “rënie në dashuri”? Padyshim që po ta mbushim mendjen me romane, shfaqje e këngë sentimentale dhe trupin me alkool, çdo dashuri që ndiejmë do ta kthejmë në këtë lloj dashurie. Nëse bëhet një ulluk në rrugicën tënde, i gjithë uji i shiut do të rrjedhë në të;

nëse vë syze blu, gjithçka sheh do të të duket blu. Por, faji për këtë mbetet i yti.

Përpara se ta lëmë çështjen e divorcit, do të doja të dalloja dy gjëra që shpesh ngatërrohen me njëra-tjetrën. Njëra është koncepti i krishterë për martesën. Tjetra është diçka krejt ndryshe: deri në çfarë mase, të krishterët, nëse janë votues ose anëtarë të parlamentit, duhet të përpiqen t'i imponojnë pikëpamjet e tyre për martesën mbi pjesën tjetër të komunitetit duke i përfshirë ato në ligjet e divorcit. Shumë njerëz kanë përshtypjen se, nëse ti vetë je i krishterë, duhet të përpiqesh ta bësh divorcin të vështirë për të gjithë. Unë nuk mendoj kështu. Unë për vete e di se do të inatosesha jashtë mase nëse muhamedanët do të mundoheshin të mos na lejonin ne të tjerëve të pinim verë. Pikëpamja ime është se të krishterët duhet ta pranojnë singërisht që shumica e britanikëve nuk janë të krishterë, prandaj nuk mund të detyrohen të jetojnë jetë të krishtera. Duhet të ketë dy lloje të ndryshme martesash: njëra e qeverisur nga shteti me rregulla të detyrueshme për të gjithë qytetarët, tjetra e qeverisur nga kisha me rregulla të detyrueshme për të gjithë anëtarët e saj. Dallimi duhet të jetë mjaft i qartë, që njeriu ta dijë nëse çifti është i martuar në kuptimin e krishterë apo jo.

Kaq për doktrinën e krishterë mbi përhershmërinë e martesës. Mbetet për t'u trajtuar diçka tjetër, edhe më e papëlqyer prej njerëzve. Gratë e krishtera premtojnë t'u binden burrave të tyre. Në martesën e krishterë burri thuhet se është "kreu". Këtu lindin dukshëm dy pyetje. (1) Pse thuhet se duhet të ketë një kre; pse jo barazi? (2) Pse duhet të jetë burri?

(1) Nevoja për një kre vjen nga ideja se martesë është e përhershme. Sigurisht që për aq kohë sa burri dhe gruaja janë

në një mendje, nuk ka pse të diskutohet nevoja për një kre; dhe mund të shpresojmë se kështu do të jetë gjendja normale e një martese të krishterë. Por, çfarë duhet të ndodhë kur ka vërtet mosmarrëveshje? Bashkëbisedim, patjetër. Por unë po supozoj se ata kanë bashkëbiseduar dhe prapë nuk arritën një marrëveshje. Ç'duhet bërë tani? Nuk mund ta vendosin me votim të shumicës, pasi nuk ka shumicë kur anëtarët janë vetëm dy. Me siguri që do të ndodhë një nga këto të dyja: ose ata duhet të ndahen e të shohin rrugët e tyre, ose njëri prej tyre duhet të jetë vendimmarrës. Nëse martesa është e përhershme, njëra nga palët duhet ta ketë pushtetin për të vendosur mbi planin e veprimit të familjes atëherë kur nuk ka zgjidhje tjetër. Nuk ka organizim të përhershëm pa një kushtetutë.

(2) Edhe nëse duhet të jetë dikush në krye, pse burri? Së pari, a ka në fakt ndonjë dëshirë serioze që të jetë gruaja? Siç ju kam thënë, unë vetë nuk jam i martuar, por mesa shoh unë, edhe gruaja që do të jetë kreu i shtëpisë së saj, zakonisht nuk e admiron të njëjtën situatë nëse e sheh të ndodhë në shtëpinë ngjitur. Ajo ka më shumë gjasa të thotë “I shkreti z. X! Si vallë e lejon atë grua të llahtarshme ta urdhërojë në atë mënyrë, unë nuk e kuptoj dot.”. Nuk mendoj se do t'i bëhej qejfi edhe për veten, nëse dikush i përmend faktin e “kryesisë” së saj. Sundimi i grave mbi burrat duhet të ketë diçka të panatyrshme në të, pasi gratë vetë janë pjesërisht të turpëruara nga kjo gjë dhe i përçmojnë burrat që sundohen prej tyre. Por ka edhe një arsye tjetër. Këtu po flas sinqerisht si një beqar, sepse në këtë rast më ndihmon ta shoh situatën më mirë nga jashtë sesa nga brenda. Marrëdhëniet e familjes me botën jashtë—atë që mund ta quajmë politika e jashtme—duhet të varen në fund nga burri, sepse atij i duhet të jetë

shumë më i drejtë me të jashtmit. Dhe zakonisht është i tillë. Gruaja lufton kryesisht për fëmijët dhe burrin e saj kundër pjesës tjetër të botës. Natyrisht, kërkesat e fëmijëve janë mbi gjithë kërkesat e tjera për gruan. Kjo është në njëfarë mënyre e drejtë. Ajo është e besuara e veçantë për interesat e tyre. Funkcioni i burrit është të kujdeset që kjo preferencë natyrale e saj të mos marrë krahë. Ai thotë fjalën e fundit për t'i mbrojtur njerëzit e tjerë nga patriotizmi i theksuar familjar i gruas. Nëse dikush ka dyshime për këtë, lejomëni t'ju bëj një pyetje të thjeshtë. Nëse qeni juaj kafshon fëmijën e komshiut, ose fëmija juaj lëndon qenin e komshiut, me kë do të kishit të bënit më parë, me zotin apo me zonjën e shtëpisë? Ose, nëse je një grua e martuar, lejomë të të pyes për këtë: sado që e admiron burrin tënd, a nuk do të thoshe se dështimi i tij kryesor është prirja e tij për të mos i mbrojtur të drejtat e tij dhe të tuat kundër fqinjëve me aq forcë sa ç'do të doje ti? Se është pak Paqësor?

FALJA

Thashë në kapitullin e mëparshëm se dëlirësia ishte virtyti i krishterë më i papëlqyer. Por nuk jam i sigurt nëse kisha të drejtë për këtë. Mendoj se ka një që është edhe më i papëlqyer. Ai parashtrohet në rregullin e krishterë: “Duaje tjetrin si veten”. Sepse, “tjetri” në moralin e krishterë përfshin edhe “armikun”, ndaj hasim këtë detyrë të tmerrshme për faljen e armiqve tanë.

Të gjithë thonë se falja është gjëja më e bukur, derisa u duhet të falin diçka; siç na u desh neve të bënim gjatë luftës. Edhe atëherë, sikur vetëm ta përmendje këtë gjë, të duhej të përballeshe me britma të inatosura. Nuk është ngaqë njerëzve u duket virtyt tepër i lartë apo i vështirë. Atyre u duket i urryer e i neveritshëm. “Kur e dëgjoj këtë më vjen për të vjellë”, thonë ata. Edhe gjysma prej jush jeni gati të më pyesni: “Si do të ndiheshe ti për faljen e Gestapos nëse do të ishte polak ose çifut?”

Edhe unë pyes veten për këtë. Shumë madje. Edhe kur krishterimi më thotë që nuk duhet ta mohoj besimin tim, aspër ta shpëtuar veten nga tortura vdekjeprurëse, pyes veten se çfarë do të bëja në një rast të tillë. Në këtë libër, unë nuk po përpiqem t’ju them se çfarë do të mund të bëja unë—shumë pak në fakt. Unë po ju them se çfarë është krishterimi. Nuk e

shpika unë. Dhe atje, në mes të tij, unë gjej: “Na fal fajet tona, siç ua falim ne fajtorëve tanë”. Nuk ekziston as sugjerimi më i vogël se falja na ofrohet mbi kushte të tjera. Na është bërë shumë e qartë që nëse nuk falim, nuk do të falemi. Rrugë të dytë s’ka. Si t’ia bëjmë?

Ka për të qenë e vështirë, por mendoj se janë dy gjëra që mund të bëjmë për ta lehtësuar sadopak. Kur nis matematikën, nuk fillon me derivatet e integralet. E nis me llogaritë e thjeshta. Po ashtu, nëse duam vërtet për të mësuar si të falim (pasi gjithçka varet nga dëshira e vërtetë), mbase duhet ta nisim me diçka më të lehtë se Gestapoja. Mund ta nisësh me burrin ose gruan, apo prindërit ose fëmijët, apo oficerin ushtarak më të afërt, për diçka që kanë bërë apo thënë gjatë javës së kaluar. Ka mundësi që kjo do të na mbajë të zënë me punë për momentin. Dhe, së dyti, mund të përpiqemi të gjejmë se çfarë kuptimi ka saktësisht të duash tjetrin si veten. Duhet ta dua atë ashtu siç e dua veten time. Po si, saktësisht, e dua veten time?

Tani që e mendoj, nuk është se kam ndonjë dashuri apo pëlqim të madh për veten time. Jo gjithmonë më pëlqen të jem në shoqërinë e vetes sime. Pra, “dua je tjetrin” nuk paska kuptimin “pëlqeje atë” apo “tërhiq prej tij”. Tashmë sigurisht, e kam provuar se nuk mund të më pëlqejë dikush me zor. A kam mendim të mirë për veten? A më duket vetja djalë i mirë? Po, kam frikë se ka raste që më duket (çastet e mia më të këqija, pa dyshim), por nuk është kjo arsyeja pse e dua veten. Në fakt, është e anasjella: dashuria ime për veten më bën ta mendoj veten si të mirë; por e menduara për veten si të mirë nuk më bën ta dua veten. Kështu, as për të dashur armiqtë nuk m’u dashka t’i mendoj si të mirë. Kjo është shumë lehtësuese. Pasi, ka shumë njerëz që mendojnë se t’i falësh

armiqtë do të thotë të nënkuptosh se ata fundja nuk qenkan aq të këqij, megjithëse janë dukshëm të tillë. Të shkojmë një hap më tej. Kur jam më i qartë në vetvete, jo vetëm që nuk e mendoj veten njeri të mirë, por e di se jam vërtet i keq. Disa nga gjërat që kam bërë mund të më neveriten e të më pështirosen. Pra, qenka e lejuar të urrej e të neverit disa nga gjërat që bëjnë armiqtë e mi. Tani që e mendoj, më kujtohen mësuesit e krishterë që më thoshin më parë se duhet të urrej veprimet e këqija të të keqit, jo të keqin vetë. Ose, siç thonë, urreje mëkatin, por jo mëkatarin.

Për shumë kohë ky dallim më dukej qesharak e i pamundur: si mund ta urresh atë që njeriu bëri, por jo njeriun vetë? Por vite më vonë kuptova befasisht se ishte dikush, të cilit ia kisha bërë këtë gjithë jetën time: vetja. Sado të mos më pëlqente burracakëria, mashtrimi apo lakmia ime, unë vazhdova ta dua veten. Në fakt, arsyeja që i urreja ato gjëra ishte pikërisht dashuria për këtë njeri. Ndieja keqardhje të zbuloja se isha ai lloj njeriu që bënte këto gjëra, pikërisht sepse e doja veten. Si rrjedhojë, krishterimi nuk i heq asnjë atom të vetëm urrejtjes që ndiejmë për mizorinë dhe tradhtinë. Ato duhet t'i urrejmë. Asnjë fjalë e thënë për to nuk ka pse të merret mbrapsht. Por ai na kërkoi t'i urrejmë ato siç i urrejmë gjërat në veten tonë: duke ndierë keqardhje për njeriun që i bëri dhe duke shpresuar, për aq sa është e mundur, që disi, diku, ai mund të shërohet e të bëhet sërish njeri.

Prova e vërtetë është kjo. Le të themi se dikush lexon në një letër një histori plot fëlliqësi dashakeqe. Më pas të supozojmë se diçka del në pah që sugjeron se historia mund të mos jetë saktësisht e vërtetë, apo aq keq sa u duk fillimisht. A është ndjesia jote e parë: "Lavdi Zotit, as ata nuk arritkan të jenë kaq të këqij", apo është një ndjesi zhgënjimi, madje

vendosmërie për t'i qëndruar historisë së parë, thjesht për kënaqësinë e mendimit se armiqtë e tu janë të këqij sa më s'ka? Nëse ndodh e dyta, kam frikë se ky është një hap i parë që, nëse i shkojmë deri në fund, do të na bëjë djaj. Vëreni se ky person nis të dëshirojë që e zeza të ishte pak më e zezë. Nëse e lëmë këtë dëshirë të jetë pa fre, më vonë do të duam ta shohim grinë si të zezë, e pastaj edhe të bardhën vetë si të zezë. Në fund do të shohim me këmbëngulje çdo gjë—përfshirë Perëndinë, miqtë tanë dhe veten tonë—si të keqe, pa mundur dot të ndalemi. Do të kemi ngecur përgjithnjë në një gjithësi urrejtjeje fund e krye.

Tani edhe një hap më tej. Të duash armikun, a do të thotë të mos e ndëshkosh atë? Jo, pasi të dua veten nuk do të thotë që nuk ia nënshtroj veten ndëshkimit—edhe vdekjes madje. Nëse ke kryer vrasje, detyra e krishterë do të ishte ta dorëzoje veten në polici dhe të të varnin. Prandaj është krejtësisht e drejtë, për mendimin tim, që një gjyqtar i krishterë të dënojë dikë me vdekje, ose një ushtar i krishterë të vrasë një armik. Kështu kam menduar gjithnjë, që para se të bëhesha i krishterë, që para luftës, e gjer më tani që jemi në paqe. Është e kotë të citosh: “Mos vrit”. Greqishtja ka dy fjalë: një fjalë që zakonisht ka kuptimin “shkaktim i vdekjes” dhe një fjalë tjetër që ka kuptimin “vrasje”. Dhe, kur citon këtë urdhërim, Krishti përdor kuptimin “vrasje” në të tre tregimet e historisë; Mateut, Markut dhe Lukës. Më kanë thënë edhe se i njëjti dallim ndodh në hebraisht. Jo çdo shkaktim i vdekjes është vrasje, sikundër jo çdo marrëdhënie seksuale është kurorëshkelje. Kur ushtarët pyetën Shën Gjon Pagëzorian se çfarë të bënin, ai kurrë as që nënkuptoi se duhet ta linin ushtrinë. As Krishti nuk e bëri këtë kur takoi një kapiten romak—një kryeqindës, siç quhej atëherë. Ideja e një kalorësi fisnik—një të krishteri

të armatosur për mbrojtjen e një kauze të mirë—është një ide e krishterë madhështore. Lufta është një gjë e tmerrshme dhe unë kam respekt për një pacifist të singertë, pavarësisht se mendoj se e ka shumë gabim. Ajo që nuk perceptoj dot është ky gjysmë-pacifizmi i sotëm që u krijon njerëzve idenë se, edhe pse duhet të luftosh, duhet ta bësh me turpinj varur sikur të të vinte turp për këtë. Kjo është ndjesia që u grabit të rinjve të krishterë, të shkëlqyer në shërbimin ushtarak, diçka që u takon me të drejtë, shoqëruesen e natyrshme të kurajës: një lloj gëzimi dhe qenieje aty me gjithë zemër.

Shpesh kam vrarë mendjen se çfarë do të ndodhte nëse, gjatë kohës që shërbeja në Luftën e Parë Botërore, unë dhe ndonjë i ri gjerman do ta kishim vrarë njëri-tjetrin një-kohësisht dhe do të gjendeshim së bashku një çast pas vdekjes. Nuk e përfytyroj dot të mund të kishim ndonjë inat, apo edhe turp. Mendoj se do të qeshnim për këtë.

E imagjinoj se dikush tani do të thotë: “Meqë u lejoka të dënosh veprimet e armikut, ta ndëshkosh e ta vrasësh atë, ku ndryshon morali i krishterë me atë të zakonshëm?” Ndryshon në gjithçka. Mos harroni, ne të krishterët mendojmë se njeriu jeton përgjithmonë. Për këtë arsye, gjërat më me rëndësi janë ato gjurmët dhe kthesat e pjesës së brendshme, qendrore të shpirtit që në fund e kthejnë atë në një krijesë të Qiellit ose të Ferrit. Nëse është e nevojshme, ne mund të vrasim, por nuk mund të urrejmë dhe ta shijojmë urrejtjen. Mund të ndëshkojmë nëse është e nevojshme, por nuk mund ta shijojmë atë. E thënë ndryshe, gjëja brenda nesh, ndjenja e zemërimit, ndjenja për të marrë hakun, është ajo që duhet të vritet. Nuk dua të them se kushdo mund të vendosë në çast që nuk do ta ndiejë atë kurrë më. Gjërat nuk ndodhin kështu. Dua të them se, sa herë që ajo ta nxjerrë kokën, ditë pas dite,

vit pas viti, për gjithë jetën tonë, ne duhet t'ia shtypim atë. Është punë e vështirë, por përpjekja nuk është e pamundur. Edhe kur jemi duke vrarë e ndëshkuar, duhet të përpiqemi të ndihemi për armikun siç ndihemi për veten: të dëshirojmë që ai të mos ishte i keq, të shpresojmë se ai do të mundë, qoftë në këtë botë, qoftë në tjetrën, të shërohet; në fakt, t'i duam të mirën. Për këtë e ka fjalën Bibla kur thotë që ta duash atë: t'i duash të mirën, jo të të pëlqejë apo të thuash se është i mirë kur nuk është i tillë.

E pranoj, kjo do të thotë se duhet të duam njerëz që nuk kanë asgjë për t'u dashur në ta. Mirëpo, çfarë ka për t'u dashur te vetja jote? Ti e do thjesht sepse është vetja jote. Perëndia na kërkon që t'i duam të gjithë vetët në të njëjtën mënyrë e për të njëjtën arsye. Por na e ka zgjidhur tashmë problemin në veten tonë për të na treguar se si funksionon. Duhet të shkojmë pastaj e ta zbatojmë këtë rregull edhe te të gjithë vetët e tjerë. Mbase e kemi më të lehtë nëse kujtojmë që Ai na do ne në të njëjtën mënyrë. Jo për ndonjë cilësi pozitive apo tërheqëse që ne mendojmë se kemi, por thjesht sepse jemi vetë, persona. Në të vërtetë nuk ka asgjë tjetër të dashur në ne. Ne faktikisht jemi krijesa që ndiejmë kaq kënaqësi në urrejtje, saqë të heqim dorë prej saj na duket sikur po heqim dorë nga birra apo duhani . . .

MËKATI I MADH

Tani arritëm te pjesa ku morali i krishterë dallon më së shumti nga gjithë moralet e tjera. Është një ves të cilit nuk i shpëton dot asnjëri në gjithë botën; të cilin çdo njeri e urren kur e sheh te dikush tjetër; të cilin thuajse askush, përveç të krishterëve, nuk e mendon dot se e ka atë vetë. Kam dëgjuar njerëz të pranojnë se janë të paduruar, se nuk e mbajnë dot veten kur bëhet fjalë për vajza apo pije alkoolike, madje edhe se janë frikacakë. Mirëpo për këtë ves nuk mendoj se e ka akuzuar njeri veten, përveç të krishterëve. Njëkohësisht, rrallëherë kam takuar një jo-të krishterë që tregon edhe mëshirën më të vogël te të tjerët për këtë ves. Asnjë faj tjetër nuk e bën njeriun më të papëlqyer se ky, e asnjë faj nuk është më i panjohur për ne vetë kur e kemi. Dhe, sa më shumë fajtorë të jemi vetë për të, aq më pak e durojmë atë te të tjerët.

Po flas për vesin e Krenarisë, ose të Mendjemadhësisë. Virtyti që në moralin e krishterë vihet përballë tij quhet Përlulësi. Nëse e mbani mend, kur po flisja për moralin seksual, ju paralajmërova se nuk është aty qendra e moralit të krishterë. Tani, pra, arritëm te qendra. Sipas mësuesve të krishterë, vesi më thelbësor, e keqja më e madhe, është krenaria. Shthurja, inati, lakmia, dehja e gjithë të tjerat, janë thjesht pickime mushkonjash në krahasim me të. Krenaria qe

ajo që e bëri djallin djall: krenaria i paraprin gjithë veseve të tjera. Ajo është mendësi krejtësisht kundër Perëndisë.

Ju duket sikur është i tepruar ky cilësim? Nëse po, mendojeni sërish. Një çast më parë ju vura në dukje se sa më shumë krenari të ketë njeriu, aq më shumë e urren krenarinë te të tjerët. Në fakt, nëse do të zbulosh se sa krenar je, mënyra më e lehtë është ta pyesësh veten: “Sa bezdi e kam kur të tjerët më shpërfillin, nuk më vënë re, japin mendim pa i pyetur kush, më nënçmojnë apo më mburren?” Ideja qëndron në faktin se krenaria e secilit konkurren me krenarinë e gjithë të tjerëve. U acarova që dikush tjetër po binte në sy gjatë festës, sepse doja unë të bija në sy. Dy që punojnë të njëjtin zanat nuk janë kurrë në të njëjtën mendje. Ajo që dua të kuptoni qartë është se Krenaria është konkurruese *në thelb*. Nëse veset e tjera janë konkurruese, si të thuash, aksidentalisht, krenaria është konkurruese për nga vetë natyra. Ajo nuk merr asnjë kënaqësi duke patur diçka, vetëm duke e patur atë më shumë se dikush tjetër. Thuhet se njerëzit janë krenarë që janë të pasur, të zgjuar apo të pashëm, por nuk është e vërtetë. Janë krenarë që janë më të pasur, më të zgjuar apo më të pashëm se të tjerët. Nëse të gjithë do të bëheshin njëlloj të pasur, të pashëm apo të zgjuar, nuk do të mbetej gjë për të qenë krenar. Krahاسimi është ai që të bën krenar, kënaqësia e të qenit mbi të tjerët. Nëse zhduket elementi konkurrues, zhduket edhe krenaria bashkë me të. Për këtë arsye them se krenaria është konkurruese në një mënyrë ndryshe nga veset e tjera. Dy burra mund t'i vërë në konkurrencë impulsi seksual, nëse ata të dy duan të njëjtën vajzë. Por kjo ndodh thjesht aksidentalisht; mund të rastiste që të donin dy vajza të ndryshme. Kurse burri krenar do të ta marrë vajzën, jo sepse e do atë, por thjesht për të vërtetuar se është më burrë sesa

ti. Lakmia mund t'i shtyjë njerëzit të konkurrojnë, nëse nuk ka mjaftueshëm për të gjithë. Por njeriu krenar, edhe pasi të ketë më shumë nga sa mund të dojë, do të përpiqet akoma të marrë më shumë thjesht për të vënë në dukje fuqinë e tij. Pothuajse të gjitha ato të këqija në mbarë botën, për të cilat njerëzit fajësojnë lakminë ose egoizmin, në të vërtetë vijnë më shumë si pasojë e Krenarisë.

Të marrim paratë, për shembull. Pa dyshim që lakmia e bën njeriun të dojë para, që të ketë një shtëpi më të mirë, pushime më të mira, gjëra më të mira për të ngrënë e për të pirë. Por vetëm deri në njëfarë mase. Çfarë e shtyn dikë që fiton dhjetë mijë sterlina në vit, të kërkojë njëzet mijë sterlina? Jo lakmia për më shumë kënaqësi: dhjetë mijë sterlina mjaftojnë për të gjithë luksin që mund të shijojë njeriu. Por krenaria—dëshira për të qenë më i pasur se një pasanik tjetër dhe (akoma më shumë) për pushtet. Pasi dihet që pushtetin Krenaria e shijon më shumë. Asgjë tjetër nuk të bën të ndihesh aq superior sa kur ke mundësinë t'i lëvizësh të tjerët si gurë shahu. Çfarë e shtyn një vajzë të bukur të përhapë mjerim kudo shkon duke grumbulluar admirues? Patjetër që jo instinkti seksual: vajza të tilla shpesh janë mjaft të ngurta seksualisht. Por është Krenaria. Çfarë e shtyn një udhëheqës politik, ose një komb të tërë, të kërkojë gjithnjë e më shumë pa u ngopur? Sërish Krenaria. Natyra e krenarisë është konkurruese, ndaj ajo vazhdon pa u ndalur. Nëse unë jam krenar, për sa kohë është dikush më i pasur, më i zgjuar apo më i fuqishëm se unë kudo në botë, ky është rivali e armiku im.

Të krishterët kanë të drejtë: Krenaria është shkaku kryesor i mjerimit në çdo komb dhe familje që në krye të herës. Veset e tjera edhe mund t'i bashkojnë njerëzit. Mes të dehurve apo të shthururve edhe mund të gjesh bashkësi, miqësi dhe shaka.

Por krenaria nënkupton gjithnjë armiqësi—ajo *është* armiqësi. Dhe jo vetëm armiqësi njeri me njeri, por edhe me Perëndinë gjithashtu.

Në Perëndinë ti ndesh diçka që është në çdo aspekt në mënyrë të pamasë superiore ndaj teje. Nëse nuk e njeh Perëndinë si të tillë—e si rrjedhojë, veten tënde si asgjë në krahasim me të—nuk e njeh Perëndinë aspak. Për aq kohë sa je krenar, nuk mund ta njohësh Perëndinë. Krenari gjithnjë i sheh gjërat nga lart poshtë. Duke parë nga lart poshtë, nuk mund të shohë diçka sipër tij.

Kjo ngre një pyetje të tmerrshme. Si është e mundur që njerëz, dukshëm të përpirë nga Krenaria, thonë se besojnë në Perëndi dhe e shfaqin veten mjaft fetarë? Druaj se këta adhurojnë një perëndi imagjinar. Këta e pranojnë teorikisht se nuk janë asgjë krahas këtij perëndie fantazmë, ndërsa në të vërtetë e përfytyrojnë gjatë gjithë kohës duke i miratuar ata e duke i menduar si më të mirë se njerëzit e zakonshëm. Paguajnë, si të thuash, një qindarkë përulësi imagjinare ndaj tij dhe marrin mbrapsht njëqindfish Krenari kundrejt njerëzve të tjerë. Besoj se për të tillë e kishte fjalën Krishti kur tha se disa do të predikonin për të e do të largonin djajtë në emrin e Tij, vetëm që t'u thuhej në fund se kurrë nuk i kishte njohur. Dhe secili prej nesh rrezikon në çdo moment të bjerë në këtë kurth vdekjeprurës. Fatmirësisht, kemi një provë për ta verifikuar këtë. Sa herë që zbulojmë se jeta jonë fetare po na bën të ndihemi që jemi të mirë—mbi të gjitha, që jemi më të mirë se dikush tjetër—mendoj se mund të themi me siguri që jemi duke u nxitur, jo prej Perëndisë, por prej djallit. Prova e vërtetë e qenies në praninë e Perëndisë është që, ose e harron veten fare, ose e mendon si një objekt të vogël, të papastër. Më e mira është ta harrosh veten fare.

Sa e tmerrshme që më i keqi ndër veset mund të futet në qendrën e jetës sonë fetare. Por shkaku është i dukshëm. Veset e tjera, më pak të këqija, vijnë nga puna e djallit nëpërmjet natyrës sonë kafshërore. Por ky nuk vjen aspak nga natyra kafshërore. Ky vjen drejtpërdrejt nga ferri. Është krejtësisht shpirtëror; e si rrjedhojë, shumë më i sofistikuar dhe vdekjeprurës. Për të njëjtën arsye, Krenaria shpesh përdoret për të mundur veset më të thjeshta. Në fakt mësuesit shpesh i drejtohen Krenarisë së një djaloshi, apo respektit për veten, siç e quajnë ata, për ta bërë të sillet mirë: mjaft njerëz kanë mundur burracakërinë, epshin apo nervat duke mësuar se ato janë të ulëta për dinjitetin e tij, domethënë me anë të Krenarisë. Dhe djalli qesh. Është mëse i kënaqur nëse ti bëhesh i dëlirë, trim e i vetëkontrolluar; mjafton që gjatë gjithë kohës të të vendosë nën diktaturën e Krenarisë. Ai në fakt është mjaft i kënaqur të të shikonte të shëruar nga morthi, nëse do të lejohej të të jepte kancerin në këmbim. Pasi Krenaria është një kancer shpirtëror: ajo shkatërron edhe mundësinë e dashurisë, kënaqjes, apo logjikës së shëndoshë.

Para se të vazhdojmë më tutje dua të ruhemi nga disa keqkuptime të mundshme:

(1) Kënaqësia kur të lëvdojnë nuk është krenari. Fëmija që përgëzohet kur i bën mësimet mirë, gruaja që lavdërohet nga i dashuri për bukurinë e saj, shpirti i shpëtuar që Krishti i thotë “Të lumtë!”, kënaqen dhe me shumë të drejtë. Pasi këtu kënaqësia qëndron jo në atë që ti je, por në faktin që ke kënaqur dikë të cilin doje ta kënaqje (dhe me të drejtë). Telashi nis kur kalon nga mendimi: “E kënaqa atë, çdo gjë është në rregull.”, në të menduarin: “Sa njeri i mirë qenkam që e kam bërë këtë!”. Sa më shumë të gëzohesh për veten, dhe sa më pak të gëzohesh për lëvdatën, aq më i keq bëhesh. Kur

gëzohesh vetëm për veten tënde dhe nuk të intereson fare lëvdata, atëherë ke arritur fundin. Prandaj mburrja, ndonëse më e dukshmja në sipërfaqe ndër llojet e krenarisë, është më pak e keqja dhe ajo që falet më kollaj. Njeriu mburravec do lëvdatë, duartrokitje dhe admirim më tepër sesa duhet dhe është gjithnjë duke e lypur atë. Është gabim, por gabim fëminor e madje (çuditërisht) një gabim i përgjithshëm. Ajo tregon që ende nuk je i plotësuar me admirimin tënd. Ti i vlerëson mjaftueshëm të tjerët sa të duash që ata të të shohin ty. Je, në fakt, njerëzor. Krenaria vërtet e zezë dhe djallëzore vjen kur i nënçmon të tjerët aq sa nuk të intereson se çfarë mendojnë për ty. Sigurisht, është e drejtë dhe shpesh e detyrueshme që të mos na interesojë çfarë mendojnë të tjerët për ne, kur e bëjmë këtë për arsyen e duhur: për arsye se na intereson shumë më shumë se çfarë mendon Perëndia për ne. Por Krenari ka një arsye tjetër pse nuk i intereson. Ai thotë: “Ç’më duhen duartrokitjet e kësaj tufe, a thua se ka ndonjë vlerë mendimi i tyre? Edhe sikur të kenë ndonjë vlerë, mos jam ai lloj burri që të skuqem nga kënaqësia e një komplimenti, si ndonjë vajzë e turpshme në kërcimin e saj të parë? Jo, unë jam një personalitet i rritur e i integruar. Çfarë kam bërë, e kam bërë për të kënaqur idealet e mia—ose ndërgjegjen time artistike—ose traditat e familjes sime—ose, me një fjalë, ngaqë ky lloj tipi jam. Nëse tufës i pëlqen, le t’i pëlqejë. Ata nuk janë asgjë për mua.” Në këtë mënyrë krenaria e plotë, e vërtetë mund ta frenojë mburrjen, pasi, siç thashë më parë, djalli vdes ta “shërojë” një gabim i vogël duke të të dhënë një të madh. Duhet të përpiqemi të mos jemi mburravecë, por kurrë nuk duhet të kërkojmë ndihmën e Krenarisë për të na shëruar nga mburrja – ajo është e keqja më e vogël.

(2) Ne në gjuhën tonë themi që një burrë është “krenar”

për të birin, ose biri për të atin, shkollën apo repartin e tij, ndaj vlen të pyesim nëse është mëkat “krenaria” e këtij lloji. Unë mendoj se varet se për çfarë saktësisht jemi “krenarë”. Shumë shpesh, në fjali të tilla, fraza “është krenar” nënkupton “ka një admirim të ngrohtë”. Një admirim i tillë është sigurisht larg të qenit mëkat. Por mund edhe të ketë kuptimin se personi në fjalë po e lartëson veten në bazë të atit të tij të shquar, ose për shkak se i përket një reparti të famshëm. Kjo është qartazi diçka e gabuar; megjithatë, është më mirë se të jesh thjesht krenar për veten. Të duash dhe të admirosh diçka jashtë vetes sate është një hap larg rrënimit të plotë shpirtëror. Megjithëkëtë, nuk ka asgjë më mirë se ta duam dhe ta admirojmë Perëndinë më shumë se çdo gjë tjetër.

(3) Të mos mendojmë se Krenaria është diçka që Perëndia e ndalon ngaqë ofendohet prej saj, apo që Përlësia është diçka që e kërkon për hir të dinjitetit të vet—sikur Perëndia vetë të ishte krenar. Ai nuk merakoset fare për dinjitetin e Tij. Ai do që ti ta njohësh; do të të japë ty Veten e Tij. Ai dhe ti jeni dy gjëra të tilla që, nëse arrin të kesh vërtet njëfarë kontakti me Të, do të jesh vërtet i përlur—i përlur me gëzim, duke ndier lehtësimin e pafund të heqjes qafe një herë e mirë të marrëzive të kota për dinjitetin tënd, që të kanë bërë të trazuar dhe të palumtur gjithë jetën. Për ta bërë të mundur atë çast, ai po përpiqet të të bëjë të përlur: po përpiqet të heqë ato maskat e kota e të shëmtuara që kemi vënë dhe me të cilat ecim kryelartë si tutkunët që jemi. Do të doja të kisha përparuar edhe vetë më shumë në përlësi: po ta kisha bërë këtë, me gjasë do të mund të flisja më shumë për çlirimin dhe rehatinë e heqjes së maskës—e heqjes qafe të vetes sime të rreme, me gjithë ato: “Më shiko mua” dhe “A nuk jam djallë i mirë”, e me gjithë pozat dhe gjestet e saj. T’i afroresh kësaj,

goftë edhe për një çast, është si uji i ftohtë për njeriun në shkretëtirë.

(4) Mos mendoni se, kur të takoni një njeri vërtet të përulur, ai do të jetë si ata që i quajnë “të përulur” njerëzit sot. Ai nuk do të jetë një lloj personi lajkatar e gojëmbël që të thotë gjithnjë se patjetër që ai nuk është askush. Me shumë gjasë, ai do të jetë dikush që duket i gëzueshëm e inteligjent, që i interesoi vërtet ajo që *ti* i the *atij*. Nëse nuk të pëlqen ai, kjo do të ndodhë sepse je ndopak ziliqar për dikë që duket se e shijon jetën kaq lehtësisht. Ai nuk do të jetë duke menduar për përulësinë: nuk do të mendojë për veten fare.

Nëse dikush kërkon të ketë përulësi, mendoj se mund t'i tregoj hapin e parë. Hapi i parë është të kuptosh se je krenar. Dhe është një hap i madh madje. Të paktë, pa këtë nuk mund të bësh asgjë. Nëse nuk mendon se je mendjemadh, kjo do të thotë se je vërtet mendjemadh.

DASHURIA

Në një kapitull të mëparshëm thashë se janë katër virtyte “themeltare” dhe tre “teologjike”. Tre teologjiket janë Besimi, Shpresa dhe Dashuria (Charity). Besimi do të trajtohet në dy kapitujt e fundit. Dashuria u trajtua pjesërisht në kapitullin 7, por aty u përqendrova në pjesën e dashurisë të quajtur Falje. Tani dua të zgjerohemi pak më shumë.

Fillimisht kuptimi i kësaj fjale. “Dashuria” sot ka thjesht kuptimin e asaj që dikur quhej “lëmoshë”—domethënë t’i jepje të varfërve. Kuptimi i mëparshëm i fjalës “charity” ishte shumë më i gjerë⁵. (Mund ta kuptojmë se si e mori kuptimin e sotëm të bamirësisë: nëse dikush ka “charity”, dhënia ndaj të varfërve është një nga gjërat më të dukshme që ai bën, ndaj njerëzit flasin sikur kjo të ishte e gjithë domethënia e asaj fjale. Në të njëjtën mënyrë, rima është gjëja më e dukshme për poezinë, ndaj disa njerëz quajnë poezi thjesht rimën e asgjë më tepër.) Charity do të thotë “Dashuri, në kuptimin e krishterë”. Por dashuria në kuptimin e krishterë nuk ka të bëjë me emocionin. Nuk është një gjendje e ndjenjave, por e vullnetit; atë gjendje të vullnetit që kemi natyrshëm për veten dhe duhet të mësojmë ta kemi edhe për të tjerët.

5 Fjala “charity”, sot përkthehet “bamirësi”, megjithëse kuptimi origjinal ishte “dashuri”. (Shën. i përkth.)

Në kapitullin për Faljen theksova se dashuria për veten nuk do të thotë të na *pëlqejë* vetja. Do të thotë të duam të mirën për veten. Po kështu Dashuria e krishterë (charity) për të tjerët është diçka krejt ndryshe nga pëlqimi apo afeksioni. Neve “na pëlqejnë” ose “kemi për zemër” disa njerëz dhe jo disa të tjerë. Është e rëndësishme të kuptohet se ky “pëlqim” i natyrshëm nuk është as mëkat, as virtyt, sikundër nuk janë mëkat apo virtyt pëlqimet e mospëlqimet për ushqimin. Janë thjesht një fakt. Por, ajo që ne bëjmë me to është patjetër ose mëkatore, ose e virtytshme.

Pëlqimi apo afeksioni i natyrshëm ndaj disa njerëzve e bën më të lehtë të jesh “i dashur” me ta. Prandaj është normalisht detyra jonë t’i nxitim afeksionet tona—të “pëlqejmë” sa më shumë njerëz (siç është shpesh detyra jonë të nxitim pëlqimin tonë për ushtrimin fizik apo ushqimin e shëndetshëm)—jo sepse ky pëlqim është virtyti i dashurisë në vetvete, por sepse e ndihmon atë. Nga ana tjetër, është e domosdoshme të kujdesemi shumë që pëlqimi ynë për një person të mos na bëjë jo mirëdashës, apo edhe të padrejtë, ndaj dikujt tjetër. Ka madje edhe raste kur pëlqimet tona bien në konflikt me dashurinë ndaj personit që pëlqejmë. Për shembull, një nënë e dashur mund të tundohet nga afeksioni i saj i natyrshëm ta “llastojë” fëmijën; domethënë, të plotësojë impulset e saj të dashurisë në kurriz të lumturisë së vërtetë të fëmijës më vonë.

Por edhe pse pëlqimet e natyrshme normalisht duhet të inkurajohen, do të ishte gabim i madh të mendoje se mënyra për t’u bërë i dashur është të ulesh e të mundohesh të krijosh ndjenja pëlqimi. Disa njerëz e kanë temperamentin “të ftohtë”; kjo mund të jetë fatkeqësi për ta, por nuk është më shumë mëkat sesa të paturit e problemeve me tretjen. Dhe

DASHURIA

nuk u heq atyre mundësinë, e as i çliron nga detyra e mësimit të dashurisë. Rregulli për të gjithë ne është mëse i thjeshtë. Mos e shpërdoro kohën duke menduar nëse “e do” apo jo tjetrin: vepro sikur e do atë. Sapo e bëjmë këtë zbulojmë një nga sekretet e mëdha. Nëse sillesh sikur e do dikë, do të arrish së shpejti ta duash atë vërtet. Nëse e dëmton dikë që nuk të pëlqen, do të zbulosh se mospëlqimi për të është rritur. Nëse i bën një të mirë, do ta gjesh veten duke e mospëlqyer më pak. Në fakt, ka vetëm një përjashtim. Nëse i bën mirë atij, jo për të kënaqur Perëndinë e për t’iu bindur ligjit të dashurisë, por për t’i treguar sa djalë i mirë e i mëshirshëm je dhe për ta bërë atë borxhli, dhe pastaj të rrish e të presësh për “mirënjohjen” e tij, me shumë gjasë do të zhgënjehesh. (Njerëzit nuk janë budallenj: ata e dallojnë shpejt shtirjen apo krekosjen.) Por sa herë që i bëjmë mirë dikujt tjetër, thjesht sepse është një vetë, i bërë (si ne) prej Perëndisë, duke dëshiruar lumturinë e tij siç dëshirojmë tonën, do të kemi mësuar si ta duam atë pak më shumë; ose së paku, ta mospëlqejmë më pak.

Si pasojë, ndonëse njerëzve, me kokën plot sentimentalizëm, dashuria e krishterë u duket diçka shumë e ftohtë, dhe megjithëse është e ndryshme nga afeksioni, ajo çon në afeksion. Dallimi midis një të krishteri dhe një njeriu të botës nuk është se njeriu i botës ka vetëm “pëlqime” dhe afeksione, ndërsa i krishteri ka vetëm “dashuri”. Njeriu i botës i trajton mirë njerëzit sepse “i pëlqen”. I krishteri, duke u përpjekur t’i trajtojë mirë secilin, zbulon se pëlqen sa vjen e më shumë njerëz—përfshirë njerëz që nuk do ta imagjinonte kurrë më parë se do t’i pëlqenin.

I njëjti ligj shpirtëror vepron llahtarshëm në drejtimin e kundërt. Mbase fillimisht gjermanët i trajtuan keq çifutët sepse i urrenin ata: më pas i urreyen ata akoma më shumë për

shkak se i kishin keqtrajtuar. Sa më mizor je, aq më shumë do të urresh; dhe sa më shumë të urresh, aq më mizor do të bëhesh—e kështu rrethi vicioz vazhdon pa mbarim.

E mira dhe e keqja rriten të dyja me interes të përbërë. Prandaj vendimet e vogla që unë e ti marrim çdo ditë kanë rëndësi kaq të pafundme. Akti i mirë më i vogël sot është pushtimi i një pike strategjike, prej të cilës, disa muaj më vonë, do të mund të realizosh fitore të cilat nuk i ke ëndërruar kurrë më parë. Një kënaqje në dukje e parëndësishme e epshit apo inatit sot, është humbja e një rruge, vije mbrojtjeje apo hekurudhe, apo një pozicioni të favorshëm prapa vijave armike, që i jep armikut një mundësi për të sulmuar të cilën nuk do ta kishte pa të.

Disa shkrimtarë e përdorin fjalën charity (dashuri) për të përshkruar, jo vetëm dashurinë e krishterë midis njerëzve, por edhe atë të Perëndisë për njeriun dhe të njeriut për Perëndinë. Për këtë të dytën, njerëzit merakosen shpesh. U thuhet se duhet ta duan Perëndinë. Ata nuk mund të gjejnë ndjenja të tilla në vetvete. Çfarë duhet të bëjnë? Përgjigja është e njëjtë si më parë. Sillu sikur e do. Mos rri duke u përpjekur të prodhosh ndjenja. Pyete veten: “Po të isha i sigurt se e dua Perëndinë, çfarë do të bëja?”. Kur ta kesh gjetur përgjigjen, bëje atë.

Në tërësi, dashuria e Perëndisë për ne është një temë shumë më e parrezikshme për ta menduar sesa dashuria jonë për Të. Askush nuk mund të ketë gjithmonë ndjenja devotshmërie. Edhe sikur të mundej, Perëndisë nuk i interesojnë ndjenjat kryesisht. Dashuria e krishterë, qoftë kundrejt Perëndisë apo kundrejt njeriut, është punë vullneti. Nëse po përpiqemi të bëjmë vullnetin e Tij, ne po i bindemi urdhërimit: “Duaje Zotin, Perëndinë tënd”. Ai do të na i japë ndjenjat e dashurisë

DASHURIA

nëse i pëlqen. Ne nuk mund t'i krijojmë vetë, e as nuk duhet t'i kërkojmë ato si diçka që na takon. Mirëpo gjëja e bukur që duhet mbajtur mend është se, megjithëse ndjenjat tona vijnë e ikin, dashuria e Tij jo. Ai nuk lodhet nga mëkatet apo indiferenca jonë; ndaj është e paepur në vendosmërinë për të na kuruar nga ato mëkate, sado të na kushtojë neve dhe sado t'i kushtojë Atij.

SHPRESA

Shpresa është një nga virtytet teologjike. Domethënë që, të shohësh vazhdimisht përpara, në drejtim të botës së përjetshme, nuk është (siç mendojnë disa njerëz sot) një formë arratie apo ëndrre me sy hapur, por një nga detyrat e një të krishteri. Kjo nuk do të thotë ta lësh botën e tashme siç është. Duke lexuar histori, mund të vëresh se të krishterët që bënë më shumë për botën e tashme ishin ata që mendonin më shumë për atë të ardhme. Vetë apostujt, që vunë në lëvizje konvertimin e Perandorisë Romake, të mëdhenjtë që themeluan kohën e Mesjetës, ungjillorët anglezë që hoqën tregtinë e skllëvërve lanë secili gjurmë në Tokë, pikërisht për shkak se mendjet e tyre mbizotëroheshin prej Qiellit. Për shkak se të krishterët kanë pushuar në shkallë të madhe së menduari për botën tjetër, janë bërë të pafrytshëm për këtë botë. Syno Qiellin dhe do ta fitosh edhe tokën bashkë me të. Syno tokën dhe nuk do të fitosh asnjërin. Duket rregull i çuditshëm, por veprimi i tij shfaqet edhe në fusha të tjera. Shëndeti është një bekim i madh, por në çastin që e bën shëndetin një nga objektivat e tu më kryesorë e të rëndësishëm, do të kthehesh në një grindavec, i cili mendon gjithë kohës se diçka nuk shkon me të. Ka më shumë mundësi të jesh i shëndetshëm nëse do më shumë gjëra të tjera—

ushqim, lojëra, punë, argëtim, ajër të pastër. Po kështu, nuk do ta shpëtojmë asnjëherë qytetërimin njerëzor, për aq kohë sa ky është qëllimi ynë kryesor. Na duhet të mësojmë të duam diçka tjetër më shumë.

Shumica prej nesh e kanë mjaft të vështirë edhe ta dëshirojnë “Qiellin”—përveç për aq sa vlen për të takuar sërish miqtë tanë që kanë vdekur. Një nga arsytet për këtë vështirësi është mungesa e trajnimit: i gjithë arsimi ynë priret ta fiksojë mendjen tonë me këtë botë. Një tjetër arsye është që, kur dëshira e vërtetë për Qiellin ngjallet në ne, ne nuk e dallojmë. Sikur të dinin vërtet të shihnin brenda zemrave të tyre, shumica e njerëzve do ta mësonin se vërtet duan, shumë madje, diçka që nuk mund të gjendet në këtë botë. Ka mjaft gjëra në këtë botë që premtojnë ta japin atë, por që nuk arrijnë dot ta përmbushim premtimin. Ëndjet që lindin në ne kur biem në dashuri për herë të parë, apo mendimi i parë për një vend të huaj, apo dëgjimi i parë për një temë që na emocionon, janë ëndje që asnjë martesë, asnjë udhëtim e asnjë studim nuk mundet vërtet t’i kënaqë. Nuk e kam fjalën për martesat, pushimet apo karrierat e cilësuarat zakonisht si të pasuksesshme. E kam fjalën për më të mirat e mundshme. U bëmë të vetëdijshëm për diçka në çastin e parë të kësaj ëndjeje, e cila u venit në realitet. Besoj se të gjithë e dinë për çfarë po flas. Bashkëshortja mund të jetë një grua e mirë, e hoteli dhe peizazhi të shkëlqyer, e profesioni i kimistit shumë interesant: por diçka mungon aty. Ka dy mënyra të gabuara për t’u përballur me këtë fakt, dhe një mënyrë të saktë.

(1) Mënyra e budallait—ai e hedh fajin mbi vetë gjërat. Ai e jeton jetën duke menduar sikur të kishte provuar një grua tjetër, të kishte shkuar me pushime më të shtrenjta, apo çfarëdo qoftë, atëherë do të mund ta kapte vërtet këtë gjënë

misterioze që po kërkojmë të gjithë. Të tillë janë shumica e njerëzve të mërzitur, të pakënaqur dhe të pasur në botë. Ata e shkojnë gjithë jetën duke kaluar nga një grua në tjetrën (përmes divorceve), nga një kontinent në tjetrin, nga një hobi në tjetrin, duke menduar gjithnjë se gjëja e radhës është “e vërteta” më në fund, por duke mbetur gjithnjë të zhgënjyer.

(2) Mënyra e “njeriut të arsyeshëm me këmbë në tokë”—Ai vendos përnjëmend që e gjithë kjo shpresë ishte iluzion. “Patjetër”, thotë ai, “kështu ndihet njeriu kur është i ri. Po, kur arrin moshën time, nuk e ndjek më fundin e ylberit”. Kështu ai vendoset diku e mëson to mos ketë shumë pritshmëri, ta shtypë atë pjesë të vetes që kërkonte, siç do të thoshte ai, të kapte yjet. Kjo gjë priret ta bëjë mendjemadh (i pëlqen të ndihet superior ndaj asaj, që ai e cilëson “adoleshenteske”). Megjithatë, ai e shtyn jetën mjaft rehatshëm në përgjithësi. Rruga e tij do të ishte më e mira që njeriu mund të ndiqte, sikur të mos jetonte përgjithmonë. Por, po sikur lumturia e pafundme të jetë vërtet aty, duke na pritur? Po sikur të mund të kapej fundi i ylberit? Në këtë rast do të ishte vërtet për të ardhur keq nëse e zbulon tepër vonë (në çastin pas vdekjes) që e ashtuquajtura “arsyeja jonë” e kishte mbytur atë aftësi brenda nesh që do të mund t’i shijonte këto gjëra.

(3) Mënyra e krishterë—i krishteri thotë: “Krijesat nuk lindin me dëshira, plotësimi i të cilave nuk ekziston. Foshnja ka uri: ekziston diçka e tillë si ushqimi. Rosaku do të notojë: ekziston diçka e tillë si uji. Njeriu ndien dëshirë seksuale: ekziston diçka e tillë si seksi. Nëse unë ndiej një dëshirë në vetvete të cilën asgjë në botë nuk mund ta plotësojë, shpjegimi më i mirë do të ishte që unë jam bërë për një botë tjetër. Fakti që asnjë nga kënaqësitë tokësore nuk mund ta plotësojë, nuk tregon se gjithësia është mashtrim. Me shumë mundësi,

kënaqësitë tokësore nuk u bënë për ta kënaqur atë, por vetëm për ta nxitur, për të sugjeruar mënyrën e vërtetë. Nëse është kështu, duhet të kem kujdes që, nga njëra anë, to mos jem përçmues apo mosmirënjohës për këto bekime tokësore dhe, nga ana tjetër, të mos i ngatërroj ato me diçka krejt tjetër, krahas të cilës ato janë veçse kopje, jehona, vegime. Duhet të mbaj gjallë në vete dëshirën për atdheun tim të vërtetë, tek i cili nuk mund të shkoj në këtë jetë; atë nuk mund ta lejoj të lihet mënjane apo të anashkalohet. Duhet ta bëj synimin kryesor të jetës rrugëtimin drejt atij vendi tjetër dhe t'i ndihmoj të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë”.

Është e kotë të merakosemi për tallësit që përpiqen ta tregojnë si qesharake shpresën e krishterë për Qiellin duke thënë se nuk kanë ndër mend “ta kalojnë përjetësinë duke i rënë harpës”. Përgjigja ndaj këtyre është që, nëse nuk i kuptojnë librat e shkruar për të rritur, të mos flasin për ta. Gjithë imazhet e shkrimit (harpat, kurorat, ari, etj.) sigurisht që shërbejnë si një përpjekje simbolike për të shprehur të pashprehshmen. Përmendja e instrumenteve muzikore është për shkak se, për shumë njerëz (jo të gjithë), muzika shërben si gjëja më e prekshme e kësaj jete që sugjeron ekstazën e pafundësisë. Kurorat përmenden për të sugjeruar faktin se të bashkuarit me Perëndinë ndajnë përjetësisht me të madhësitë, fuqinë dhe gëzimin e Tij. Ari përmendet për të sugjeruar faktin se Qielli është i përjetshëm (ari nuk ndryshket) dhe se sa i çmueshëm është. Kush i merr këto simbole në kuptimin e parë, duhet të mendojë në të njëjtën mënyrë se, kur Krishti na tha të jemi si pëllumbat, po thoshte që duhet edhe ne të bëjmë vezë.

BESIMI

Do të flas në këtë kapitull për atë që të krishterët e quajnë Besim. Fjala besim përdoret nga të krishterët në dy kuptime, ose në dy nivele të fjalës, dhe unë do t'i trajtoj me radhë. Në kuptimin e parë nënkupton thjesht të pranosh ose cilësosh si të vërteta doktrinat e krishterimit. Është diçka mjaft e thjeshtë. Por ajo që i habit njerëzit—më habiste mua të paktën—ishte fakti se të krishterët e cilësonin besimin në këtë kuptim si një virtyt. Pyesja se si vallë mund të jetë kjo gjë virtyt—çfarë ka të moralshme apo të pamoralshme për besimin apo mosbesimin e një sërë pohimeve? Unë mendoja se, qartazi, njeriu i logjikshëm e pranon, ose e mohon një pohim të caktuar, jo sepse do apo nuk do, por sepse provat për të i duken të vlefshme apo të pavlefshme. Nëse gabohet në vlefshmërinë e provave, kjo nuk do të thotë se është njeri i keq, por thjesht që nuk u tregua shumë i zgjuar. E, nëse provat nuk i dukeshin të vlefshme, por përpiquej ta detyronte veten të besonte pavarësisht kësaj, kjo do të ishte thjesht budallallëk.

Në fakt, ende mendoj në këtë mënyrë. Por ajo që nuk e shihja atëherë—dhe që mjaft njerëz nuk e shohin sot—ishte kjo. Unë po supozoja se, sapo mendja njerëzore e pranon diçka si të vërtetë, do të vazhdojë vetvetiu ta cilësojë atë si të vërtetë, derisa të ketë një arsye të fortë që e detyron ta

rishqyrtojë atë. Në fakt, po supozoja se mendja njerëzore sundohet krejtësisht nga arsyeja. Por kjo nuk është e vërtetë. Për shembull, arsyeja ime është mëse e bindur nga provat e shumta se anestezia nuk më mbyl dhe se kirurgët e mirëtrajnuar nuk e nisin operimin derisa unë të jem i pavetëdijshëm. Por kjo nuk e ndryshon faktin që, sapo më shtrijnë në tavolinë dhe më vendosin maskën e frikshme në fytyrë, brenda më nis një panik fëmënor. Më krijohen mendime sikur do të mbytem, sikur do të më çajnë kur të jem ende i vetëdijshëm. Si të them, e humbas besimin në anestezia. Nuk e humbas besimin për shkak të arsyes: arsyeja është baza e besimit tim. E humbas për shkak të imagjinatës dhe emocioneve të mia. Beteja është midis besimit dhe arsyes nga njëra anë, kundër emocionit dhe imagjinatës nga ana tjetër.

Kur e mendon, mund të vësh plot raste të tilla. Një burrë mund ta dijë, bazuar në prova mjaft bindëse, se një e njohura e tij mjaft e pashme është gënjeshtare dhe nuk i mban sekretet, ndaj nuk i duhet besuar. Mirëpo, duke u gjendur pranë saj, mendja e tij e humb besimin e vet në këto prova dhe nis të mendojë: “Mbase kësaj here do të jetë ndryshe”, e sërish bëhet budalla dhe i tregon diçka që nuk duhet t’i kishte treguar. Mendja dhe emocionet e tij e kanë shkatërruar besimin e tij në atë që ai e dinte se ishte e vërtetë. Ose të marrim djalin që po mëson të notojë. Arsyeja e tij e di më së miri që një trup njerëzor pa mbështetje nuk ka pse të zhytet në ujë: ai ka parë dhjetëra njerëz të pluskojnë dhe notojnë. Por e gjithë çështja është a do të jetë i aftë të vazhdojë ta besojë këtë kur instruktori ta largojë dorën e tij, duke e lënë të pambështetur mbi ujë—apo do të pushojë së besuari dhe, i frikësuar, të zhytet poshtë.

E njëjta gjë ndodh me krishterimin. Unë nuk i kërkoj

askujt ta pranojë krishterimin, nëse arsyetimi i tij më i shëndoshë i thotë se provat anojnë kundër tij. Besimi nuk hyn në këtë pjesë. Por, le të themi se arsyeja e dikujt vendos se provat anojnë në favor të krishterimit. Unë mund t'i them këtij personi se çfarë do të ndodhë me të në javët në vazhdim. Do të vijë një çast kur ai të marrë një lajm të keq, ose të futet në telashe, ose të jetojë në mes të njerëzve të tjerë që nuk e besojnë krishterimin, dhe menjëherë emocionet e tij do ta bombardojnë besimin e tij. Ose do të vijë një çast kur ai do të dëshirojë një femër, ose do të dëshirojë të thotë një gënjeshtër, ose do të ndihet shumë i kënaqur me veten, ose do të shohë një mundësi për të fituar para në një mënyrë që nuk është krejtësisht e drejtë: një çast që, në fakt, do të ishte shumë e leverdishme nëse krishterimi nuk do të ishte i vërtetë. Dhe përsëri dëshirat e tij do të sulmojnë. Nuk e kam fjalën kur dalin arsye të reja të vërteta kundër krishterimit. Ato duhet të trajtohen, por kjo është një çështje tjetër. Unë po flas për çastet kur kundër tij ngrihet veçse një tekë, një gjendje shpirtërore e përkohshme.

Tani, besimi, në kuptimin që po e përdor unë, është arti i mbajtjes fort pas gjërave që arsyeja jote i ka pranuar, pa varësisht gjendjeve të tua shpirtërore që ndryshojnë. Se gjendjet shpirtërore ndryshojnë, çfarëdo këndvështrimi të marrë arsyeja jote. Këtë e di nga eksperiencia. Tani, që jam i krishterë, kam momente kur i gjithë ky këndvështrim më duket sikur vështirë të jetë i vërtetë. Por, kur isha ateist, kisha momente në të cilat krishterimi më dukej aq i mundshëm, sa më frikësonte. Ky rebelim i gjendjeve të tua shpirtërore kundër vetes tënde reale do të vijë patjetër. Prandaj besimi është një virtyt kaq i nevojshëm. Nëse nuk u tregon derën e daljes gjendjeve të tua të ndryshme shpirtërore, nuk mund

të jesh i krishterë i mirëfilltë, madje as një ateist i mirëfilltë, por thjesht një krijesë që shkon sa andej këtej, besimet e të cilës varen nga moti apo nga humori. Si rrjedhojë, na duhet të trajnojmë zakonet e besimit.

Hapi i parë është të pranosh faktin se gjendet e tua shpirtërore ndryshojnë. Ai i radhës, është të sigurohemi se, nëse e kemi pranuar krishterimin, atëherë disa nga doktrinat kryesore të tij duhet të mbahen parasysh në mënyrë të qëllimshme në çaste të caktuara çdo ditë. Kjo është arsyeja pse lutjet e përditshme, leximet fetare dhe vajtja në kishë janë pjesë të domosdoshme të jetës së krishterë. Na duhet të kujtojmë vazhdimisht se çfarë besojmë. As ky besim e asnjë besim tjetër nuk do të mbetet vetvetiu i gjallë në mendjen tonë. Ai duhet ushqyer. Faktikisht, duke i shqyrtuar qindra njerëzit që e humbasin besimin në krishterim, pyes veten se sa prej tyre iu mbush mendja për shkak të arsytimit të sinqertë? A nuk ndodh që shumica prej tyre thjesht e lejojnë veten që t'i marrë rrjedha?

Tani duhet të trajtoj besimin në kuptimin e dytë e më të lartë. Kjo në fakt është gjëja më e vështirë që kam trajtuar deri tani. Dua t'i qasem duke iu kthyer çështjes së Përlulësisë. Mund ta mbani mend se thashë që hapi i parë drejt përlulësisë ishte të kuptosh që je krenar. Tani po shtoj se hapi i radhës është të bësh përpjekje serioze për të praktikuar virtytet e krishtera. Një javë nuk është e mjaftueshme. Javën e parë gjërat shkojnë vaj. Provo njëherë gjashtë javë. Deri atëherë, duke arritur të biesh poshtë, edhe më poshtë se pika e nisjes, për aq sa mund ta kuptosh, do të kesh zbuluar disa të vërteta për veten. Askush nuk e di se sa i keq është deri kur i duhet të mundohet fort për të qenë i mirë. Po qarkullon një ide e kotë që njerëzit e mirë nuk e dinë se çfarë është tundimi.

Një gënjeshtër e padiskutueshme. Vetëm ata që përpiqen t'i rezistojnë tundimit e dinë se sa i fortë është ai. Në fund të fundit, ju e zbuloni forcën e ushtrisë gjermane duke luftuar kundër saj, jo duke u dorëzuar. Fuqinë e erës e zbuloni duke u përpjekur të ecni kundër saj, jo duke u shtrirë përtokë. Njeriu që i dorëzohet tundimit pas pesë minutash as që e ka idenë se si do të ishte një orë më vonë. Prandaj, në njëfarë mënyre, njerëzit e ligj dinë shumë pak për ligësinë. Kanë jetuar nën strehën e dorëzimit para saj. Kurrë nuk e zbulojmë forcën e impulsit të së keqes brenda nesh, derisa përpiqemi ta luftojmë atë: dhe Krishti, për shkak se ishte i vetmi njeri që nuk iu dorëzua kurrë tundimit, është njëherësh i vetmi që e njeh kuptimin e tundimit plotësisht—i vetmi realist i vërtetë. Shumë mirë, pra. Gjëja më e rëndësishme që mësojmë, nga përpjekja serioze për të praktikuar virtytet e krishtera, është fakti i dështimit tonë. Nëse ka pasur ndonjë ide, sipas së cilës Perëndia na ka vënë në njëfarë provimi, ku mund të marrim nota të mira duke i merituar ato, kjo duhet zhdukur. Nëse ka pasur ndonjë ide për njëfarë pazari—ku ne mund të kryejmë detyrimin tonë të kontratës, duke e vendosur Perëndinë në borxhin tonë, dhe Ai, për hir të drejtësisë, është i detyruar të kryejë detyrimin e Tij—kjo duhet zhdukur.

Mendoj se idenë e provimit dhe të pazarit e ka kushdo që beson në ndonjë mënyrë të vagullt në Perëndi, derisa bëhet i krishterë. Copëtimi i kësaj ideje është pasoja e parë e krishterimit të vërtetë. Duke zbuluar copat e thyera të kësaj ideje, njerëzit mendojnë se hidhet poshtë edhe krishterimi, ndaj heqin dorë. Ata duket sikur e mendojnë Perëndinë si tepër naiv. Në fakt, Perëndia është mëse i vetëdijshëm për këtë. Pikërisht një nga gjërat që duhej të bënte Krishterimi ishte të shkatërronte këtë ide. Perëndia ka qenë duke pritur

çastin që ti do të zbuloje se nuk bëhet fjalë për të merituar notë kaluese në këtë provim, e as për futjen e Tij në borxh ndaj teje.

Dhe më pas vjen zbulimi tjetër. Çdo tipar që ti ke, fuqia jote e të menduarit apo e lëvizjes së gjymtyrëve të tu në çdo çast, të jepet prej Perëndisë. Nëse ia përkushton çdo çast të jetës sate vetëm e vetëm shërbimit të Tij, ti nuk i jep Atij asgjë që nuk është tashmë e Tija, në njëfarë kuptimi. Ndaj më lini t'ju tregoj se si është kur ne bëjnë diçka për Perëndinë apo kur i japim diçka Atij. Është si një fëmijë i vogël që shkon tek ati dhe i thotë: “Babi, më jep gjashtë shilinga që të të blej diçka për ditëlindje”. Sigurisht që ati e bën këtë dhe është i kënaqur me dhuratën e fëmijës. Çdo gjë duket mirë e bukur, por vetëm një i pamend do të mendonte se ati doli gjashtë shilinga plus në këtë rast. Pasi njeriu i ka bërë këto dy zbulime, Perëndia mund të veprojë gjëra të jashtëzakonshme. Vetëm pas kësaj fillon jeta e vërtetë. Tani njeriu u zgjua. Tani mund të vazhdojmë të flasim për Besimin në kuptimin e dytë të tij.

BESIMI

Dua të nis duke thënë diçka që do të doja të gjithë ta vërenit me vëmendje. Shikoni. Nëse ky kapitull nuk ka kuptim për ju, nëse duket se po u përgjigjet pyetjeve që ju nuk i keni bërë kurrë, mësoni menjëherë. Mos u shqetësoni për të. Ka gjëra të caktuara në lidhje me krishterimin që mund të kuptohen nga jashtë tij, para se të bëhesh i krishterë. Por ka edhe shumë gjëra që nuk mund të kuptohen, pa ecur njëfarë distance në udhën e krishterë. Këto gjëra janë tërësisht praktike, ndonëse nuk duken si të tilla. Janë udhëzime për të përballuar udhëkryqe e pengesa të caktuara në udhëtim, të cilat nuk kanë kuptim derisa njeriu të ketë arritur në ato vise. Në çdo rast që hasni thënie në shkrimet e krishtera, të cilat ju duken pa kuptim, mos u shqetësoni. Mësoni. Do të vijë një ditë, mbase vite më vonë, kur papritmas do ta shihni kuptimin e tyre. Nëse dikush mund ta kuptojë para kohe, do të ishte vetëm në dëm të tij.

Kjo patjetër që më fajëson mua më shumë se këdo tjetër. Ajo të cilën do të përpiqem të shpjegoj në këtë kapitull mund të jetë e paarritur prej meje. Mund të jem duke menduar se jam aty, kur në fakt nuk kam arritur ende. Thjesht ju kërkoj të krishterëve të mësuar të vëzhgojnë me kujdes dhe të më tregojnë se ku mund të gaboj; të tjerët mund ta marrin atë që them duke lënë vend për dyshim të arsyeshëm—si diçka e

ofruar për shkak se mund të ndihmojë, jo për shkak se jam i sigurt se kam të drejtë.

Po përpiqem të flas për Besimin në kuptimin e dytë, më të lartin. Sapo thashë se çështja e Besimit në këtë kuptim lind pasi personi ka bërë më të mirën për të praktikuar virtytet e krishtera, ka zbuluar se ka dështuar, dhe e ka parë se edhe nëse do të mund t'i realizonte, thjesht do të ishte duke i kthyer Perëndisë atë që tashmë ishte e Tija. Domethënë, ai ka zbuluar falimentimin e tij. Edhe një herë, ajo që i intereson Perëndisë nuk ka të bëjë saktësisht me veprimet tona. Atij i intereson që ne të jemi krijesa të një lloji ose cilësie të caktuar—krijesat që Ai na krijoi të ishim—krijesa që në njëfarë mënyre lidhen me Të. Nuk shtoj “dhe lidhen me njëra-tjetrën në një mënyrë të caktuar”, pasi kjo është e përfshirë: nëse je në rregull me Të, je padyshim në rregull me krijesat e tjera, si telat e diskut të rrotës: nëse janë të vendosura në vendin e duhur në rrotë, janë edhe në pozicionin e duhur në lidhje me njëra-tjetrën. Ndërsa për aq kohë sa njeriu e mendon Perëndinë si një vlerësues që do t'i korrigjojë detyrën, ose një palë tjetër në një lloj pazari—për aq kohë sa mendon për të drejta dhe detyra mes tij dhe Perëndisë—ai nuk është ende në një marrëdhënie të drejtë me të. Ai po keqkupton çfarë është ai dhe çfarë është Perëndia. Dhe nuk mund të kemi marrëdhënie të drejtë me Të pa zbuluar faktin e falimentimit tonë.

Them “zbuluar” në kuptimin e vërtetë të fjalës: nuk po përdor shprehjen në mënyrë boshe, si papagall. Sigurisht, çdo fëmijë me njëfarë arsimimi fetar do të mësojë shpejt të thotë se ne nuk mund t'i ofrojmë asgjë Perëndisë, që nuk i përket tashmë Atij: edhe atë nuk arrijmë ta ofrojmë pa mbajtur diçka për vete. Por unë po flas për zbulimin e vërtetë të kësaj: ta kuptosh me gjithë mend nga eksperiencia që kjo është e vërtetë.

Në këtë kuptim, nuk mund ta zbulojmë dështimin tonë në mbajtjen e ligjit të Perëndisë përveçse duke e tentuar mbajtjen e tij me të gjitha forcat tona (dhe duke dështuar). Pa e provuar vërtet këtë, çfarëdo që të themi me zë të lartë, do të mbetet e fshehur në mendjen tonë ideja që, nëse përpiqemi më fort herën tjetër, do t'ia dalim të jemi plotësisht të mirë. Pra, në njëfarë kuptimi, rruga e kthimit të Perëndia është rruga e përpjekjes morale gjithnjë e më të madhe. Nga ana tjetër, nuk është kjo përpjekje ajo që do të na çojë në shtëpi. E gjithë përpjekja çon në çastin kritik ku kthehemi të Perëndia dhe i themi: “Ti duhet ta bësh këtë. Unë nuk mundem”. Ju lutem, mos filloni të pyesni veten: “A e kam arritur këtë çast?”. Mos u ulni duke vëzhguar mendjen tuaj nëse po ndodh apo jo. Kjo e çon njeriun në një udhë shumë të gabuar. Kur na ndodhin gjërat më të rëndësishme në jetë, ne shpesh nuk jemi të vetëdijshëm në çast se çfarë po ndodh. Njeriu nuk i thotë gjithnjë vetes: “Pa shih! Po rritem”. Shpeshherë ai e kupton se çfarë ka ndodhur vetëm duke parë mbrapa, dhe e dallon atë që njerëzit e quajnë “rritje”. Mund ta dallosh këtë edhe në gjëra të thjeshta. Njeriu që përpiqet me ankth të shikojë nëse do ta zërë gjumi, me shumë mundësi do të mbetet zgjuar. Edhe gjëja për të cilën po flas unë mund të mos u ndodhë të gjithëve në një çast si rrufe—siç i ndodhi shën Palit apo Bunyan-it. Mund të jetë aq graduale, sa asnjë nuk do të mund të përcaktojë orën apo edhe vitin me saktësi. Ajo që ka rëndësi është natyra e vetë ndryshimit, jo se si ndihemi ne gjatë tij. Është ndryshimi, nga të qenit plot vetëbesim në përpjekjet tona, në gjendjen ku jemi të pashpresë për të bërë diçka vetë, dhe ia lëmë në dorë Perëndisë.

E di që fjalët “ia lëmë në dorë Perëndisë” mund të keq-kuptohen, por ato duhet të mbeten këtu për një moment.

I krishteri ia lë në dorë Perëndisë në kuptimin që i beson plotësisht Krishtit. Ai beson se Krishti do të ndajë bashkë me të atë bindje të përsosur njerëzore që bëri nga lindja e Tij deri në kryqëzim: që Krishti do ta bëjë atë më të ngjashëm me Të dhe, si të thuash, do t'i kompensojë mangësitë e tij. Në terminologjinë e krishterë, Ai do ta ndajë “birërinë” e tij me ne, do të na bëjë si Vetja, “Bij të Perëndisë.” Kuptimin e këtyre fjalëve do të tentoj ta analizoj më tej në librin IV. Që ta kuptoni në një mënyrë tjetër, Krishti ofron diçka në këmbim të asgjëje: ofron madje gjithçka në këmbim të asgjëje. Në njëfarë mënyrë, gjithë jeta e krishterë konsiston në pranimin e kësaj oferte të mrekullueshme. Por vështirësia qëndron në pranimin e faktit se çdo gjë që ne kemi bërë dhe mund të bëjmë, nuk është asgjë. Ne do të na pëlqente më shumë sikur Perëndia të na i llogariste të mirat dhe të na i injoronte të këqijat. Përsëri, në një kuptim, ti mund të thuash që asnjë tundim nuk mposhtet derisa ne të ndalojmë së përpjekuri për ta mposhtur atë—derisa të heqim dorë. Por nuk do të mund të “hiqje dorë” siç duhet e për arsyen e duhur, pa dhënë më parë maksimumin tënd. Dhe nga ana tjetër, sigurisht që t’ia lësh gjithçka në dorë Krishtit nuk do të thotë aspak që të heqësh dorë. Pa diskutim që t’i besosh atij do të thotë të mundohesh të bësh gjithçka që thotë ai. Nuk ka kuptim të thuash se i beson dikujt kur nuk e merr parasysh këshillën e tij. Ndaj, nëse i je dorëzuar Atij vërtet, rrjedhimisht duhet të jesh duke u përpjekur t’i bindesh Atij. Por këtë e bën në një mënyrë të re, pa qenë aq në merak sa më parë. Nuk e bën për t’u shpëtuar, por sepse Ai ka filluar tashmë të të shpëtojë. Jo duke shpresuar për Qiellin si shpërblim për veprimet e tua, por si një dëshirë e pashmangshme për të vepruar në një mënyrë të caktuar, e cila vjen nga fakti se rrezet e para të

Qiellit tashmë shkëlqejnë brenda teje.

Të krishterët kanë diskutuar shpesh nëse janë veprat e mira ato që e çojnë të krishterin në shtëpi (në Parajsë), apo Besimi në Krishtin. Unë nuk kam fare të drejtë të flas mbi një çështje kaq të vështirë, por më duket sikur është si të pyesësh se cili nga tehet e gërshtë është më i domosdoshëm. Përpjekja serioze morale është e vetmja gjë të sjell në pikën e dorëzimit. Besimi në Krishtin është e vetmja gjë që, në këtë pikë, mund të të shpëtojë nga dëshpërimi. Dhe nga ai Besim në Të, do të vijë se s'bën vepra të mira. Janë dy shtrembërime të së vërtetës, me të cilat grupe të ndryshme të krishterësh kanë akuzuar të krishterët e tjerë. Mbase ato na e qartësojnë se si është e vërteta. Njëri grup u akuzua se po thoshte: “Vetëm veprat e mira kanë rëndësi. Gjëja më e mirë që mund të bësh është bamirësia. Forma më e mirë e bamirësisë është dhënia e parave. Më e mira është t'i japësh para kishës. Ndaj na jep dhjetë mijë sterlina dhe do të mbarosh punë”. Sigurisht që përgjigja ndaj kësaj marrëzie do të ishte që veprat e mira të bëra për një motiv të tillë, me idenë se Qielli mund të blihet, nuk do të ishin fare vepra të mira, por spekulime komerciale. Grupi tjetër akuzohej se po thoshte: “Vetëm besimi ka rëndësi. Si rrjedhojë, nëse ke besim, nuk ka fare rëndësi se çfarë bën. Mëkato pa e vrarë mendjen hiç, mik. Bëj qejf e Krishti do të sigurohet që, çfarëdo që të bësh, në fund nuk do të ketë rëndësi”. Përgjigjia për këtë marrëzi është që, nëse ai që ti e quan “besim” në Krishtin nuk i kushton as vëmendjen më të vogël asaj që Krishti thotë, ai nuk është fare besim—as zënie besë, por thjesht pranim intelektual i njëfarë teorie për Të.

Bibla e vulos çështjen pa mëdyshje kur i bashkon të dyja gjërat në një fjali mahnitëse. Gjysma e parë thotë: “Punoni

për shpëtimin tuaj me frikë e me dridhje” - që duket sikur gjithçka varet nga ne dhe veprat e mira që ne bëjmë, por gjysma tjetër vazhdon: “sepse është Perëndia ai që iu jep vullnetin dhe forcën për të vepruar”, dhe duket se po thotë që Perëndia bëri gjithçka, ndërsa ne asgjë. Kam frikë se me këto lloj gjërash ndeshemi në krishterim. E pyes veten se ç’kuptim kanë, por nuk habitem. Kuptoni që tani po përpiqemi të kuptojmë dhe të ndajmë në pjesë të veçuara hermetikisht se çfarë bën Perëndia dhe çfarë bën njeriu, kur Perëndia dhe njeriu punojnë së bashku. Prandaj mendojmë fillimisht se duhet t’i ngjajë patjetër dy njerëzve që punojnë së bashku, ndaj mund të thuhet: “Ai bëri këtë dhe unë bëra atë”. Por kjo e menduar bie poshtë. Perëndia nuk është i tillë. Ai është po aq brenda teje sa edhe jashtë teje. Edhe sikur ta kuptonim se cili bëri cilën pjesë të punës, nuk mendoj se kjo mund të shprehej korrektësisht nga gjuhët njerëzore. Kisha të ndryshme thonë gjëra të ndryshme në përpjekje për ta shprehur atë. Por, edhe kishat që mëshojnë më fort te veprat e mira do të të thonë që ke nevojë për besim; edhe ato që mëshojnë më fort te besimi të thonë se të duhen vepra të mira. Deri këtu mund të shkoj unë të paktën.

Mendoj se të gjithë të krishterët do të binin dakord me mua nëse do të thosha se, ndonëse krishterimi fillimisht duket të jetë i përbërë nga morali, nga detyrat, rregullat, faji dhe virtyti, të drejton në vazhdim jashtë tyre, te diçka përtej. Arrin t’i hedhësh sytë një vendi ku nuk flitet për këto gjëra, përveçse me shaka mbase. Të gjithë ata atje janë të mbushur plot mirësi, si pasqyra e mbushur me dritë. Por ata nuk e dallojnë si mirësi. Nuk e dallojnë si asgjë. Nuk e mendojnë atë. Ata janë tepër të zënë duke parë burimin prej të cilit ajo vjen. Por kjo ndodh afër fazës kur udha e kalon cakun e botës sonë.

THJESHT KRISHTËRIM

Sytë e askujt nuk mund të shquajnë shumë larg matanë atij:
sytë e shumë të tjerëve mund të shohin më larg se të mitë.

LIBRI KATËR

**PËRTEJ PERSONALITETIT
DHE HAPAT E PARË
NË DOKTRINËN
E TRINISË**

BËRJE DHE LINDJE

Të gjithë më kanë paralajmëruar të mos ju tregoj atë që do t'ju tregoj në këtë libër të fundit. Ata më thonë: “Lexuesi i zakonshëm nuk do Teologji; jepi thjesht këshilla fetare praktike”. Këshillën e tyre e kam hedhur poshtë. Unë nuk mendoj se lexuesi i zakonshëm është kaq mendjeshkurtër. Teologji do të thotë “shkenca e Perëndisë”, dhe mendoj se çdokush që kërkon të mendojë për Perëndinë, do të donte të kishte idetë më të qarta dhe më të sakta të mundshme për Të. Ju nuk jeni fëmijë: e përse duhet të trajtoheni si të tillë?

Në njëfarë mënyre e kuptoj fare mirë pse disa njerëz i nuk ndihen rehat nga tema e Teologjisë. Më kujtohet, kur po mbaja një ligjëratë para Forcave Ajrore Mbretërore të Britanisë, që një oficer i regjur nga përvoja u ngrit dhe tha: “Këto gjëra nuk më hyjnë në punë. Por, ta dish, edhe unë jam njeri fetar. E di se ka një Perëndi. Unë e kam ndier vetë, jashtë, në natën e shkretëtirës, atë mister të pamasë. E për këtë arsye nuk i besoj gjithë këto formulat e dogmat tuaja të sofistikuar në lidhje me Të. Për këdo që e ka takuar Atë vërtet, gjithë këto duken aq të kota, aq pedanteske dhe joreale!”.

Në një kuptim të caktuar, jam dakord me këtë njeri. Mendoj se ai me siguri pati një përjetim të vërtetë të Perëndisë në shkretëtim. Mendoj edhe se, kur u kthye nga ky përjetim

te besoret e krishtera, ai po kthehej vërtet nga diçka reale te diçka më pak reale. Në të njëjtën mënyrë, nëse dikush e sheh oqeanin Atlantik nga buzë plazhit, e shkon më pas dhe sheh një hartë të Atlantikut, edhe ky po kthehej nga diçka reale te diçka më pak reale: nga dallgët reale te një letër e ngjyrosur. Por ideja është kjo. Harta vërtet është thjesht një letër e ngjyrosur, por ka dy gjëra për të që duhen mbajtur mend. Së pari, ajo bazohet në zbulimet e qindra e mijëra njerëzve që kanë lundruar në Atlantikun e vërtetë. Kështu ajo ka pas vetes eksperiencat të shumta po aq reale sa ajo që mund të kesh patur nga plazhi; por, teksa e jotja ishte një pamje e vetme e izoluar, harta i thur bashkë të gjitha ato eksperiencat të ndryshme. Së dyti, nëse do të shkosh diku, është absolutisht e domosdoshme të kesh hartë. Për aq kohë sa je i kënaqur me shëtitjet në plazh, këtë peizazh me të drejtë nuk do ta ndërroje me një hartë. Por harta do të jetë shumë më e dobishme se shëtitjet në plazh nëse kërkon të shkosh në Amerikë.

Teologjia, pra, është si një hartë. Nëse mbetesh vetëm me të mësuarin dhe të menduarin për doktrinat e krishtera, do të përjetosh diçka më pak reale dhe më pak emocionuese sesa gjërat si ajo që miku im përjetoj në shkretëtirë. Doktrinat nuk janë Perëndia. Ato janë vetëm një lloj harte. Por kjo hartë bazohet mbi eksperiencat e qindra njerëzve që ishin në kontakt të vërtetë me Perëndinë. Krahës këtyre eksperiencave, çdo emocion apo ndjesi perëndishmërie që mund të kemi unë e ti, është veçse elementare dhe e vogël. Dhe së dyti, të duhet patjetër harta nëse kërkon të shkosh më tutje. Pasi, ajo që i ndodhi atij njeriu në shkretëtirë, vërtet mund të ketë qenë reale e padyshim emocionuese, por nuk del gjë prej saj. Nuk të çon askund. Nuk ka asgjë që mund të bësh në lidhje me

të. Kjo madje është arsyeja përse një fe kaq e vagullt—vetëm me ndjenja për Perëndinë në natyrë e kesi gjërash—është kaq joshëse. Ka vetëm emocione e aspak punë: si vëzhgimi i valëve në plazh. Por nuk mund të shkosh në Njufauld⁶ duke e studiuar në këtë mënyrë Atlantikun, dhe jeta e përjetshme nuk mund të merret thjesht duke ndier praninë e Perëndisë në lule apo në muzikë. As mund të shkosh diku thjesht duke parë hartat, pa shkuar në det. Dhe as nuk do të jesh i sigurt nëse shkon në det pa hartë.

E thënë ndryshe, Teologjia është praktike; veçanërisht tani. Dikur, kur arsimi dhe diskutimi ishte i pakët, disa ide të thjeshta për Perëndinë edhe mund të ishin të pranueshme. Por jo tani. Të gjithë lexojnë, të gjithë dëgjojnë diskutime të gjërave. Rrjedhimisht, edhe nëse nuk e dëgjon Teologjinë, nuk do të thotë se nuk ke fare ide për Perëndinë. Do të thotë se ke shumë ide të gabuara—ide të këqija, të ngatërruara e të hedhura poshtë tashmë. Pasi një pjesë e madhe e ideve për Perëndinë, që na parashtrohen sot si risi, janë thjesht ato të cilat Teologët e vërtetë i provuan shekuj më parë dhe i hodhën poshtë. Të besosh në fenë e përhapur të Anglisë së sotme është një regres—si të besosh se toka është e sheshtë.

Pasi, në thelb, a nuk është ideja më e përhapur për krishterimin kjo: që Jezu Krishti qe një mësues i madh moral dhe, po ta ndjekim këshillën e tij, mund të kemi mundësinë të themelojmë një rend shoqëror më të mirë dhe të shmangim një tjetër luftë”? Tani, po, kjo është e vërtetë. Por është një pjesë shumë e vogël e së vërtetës për krishterimin e nuk ka asnjë rëndësi praktike.

Është sigurisht e vërtetë që, nëse ndjekim këshillën e Krishtit, do të arrijmë të jetojmë në një botë më të lumtur

6 Në Kanada, shën. red.

shumë shpejt. Madje as që kemi nevojë të shkojmë deri te Krishti. Sikur të bënim gjithçka që na kanë thënë Platoni ose Aristoteli ose Konfuci, do të ishim shumë më mirë nga sa jemi. E çfarë pastaj? Ne asnjëherë nuk e kemi dëgjuar këshillën e mësuesve të mëdhenj. E pse do ta bëjmë këtë tani? Përse do të jemi të gatshëm ta ndjekim Krishtin më shumë se të tjerët? Sepse është mësuesi moral më i mirë? Por kjo e bën edhe më pak të mundur që ne do ta ndjekim atë. Nëse nuk arrijmë të nxëmë mësimet elementare, sa janë gjasat që të nxëmë më të avancuarin? Nëse krishterimi është thjesht një tjetër këshillë e mirë, atëherë nuk ka as edhe një rëndësi. Këshillat e mira nuk na kanë munguar në këta katër mijëvjeçarët e fundit. Disa të tilla më shumë nuk ndryshojnë asgjë.

Mirëpo, sa i hedh sytë një shkrimi të vërtetë të krishterë, zbulon se ata po flasin për diçka krejt ndryshe nga kjo fe moderne. Ata thonë se Krishti është Biri i Perëndisë (cilido qoftë kuptimi i kësaj). Thonë se ata që e vendosin besimin tek Ai mund të bëhen edhe ata Bij të Perëndisë (cilido qoftë kuptimi i kësaj). Thonë se vdekja e Tij na ka shpëtuar nga mëkatet tona (cilido qoftë kuptimi i kësaj).

Është e kotë të ankohesh se këto pohime janë të vështira. Krishterimi pretendon të na tregojë për një botë tjetër, diçka përtej asaj që prekim, dëgjojmë dhe shohim. Mund të mendosh se ky pretendim është i rremë; por nëse është i vërtetë, ajo që na tregon duhet të jetë patjetër e vështirë—të paktën po aq e vështirë sa fizika moderne, dhe për të njëjtën arsye.

Pohimi i krishterimit që na trondit më shumë është ai që thotë se, duke e bashkëlidhur veten me Krishtin, ne mund të “bëhemi Bij të Perëndisë”. Dikush mund të pyesë: “Nuk qenkemi tashmë Bij të Perëndisë? Patjetër që Perëndia si Atë është një nga idetë kryesore të krishterimit, apo jo?”. Po,

patjetër që në një kuptim të caktuar ne jemi tashmë bij të Perëndisë. Domethënë, Perëndia na krijoi, na do dhe kujdeset për ne, e në këtë mënyrë është një atë për ne. Por, kur Bibla thotë se ne “bëhemi” Bij të Perëndisë, po flet qartazi për diçka tjetër. Dhe kjo na vë përballë qendrës së vetë Teologjisë.

Një nga besoret e krishtera thotë se Krishti është Biri i Perëndisë “i lindur, jo i krijuar”, dhe kësaj i shton “i lindur prej Atit të tij para gjithë botëve”. Ju lutem kuptojeni se kjo nuk ka aspak të bëjë me faktin që Krishti lindi në tokë si njeri, si biri i një të virgjre. Nuk po flasim për Lindjen e Virgjër. Po flasim për diçka që ndodhi që para se të krijohet Natyra vetë, para fillimit të vetë kohës. “Përpara gjithë botëve”, Krishti u lind, nuk u krijua. Çfarë do të thotë kjo?

Nuk para i përdorim më fjalët *i lindi*⁷ aq shpesh në anglishten moderne, megjithatë njerëzit e dinë kuptimin. Të të lindë dikush do të thotë të bëhesh atë i tij, kurse të krijosh do të thotë të bësh diçka. Dhe ndryshimi qëndron këtu. Kur të lind, të lind diçka e të njëjtit lloj si vetja jote. Njeriut i lindin bebe njerëzore, kastorit i lindin kastorë të vegjël dhe zogut vezë që kthehen në zogj të vegjël. Por kur bën diçka, ajo është e një lloji ndryshe nga ti. Zogu bën një fole, kastori ndërton një digë, njeriu bën një aparat radioje. Mund të bëjë edhe diçka më të ngjashme me veten se një aparat radioje; një statujë, për shembull. Nëse është një gdhendës mjaft i aftë mund ta bëjë statujën të duket vërtet si një njeri. Por jo një njeri të vërtetë, sigurisht: thjesht diçka që duket si i tillë. Ajo nuk mund të marrë frymë apo të mendojë. Nuk është e gjallë.

Kjo është gjëja e parë që duhet qartësuar. Ajo që Perëndia lind është Perëndi; si ajo që lind njeriu është njeri. Ajo që Perëndia krijon nuk është Perëndi, si ajo që njeriu krijon nuk

7 Nga anglishtja, begot: u bë atë i tij.

është njeri. Prandaj njerëzit nuk janë Bij të Perëndisë në të njëjtin kuptim siç është Krishti. Mund të jenë si Perëndia në mënyra të caktuara, por nuk janë gjëra të të njëjtit lloj. Janë më shumë si statuja ose piktura të Perëndisë.

Statuja ka formën e njeriut, por nuk është e gjallë. Kështu, njeriu ka ngjashmërinë ose “formën” e Perëndisë (në kuptimin që do të shpjegoj më pas), por nuk ka në vete atë lloj jete që ka Perëndia. Le të marrim pikën e parë (ngjashmërinë e njeriut me Perëndinë). Gjithçka që Perëndia ka bërë, ka njëfarë ngjashmërie me të. Hapësira është si ai në madhësinë e saj: jo se madhësia e hapësirës është e të njëjtit lloj si ajo e Perëndisë, por është si një simbol i saj, si një përkthim i saj në terma jo-shpirtërorë. Materia është si Perëndia në energjinë që zotëron: ndonëse, përsëri, patjetër që energjia fizike është diçka krejt tjetër nga fuqia e Perëndisë. Bota bimore është si Perëndia sepse është e gjallë, dhe Ai është “Perëndia i gjallë”. Por jeta, në këtë kuptim biologjik, nuk është e njëjtë me jetën që është në Perëndinë: është thjesht një lloj simboli ose hijeje e saj. Kur arrijmë te kafshët, gjejmë ngjashmëri të llojeve të tjera përveç jetës biologjike. Aktiviteti i shumtë dhe pjelloria e insekteve, për shembull, ka një fije ngjashmërie me krijueshmërinë dhe aktivitetin pa pushim të Perëndisë. Te gjitarët më të ndërlikuar gjejmë fillesat e një afeksioni instinktiv. Nuk është e njëjta gjë me dashurinë që ekziston në Perëndinë, por është si ajo—ashtu si një pikturë mbi një copë letër mund të jetë vërtet “si” një peizazh. Kur arrijmë te njeriu, kafsha më e lartë, marrim ngjashmërinë më të plotë me Perëndinë, me sa dimë ne. (Mund të ketë krijesa në botë të tjera që janë më të ngjashme me Perëndinë se njeriu, por ne nuk dimë gjë për to.) Njeriu jo vetëm jeton, por edhe dashuron e arsyeton. Jeta biologjike arrin nivelin më të lartë

të njohur në të.

Por ajo që njeriu, në kushtet e tij natyrore, nuk ka, është jeta Shpirtërore—lloji i ndryshëm e më i lartë i jetës që ekziston në Perëndinë. Fjalën *jetë* e përdorim për të dyja, por të mendosh se ato janë njëlloj, është si të mendosh se “madhësia” e hapësirës dhe “madhësia” e Perëndisë janë e njëjta lloj madhësie. Në fakt, dallimi midis jetës Biologjike dhe jetës Shpirtërore është kaq i rëndësishëm, sa po iu caktoj dy emra të ndryshëm. Biologjikja është ajo që na vjen prej natyrës dhe që (si gjithçka në Natyrë) priret gjithnjë të tretet dhe të kalbet, aq sa ka nevojë pa pushim për ndihmesën e Natyrës në formën e ajrit, ujit, ushqimit, etj., është *Biosi*. Jeta Shpirtërore, e cila është në Perëndinë prej gjithë përjetësisë dhe e cila bëri gjithë universin natyror, është *Zoe*. *Biosi* ka patjetër një ngjashmëri të vagullt ose simbolike me *Zoen*, por vetëm një ngjashmëri si ajo e një fotoje me një vend, apo e një statuje me një njeri. Njeriu që kalon nga pasja e *Biosit* në atë të *Zoes* ka kaluar një ndryshim si ai i një statuje që kalon nga gdhendje e gurit në një njeri të vërtetë.

Dhe pikërisht për këtë bën fjalë krishterimi. Bota është punishtja e një skulptori të madh. Ne jemi statujat, e qarkullon një thashethem në punishte se disa prej nesh një ditë do të ngjallen.

PERËNDIA TRI-PERSONAL

Kapitulli i kaluar bënte fjalë për dallimin mes lindjes dhe bërjes. Njeriu e lind një fëmijë, por një statujë thjesht e bën. Perëndia lind Krishtin, por njerëzit thjesht i bën. Por, duke thënë këtë, unë kam ilustruar vetëm një pikë në lidhje me Perëndinë, domethënë se ajo çka Perëndia Atë lind është Perëndi, diçka e të njëjtit lloj me Vetën e Tij. Në atë mënyrë është si një atë njerëzor që lind një bir njerëzor. Mirëpo nuk është tamam kështu. Ndaj më duhet të shpjegoj pak më shumë.

Ka shumë njerëz sot që thonë: “Unë besoj në një Perëndi, por jo në një Perëndi personal”. Sipas tyre, ajo gjëja misterioze pas gjithçkaje tjetër duhet të jetë më shumë se një person. Tani të krishterët janë shumë dakord për këtë. Por të krishterët janë të vetmit njerëz që ofrojnë një ide se si mund të jetë një qenie përtej personalitetit. Të gjithë të tjerët, ndonëse thonë që Perëndia është përtej personalitetit, në të vërtetë e mendojnë Atë si diçka jopersonale: domethënë, diçka më pak se personale. Në qoftë se po kërkon diçka mbi-personale, diçka më shumë se një person, atëherë çështja nuk qëndron në zgjedhjen midis idesë së krishterë dhe ideve të tjera. Ideja e krishterë është e vetmja në treg.

Po, disa mendojnë që pas kësaj jete, ose pas disa jetëve,

shpirtrat njerëzorë do të “përthithen” në Perëndinë. Por, kur përpiqen të shpjegojnë se çfarë duan të thonë me këtë, ata duket se e mendojnë përthithjen në Perëndinë si kur një gjë materiale përthithet nga një tjetër. Ata thonë se është si një pikë ujë që bie në det. Mirëpo aty pika e ujit përfundon. Nëse e njëjta gjë ndodh me ne, atëherë të përthithesh do të thotë të pushosh së ekzistuari. Vetëm të krishterët kanë një ide se si shpirtrat njerëzore mund të përfshihen në jetën e Perëndisë e megjithëkëtë të mbeten vetvetja—faktikisht, të jenë më shumë vetvetja nga sa ishin më parë.

Ju paralajmërova që Teologjia është praktike. I gjithë qëllimi i ekzistencës sonë duket se është që të përfshihemi në jetën e Perëndisë. Idetë e gabuara për këtë jetë, e bëjnë të vështirë këtë. Kurse tani, do t’ju kërkoja për disa minuta të më ndiqnit me shumë vëmendje.

Ju e dini se në hapësirë lëvizet në tre mënyra: majtas ose djathtas, para ose mbrapa, lart ose poshtë. Çdo drejtim është ose një prej këtyre, ose një kompromis midis tyre. Ato quhen tre Dimensionet ose Përmasat. Tani vini re këtë. Nëse përdor vetëm një dimension, mund të vizatosh vetëm një vijë të drejtë. Nëse përdor dy, mund të vizatosh një figurë, të themi, një katror. Dhe katrori përbëhet nga katër vija të drejta. Tani një hap më tej. Nëse ke tre dimensione, mund të ndërtohet atë që quhet një trup gjeometrik, të themi një kub: diçka si zari ose kubi i sheqerit. Dhe kubi përbëhet nga gjashtë katrorë.

E kapët idenë? Bota një-dimensionale do të ishte një vijë e drejtë. Në një botë dy-dimensionale, ka ende vija të drejta, por disa vija të drejta përbëjnë një figurë. Në botën tre-dimensionale, ende ka figura, por shumë prej tyre përbëjnë një trup gjeometrik. Domethënë, ndërsa përparon në nivele më realë e më të ndërlikuar, ti nuk i lë pas gjërat që gjete në

nivelet më të thjeshta. Ato i ke ende, por të kombinuara në mënyra të reja—në mënyra që nuk i imagjinoje dot nëse do të njihje vetëm nivelet më të thjeshta.

Tani përshkrimi i krishterë i Perëndisë përfshin pikërisht këtë parim. Niveli njerëzor është në fakt një nivel i thjeshtë e mjaft i zbrazët. Sipas nivelit njerëzor, një person është një qenie dhe dy persona janë dy qenie të veçanta—ashtu si, në dy dimensione (si fleta e letrës) një katror është një figurë dhe dy katrorë janë dy figura të veçanta. Edhe në nivelin Hyjnor gjenden personalitete; por atje i gjen të kombinuar në mënyra të reja që ne, të cilët nuk jetojmë në atë nivel, nuk mund t'i imagjinojmë. Në dimensionin e Perëndisë, nëse mund të shprehemi kështu, ti gjen një qenie që është tre Persona ndërkohë që mbetet një Qenie, ashtu si kubi që është gjashtë katrorë duke mbetur njëherësh një kub. Sigurisht që ne nuk mund ta kuptojmë plotësisht një qenie të tillë: sikundër nuk do ta imagjinonim kurrë një kub siç duhej nëse do të perceptonim vetëm dy dimensione të hapësirës. Por një ide të vogullt të saj mund ta kemi. Dhe duke e patur, për të parën herë në jetë marrim një ide të sigurt, ndonëse të vogullt, për diçka mbi-personale—diçka më shumë se një person. Është diçka që nuk do ta kishim hamendësuar kurrë, e megjithëkëtë, kur na thuhet, na duket sikur duhet ta kishim menduar më parë, ngaqë përputhet kaq mirë me gjërat që tashmë i dimë.

Mund të pyesni: “Nëse nuk mund ta imagjinojmë një Qenie tri-personale, ç’dobi ka të flasim për Të?”. Të flasësh për Të nuk ka ndonjë dobi të madhe. Ajo që ka rëndësi në fakt është të përfshihesh në atë jetë tri-personale, gjë e cila mund të ndodhë në çdo çast—që sonte madje.

Dua të them këtë. Një i krishterë i thjeshtë gjunjëzohet

për të thënë lutjet e tij. Ai po përpiqet të kontaktojë me Perëndinë. Por, duke qenë i krishterë, ai e di se ajo çka e shtyu të lutet është Perëndia vetë: Perëndia brenda tij, si të thuash. Por e di gjithashtu se e gjithë njohuria e vërtetë që ka për Perëndinë vjen përmes Krishtit, Njeriut që ishte Perëndi—se Krishti qëndron përkrah tij, duke e ndihmuar të lutet, duke u lutur për të. Ju e shihni se çfarë po ndodh. Perëndia është gjëja të cilit ai po i lutet—qëllimi që po përpiqet të arrijë. Perëndia është njëherësh gjëja brenda tij që po e nxit atë—fuqia motivuese. Perëndia është njëherësh rruga ose ura në të cilën ai nxitet të shkojë drejt atij qëllimi. Pra e gjithë jeta e trefishtë e Qenies tri-personale ndodh në fakt në dhomën e vogël të zakonshme, ku një njeri i zakonshëm po thotë lutjet e tij. Njeriu po përfshihet në llojin më të lartë të jetës—në atë që e quajta Zoe ose jetë shpirtërore. Ai po tërhiqet drejt Perëndisë, prej Perëndisë, duke mbetur ende vetvetja.

Dhe kështu nisi Teologjia. Njerëzit tashmë dinin diçka për Perëndinë në mënyrë të vagullt. Pastaj erdhi dikush që tha se ishte Perëndia; megjithëkëtë ky nuk ishte një lloj njeriu që mund ta injoroje si të marrë. Ai i bëri ata ta besonin. Ata e takuan Atë sërish pasi e panë të vritej. E më pas, pasi formuan një shoqëri, ose komunitet, të vogël, ata në një njëfarë mënyre e gjetën Perëndinë edhe brenda tyre: duke i drejtuar, duke u mundësuar të bënin gjëra që nuk mund t'i bënin më parë. Dhe kur e kuptuan të gjithën zbuluan se kishin arritur në përkufizimin e krishterë të Perëndisë tri-personal.

Ky përkufizim nuk është diçka që e kemi shpikur ne. Teologjia është, në njëfarë kuptimi, shkencë eksperimentale. Fetë e thjeshta janë ato të shpikurat. Kur them se është shkencë eksperimentale “në njëfarë kuptimi”, dua të them se është si shkencat e tjera eksperimentale në disa mënyra, por

jo në të gjitha ato. Nëse je gjeolog që studion gurë, duhet të shkosh e të gjesh gurë. Ata nuk do të vijnë te ti, dhe nuk do të largohen nëse shkon tek ata. Iniciativa bie e gjitha në anën tënde. Ata nuk mund as të të ndihmojnë, as të të pengojnë. Por, të themi se je një zoolog dhe do të bësh foto të kafshëve të egra në habitatet e tyre. Kjo ndryshon pak nga studimi i gurëve. Kafshët e egra nuk do të vijnë tek ti: mirëpo mund të largohen prej teje. Nëse nuk rri shumë qetë, do të largohen. Fillon të ketë një gjurmë të vogël të iniciativës nga ana e tyre.

Tani një shkallë më lart; le të themi se do të njohësh një njeri. Nëse ai është i vendosur të mos të të lejojë, nuk mund ta njohësh dot. Duhet të fitosh besimin e tij. Në këtë rast, iniciativa ndahet barazisht— për të patur një miqësi duhet të duan të dy palët.

Kur vjen puna te njohja e Perëndisë, iniciativa qëndron nga ana e Tij. Nëse Ai nuk ta tregon Vetën, asgjë që ti mund të bësh nuk do të ta mundësojë këtë gjë. Dhe Ai faktikisht u tregon më shumë nga Vetja e Tij disa njerëzve sesa të tjerëve—jo pasi i preferon, por sepse është e pamundur për Të t'i tregojë Vetën dikujt, mendja dhe karakteri i të cilit janë në një gjendje të gabuar. Si drita e diellit, ndonëse nuk ka preferenca, nuk reflektohet aq qartë te një pasqyrë e pluhurosur sa te një e pastër.

Mund ta thuash këtë edhe në një mënyrë tjetër duke qartësuar se, teksa në shkencat e tjera ti përdor instrumente jashtë vetes (si mikroskopë dhe teleskopë), instrumenti që përdor për të parë Perëndinë është e gjithë vetja jote. E nëse vetja e një njeriu nuk mbahet e pastër dhe e shkëlqyer, do ta shikojë Perëndinë turbull; si hëna e parë nga një teleskop i pisët. Prandaj kombe të këqija kanë fe të këqija: ata e kanë parë Perëndinë përmes një xhami të pisët.

Perëndia mund t'ua zbulojë Vetën siç është vërtet vetëm njerëzve të vërtetë. Jo vetëm njerëzve që janë të mirë individualisht, por njerëzve të bashkuar në një trup, që e duan njëri-tjetrin, e ndihmojnë njëri-tjetrin, i shfaqin Perëndinë njëri-tjetrit. Pasi kështu donte Perëndia që të ishte njerëzimi; si instrumentistët në një formacion muzikor, apo organet e një trupi.

Si rrjedhojë, instrumenti i vetëm tërësisht i përshtatshëm për të mësuar për Perëndinë është i gjithë komuniteti i krishterë, që e pret Atë së bashku. Vëllazëria e krishterë përbën, si të themi, instrumentet teknike për këtë shkencë—pajisjet laboratorike për të. Për këtë arsye, të gjithë ata që dalin një herë në ca vjet me një fe qartazi të thjeshtëzuar, duke dashur ta zëvendësojnë traditën e krishterë, janë thjesht duke humbur kohën. Janë si dikush që nuk ka instrument tjetër veç një palë dylbish të vjetra dhe pretendon të kapë në gabim të gjithë astronomët e vërtetë. Ai mund të jetë tip shumë i zgjuar—edhe më si zgjuar se disa nga astronomët e vërtetë; por ai nuk po i jep asnjë mundësi vetes. E pas dy vjetësh të gjithë do ta kenë harruar, kurse shkenca e vërtetë vazhdon ende.

Nëse krishterimi do të ishte diçka e shpikur prej nesh, sigurisht që mund ta kishim bërë më të lehtë. Por ja që nuk është i shpikur prej nesh. Nuk mund të konkurrojmë, për thjeshtësi, me ata që shpikin fe. Si mund ta bëjmë këtë kur merremi me Faktin? Patjetër që kushdo mund të bëhet i thjeshtë, nëse nuk e vret mendjen për faktet.

KOHA DHE PËRTEJ KOHËS

Është e kotë ajo ideja që kur lexon një libër nuk duhet të “kapërcesh” asgjë. Të gjithë njerëzit me mend kapërcejnë pa e vrarë mendjen kur arrijnë në një kapitull që nuk ka asnjë dobi për ta. Në këtë kapitull do të flas për diçka që mund të jetë shumë ndihmuese për disa lexues, por që të tjerëve mund t’u duket një ndërlikim i panevojshëm. Nëse je i dyti nga këta lexues, të këshilloj të mos shqetësohesh për këtë kapitull, por të vazhdash me të radhës.

Kapitullin e kaluar m’u desh të prekja çështjen e lutjes, ndaj sa kohë që e kemi të freskët në mendje edhe ju edhe unë, do të doja të sqaroja një vështirësi që hasin njerëzit në lidhje me idenë e lutjes,. Një njeri ma formuloi duke thënë: “Te Perëndia besoj patjetër, po nuk e kapërdij dot idenë se si mund të dëgjojë Ai qindra miliona njerëz që i drejtohen Atij në të njëjtin çast”. Dhe kam zbuluar se shumë njerëz mendojnë në këtë mënyrë.

Tani, gjëja e parë që duhet vënë re është se strumbullari i gjithë çështjes janë fjalët *në të njëjtin çast*. Shumica prej nesh mund ta përfytyrojmë Perëndinë duke u marrë me çdo numër të caktuar aplikantësh, sikur nëse ata vijnë një nga një dhe nëse Ai ka një pafundësi kohe në dispozicion për ta bërë këtë. Pra rrënja e vërtetë e kësaj vështirësie është ideja se Perëndia

fut shumë gjëra në një çast të vetëm kohe.

Kjo sigurisht është ajo çka ndodh me ne. Jeta neve na vjen çast pas çasti. Njëri çast zhduket para se tjetri të mbërrijë. Dhe secili ka vetëm pak hapësirë. Kështu funksionon Koha. Dhe ne sigurisht e marrim të mirëqenë se një seri kohe e tillë—ky rregullim i të shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes—nuk është thjesht mënyra si na paraqitet jeta neve, por mënyra si ekziston çdo gjë në të vërtetë. Ne priremi të supozojmë se krejt gjithësia e Perëndia Vetë lëvizin gjithë kohës nga e shkuara në të ardhmen siç bëjmë ne. Por shumë njerëz të mësuar nuk bien dakord me këtë. Teologët ishin të parët që nisën idenë se disa gjëra nuk janë fare në Kohë: më vonë filozofët e përqaftuan këtë ide, e tani shkencëtarët po bëjnë të njëjtën gjë.

S'ka thujas asnjë dyshim që Perëndia nuk është në Kohë. Jeta e Tij nuk përbëhet nga çaste që pasojnë njëri-tjetrit. Nëse një milion njerëz i luten Atij sonte në dhjetë e gjysmë, Ai nuk ka pse t'i dëgjojë ata në atë grimë që ne e gjuajmë dhjetë e gjysmë. Dhjetë e gjysma—si dhe çdo çast tjetër që nga fillimi i botës—është gjithnjë e Tashme për Të. Nëse doni ta mendoni në këtë mënyrë, Ai ka gjithë përjetësinë për të dëgjuar atë lutje milisekondëshe të pilotit para se avioni të përplasët i përfshirë nga flakët.

Është e vështirë, e di. Do të përpiqem t'ju jap diçka, jo të njëjtë, por disi të ngjashme me këtë. Të themi se po shkruaj një roman. Dhe shënoj: “Maria la punën e saj; një çast më pas dëgjoi një trokitje në derë!”. Meqë Marisë i duhet të jetojë në kohën imagjinare të historisë sime, për të nuk ka interval midis lënies së punës dhe dëgjimit të trokitjes. Mirëpo unë, krijuesi i Marisë, nuk jetoj aspak në atë kohë imagjinare. Midis shkrimit të gjysmës së parë dhe gjysmës së dytë të asaj

fjalie, unë mund të ulem duke menduar për tre orë në lidhje me Marinë. Unë mund të mendoj për Marinë sikur ajo të ishte personazhi i vetëm i librit për aq kohë sa të dëshiroj, dhe orët e kaluara prej meje në këtë nuk do të shfaqeshin aspak në kohën e Marisë (në kohën brenda historisë).

Patjetër që ky nuk është një ilustrim i përsosur. Por mund të na japë një vështrim mbi atë që unë besoj se është e vërtetë. Perëndia nuk nxitohet nëpër rrjedhën kohore të kësaj gjithësie, sikurse shkrimtari nuk nxitohet prej rrjedhës kohore imagjinare të romanit të tij. Ai ka vëmendje të pafundme për t'i kushtuar secilit prej nesh. Ai nuk ka pse të merret me ne të gjithë përnjëherë. Ti je po aq vetëm për vetëm me Të sa do të ishe po të të kishte krijuar vetëm ty. Kur Krishti vdiq, vdiq për ty individualisht sikur ti të ishe njeriu i vetëm në botë.

Pika ku ilustrimi im dështon është kjo. Shkrimtari në të del nga një seri Kohe (ajo e romanit) vetëm duke shkuar në një seri Kohe tjetër (atë të vërtetën). Kurse Perëndia, besoj unë, nuk jeton fare në seri Kohe. Jeta e Tij nuk ndodh nga një çast në tjetrin si e jona. Ai, si të thuash, është ende në vitin 1920 dhe ka arritur tashmë në vitin 1960. Pasi jeta e Tij është Vetja e Tij.

Nëse e përfytyron kohën si një vijë e drejtë nëpër të cilën ne duhet të kalojmë, atëherë Perëndinë duhet ta përfytyrosh si fletën në të cilën kjo vijë është vizatuar. Ne i kalojmë pikat e vijës një nga një: na duhet të lëmë pas A-në për të shkuar te B-ja, dhe nuk arrijmë dot te C-ja pa e lënë pas B-në. Perëndia, nga lart, ose nga jashtë, ose nga rreth e qark saj, e përmban të gjithë vijën dhe e sheh të gjithën atë.

Ia vlen të përpiqesh ta kuptosh këtë ide, pasi kjo heq disa vështirësi të mundshme në krishterim. Një nga kundërshtitë

që kisha para se të bëhesha i krishterë ishte kjo. Të krishterët thoshin se Perëndia i përjetshëm, që është kudo dhe e vë në lëvizje krejt gjithësinë, u bë në një moment një qenie njerëzore. Atëherë si vazhdonte gjithësia të lëvizte kur Ai ishte foshnjë, apo kur Ai flinte gjumë? thosha unë. Si mund të ishte Ai në të njëjtën kohë edhe Perëndi që di gjithçka, edhe njeri që i pyeste dishepujt: “Kush më preku?”. Ju e vini re se thelbi i këtij argumenti qëndron në fjalët e kohës: “Kur Ai ishte foshnjë”—“Si mund ta bënte këtë në të njëjtën kohë?” Me fjalë të tjera, unë po supozoja se jeta e Krishtit si Perëndi ishte në kohë, dhe se jeta e Tij si njeriu Jezu në Palestinë ishte një periudhë e shkurtër e marrë nga kjo kohë, siç qe shërbimi im ushtarak një periudhë e shkurtër e marrë nga koha totale e jetës sime. Dhe shumica prej nesh priren të mendojnë në këtë mënyrë. E përfytyrojmë Perëndinë duke jetuar përmes një periudhe kur jeta e Tij njerëzore ishte ende në të ardhmen: më pas në një periudhë kur kjo u bë e tashme dhe duke vazhduar më vonë në atë kur e kujton si diçka në të kaluarën. Por ndoshta këto ide nuk korrespondojnë aspak me faktet reale. Nuk mund ta futësh jetën tokësore të Krishtit në Palestinë në ndonjë marrëdhënie kohore me jetën e Tij si Perëndi përtej gjithë hapësirës dhe kohës. Do të sugjeroja se është një e vërtetë e pakohë për Perëndinë që, natyra njerëzore, me gjithë eksperiencat e saj të dobësisë, gjumit dhe mosdijes, është disi e përfshirë në gjithë jetën e Tij hyjnore. Kjo jetë njerëzore në Perëndinë është, nga këndvështrimi ynë, një periudhë e caktuar e historisë së botës sonë (nga viti i lindjes së Krishtit deri te Kryqëzimi i Tij). Ndaj e përfytyrojmë atë edhe si një periudhë në historinë e ekzistencës së Perëndisë. Por Perëndia nuk ka histori. Ai është atë thelbësisht dhe krejtësisht real sa nuk mund të ketë një të tillë. Sepse

historia nënkupton patjetër që një pjesë e realitetit tënd ka humbur (pasi ka rrëshkitur tashmë në të shkuarën) dhe që një pjesë tjetër nuk është zotëruar ende (pasi është akoma në të ardhmen). Nënkupton faktikisht të mos kesh asgjë tjetër, vetëm një të tashme të vogël, e cila ka shkuar para se të mund të flasësh për të. Larg qoftë që të mendojmë kështu për Perëndinë. Edhe ne mund të shpresojmë se nuk do të jemi gjithmonë të racionuar në mënyrë të tillë.

Një vështirësi tjetër që kemi, si pasojë e besimit se Perëndia është në kohë, është kjo. Kush beson sadopak në Perëndinë, beson që Ai e di se çfarë do të bëjmë unë e ti nesër. Por, nëse ai e di se unë do të bëj këtë dhe atë, si mund të jem i lirë për të vepruar ndryshe? Po përsëri vështirësia vjen nga mendimi se Perëndia lëviz me kohën në të njëjtën mënyrë si ne; me të vetmin ndryshim që Ai mund të shohë përpara kurse ne jo. Po, nëse do të ishte kështu, nëse do t'i *parashihte* veprat tona, vështirë se do të mund të kuptonim si mund të ishim të lirë për të mos i bërë ato. Por le të supozojmë se Perëndia është jashtë e përmbi rrjedhën kohore. Në këtë rast, “e nesërmja” jonë është e dukshme për të në të njëjtën mënyrë si ajo që ne e quajmë “sot”. Të gjitha ditët janë “Tani” për Të. Ai nuk i kujton gjërat që ti ke bërë dje; Ai thjesht të sheh ty duke i bërë, pasi, edhe pse ti e ke humbur të djeshmen, Ai nuk e ka humbur. Ai nuk të parasheh ty duke i bërë gjërat nesër; Ai thjesht të sheh ty duke i bërë ato: sepse, megjithëse e nesërmja nuk ka ardhur për ty, për Atë ka ardhur. Ti nuk ke menduar se veprimet që je duke bërë në këtë çast janë më pak të lira për shkak se Perëndia e di se çfarë po bën. Epo Ai i di veprimet e tua nesër në të njëjtën mënyrë—sepse Ai është tashmë në të nesërmen dhe mundet thjesht të të shohë ty. Në një njëfarë kuptimi, Ai nuk e di veprimin tënd derisa ti ta kesh

bërë: por çasti që ti e ke bërë është gjithmonë “Tani” për Të.

Mua më ka ndihmuar jashtë mase kjo ide. Nëse ty nuk të ndihmon, thjesht lëre. Është një “ide e krishterë” në kuptimin që pranohej nga të krishterë të mëdhenj e të urtë dhe nuk ka diçka në të në kundërvënie me krishterimin. Por nuk është në Bibël apo në ndonjë nga besoret. Mund të jesh një i krishterë i përkryer pa e pranuar atë, madje pa menduar fare për këtë çështje.

INFEKSIONI I MIRË

Dua ta nis këtë kapitull duke ju kërkuar të krijoni një imazh të qartë në mendjen tuaj. Imagjinoni dy libra në një tryezë njëri mbi tjetrin. Pa diskutim që ai poshtë po e mban tjetrin lart—po e mbështet atë. Për shkak të librit poshtë ai lart po qëndron, të themi pesë centimetër mbi syprinën e tryezës dhe nuk e prek atë. Le ta quajmë librin poshtë A dhe atë lart B. Pozicioni i librit A është shkaktari i pozicionit të librit B. E qartë? Tani le të përfytyrojmë—në realitet është sigurisht e pamundur, por për hir të ilustrimit—që të dy librat kanë qenë në këtë pozicion për gjithë përjetësinë. Në këtë rast, pozicioni i B-së do të kishte qenë gjithnjë si rezultat i pozicionit të A-së. Por njëherazi pozicioni i A-së nuk do të mund të kishte ekzistuar para pozicionit të B-së. Me fjalë të tjera, rezultati nuk vjen *pas* shkakut. Patjetër që zakonisht nuk ndodh kështu: ti fillimisht ha kastravecën e më pas ke problemet me tretjen. Por kjo nuk ndodh me të gjithë shkaqet dhe pasojat. Do ta kuptoni shumë shpejt pse mendoj se kjo është e rëndësishme.

Disa faqe më parë thashë se Perëndia është një Qenie që përmban tre Persona, por duke mbetur një Qenie, si kubi që përmban gjashtë katrorë, por mbetet një trup. Por sapo nis të shpjegoj mënyrën si ndërlidhen këta Persona më duhet të përdor fjalë që e bëjnë të duket sikur njëri prej tyre ishte aty

para të tjerëve. Personi i Parë quhet Ati dhe i Dyti Biri. Thamë që të Parit i lindi i dyti; e quajmë *lindje* dhe jo *bërje*, sepse ajo çka Ai lind është e të njëjtit lloj me Vetveten. E vetmja fjalë e përshtatshme është fjala Atë, në njëfarë mënyre. Por fatkeqësisht kjo sugjeron se Ai ishte aty i pari—si një atë njerëzor që është aty përpara se të ekzistojë i biri. Por nuk është ashtu. Nuk ka para apo pas në këtë gjë. Prandaj mendoj se është me rëndësi ta kemi të qartë se si diçka mund të jetë burimi, shkaku apo origjina e diçkaje tjetër pa qenë aty më parë se ajo. Biri ekziston sepse Ati ekziston; por kurrë nuk ka pasur një çast përpara se Atit t'i lindte Biri.

Mbase mënyra më e mirë për ta menduar këtë është kjo. Unë ju kërkova tani të përfytyroni dy librat, dhe mendoj se shumica prej jush e bëtë këtë. Pra, ju kryet një veprim të imagjinatës dhe si rezultat patët një pamje mendore. Është mëse e qartë se veprimi i imagjinatës ishte shkaku dhe pamja mendore pasoja. Por kjo nuk do të thotë që ju e bëtë përfytyrimin të parin dhe më pas përftuat pamjen. Në çastin që ju e bëtë këtë, pamja ishte aty. Vullneti juaj e mbante pamjen para jush gjithë kohës. Megjithëkëtë, veprimi i vullnetit tuaj dhe pamja nisën saktësisht në të njëjtin çast dhe përfunduan po njëherësh. Nëse një Qenie e përjetshme do të imagjinonte gjithnjë diçka, veprimi i tij gjithnjë do të prodhonte një pamje mendore, por pamja do të ishte po aq e përjetshme sa edhe veprimi.

Kështu duhet të mendojmë për Birin, si duke buruar gjithnjë prej Atit, si drita nga llamba, nxehtësia nga zjarri, mendimi nga mendja. Ai është shprehja e Vetes e Atit—ajo që Ati ka për të thënë. Dhe nuk ka pasur kurrë një kohë kur ai nuk po e thoshte atë. Por, e vutë re se çfarë po ndodh? Pamjet e dritës apo nxehtësisë e bëjnë të tingëllojë sikur Ati dhe Biri

janë dy gjëra, jo dy Persona. Pra, fund të fundi, tabloja që na jep Besëlidhja e Re e një Ati dhe Biri rezulton të jetë shumë më e saktë se gjithçka tjetër me të cilën ne mundohemi ta zëvendësojmë. Kjo ndodh gjithnjë kur largohesh nga fjalët e Biblës. Është e drejtë të largohesh prej tyre për një çast në mënyrë që të qartësosh diçka të veçantë. Por gjithnjë duhet të kthehesh. Perëndia di natyrshëm se si ta përshkruajë Vetën më mirë sesa mund të dimë ne ta përshkruajmë Atë. Ai e di se marrëdhënia e Atit me Birin është më e ngjashmja me atë të Personit të Parë dhe Atij të Dytë sesa gjithçka tjetër që ne mund të mendojmë. Ç'është më e rëndësishmja, kjo është një marrëdhënie dashurie. Ati gëzohet thellësisht në Birin e Tij; Biri e admiron thellësisht Atin e Tij.

Para se të vazhdojmë, vëreni sa rëndësi praktike ka kjo. Shumë njerëzve u pëlqen të përsëritin pohimin e krishterë që “Perëndia është dashuri”. Por duket se ata nuk e kuptojnë që fjalët “Perëndia është dashuri” janë pa asnjë kuptim nëse Perëndia nuk përmban të paktën dy Persona. Dashuria është diçka që një person e ka për një person tjetër. Nëse Perëndia do të ishte një person i vetëm, atëherë para se të krijohej bota Ai nuk ishte dashuri. Ajo që këta njerëz duan të thonë me fjalët “Perëndia është dashuri” sigurisht që është shpesh diçka krejt tjetër: që “Dashuria është Perëndi”. Këta duan të thonë se ndjenjat tona të dashurisë, sido dhe kudo që të lindin, apo çfarëdo pasoja të kenë, duhen trajtuar me respektin më të madh. Mbase duhet vërtet. Por kjo është diçka krejt ndryshe nga ajo që të krishterët nënkuptojnë me fjalinë “Perëndia është dashuri”. Ata besojnë se veprimtaria e gjallë dhe dinamike e dashurisë ka qenë duke ndodhur gjithmonë në Perëndinë dhe ka krijuar gjithçka tjetër.

Dhe ky, meqë ra fjala, është mbase dallimi më i rëndësishëm

midis krishterimit dhe feve të tjera: Perëndia i krishterimit nuk është diçka statike—as një person statik madje—por një aktivitet dinamik e ritmik, një jetë, një lloj drame thuajse. Nëse nuk ju duket mungesë respekti, do të thosha si një lloj vallëzimi. Bashkimi midis Atit dhe Birit është diçka kaq e gjallë dhe konkrete saqë është në vetvete gjithashtu një Person. E di se është diçka thuajse e paperceptueshme, por shikojeni në këtë mënyrë. Dihet që midis qenieve njerëzore, të bashkuara si familje, si një klub apo një sindikatë, përmendet “shpirti” i asaj familjeje, klubi apo sindikate. Njerëzit flasin për këtë “shpirt” për shkak se anëtarët individualë, në çastin që bashkohen, zhvillojnë vërtet mënyra të caktuara të të folurit dhe të sjelljes që nuk do t’i kishin duke qenë veçmas⁷. Është si lindje e një lloj personaliteti kolektiv. Nuk është një person i vërtetë, sigurisht; është thjesht i ngjashëm me një person. Mirëpo ky është vetëm një nga ndryshimet midis nesh dhe Perëndisë. Ajo që del nga jeta e bashkuar e Atit dhe Birit është një Person i vërtetë, është në fakt i Treti nga tre Personat që janë Perëndi.

Ky person i tretë quhet, në gjuhën teknike, Shpirti i Shenjtë, ose “fryma” e Perëndisë. Mos u shqetësoni e as mos u habisni nëse në mendjet tuaja ju duket më i turbullt e më paqartë se dy të tjerët. Mendoj se ka një arsye përse ndodh kjo. Zakonisht në jetën e krishterë ti nuk e sheh Atë drejtpërdrejt. Ai është gjithnjë duke vepruar përmes teje. Nëse mendon për Atin si Dikush “atje tej”, para teje, kurse për Birin si Dikush që rri përkrah teje, duke të ndihmuar të lutesh, duke u përpjekur të të kthejë në një bir edhe ty, atëherë Personin e tretë duhet ta mendosh si Dikush brenda teje, ose pas teje.

7 Sigurisht, kjo sjellje kolektive mund të jetë më e mirë ose më e keqe se ajo individuale.

Mbase disa e kanë më të lehtë ta nisin me Personin e tretë e më pas të vazhdojnë me të tjerët. Perëndia është dashuri dhe kjo dashuri vepron përmes njerëzve—veçanërisht përmes krejt komunitetit të krishterë. Por fryma e dashurisë është, që nga përjetësia, një dashuri që zhvillohet ndërmjet Atit dhe Birit.

Dhe çfarë rëndësie ka e gjithë kjo tani? Më shumë se gjithçka tjetër në botë. I gjithë vallëzimi, ose drama apo modeli i kësaj jete tri-Personale, duhet të luhet në secilin prej nesh. Ose (e thënë anasjelltas) secili prej nesh duhet të futet në këtë model, të gjejë rolin e tij në vallëzim. Nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të arritur lumturinë për të cilën jemi krijuar. Gjërat e mira, ashtu si të këqijat, kapen me anë të një lloj infeksioni. Nëse do të ngrohesh duhet të qëndrosh pranë zjarrit; nëse do të lagesh duhet të hidhesh në ujë. Nëse do gëzim, fuqi, paqe, jetë të përvetshme, duhet t'i afroresh, madje të futesh brenda gjësë që i ka ato. Nuk janë si një çmim që Perëndia mundet thjesht t'ia japë kujt do që Ai zgjedh. Ato janë një shatërvan i madh energjie dhe bukurie që buron në vetë qendrën e realitetit. Nëse je afër këtij shatërvani, stërkalat e tij do të të lagin: nëse jo, do të mbetesh i thatë. Si mund të mos jetojë përjetë një njeri që është i bashkuar me Perëndinë? Si mund të mos venitet e të vdesë një njeri që është i ndarë prej Perëndisë?

Por si mund të bashkohet ai me Perëndinë? Si është e mundur të përfshihesh brenda jetës tri-Personale?

Ju kujtohet se çfarë thashë në kapitullin II për *lindjen* dhe *bërjen*. Ne nuk jemi të lindur prej Perëndisë, por vetëm të bërë prej tij: në gjendjen tonë natyrale ne nuk jemi bij të Perëndisë, por, si të thuash, vetëm statuja. Nuk e kemi Zoe-n apo jetën shpirtërore; vetëm Bios-in ose jetën biologjike që do

INFEKSIONI I MIRË

të rreshket e do të vdesë. Tani, gjithë oferta që bën krishterimi është kjo: nëse e lëmë Perëndinë të veprojë me ne siç do Ai, ne mund të kemi pjesë në jetën e Krishtit. Në këtë mënyrë, ne do të kemi pjesë në një jetë që u lind, nuk u bë; që gjithnjë ka ekzistuar dhe gjithnjë do të ekzistojë. Krishti është Biri i Perëndisë. Nëse bëjmë pjesë në këtë jetë të tillë, edhe ne do të bëhemi bij të Perëndisë. Ne do ta duam Atin siç e do Ai dhe Shpirti i Shenjtë do të vijë në ne. Ai erdhi në këtë botë e u bë njeri për ta përhapur te njerëzit e tjerë jetën që Ai ka—atë që unë e quaj “infeksion i mirë”. Çdo i krishterë duhet të bëhet një Krisht i vogël. Ky është qëllimi i vetëm i të qenit i krishterë.

USHTARËT KOKËFORTË PREJ LODRE

Biri i Perëndisë u bë njeri që t'u mundësonte njerëzve të bëhen bij të Perëndisë. Ne nuk e dimë—ose të paktën unë nuk e di—se si do të kishin shkuar gjërat nëse raca njerëzore nuk do të rebelohej kurrë kundër Perëndisë, apo t'i bashkohej armikut. Mbase çdo njeri do të ishte “në Krishtin”, do të merrte pjesë në jetën e Birit të Perëndisë, që nga çasti kur lindi. Mbase Bios-i, jeta natyrore, do të përthithej nga Zoe-ja, jeta e pakrijuar, menjëherë dhe përherë. Por ky është hamendësim. Neve na intereson mënyra si funksionojnë gjërat tani.

Dhe gjendja aktuale e gjërave është kjo. Dy llojet e jetës tani janë jo vetëm të ndryshme (të tilla do të ishin gjithmonë) por faktikisht të kundërta. Jeta natyrore, në secilin prej nesh, është diçka me në qendër veten, diçka që do të përkëdhelet dhe të admirohet, të përfitojë nga jetët e tjera, të shfrytëzojë krejt gjithësinë. Dhe do veçanërisht të lihet rehat: të qëndrojë larg diçkaje më të mirë, më të fortë apo më të lartë se ajo; larg gjithçkaje që mund ta bëjë të ndihet e vogël. Ajo frikësohet nga drita dhe ajri i botës shpirtërore, ashtu si njerëzit që rriten pisanjosë kanë frikë nga larja. Dhe në njëfarë kuptimi ka të drejtë. Ajo e di që, nëse e mbërthen jeta shpirtërore, i gjithë vullneti për veten e përqendrimi te vetja do të vriten, ndaj është gati të luftojë me mish e shpirt për ta shmangur këtë.

A ke menduar ndonjëherë kur ke qenë fëmijë se sa qejf do të ishte nëse lodrat e tua do të bëheshin të gjalla? Epo le të supozojmë se mund t'i ngjallje vërtet. Përfytyro sikur ta ktheje një ushtar lodër në njeri të vogël prej vërteti. Kjo do të përfshinte kthimin e kauçukut në mish. Dhe supozoni se ushtarit prej kauçuku nuk do t'i pëlqente kjo gjë. Atij nuk i intereson mishi: ajo që sheh ai është që kauçuku po prishet. Ai mendon se ti po e vret atë. Do të bëjë gjithçka është e mundur për të të ndaluar. Do të bëjë çmos që të mos bëhet njeri.

Nuk e di se çfarë do të bëje ti me këtë ushtar kauçuku. Por ajo që Perëndia bëri me ne ishte kjo: Personi i dytë në Perëndinë, Biri, u bë Vetë njeri: lindi në botë si njeri i vërtetë. Një njeri me gjatësi të caktuar, me flokë me ngjyrë të caktuar, që flet një gjuhë të caktuar, që ka një peshë të caktuar. Qenia e Përjetshme, e cila di gjithçka dhe krijoi krejt gjithësinë, u bë jo thjesht njeri, por (përpara kësaj) foshnjë, dhe përpara kësaj *fetus* brenda trupit të një Gruaje. Nëse dëshiron ta kuptosh më thellë këtë, mendoje sikur ti të bëheshe një kërmill, ose gaforre.

Rezultati ishte që tani kishim një njeri, i cili ishte vërtet ajo që duhej të ishte çdo njeri tjetër. Një njeri në të cilin, jeta e krijuar, e marrë nga e ëma e tij, e lejoi veten të kthehej krejtësisht dhe përsosmërisht në jetën e lindur. Krijesa natyrore njerëzore në Të u përfshi krejtësisht prej Birit hyjnor. Në një çast, njerëzimi mbërriti në destinacion, si të thuash; kaloi në jetën e Krishtit. Dhe për shkak se vështirësia për ne qëndron në faktin se jeta natyrore duhet të “vritet”, në njëfarë mënyre, Ai zgjodhi një karrierë tokësore që përfshiu vrasjen e dëshirave të Tij njerëzore në çdo drejtim—varfëri, keqkuptim nga vetë familja e Tij, tradhti nga një prej miqve të Tij të ngushtë, përqeshje dhe keqtrajtim nga policia dhe

vrasje me anë të torturës. Kështu, duke qenë e vrarë në këtë mënyrë—e vrarë ditë pas dite—krijesa njerëzore në Të, për shkak se qe e bashkuar me Birin hyjnor, u ngjall sërish. U ngjall Njeriu në Krishtin: jo thjesht Perëndia. Këtu qëndron e gjithë ideja. Për herë të parë vështruam një njeri të vërtetë. Një ushtar kauçuku—kauçuku prej vërteti si të tjerët—u bë, plotësisht dhe në mënyrë të lavdishme, i gjallë.

Dhe mbërrimë në mënyrë të pashmangshme në pikën ku shembulli im me ushtarin e kauçukut nuk vlen më. Nuk do të ndryshonte asgjë për ushtarët e kauçukut apo statujat e tjera, nëse një prej tyre ngjallet. Ato janë të gjitha të veçuara. Por njerëzit jo. Ata duken të veçuar sepse ti i sheh duke ecur veçmas. Por ne gjithsesi jemi bërë në atë mënyrë që të shohim vetëm çastin e së tashmes. Nëse do të shihnim të shkuarën, pamja do të ishte ndryshe. Pasi ishte një kohë ku çdo njeri ishte pjesë e nënës së tij: madje një kohë edhe më e hershme kur ishte pjesë e atit të tij, dhe kur ishte pjesë e gjyshërve të tij. Nëse e sheh njerëzimin të përhapur në kohë, siç e sheh Perëndia, nuk përfton pamjen e pikave të ndryshme të shpërndara. Do të dukej si një gjë e vetme që rritet—një pemë tejet e ndërlikuar. Çdo individ do të shfaqej i lidhur me të tjerët. Dhe jo vetëm kaq. Individët, siç nuk janë të ndarë nga njëri-tjetri, në fakt nuk janë as të ndarë nga Perëndia në të vërtetë. Çdo burrë, grua e fëmijë kudo në botë ndien dhe merr frymë në këtë çast vetëm për shkak se Perëndia, i “bën të vazhdojnë akoma”, si të thuash.

Si rrjedhojë, kur Krishti bëhet njeri nuk është në të vërtetë siç mund të bëhesh ti një ushtar kauçuku. Është sikur diçka, e cila i ka ndikuar gjithnjë masat e njerëzve, nis në një çast t’i ndikojë ato në një mënyrë të re. Nga ky çast, efekti përhapet nëpër gjithë njerëzimin. Ai sjell ndryshim si për ata

që jetuan pas Krishtit edhe për ata që jetuan para Tij. Sjell ndryshim edhe për njerëzit që nuk kanë dëgjuar kurrë për Të. Është si hedhja në një gotë ujë e një pike substance që i jep të gjithës një shije ose një ngjyrë krejt të re. Mirëpo, pa diskutim që asnjë nga këto ilustrime nuk funksionon në mënyrë të përkryer. Në fund, vetëm Perëndia është si vetja e Tij dhe ajo çka Ai bën nuk është e njëjtë me asgjë tjetër. As që mund të shpresosh se do të jetë.

Cili pra është ky ndryshim që Ai ka sjellë për të gjitha masat e njerëzve? Pikërisht kjo; të bëhesh bir i Perëndisë, të kthehesh nga diçka e krijuar në diçka të lindur, të kalosh nga jeta e përkohshme biologjike në jetën e përhjetshme “shpirtërore”, u bë e mundur për ne. Njerëzimi është parimisht “i shpëtuar” tashmë. Ne si individë na duhet ta përvetësojmë këtë shpëtim. Por puna vërtet e rëndë—ajo që ne nuk do të mund ta bënim—është kryer në emrin tonë. Nuk na duhet të mundohemi për ta arritur jetën shpirtërore me përpjekjet tona; ajo tashmë ka zbritur vetë në racën njerëzore. Nëse thjesht i paraqitemi zemërhapur atij Njeriu, në të cilin kjo jetë ishte plotësisht e pranishme dhe i cili, ndonëse Perëndi, është njëherësh vërtet njeri, Ai do ta bëjë këtë në ne, dhe për ne. Kujtoni çka thashë për “infeksionin e mirë”. Një nga raca jonë e ka këtë jetë të re: nëse i afrohem Atij, ajo do të na ngjitet edhe neve.

Sigurisht, këtë mund ta shprehësh në gjithfarë mënyrash të ndryshme. Mund të thuash se Krishti vdiq për mëkatet tona. Mund të thuash se Ati na ka falur për shkak se Krishti ka bërë për ne atë që ne duhet të kishim bërë. Mund të thuash se Ati na ka falur për shkak se Krishti ka bërë në vendin tonë atë që ne duhet të kishim bërë. Mund të thuash se jemi larë nga gjaku i Qengjit. Mund të thuash se Krishti e mundi vdekjen. Të gjitha janë të vërteta. Nëse ndonjëra prej tyre nuk

THJESHT KRISHTËRIM

të pëlqen, lëre dhe merru me atë formulë që të pëlqen më shumë. Por, çfarëdo që të bësh, mos u grind me të tjerët ngaqë ata përdorin një formulë të ndryshme nga ti.

DY QARTËSIME

Për të evituar keqkuptimet, po shtoj dy sqarime në lidhje me pikat që dolën në pah kapitullin e kaluar.

(1) Një kritik i zgjuar më shkroi se përse vallë, meqë Perëndia donte bij dhe jo “ushtarë lodre”, nuk *lindi* shumë bij që në fillim në vend që të *bënte* së pari ushtarë lodra e më pas t’i sillte në jetë me anë të këtij procesi kaq të vështirë e të dhimbshëm. Njëra pjesë e kësaj përgjigjeje është mjaft e thjeshtë: tjetra me shumë mundësi është përtej çdo njohurie njerëzore. E thjeshta është kjo. Procesi i kthimit nga krijesë në bir nuk do të ishte as i vështirë e as i dhimbshëm sikur raca njerëzore të mos ishte kthyer kundër Perëndisë shekuj më parë. Ata mund ta bënin këtë për shkak se Ai u dha vullnet të lirë. U dha njerëzve vullnet të lirë pasi një botë thjesht robotike nuk do të mund të donte kurrë dhe si rrjedhojë nuk do të njihnte kurrë lumturinë e pafund. Pjesa e vështirë është kjo. Të gjithë të krishterët bien dakord që ka vetëm një “Bir të Perëndisë”, në kuptimin e plotë dhe origjinal. Nëse këmbëngulim duke pyetur “A mund të kishte më shumë?”, gjendemi në ujëra tepër të thella. A kanë ndonjë kuptim fjalët “mund të kishte” kur flasim për Perëndinë? Ti mund të thuash që diçka e përkohshme e caktuar “mund të kishte qenë” ndryshe nga ç’është, sepse do të kishte qenë ndryshe

nëse diçka tjetër do të ishte ndryshe, dhe diçkaja tjetër do të ishte ndryshe nëse një gjë e tretë do të ishte ndryshe, e kështu me radhë. (Shkronjat në këtë faqe do të kishin qenë të kuqe nëse printeri do të përdorte bojë të kuqe, dhe do të përdorte bojë të kuqe nëse do të udhëzohej për këtë, e kështu me radhë.) Por, kur flasim për Perëndinë—domethënë për shkëmbin e themelit, për Faktin e pareduktueshëm mbi të cilin varen gjithë faktet e tjera—është e pakuptimtë të pyesim nëse gjërat mund të kishin qenë ndryshe. Gjërat janë kështu siç janë, dhe pikë. Mirëpo përtej edhe kësaj, unë e kam shumë të vështirë idenë e Atit duke lindur shumë bij nga e gjithë përjetësia. Për të qenë shumë, duhet të jenë disi të ndryshëm nga njëri-tjetri. Dy qindarka kanë të njëjtën formë. Si janë dy? Duke zënë vende të ndryshme, duke u përbërë nga atome të ndryshëm. Me fjalë të tjera, për t'i menduar të ndryshme, na duhet të fusim hapësirën dhe materien; në fakt na duhet të fusim “Natyren”, ose gjithësinë e krijuar. Unë mund ta kuptoj dallimin midis Atit dhe Birit pa nevojën e hapësirës ose materies, sepse njëri lind dhe tjetri është i lindur. Marrëdhënia e Atit me Birin nuk është e njëjtë si marrëdhënia e Birit me Atin. Por nëse do të kishte disa bij, ata do të kishin me njëri-tjetrin dhe me Atin të njëjtën marrëdhënie. Si mund të ishin ndryshe nga njëri-tjetri? Sigurisht që kjo vështirësi nuk duket që në pamje të parë. Unë mund të mendoj lehtësisht se mund ta formoj idenë e disa “bijve”. Por, duke menduar mirë, zbuloj se ideja duket e mundur vetëm sepse po i përfytyroja si forma njerëzore të vagullta duke qëndruar bashkë në një lloj hapësire. Domethënë, ndonëse po pretendoja të mendoja për diçka që ekziston përpara se të bëhej ndonjë gjithësi, në të vërtetë isha duke futur kontrabandë imazhin e një gjithësie e cila përmban diçka *brenda* saj. Kur pushoj së menduari në

këtë mënyrë dhe përpiqem ende të përfytyroj Atin duke lindur shumë bij “përpara gjithë botëve”, zbuloj se në fakt nuk përfytyroj dot asgjë. Ideja tretet në veçse fjalë boshe. (A u krijua Natyra—hapësira, koha e materia—posaçërisht për krijimin e shumëçkaje? A nuk ka vërtetë mënyrë tjetër për të pasur shumë shpirtra të përjetshëm pa bërë më parë krijesa natyrore në gjithësi, për t’i bërë ata shpirtërore më pas? Por gjithë kjo është sigurisht thjesht hamendësim.)

(2) Ideja se gjithë raca njerëzore është, në njëfarë kuptimi, një gjë—një organizëm i madh, si një pemë—nuk duhet të ngatërrohet me idenë se dallimet individuale nuk kanë rëndësi, apo se njerëzit realë, Tomi, Nobi dhe Ketij janë disi më pak të rëndësishëm sesa gjërat kolektive si klasat, racat e kështu me radhë. Përkundrazi, këto dy ide janë të kundërta. Gjërat që janë pjesë e një organizmi të vetëm mund të jenë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra: gjërat që nuk janë, mund të jenë shumë të ngjashme. Gjashtë qindarka janë mjaft të ndara dhe shumë të ngjashme: hunda dhe mushkëritë e mia janë mjaft të ndryshme, por janë të gjalla vetëm për shkak se janë pjesë të trupit tim dhe pjesëtare të jetës së tij të përbashkët. Krishterimi i cilëson individët njerëzore, jo si thjesht anëtarë të një grupi apo sende të një liste, por si organe të një trupi—të ndryshëm nga njëri-tjetri dhe ku secili kontribuon diçka që tjetri nuk mund ta bëjë. Çdoherë që e kap veten duke dëshiruar t’i kthesh fëmijët, nxënësit apo edhe fqinjët e tu në njerëz saktësisht si vetja jote, kujto që me shumë mundësi Perëndia nuk e dëshiron kurrë këtë. Ti dhe ata jeni organe të ndryshëm, që kanë për qëllim të bëjnë gjëra të ndryshme. Nga ana tjetër, kur tundohesh të mos shqetësohesh për telashet e dikujt tjetër ngaqë “s’ke punë me të”, kujto që, ndonëse ai është i ndryshëm nga ti, është pjesë

THJESHT KRISHTËRIM

e të njëjtit organizëm si ti. Nëse harron që ai i përket të njëjtit organizëm si ti, do të bëhesh Individualist. Nëse harron që ai është një organ i ndryshëm nga ti, nëse do t'i eliminosh ndryshimet e t'i bësh njerëzit të gjithë njësoj, do të bëhesh Totalitar. Por një i krishterë nuk mund të jetë as Totalitar, as Individualist.

Unë ndiej një dëshirë të fortë t'ju them—dhe besoj se ju ndieni një dëshirë të fortë të më thoni—se cili nga këta dy gabime është më i keq. Këtu djalli po na e hedh. Ai i dërgon gabimet në botë gjithnjë në çifte—në çifte të kundërtash. Dhe gjithnjë na inkurajon të kalojmë kohë duke menduar se cili është më i keq. Ju sigurisht që e kuptoni pse, apo jo? Ai përdor mospëlqimin e tepruar që keni për njërin gabim për t'ju tërhequr ngadalë drejt tjetrit. Por të mos mashtrohemi. T'i mbajmë sytë te qëllimi dhe të ecim në mes të të dyja gabimeve. Asnjë punë tjetër nuk kemi me secilin prej tyre.

LE TË BËJMË SIKUR

Mund ta nis sërish duke vendosur dy pamje, ose më mirë dy histori, në mendjet tuaja? Njëra është historia që kemi lexuar të gjithë, *E bukura dhe bisha*. Vajzës, siç ju kujtohet, i duhej të martohej me një përbindësh për njëfarë arsyeje. Dhe ajo e bëri këtë. Ajo e puthi si të ishte një njeri. Dhe më pas, e lehtësuar pa që ai vërtet u kthye në një njeri e gjithçka shkoi mbarë. Historia tjetër bën fjalë për dikë që i duhej të vinte një maskë; maskë e cila e bënte të dukej më i mirë nga sa ishte vërtet. E mbajti atë për vitet të tëra. Dhe kur e hoqi, ai zbuloi se fytyra e tij kishte marrë formën e maskës. Tani ai ishte vërtet i bukur. Ajo që nisi si një maskim, u bë realitet. Mendoj se të dyja këto histori na ndihmojnë (në një mënyrë të zbukuruar, sigurisht) të përfytyrojmë atë që kam për të thënë në këtë kapitull. Deri tani, jam përpjekur të përshkruaj faktet—çfarë Perëndia është dhe çfarë Ai ka bërë. Tani dua të flas për anën praktike—çfarë duhet të bëjmë më tej? Çfarë ndryshon e gjithë kjo teologji për ne? Ndryshimin mund të nisë ta bëjë që sonte. Nëse ishe aq i interesuar sa të lexoje deri këtu, ka të ngjarë të jesh aq i interesuar sa të bësh një përpjekje për të thënë lutjet e tua: dhe, çfarëdo tjetër të thuash, me shumë mundësi do të thuash Lutjen e Zotit.

Fjalët e para të saj janë *Ati ynë*. E kuptoni tani domethënien

e këtyre fjalëve? Ato duan të thonë, në të vërtetë, që ti po e vendos veten në vendin e një biri të Perëndisë. Për ta thënë më thjesht, po *vishesh si Krishti*. Je duke bërë sikur, nëse të pëlqen ta mendosh kështu. Sepse, në çastin që e kupton domethënien e këtyre fjalëve, e ke sigurisht të qartë se nuk je një bir i Perëndisë. Nuk je një qenie si Biri i Perëndisë, vullneti dhe interesat e të cilit janë të njëjta me ato të Atit. Je një grumbull frikërash, shpresash, lakmish, xhelozish dhe vetëmashtrimi, ku të gjitha janë të përqendruara te vetja dhe të destinuara për vdekje. Në këtë mënyrë, pra, kjo e veshur si Krishti është një fyerje përqeshëse. Por e çuditshmja është se Ai na ka urdhëruar ta bëjmë këtë.

Përse? Ç’e mirë vjen nga shtirja sikur je diçka që nuk je? Epo, ju e dini edhe në nivelin njerëzor që ka dy lloje shtirjesh. Ka një lloj të keq, ku në vend të gjësë reale është diçka e rremë; si një njeri që bën sikur do të të ndihmojë kur nuk të ndihmon vërtet. Por ka edhe një lloj të mirë të saj, ku shtirja të çon drejt gjësë reale. Kur nuk ndihesh aq miqësor brenda teje, por e di që duhet të jesh i tillë, shumë shpesh gjëja më e mirë që mund të bësh është të sillesh në mënyrë miqësore, sikur je një person më i mirë nga sa je vërtet. Dhe, në pak minuta, siç e kemi vënë re të gjithë, do të ndihesh vërtet më miqësor nga sa ishe. Shpeshherë e vetmja mënyrë për të fituar një cilësi të caktuar në të vërtetë është të nisësh të sillesh sikur tashmë e ke atë. Prandaj lojërat e fëmijëve janë kaq të rëndësishme. Ata janë gjithnjë duke bërë sikur janë të rritur—duke luajtur lojëra ushtarësh, shitësish. Por gjithë atë kohë, ata po forcojnë muskujt dhe po mprehin mendjet në mënyrë që shtirja e të qenit të rritur do t’i ndihmojë vërtet të rriten.

Tani, në çastin që e kupton: “Ja tek jam, duke u veshur si Krishti”, ka shumë mundësi që do të vëresh përnjëmend

disa mënyra se si kjo shtirje mund të bëhet më pak shtirje, e më shumë realitet. Do të gjeje disa gjëra që po ndodhin në mendjen tënde, të cilat nuk do të ndodhnin nëse do të ishte vërtet një bir i Perëndisë. Epo ndaloji ato, pra. Ose mund të kuptosh që, në vend që të thuash disa lutje, duhet të jesh poshtë duke shkruar një letër, ose duke ndihmuar gruan tënde të lajë enët. Atëherë shko dhe bëji ato.

E kuptoni se çfarë po ndodh. Vetë Krishti, Biri i Perëndisë që është njeri (si ti) dhe Perëndi (si Ati i Tij) është në fakt përkrah teje dhe tashmë që në atë çast po nis ta kthejë shtirjen tënde në realitet. Nuk është thjesht një mënyrë e bukur për të thënë se ndërgjegjja jote po të tregon çfarë të bësh. Duke pyetur ndërgjegjen do të marrësh një përgjigje; duke kujtuar që po vishesh si Krishti, merr një përgjigje tjetër. Ka plot gjëra, të cilat ndërgjegjja jote mund të mos i cilësojë si shumë të gabuara (sidomos ato në mendjen tënde), por ti do ta kuptosh menjëherë që nuk mund të vazhdosh t'i bësh nëse po përpiqesh seriozisht të bëhesh si Krishti. Pasi tani nuk po mendon thjesht për të drejtën dhe të gabuarën; po përpiqesh të kapësh infeksionin e mirë të një Personi. Kjo i ngjan vizatimit të një portreti më shumë sesa bindjes një sere rregullash. Dhe, për çudi, në një mënyrë është shumë më e vështirë sesa bindja e rregullave, dhe në një mënyrë tjetër është shumë më e lehtë.

Biri i vërtetë i Perëndisë është përkrah teje. Ai po fillon të të kthejë në atë lloj gjëje si Vetja e Tij. Po fillon, si të thuash, të ta “injektojë” llojin e tij të jetës dhe të menduarit, Zoe-n e Tij. Po nis ta kthejë këtë ushtar kauçuku në një njeri të gjallë. Pjesa jote që nuk e pëlqen këtë është pjesa e mbetur ende kauçuk.

Disa prej jush mund të ndihen që eksperiencia juaj nuk

ngjan fare me këtë. Mund të thoni: “Kurrë nuk e kam ndier ndihmën nga një Krisht i padukshëm, por jam ndihmuar shpesh nga njerëz të tjerë”. Kjo është si gruaja në luftën e parë që tha se nuk shqetësohej po të kishte mungesë buke pasi në shtëpinë e saj hanin gjithnjë bukë të thekur. Pa bukë nuk ka bukë të thekur. Pa ndihmë prej Krishtit, nuk do të kishte ndihmë nga njerëzit e tjerë. Ai vepron në ne në shumë lloj mënyrash: jo vetëm përmes asaj që ne e quajmë “jetë fetare”. Vepron përmes Natyrës, përmes trupave tanë, përmes librave, ndonjëherë përmes eksperiencave që duken (për një kohë) *kundër* krishterimit. Kur një i ri, i cili e ka pasur rutinë të shkonte në kishë, kupton që nuk beson në krishterim dhe pushon së shkuari aty—përderisa e bën sinqerisht dhe jo për të acaruar prindërit—me shumë mundësi është më pranë frymës së Krishtit sesa kurrë më parë. Por, mbi të gjitha, Ai punon në ne përmes njëri-tjetrit.

Njerëzit janë pasqyra, ose “mbartës” të Krishtit për njerëzit e tjerë. Ndonjëherë mbartës të pandërgjegjshëm. Ky “infeksion” i mirë mund të mbartet edhe nga ata që nuk e kanë vetë atë. Mua më ndihmuar për të mbërritur në krishterim edhe njerëz që vetë nuk ishin të krishterë. Por zakonisht ata që e njohin Atë e tejçojnë te të tjerët. Prandaj është kaq e rëndësishme që kisha, trupi i besimtarëve të krishterë, t’ia shfaqë Atë njëri-tjetrit. Mund të thuash që, kur dy të krishterë e ndjekin Krishtin së bashku, ka jo dy herë më shumë krishterim sesa veç e veç, por gjashtëmbëdhjetë herë më shumë.

Por mos harroni. Është e natyrshme që foshnja të pijë qumështin e të ëmës pa e njohur të ëmën. Po aq e natyrshme është edhe që ne ta shohim njeriun i cili na ndihmon pa e parë Krishtin pas tij. Por nuk duhet të mbetemi foshnja. Duhet të

ecim për të njohur Dhënësin e vërtetë. Mosbërja e kësaj është çmenduri. Do të mbeteshim të varur nga qeniet njerëzore në këtë rast. Dhe do të kishim vetëm zhgënjim. Edhe më të mirët prej tyre bëjnë gabime; dhe të gjithë ata vdesin. Duhet të jemi mirënjohës për njerëzit që na kanë ndihmuar, t'i nderojmë dhe t'i duam ata. Por kurrë, kurrë mos e vendos gjithë besimin tënd në një qenie njerëzore: edhe sikur të jetë më i miri e më i urti në gjithë botën. Me rërën mund të bësh shumë gjëra të bukura: por mos provo të ndërtosh shtëpi mbi të.

Dhe tani nisim të kuptojmë se për çfarë flet gjithë kohës Besëlidhja e Re. Ajo thotë se të krishterët “lindin sërish”; thotë që ata “veshin Krishtin” ; që Krishti “formohet në ne”; që ne kemi “mendjen e Krishtit”.

Hiqe nga mendja idenë se këto janë thjesht mënyra të bukura për të thënë që të krishterët duhet të lexojnë atë që thotë Krishti dhe të përpiqen ta bëjnë—si dikush që mund të lexojë atë që thotë Platoni apo Marksi e të përpiqet ta bëjë. Kuptimi i atyre është shumë më i thellë. Ato nënkuptojnë që një Person i vërtetë, Krishti, po të bën diçka ty, këtu, tani, në po atë dhomë ku ti thua lutjet e tua. Nuk bëhet fjalë për një njeri të mirë që vdiq dy mijë vjet më parë. Bëhet fjalë për një Njeri të gjallë, po aq njeri sa ti, dhe po aq Perëndi sa në kohën kur Krijoi botën, i cili vjen vërtet dhe ndërhyr në veten tënde; vret veten e vjetër natyrore në ty dhe e zëvendëson me llojin e vetes që ka Ai. Fillimisht, vetëm për pak momente. Më pas për periudha më të gjata. Në fund, nëse gjithçka shkon mirë, të kthen në mënyrë të përhershme në një lloj gjëje tjetër; në një Krisht të vogël të ri, një qenie e cila, në mënyrën e vet, ka të njëjtin lloj jete si Perëndia; e cila është pjesëtare e fuqisë, gëzimit, njohurisë dhe përjetësisë së Tij. Dhe së shpejti ne zbulojmë dy gjëra të tjera.

(1) Ne fillojmë të vëmë re, përveç veprave të caktuara mëkatore tonat, mëkatshmërinë tonë. Fillojmë të shqetësohemi jo vetëm për atë që bëjmë, por për atë që jemi. Kjo mund të tingëllojë si disi e vështirë, ndaj do të përpiqem ta qartësoj me rastin tim. Kur mbërrij në mbrëmje te lutjet e mia, duke u përpjekur të ballafaqohem me mëkatet e ditës, në nëntë nga dhjetë raste mëkati më i dukshëm është ai kundër dashurisë; do të jem hidhëruar, acaruar, shpërthyer ose rrëmbyer; do të kem përçmuar ose refuzuar. Dhe justifikimi i menjëhershëm në mendjen time është fakti i provokimit të papritur e të befasishëm. Isha pa mendje, nuk pata kohë ta mbledh veten. Kjo mund të jetë një rrethanë lehtësuese në lidhje me ato veprime specifike. Do të kishte qenë padyshim më keq nëse do të ishin të qëllimshme e të paramenduara. Nga ana tjetër, a nuk është ajo që njeriu bën kur kapet pa mendje treguesi më i mirë se çfarë lloj njeriu është ai? Ajo që del në pah para se njeriu të ketë kohë për ta maskuar, a nuk është padyshim e vërteta? Nëse ka minj në qilar, rasti më i mirë për t'i parë ata është të shkosh befasisht. Por minjtë nuk i krijon befasia. Ajo thjesht nuk i lejon të fshihen. Në të njëjtën mënyrë, nuk është befasia e provokimit ajo që prodhon një njeri grindavec; ajo thjesht nxjerr në pah grindavecin që unë jam vërtet. Minjtë kanë qenë gjithnjë në qilar, por nëse shkon tërë zhurme ata do të jenë fshehur para se ti të ndezësh dritën. Me sa duket minjtë e inatit dhe hakmarrjes janë gjithnjë në qilarin e shpirtit tim. Tani ky qilar është i paarritshëm prej vullnetit tim të vetëdijshëm. Unë mund t'i kontrolloj veprimet e mia deri në njëfarë mase: kurse temperamentin tim nuk e kontrolloj dot drejtpërsëdrejti. Dhe nëse ajo që ne jemi është edhe më e rëndësishme (siç thashë më parë) se ajo që bëjmë—nëse ajo që bëjmë është kryesisht provë e asaj

që ne jemi—rrjedh që ndryshimi për të cilin kemi më shumë nevojë është i pamundur të bëhet përmes përpjekjeve tona të drejtpërdrejta e vullnetare. Dhe kjo vlen edhe për veprat e mia të mira. Sa prej tyre u bënë për motivin e duhur? Sa u bënë nga frika e opinionit publik, apo nga dëshira për t'u mburrur? Sa u bënë nga një lloj kokëfortësie ose kryelartësie e cila, në rrethana të tjera, mund të çonte po aq lehtësisht në vepra të këqija? Por unë nuk mundem, përmes përpjekjeve morale të drejtpërdrejta, t'i jap vetes time motive të reja. Pas vetëm pak hapash në jetën e krishterë, ne kuptojmë që gjithçka e nevojshme për t'u bërë në shpirtat tanë mund të bëhet vetëm prej Perëndisë. Dhe kjo na çon në diçka që, në gjuhën time, ka qenë mjaft keqinformuese deri më tani.

(2) Unë kam folur sikur të ishim ne ata që bëjmë gjithçka. Sigurisht që në realitet është Perëndia Ai që bën gjithçka. Më e mira që ne mund të bëjmë është ta lejojmë atë të ndodhë në ne. Në njëfarë kuptimi, mund edhe të thuash se Perëndia është Ai që po “bën sikur”. Perëndia Tre-Personal, sheh, si të thuash, para vetes një kafshë njerëzore lakmitare, grindavece, rebele dhe të përqendruar te vetja. Por Ai thotë: “Le të bëjmë sikur kjo nuk është thjesht një Krijesë, por Biri ynë. Përderisa është njeri, është i ngjashëm me Krishtin, se Ai u bë Njeri. Le të bëjmë sikur është si Ai edhe në Frymë. Le ta trajtojmë sikur të mos ishte ai që është faktikisht. Le të shtiremi, që këtë shtirje ta bëjmë realitet”. Perëndia të sheh ty sikur të ishe një Krisht i vogël: Krishti qëndron krah teje për të të kthyer një në të tillë. Do të guxoja madje të thosha se kjo ide e lojës hyjnore “bëjmë sikur” tingëllon e çuditshme fillimisht. Por a është vërtet e tillë? A nuk është kjo mënyra se si diçka më e lartë e lartëson të ulëtën? Nëna e mëson foshnjën të flasë duke i folur sikur ai e kupton që përpara se ta kuptojë vërtet.

THJESHT KRISHTËRIM

Ne i trajtojmë qentë sikur të ishin “pothuajse njerëz”; prandaj ata bëhen vërtet “pothuajse njerëz” në fund.

KRISHTERIMI: I LEHTË, APO I VËSHTIRË?

Në kapitullin e shkuar po shqyrtonim idenë e krishterë të “veshjes së Krishtit” ose të “të veshurit si” një bir në mënyrë që të bëheshim në fund bij të vërtetë. Ajo që dua të qartësoj është se kjo nuk është njëra nga shumë detyrat e një të krishteri: nuk është as një lloj ushtrimi i veçantë për klasën e lartë. Është krishterimi krejt. Krishterimi nuk të ofron asgjë më shumë se kaq. Dhe do të doja t’ju tregoja dallimin mes tij dhe ideve të zakonshme të “moralit” dhe “sjelljes së mirë”.

Ideja e zakonshme që ne kemi para se të bëhemi të krishterë është kjo. Ne marrim si pikënisje veten e zakonshme me dëshirat dhe interesat e saj të ndryshëm. Paskëtaj e pranojmë që diçka tjetër—mund ta quash “moral”, “sjellje e denjë” apo “e mira e shoqërisë”—ka pretendime mbi këtë veten tonë: pretendime që bien në konflikt me dëshirat e saj. “Të jesh i mirë” për ne është t’u dorëzohesh atyre pretendimeve. Disa nga gjërat që vetja e zakonshme dëshironte rezultuan “të gabuara”, siç i quajmë ne. Ndaj duhet të heqim dorë prej tyre. Gjëra të tjera, që vetja nuk donte t’i bënte, dolën se ishin “të drejta”: ndaj ato duhet t’i bëjmë. Mirëpo gjatë gjithë kohës shpresa jonë është që, pasi të jenë plotësuar kërkesat, vetja e gjorë natyrore do të ketë ende një mundësi, dhe njëfarë kohe,

për të vazhduar jetën e saj e për të bërë çfarë i pëlqen. Ne faktikisht jemi si një njeri i ndershëm që paguan taksat. Ai i paguan ato patjetër, por shpreson që t'i mbeten mjaftueshëm për të jetuar. Sepse ne ende e marrim veten tonë natyrore si pikënisje.

Për aq kohë sa mendojmë në këtë mënyrë, pasoja do të jetë me shumë mundësi një nga këto të dyja. Ose do të heqim dorë nga të qenit të mirë, ose do të bëhemi vërtet të palumtur. Pasi, mos kini asnjë mëdyshje: nëse vërtet do të përmbushni gjithë kërkesat që i bëhen vetes natyrore, asgjë nuk do t'i mbetet asaj për të jetuar. Sa më shumë i bindesh ndërgjegjes, aq më shumë ajo do të kërkojë prej teje. Dhe vetja natyrore, e uritur, e prangosur dhe e munduar në çdo drejtim, do të bëhet sa vjen e më e inatosur. Në fund, ose do të të duhet të heqësh dorë nga të qenit i mirë, ose do të bëhesh si ata njerëz që, siç thotë shprehja “jetojnë për të tjerët”, por janë gjithnjë të pakënaqur dhe murmuritës—që pyesin gjithnjë veten pse të tjerët nuk i vënë re më shumë dhe e bëjnë gjithnjë veten martirë. Dhe kur bëhesh i tillë do të jesh një bezdi shumë më e madhe për këdo që jeton me ty sesa po të mbeteshe sinqerisht egoist.

Udha e krishterë është ndryshe: më e rëndë dhe më e lehtë. Krishti thotë: “Jepmi të gjitha. Unë nuk dua kaq nga koha jote dhe kaq nga paratë e kaq nga puna jote: unë të dua Ty. Nuk erdha ta torturoj veten tënde natyrore, por ta vras atë. Masat gjysmë-të ashpra nuk bëjnë punë. Nuk dua të pres një degë këtu e një degë atje; dua ta rrëzoj të gjithë pemën. Nuk dua ta mbush një dhëmb, apo t'i ve urë apo ilaç, por ta shkul atë. Dorëzoje krejtësisht veten natyrore, me gjithë dëshirat që i mendon të pafajshme bashkë me ato që i mendon të këqija—të gjithën atë. Unë do të të jap një vete të re në vend të kësaj.

Do të të jap, në fakt, Vetën Time: vullneti Im do të bëhet i yti”.

Kjo është edhe më e vështirë, edhe më e lehtë se kjo që përpiqemi të bëjmë ne të gjithë. Besoj se e keni vënë re që Krishti Vetë e përshkruan udhën e krishterë herë si shumë të vështirë, herë si shumë të lehtë. Ai thotë: “Merr Kryqin tënd”—domethënë, ajo është si të shkosh për t’u rrahur për vdekje në një kamp përqëndrimi. Një çast më vonë, Ai thotë: “Zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime e lehtë”. Dhe të dyja i ka seriozisht. Është e kuptueshme se pse të dyja ato janë të vërteta.

Mësuesit thonë që nxënësi më përtac i klasës është ai që do të lodhet më shumë në fund. Dhe e kanë seriozisht këtë. Nëse u jep një teoremë gjeometrie dy djemve të vegjël për ta zbatuar, ai që është gati për të bërë punën e vështirë, do të përpiket ta kuptojë atë. Përtaci do ta mësojë përmendsh pasi, në atë moment, kjo kërkon më pak mundim. Por, gjashtë muaj më vonë, kur kanë për t’u përgatitur për testim, përtaci është ai që i duhet të bëjë orë të tëra përpjekje mjerane për gjërat që tjetri jo vetëm i kupton, por vërtet i shijon, për punë minutash. E marrë në afatgjatë, përtacia përmban më shumë punë. Ose shikojeni në këtë mënyrë. Në një betejë, ose në alpinizëm, rastis shpesh diçka që kërkon shumë kurajë për t’u bërë. Mirëpo kjo është e njëjta gjë e cila, në afatgjatë, është më e sigurt për t’u bërë. Nëse i tutesh, disa orë më vonë do ta gjes veten në një rrezik më të madh. Burracakëria është faktikisht rrezikshmëria më e madhe.

Kjo vlen edhe në këtë rast. Gjëja e tmerrshme, gati e pamundur, është t’ia dorëzosh gjithë veten tënde—gjithë dëshirat dhe meraket e tua—Krishtit. Por është shumë më e lehtë sesa ajo që ne jemi duke u përpjekur të bëjmë në vend të kësaj. Ne jemi duke u përpjekur të mbetemi ajo që ne e quajmë

“vetvetja”, të ruajmë lumturinë personale si qëllimin më të madh të jetës e të jemi “të mirë” në të njëjtën kohë. Të gjithë ne përpiqemi ta lëmë mendjen dhe zemrën të ndjekin rrugën e tyre—të përqendruara te paratë, kënaqësia ose ambicia—duke shpresuar, pavarësisht këtyre, të sillemi me sinqeritet, dëlirësi dhe përlulësi. Kjo është pikërisht ajo që Krishti na paralajmëroi të mos bënim. Siç thotë Ai, ferra nuk prodhon fiq. Nëse jam një arë që nuk përmban asgjë tjetër veç farës së barit, nuk do të prodhoj kurrë grurë. Prerja e barit mund ta mbajë atë të shkurtër, por unë përsëri do të prodhoj bar dhe jo grurë. Nëse dua të prodhoj grurë, ndryshimi duhet të bëhet më thellë sesa sipërfaqja. Duhet të plugohem dhe ri-mbillem.

Prandaj problemi i vërtetë i jetës së krishterë vjen aty ku njerëzve zakonisht nuk iua pret mendja. Nis në çastin që ti zgjohesh në mëngjes. Gjithë dëshirat dhe shpresat e tua të vërsulen si kafshë grabitqare. Dhe puna e parë e çdo mëngjesi konsiston thjesht në sprapsjen e tyre; në dëgjimin e atij zërit tjetër, në përqaftimin e atij këndvështrimit tjetër, në lejimin e asaj jete më të madhe, më të fortë dhe më të qetë të rrjedhë brenda teje. Dhe në vazhdimin e kësaj, gjithë ditën. Në të qëndruarit larg nga gjithë meraket dhe shqetësimet; në lundrimin kundër erës.

Fillimisht mund ta bëjmë vetëm për pak çaste. Por, prej atyre çasteve, një lloj jete e re përhapet nëpër sistemin tonë: sepse tani po e lejojmë atë të veprojë në pjesët e duhura brenda nesh. Është ndryshimi midis lyerjes me bojë, që thjesht shtrohet në sipërfaqe, dhe një njolle ose ngjyruesi që përthithet brenda. Ai nuk tha kurrë fjalë në erë, të vagullta apo idealiste. Kur tha: “Jini të përkryer”, e kishte në kuptimin e plotë të fjalës. E kishte me kuptimin që duhet të bëjmë trajtimin e plotë. Është i vështirë, por kompromisi që na

gënjen mendja të bëjmë është më i vështirë—faktikisht, është i pamundur. Mund të jetë e vështirë për një vezë të kthehet në zog: të mësojë të fluturojë duke qenë ende vezë është akoma edhe më e vështirë. Ne tani jemi si vezë. Dhe nuk mund të vazhdojmë të jesh përherë thjesht një vezë e zakonshme modeste. Duhet të çelim, ose përndryshe do të prishemi.

Më lejoni t'i kthehem asaj që thashë më parë? Ky është i gjithë krishterimi. Nuk ka asgjë tjetër. Mund të ngatërrohesh lehtësisht me këtë. Është e lehtë të mendosh se kisha ka një sërë objektesh të ndryshme—arsimin, ndërtimin, misionet, shërbesat. Është po aq e lehtë të mendosh që shteti ka objekte të ndryshme—ushtarake, politike, ekonomike, etj. Por në njëfarë mënyre gjërat janë më të thjeshta se kaq. Shteti ekziston thjesht për të promovuar dhe mbrojtur lumturinë e zakonshme të qenieve njerëzore në këtë jetë. Burri dhe gruaja që bisedojnë pranë zjarrit, miqtë duke luajtur me shigjeta të vogla në një klub, njeriu që lexon një libër në dhomën e tij, ose ai që punon kopshtin e tij—për këto gjëra ekziston shteti. Dhe nëse nuk ndihmojnë në shtimin, zgjatjen dhe mbrojtjen e momenteve të tilla, gjithë ligjet, parlamentet, ushtritë, gjykatat, policia, ekonomia, etj., janë thjesht një humbje kohe. Në të njëjtën mënyrë, kisha ekziston për asnjë qëllim tjetër përveçse për t'i tërhequr njerëzit drejt Krishtit, për t'i bërë ata Krishtër të vegjël. Nëse nuk e bëjnë këtë, gjithë katedralet, klerikët, misionet, predikimet madje dhe vetë Bibla janë thjesht një humbje kohe. Për këtë qëllim u bë Perëndia Njeri, jo për një tjetër. Madje them se edhe vetë gjithësia mos u krijua pikërisht për këtë qëllim. Në Bibël thuhet se krejt gjithësia u bë për Krishtin e se gjithçka mblidhet së bashku në Të. Nuk besoj se ndonjëri nga ne mund ta kuptojë se si do të ndodhë kjo në lidhje me krejt gjithësinë. Ne as që e dimë se

çfarë ekziston (ose jo) në pjesët e saj miliona milje larg kësaj Toke. Edhe në këtë Tokë ne nuk e dimë se si kjo zbatohet te gjërat e tjera veç njerëzve. Në fund të fundit, kjo është e kuptueshme. Neve plani na është treguar për aq sa ka të bëjë me ne.

Më pëlqen ndonjëherë të përfytyroj se si mund të zbatohet ai për gjërat e tjera. Mendoj se mund ta kuptoj se si kafshët më të larta tërhiqen, në njëfarë mënyre, prej Njeriut kur ai i do ato dhe i bën (siç i bën vërtet) shumë më të përafërta me njeriun nga sa do të ishin në rast të kundërt. Mund ta kuptoj edhe mënyrën se si gjërat e vdekura e bimët tërhiqen prej Njeriut teksa ai i studion dhe i vlerëson ato. Dhe po të kishte krijesa inteligjente në botë të tjera, ato mund të bënë të njëjtën gjë me botët e tyre. Ndoshta kur krijesat inteligjente hyjnë në Krishtin, sjellin në njëfarë mënyre gjithçka tjetër me to. Por unë nuk e di, thjesht hamendësoj.

Ajo që na është thënë është si njerëzit mund të tërhiqen në Krishtin—të bëhen pjesë e asaj dhurate të mrekullueshme që Princi i ri i gjithësisë dëshiron t'i ofrojë Atit të Tij—dhuratë që është Vetja e Tij, e si rrjedhojë edhe ne në Të. Është e vetmja gjë për të cilën u krijuam. Dhe ka aludime të çuditshme e drithëruese në Bibël që , kur ne futemi në Të, shumë gjëra të tjera në Natyrë do të fillojnë të rregullohen. Ëndrra e keqe do të marrë fund, do të bëhet mëngjes.

LLOGARITJA E ÇMIMIT

Mora vesh se mjaft njerëz u shqetësuan nga ajo që thashë në kapitullin e kaluar për fjalët e Zotit Tonë “jini të përkryer”. Disa njerëz duket se mendojnë që do të thotë “po të mos jeni të përkryer, unë nuk do t’ju ndihmoj”; kështu, meqë nuk mund të jemi të përkryer, pozita jonë në këtë rast do të ishte e pashpresë. Por nuk mendoj se Ai donte të thoshte këtë. Unë mendoj se Ai po thoshte: “E vetmja ndihmë që do t’ju jap është ndihma për të qenë të përkryer. Ju mund të doni diçka më pak, por unë nuk do t’ju jap asgjë më pak”.

Më lejoni t’ua shpjegoj. Kur isha fëmijë, kisha shpesh dhimbje dhëmbi dhe e dija se, po të shkoja te mamaja, ajo do të më jepte diçka që do të ma qetësonte dhimbjen për atë natë dhe do të më lejonte të flija. Mirëpo unë nuk shkoja te mamaja. Të paktën jo derisa dhimbja të bëhej shumë keq. Arsyeja pse nuk shkoja është kjo. Nuk dyshoja që aspirinën do të ma jepte, por e dija se do të bënte edhe diçka tjetër. E dija që mëngjesin tjetër do të më çonte te dentisti. Ishte e pamundur të merrja prej saj atë që doja, pa marrë diçka më shumë, që unë nuk e doja. Unë doja pushim të menjëhershëm të dhimbjes: por nuk mund ta merrja këtë pa rregullim të përhershëm të dhëmbëve. Dhe ata dentistë i njihja: e dija se ata do të rrëmonin edhe dhëmbë të tjerë që nuk kishin nisur

të dhembin ende. Qeni flinte, ata do ta zgjonin. Po t'u jepje gishtin, të merrnin krahun.

Nëse më lejoni tani ta shpreh në këtë mënyrë, Zoti ynë është si dentistët. Nëse i jep gishtin, Ai do të marrë krahun. Dhjetëra njerëz shkojnë tek Ai për t'u shëruar nga një mëkati i caktuar që i bën me turp (si masturbimi apo burracakëria fizike) ose që e prish qartazi ditën e tyre (si zemërimi i shpeshtë ose pija). Atë do ta shërojë, pa merak; por nuk do ta lërë me kaq. Ti mund të kishe kërkuar vetëm kaq; mirëpo kur e thërret, Ai do të të bëjë trajtim të plotë.

Prandaj Ai i paralajmëroi njerëzit që të llogarisnin çmimin para se të bëheshin të krishterë. “Mos dyshoni për këtë”, thotë Ai, “nëse më lejoni, unë do t'ju bëj të përkryer. Në çastin që e lë veten në duart e Mia, kjo është ajo që do të të ndodhë. As diçka më pak e as diçka ndryshe. Ti ke vullnet të lirë dhe, nëse zgjedh, mund të më largosh. Por dije që, nëse nuk më largon, unë do ta çoj këtë punë deri në fund. Sado vuajtje të të kushtojë në jetën tënde tokësore, çfarëdo pastrimi të pakonceptueshëm të të kushtojë pas vdekjes, sado të më kushtojë mua, unë nuk do të pushoj dhe nuk do të të lë të pushosh derisa të jesh vërtet i përkryer—derisa Ati im të thotë pa rezerva se Ai është i kënaqur me ty, siç tha se ishte i kënaqur me mua. Këtë mund të bëj dhe do të bëj. Por asgjë më pak se kaq”.

Pavarësisht kësaj—dhe kjo është ana tjetër, po aq e rëndësishme—Ndihmuesi që, në afatgjatë, nuk do të kënaqet me diçka më pak se përsosmëria absolute, do të jetë mëse i gëzuar nga përpjekja jote e parë dhe e dobët nesër për të kryer detyrën më të thjeshtë. Siç e vë në dukje një shkrimtar i madh i krishterë (George MacDonald), çdo baba është i kënaqur me përpjekjet e para të një foshnje për të ecur: asnjë baba nuk

kënaqet me diçka më pak se ecja e fortë, e lirë dhe burrërore e një biri të rritur. Në të njëjtën mënyrë, ai tha: “Perëndia kënaqet lehtë, por nuk kënaqet me pak”.

Pasoja praktike e kësaj është kjo. Nga njëra anë, kërkesa e Perëndisë për përsosmëri nuk ka përse të të dekurajojë aspak në përpjekjet e tua aktuale për të qenë i mirë, madje as në dështimet e tua. Ai do të të ngrejë ty çdo herë që bie. Dhe Ai e di shumë mirë që përpjekjet e tua nuk do të të çojnë ty as afër përsosmërisë. Nga ana tjetër, ti duhet ta kuptosh që në krye të herës se synimi tek i cili Ai po të drejton është përsosmëria absolute, dhe asnjë fuqi në gjithësi, përveç teje, nuk mund ta pengojë atë për të të çuar te ky synim. Kështu është puna. Dhe është shumë e rëndësishme ta kuptosh këtë. Nëse nuk e kupton, ka rrezik të fillosh të tërhiqesh e t’i rezistosh Atij pas njëfarë kohe. Mendoj se shumë prej nesh, pasi Krishti na ka aftësuar të mundim një apo dy mëkate që ishin shumë bezdi për ne, priremi të mendojmë (megjithëse nuk e themi me fjalë) se tani jemi mjaftueshëm të mirë. Ai e bëri atë që ne donim të bënte, ndaj do të na bëhej qejfi nëse tani do të na linte të qetë. Ne themi: “Nuk kisha ndërmend të bëhesha shenjtor, doja thjesht të isha një njeri i mirë i zakonshëm”. Dhe na duket se po tregohemi të përulur duke e thënë këtë.

Mirëpo ky është një gabim fatal. Sigurisht që ne as deshëm, as kërkuam të na kthente në atë lloj krijese që Ai do të na kthejë. Çështja nuk është se çfarë qëllimi kishim ne për veten, por çfarë qëllimi kishte Ai për ne kur na krijoi. Ai është shpikësi; ne jemi thjesht pajisja. Ai është piktori, ne thjesht piktura. Si mund ta dimë ne se çfarë qëllimi kishte Ai për ne? Ai, kuptojeni, tashmë na ka bërë ne diçka shumë më ndryshe nga ajo që ishim më parë. Kohë më parë, para se të lindnim, kur ishim në trupin e nënave tona, ne kaluam në

faza të ndryshme. Ne ishim në një moment të ngjashëm me perimet, e në një moment tjetër më shumë si peshqit: vetëm në fazën e fundit ne u bëmë si foshnja njerëzore. Nëse do të ishim të vetëdijshëm në ato faza të hershme, guxoj të them se do të mbeteshim të kënaqur të qëndronim si perime ose si peshq—nuk do të donim të bëheshim foshnja njerëzore. Por gjatë gjithë kësaj kohe Ai e dinte planin që kishte për ne dhe ishte i vendosur ta zbatonte. Diçka e përafërt po ndodh tani në një nivel më të lartë. Ne mund të jemi të kënaqur të mbetemi “njerëz të zakonshëm”, siç i quajmë ne: por Ai është i vendosur të vërë në zbatim një plan krejt tjetër. Të zmbropsesh nga ky plan nuk është përlulesi, por përtaci e burracakëri. T’i nënshtrohesh atij, nuk është mashtrim apo lartësim i vetes; është bindje.

Ja edhe një mënyrë tjetër për të paraqitur dy anët e së vërtetës. Nga njëra anë, asnjëherë nuk duhet të gënjejmë veten se përpjekjet tona pa patur ndihmë mund të na mundësojnë të jemi njerëz “të mirë” as për njëzet e katër orët e ardhshme. Pa mbështetjen e Tij, asnjë prej nesh nuk mund të jetë i sigurt nga ndonjë mëkat i tmerrshëm. Nga ana tjetër, asnjë masë shenjtërie apo heroizmi e regjistruar edhe nga shenjtoret më të mëdhenj të gjithë kohërave, nuk është përtej asaj që Ai është i vendosur të prodhojë në fund të secili prej nesh. Puna nuk do të përfundojë në këtë jetë; por Ai do të na sjellë sa më pranë të jetë e mundur para vdekjes.

Prandaj nuk duhet të habitemi nëse na pret një kohë e vështirë përpara. Kur dikush kthehet te Krishti dhe duket se po ia kalon mjaft mirë (në kuptimin që disa nga zakonet e tij të këqija janë larguar tani), atij shpesh i krijohet ideja se do të ishte e natyrshme që gjërat tani të shkonin vaj. Mirëpo kur vijnë telashet—sëmundjet, problemet financiare, lloje të

reja tundimi—ai zhgënjehet. Ai mendon se këto gjëra mund të kishin qenë të nevojshme për ta zgjuar dhe për ta bërë të pendohej në ditët e vjetra të këqija; por tani pse? Sepse Perëndia po e detyron atë të ngjitet, ose të rritet, në një nivel tjetër: po e vendos atë në situata ku do t'i duhet të ishte më trim, ose më i duruar, ose më i dashur, nga sa ëndërronte më parë se do të ishte. E gjithë kjo mund të na duket e panevojshme; por kjo ndodh ngaqë ende nuk kemi as idenë më të vogël se çfarë gjëje madhështore do të bëjë Ai me ne.

Më duhet të huazoj edhe një tjetër shëmbëlltyrë nga George MacDonald-i. Mendo sikur je një shtëpi e gjallë. Perëndia vjen për ta rindërtuar këtë shtëpi. Ti edhe mund ta kuptosh fillimisht se çfarë po bën Ai. Ai po pastron ulluqet dhe po rregullon pikat e çatisë etj.: ti e dije se këto punë duheshin bërë dhe nuk habitesh për këtë. Por së shpejti ai nis ta shembë shtëpinë në një mënyrë tmerrësisht të dhimbshme, e cila duket e pakuptimtë. Po çfarë ka ndër mend të bëjë Ai vallë? Shpjegimi i kësaj është se Ai po ndërton një shtëpi krejt ndryshe nga ajo që mendoje ti—duke bërë një shtesë këtu, një kat atje, duke ngritur kulla, duke rregulluar kopshte. Ti mendove se do të të bënte një shtëpi të vogël fshati: por ai po ndërton një pallat. Ai ka ndërmend të vijë e të jetojë Vetë aty.

Urdhërimi *Jini të përkryer* nuk është një ekzagjerim idealist. As një urdhër për të bërë të pamundurën. Ai do të bëjë neve krijesa që mund t'i binden këtij urdhërimi. Ai tha (në Bibël) që ne ishim “perëndi” dhe do ta përmbushë Fjalën e Tij. Nëse e lejojmë—sepse edhe mund ta pengojmë nëse zgjedhim—Ai do të shndërrojë edhe më të dobët të më të ndyrët ndër ne në perëndi ose perëndesha, në krijesa rrëzëllitëse, të pavdekshme, që rrezatojnë kudo me një energji, gëzim, urtësi dhe dashuri të tillë që tani as që mund ta përfytyrojmë; një

THJESHT KRISHTËRIM

pasqyrë e shkëlqyer, e patëmetë, e cila i reflekton Perëndisë përsosmërisht (megjithëse në një shkallë më të vogël, sigurisht) mirësinë, gëzimin dhe fuqinë e pakufishme të Vetes së Tij. Ky proces do të jetë i gjatë dhe pjesërisht i dhimbshëm, por kjo është ajo çfarë na pret. Asgjë më pak. Atë që tha, Ai e tha seriozisht.

NJERËZ TË MIRË APO NJERËZ TË RINJ

Ai e kishte seriozisht atë që tha. Kush e vendos veten në duart e Tij do të bëhet i përsosur, ashtu si Ai është i përsosur. I përsosur në dashuri, urtësi, gëzim, bukuri dhe pavdekshmëri. Ndryshimi nuk do të kryhet në këtë jetë, pasi vdekja është një pjesë e rëndësishme e trajtimit. Se sa larg do të ketë arritur ndryshimi para vdekjes për çdo të krishterë të caktuar, nuk e dimë.

Mendoj se tani është çasti i duhur të shqyrtojmë një pyetje të zakonshme: nëse krishterimi është i vërtetë, pse nuk janë të gjithë të krishterët dukshëm më të mirë sesa të gjithë jo-të krishterët? Pas kësaj pyetjeje qëndron diçka e cila është pjesërisht mjaft e arsyeshme dhe pjesërisht krejt e paarsyeshme. E arsyeshmja është kjo. Nëse kthimi në krishtërim nuk shkakton asnjë përmirësim në veprimet e jashtme të njeriut—nëse ai vazhdon të jetë po aq arrogant, përçmues, lakmitar apo ambicioz sa më parë—atëherë mendoj se duhet të dyshojmë se mos “kthimi” i tij në besim ishte në një masë të madhe imagjinar; dhe pas kthimit fillestar në besim të një njeriu, sa herë që ai mendon se ka përparuar, ky është testi për ta provuar këtë. Ndjenjat pozitive, informacionet e reja, interesi në rritje për “fenë” nuk kanë asnjë domethënie nëse nuk e ndryshojnë vërtet për mirë sjelljen tonë; ashtu si “të

ndihesh më mirë” nuk ka asnjë dobi nëse termometri tregon se temperatura jote është ende e lartë. Në këtë kuptim bota e jashtme ka plotësisht të drejtë ta gjykojë krishterimin në bazë të rezultateve të tij. Krishti na tha të gjykojmë nga rezultatet. Pema njihet nga frytet; ose pudingu nga të ngrënit, siç themi ne. Kur ne të krishterët sillemi keq, ose nuk sillemi mirë, e bëjmë krishterimin të pabesueshëm për botën jashtë. Pllakatet e kohës së luftës na thoshin se e Folura Pa Mend kushton Jetë. Është po aq e vërtetë që Jeta Pa Mend kushton të Folur. Jetët tona të pakujdesshme e bëjnë botën jashtë të flasë; dhe u japim shkas për të folur në mënyrë dyshuese për të vërtetën e vetë krishterimit.

Por ekziston një mënyrë tjetër e të kërkuarit të rezultateve, në të cilën bota e jashtme mund të tregohet shumë e palogjikshme. Ata mund të mos kërkojnë thjesht që jeta e çdo njeriu të përmirësohet nëse bëhet i krishterë: ata mund të kërkojnë edhe që, para se të besojnë krishterimin duhet ta shohin gjithë botën të ndarë qartazi në dy kampe—të krishterin dhe jo-të krishterin—dhe që krejt njerëzit në kampin e parë të jenë dukshëm e në çdo çast më të mirë se të gjithë ata në të dytin. Kjo është e palogjikshme për disa arsye.

(1) Së pari, situata reale e botës është shumë më e ndërlikuar se kaq. Bota nuk përbëhet nga të krishterë 100 përqind dhe jo-të krishterë 100 përqind. Ka njerëz (madje shumë) që gradualisht po pushojnë së qeni të krishterë, por që ende e quajnë veten me këtë emër: disa prej tyre janë klerikë. Ka njerëz të tjerë që po bëhen dalëngadalë të krishterë edhe pse nuk e quajnë ende veten të tillë. Ka njerëz që nuk e pranojnë plotësisht doktrinën e krishterë për Krishtin, por që janë aq shumë të tërhequr prej Tij saqë i përkasin Atij në një kuptim më të thellë sesa e kuptojnë ata vetë. Ka njerëz në

fe të tjera, që Perëndia ndikon fshehtas për të shfrytëzuar ato pjesë të fesë së tyre që janë në përputhje me krishterimin, që në këtë mënyrë i përkasin Krishtit pa e ditur ata. Për shembull, një budist vullnetmirë mund të përqendrohet më shumë në mësimet budiste për mëshirën, duke lënë në sfond (ndonëse ai ende mund të thotë se i beson) mësimet budiste për disa gjëra të tjera. Shumë nga paganët e mirë shumë kohë përpara lindjes së Krishtit mund të kenë qenë në këtë pozitë. Dhe gjithmonë, patjetër, ka shumë njerëz që janë thjesht të ngatërruar në mendjet e tyre, duke pasur shumë besime kontradiktore të grumbulluar bashkë. Rrjedhimisht, është e padobishme të bësh gjykime në masë për të krishterët dhe jo-të krishterët. Ka njëfarë dobie të krahasosh qentë dhe macet, ose edhe meshkujt dhe femrat, në masë, pasi aty dihet me siguri se çfarë është secili. Kafsha gjithashtu nuk mund të kthehet (as dalëngadalë dhe as menjëherë) nga qen në mace. Por kur krahasojmë të krishterët në përgjithësi dhe jo-të krishterët në përgjithësi, në mendje nuk kemi njerëz të vërtetë që zakonisht i njohim, por thjesht dy ide të vagullta, të përfutuara nga romanet dhe gazetatat. Nëse do të krahasosh një të krishterë të keq dhe një ateist të mirë, duhet të mendosh për dy njerëz të vërtetë që i ke takuar vërtet. Pa zbritur me këmbë në tokë në këtë mënyrë, do të jemi thjesht duke shkuar kohën dëm.

(2) Të themi se kemi zbritur me këmbë në tokë dhe po flasin tani, jo për një të krishterë dhe një jo-të krishterë imagjinar, por për dy njerëz të vërtetë që kemi në lagje. Edhe në këtë rast duhet të tregohemi të kujdesshëm për të bërë pyetjen e duhur. Nëse krishterimi është i vërtetë, atëherë duhet të rrjedhë që (a) Çdo i krishterë do të jetë më i mirë sesa do të ishte ai person po të mos ishte i krishterë. (b) Çdo njeri

që bëhet i krishterë do të jetë më i mirë nga sa ishte më parë. Në të njëjtën mënyrë, nëse reklamat e pastës së dhëmbëve Whitesmile janë të vërteta duhet të rrjedhë që (a) Kushdo që e përdor atë do të ketë dhëmbë më të mirë sesa do të kishte pasur i njëjti person po të mos e përdorte. (b) Nëse dikush fillon ta përdorë, dhëmbët e tij do të jenë më mirë. Por fakti që unë, edhe pse përdor Whitesmile (dhe kam trashëguar dhëmbë të këqij nga të dy prindërit), nuk kam dhëmbë aq të mirë sa një zezak i ri i shëndetshëm që nuk ka përdorur kurrë pastë dhëmbësh, nuk e tregon në vetvete që reklamat janë të pavërteta. E krishtera znjsh. Beits mund të ketë një gjuhë më therëse sesa jobesimtari Dik Firkin. Kjo, në vetveten, nuk mjafton të tregojë nëse krishterimi funksionon apo jo. Pyetja është se si do të ishte gjuha e znjsh. Beits nëse ajo nuk do të ishte e krishterë dhe si do të ishte ajo e Dikut nëse ai do të bëhej i tillë. Znjsh. Beitsi dhe Diku, si pasojë e shkaqeve natyrore dhe të rrethanave ku u rritën, kanë temperamente të caktuar. Krishterimi shpall se do t'i vendosë të dy temperamentet nën një menaxhim të ri, nëse ata e lejojnë këtë gjë. Ajo që ti mund të pyesësh me të drejtë është nëse ky menaxhim, nëse lejohet të marrë drejtimin, e përmirëson problemin. Dihet që ajo që po menaxhohet në rastin e Dik Firkinut është shumë më “e mirë” sesa ajo që po menaxhohet te znjsh. Beitsi. Nuk është kjo puna. Për të gjykuar menaxhimin e një fabrike, nuk duhet të marrësh parasysh vetëm prodhimin, por edhe pajisjet. Duke pasur parasysh pajisjet e Fabrikës A, është e habitshme edhe që arrijnë të prodhojnë diçka; duke pasur parasysh pajisjet me parametrat më të fundit të Fabrikës B, prodhimi i saj, ndonëse i lartë, mund të jetë shumë më i ulët nga sa duhet të jetë. Sigurisht që menaxheri i mirë i Fabrikës A do të marrë makineri të reja sa më shpejt të mundet, por kjo do të kërkojë

kohë. Por prodhimi i ulët gjatë kësaj kohe nuk tregon që ai po dështon.

(3) Dhe tani, të shkojmë pak më thellë. Menaxheri do të vendosë makineri të reja: para se Krishti të ketë mbaruar punë me znjsh. Beits, ajo do të jetë vërtet “e mirë”. Por, po ta linim me kaq, do të dukej sikur i vetmi qëllim i Krishtit ishte ta ngrinte znjsh. Beits në të njëjtin nivel ku Diku ka qenë tërë kohës. Ne në fakt kemi folur sikur Diku është në rregull; sikur krishterimi të ishte diçka që u nevojitej njerëzve të këqij dhe të mirët mund t’ia dalin edhe pa të; dhe sikur mirësia të ishte gjithçka që Zoti kërkon. Por ky do të ishte një gabim fatal. E vërtetë është që në sytë e Perëndisë Dik Firkinin ka po aq nevojë për “shpëtim” sa edhe znjsh. Beits. Në njëfarë kuptimi (të cilin do ta sqaroj më vonë) mirësia vështirë se hyn në punë.

Mos prit që Perëndia ta shohë natyrën e qetë dhe miqësore të Dikut me syrin tonë. Ato kanë rezultuar si pasojë e shkaqeve natyrore që Perëndia Vetë i ka krijuar. Duke qenë tipare temperamenti, ato do të zhduken nëse Dikut do t’i ndryshojë sistemi tretës. Faktikisht mirësia është dhurata e Perëndisë për Dikun, jo dhurata e Dikut për Perëndinë. Ai ka lejuar në të njëjtën mënyrë që shkaqet natyrore, duke vepruar në një botë të prishur prej shekujsh prej mëkatit, të prodhojnë në znjsh. Beits mendjengushtësinë dhe acarimin që shkakton pjesën më të madhe të të këqijave të saj. Ai ka ndërmend ta rregullojë këtë pjesë të sajën, në kohën e duhur. Por, për Perëndinë, kjo nuk është pjesa thelbësore e çështjes. Kjo nuk paraqet ndonjë vështirësi. Ai nuk merakoset për këtë. Ajo që Perëndia po kërkon, po pret dhe po punon të realizojë, nuk është e lehtë as për Të, pasi vetë natyra e kësaj çështjeje e bën të pamundur realizimin thjesht me anë të fuqisë. Ai po pret dhe po e kërkon atë si te znjsh. Beits edhe te Dik Firkinin. Ajo

është një gjë që secili mund t'ia japë Atij, lirisht, ose lirisht mund t'ia refuzojë. A do të kthehen tek Ai dhe të përmbushin të vetmin qëllim për të cilin u krijuan, apo jo? Vullneti i tyre i lirë dridhet brenda si gjilpërë busulle. Por kjo gjilpërë mund ta zgjedhë drejtimin vetë. *Mund* të na drejtojë drejt veriut të vërtetë; por nuk është e detyruar. A do të kthehet gjilpëra, të qëndrojë dhe të drejtohet nga Perëndia?

Mos më keqkuptoni. Patjetër Perëndia e konsideron karakterin grindavec si të keq dhe të padëshiruar. Dhe sigurisht që natyrën e sjellshme Ai e cilëson si diçka të mirë—të mirë si buka, ose rrezja e diellit, ose uji. Por këto janë gjëra të mira që na i jep Ai; ne thjesht i marrim. Ai i krijoi nervat e qëndrueshëm dhe sistemin e mirë tretës të Dikut, dhe Ai ka në dispozicion shumë të tjera të tilla veç këtyre. Perëndisë nuk i kushton asgjë, për aq sa mund të gjykojmë ne, që të krijojë gjëra të mira: por konvertimi i vullneteve rebelë i kushtoi Atij kryqëzimin. Dhe, duke qenë vullnete, ata mund ta refuzojnë kërkesën e Tij—si te njerëzit e mirë edhe te të ligjtë. E pastaj, ngaqë mirësia e Dikut ishte thjesht pjesë e natyrës, do të shpërbëhet e gjitha në fund. Sepse e gjithë natyra do të marrë fund. Përbërja psikologjike e Dikut është formuar nga shkaqe natyrore, ashtu si përbërja e ngjyrave të perëndimit. Ajo do të shpërbëhet së shpejti (pasi natyra kështu funksionon) dhe ajo përbërje do të zhduket, në të dyja rastet. Diku ka patur mundësinë ta kthejë (ose më mirë, ta lejojë Perëndinë ta kthejë) këtë përbërje të çastit në bukurinë e një shpirti të përjetshëm: dhe ai nuk e ka shfrytëzuar atë mundësi.

Këtu ka një paradoks. Për sa kohë nuk kthehet te Perëndia, Diku mendon se mirësia e sjelljes së tij i përket atij, dhe, për aq kohë sa mendon kështu, ajo nuk i përket atij. Sapo ai

kupton se mirësia e tij nuk është e tija, por një dhuratë nga Perëndia, dhe sapo ia ofron sërish Perëndisë—atëherë ajo nis të bëhet vërtet e tija. Sepse tani Diku po fillon të marrë pjesë në krijimin e tij. Të vetmet gjëra që ne mund të mbajmë, janë ato që lirisht ia japim Perëndisë. Ato që përpiqemi të mbajmë për vete janë pikërisht atë që do t'i humbim me siguri.

Prandaj nuk duhet të habitemi kur gjejmë midis të krishterëve disa njerëz që janë ende jo të mirë. Në fakt, kur e mendon, jo të mirët kanë një arsye përse kthehen te Krishti më shumë sesa “të mirët”. Kjo ishte ankesa që i drejtohej Krishtit gjatë jetës së Tij në tokë: Ai dukej se tërhiqte “njerëz shumë të këqij”. Këtë kundërshtim njerëzit e kishin dhe vazhdojnë ta kenë. Nuk është e qartë arsyeja? Krishti tha “Lum skamësit” dhe “Sa e vështirë është për të pasurit të hyjnë në Mbretërinë”, dhe këtu përfshinte padyshim së pari të varfrit dhe të pasurit ekonomikisht. Por a nuk vlejnë fjalët e Tij edhe për një lloj tjetër pasurie dhe varfërie? Pasja e shumë parave mund të shkaktojë rrezikun e të qenit boll i kënaqur me lumturitë që ato mund të japin, duke mos arritur të kuptosh nevojën për Perëndinë. Nëse gjithçka duket se realizohet thjesht me firmosje çeqesh, ti mund ta harrosh që në çdo çast je krejtësisht i varur prej Perëndisë. Tepër thjesht: dhuntitë natyrore mbartin një rrezik të ngjashëm. Nëse ke nerva të shëndetshëm, inteligjencë, shëndet, popullaritet dhe nëse ke patur një edukim të mirë, ti ke më shumë mundësi të mbetesh i kënaqur me karakterin tënd ashtu siç është. “Pse ta ngatërrojmë Perëndinë?”, mund të pyesësh ti. Njëfarë niveli i sjelljes së mirë të vjen mëse natyrshëm. Ti nuk je si ato krijesa të mjera që pengohen gjithnjë prej seksit, dehjes, ankthit apo zemërimit. Të gjithë thonë se je njeri i mirë dhe (të mbetet midis nesh) ti bie dakord me ta. Ka shumë të ngjarë

që të besosh se e gjithë kjo mirësi është për shkakun tënd; dhe mund të mos e ndiesh nevojën për një mirësi të një lloji më të mirë. Njerëzit që i kanë këto lloje të natyrshme mirësie, shpesh nuk mund ta dallojnë nevojën e tyre për Krishtin derisa, një ditë, mirësia natyrore i zhgënjën dhe kënaqësia e tyre me veten shkërmoqet. E thënë ndryshe, për njerëzit e “pasur” në këtë kuptim është e vështirë të hyjnë në Mbretëri.

Është shumë ndryshe për jotë mirët—përtë vegjlit, të ulët, të frikësuarit, perversët, të vetmuarit, të paqëndrueshmit, njerëzit me pasione; me epsh apo të paekuilibruar. Nëse përpiqen të bëjnë çfarëdo mirësie, ata e kuptojnë dy herë më shpejt që kanë nevojë për ndihmë. Për ta është ose Krishti, ose asgjë. Ose marrin kryqin dhe e ndjekin,—ose nuk ka shpresë për ta. Ata janë delet e humbura; Ai erdhi posaçërisht për t'i gjetur ato. Ata janë (në kuptimin real dhe të tmerrshëm) të “varfër”: Ai i bekoj ata. Ata janë “grupi i keq” me të cilin endet Ai. Dhe farisenjtë ende thonë, siç thanë në fillim: “Sikur krishterimi të kishte diçka të mirë, këta nuk do të ishin të krishterë”.

Për secilin prej nesh ka ose një paralajmërim, ose një inkurajim. Në qoftë se je një person i mirë—në qoftë se e ke të lehtë të jesh i virtytshëm—kujdes! Prej atyre që u është dhënë shumë, pritët shumë. Nëse i merr për meritat e tua ato që janë në të vërtetë dhuratat e Perëndisë për ty përmes natyrës dhe nëse mbetesh i kënaqur thjesht të jesh i mirë, je ende një rebel. Gjithë ato dhurata do ta bëjnë rënien tënde edhe më të tmerrshme, prishjen tënde më të ndërlikuar, shembullin tënd të keq më shkatërrimtar. Djalli ishte kryeengjell dikur. Dhuntitë e tij natyrore ishin aq më lart të tuave sa janë të tuat mbi ato të një shimpanzeje.

Por nëse je një krijesë e mjerë—e helmuar nga një rritje

e keqe në një shtëpi xhelozish vulgare dhe sherresh pakup-
tim—e ngarkuar, jo prej zgjedhjes sate, me ndonjë shthurje
të neveritshme seksuale—e bezdisur ditë pas dite nga një
kompleks inferioriteti që të bën t'u ulërasësh miqve të tu—
mos u dëshpëro. Ai i di të gjitha këto. Ti je një nga skamësit
që ai lumturoi. Ai e di se ç'mjet të shkatërruar po përpiqesh
të drejtosh. Vazhdo. Bëj ç'të mundesh. Një ditë (mbase në një
botë tjetër, por edhe më herët) Ai do ta hedhë atë për skrap
dhe do të të japë një të ri. Dhe më pas ti mund të na mahnitësh
të gjithëve—si edhe veten tënde. Pasi ti e ke mësuar drejtimin
e mjetit në një kurs të vështirë. (Disa nga të parët do të jenë të
fundit dhe disa nga të fundit do të jenë të parët.)

“Mirësia”—personaliteti i plotë, i integruar—është diçka e
shkëlqyer. Duhet të përpiqemi me çdo mjet mjekësor, arsimor,
ekonomik dhe politik të mundemi për të prodhuar një botë
ku sa më shumë njerëz të jetë e mundur të rriten “të mirë”;
siç duhet të përpiqemi të prodhojmë një botë ku ka ushqim
me shumicë për të gjithë. Por nuk duhet të hamendësojmë se
po ia dolëm t'i bëjmë të gjithë “të mirë” do t'i kemi shpëtuar
shpirtrat e tyre. Një botë njerëzish të mirë, të kënaqur me
mirësinë e tyre, duke mos kërkuar gjë tjetër, që i ka kthyer
shpinën Perëndisë, do të kishte po aq dëshpërimisht nevojën
për shpëtim sa një botë e mjerë—dhe mbase do të ishte edhe
më e vështirë për t'u shpëtuar.

Shpengimi gjithnjë përfshin përmirësim, edhe tani këtu,
edhe në fund kur do t'i përmirësojë njerëzit në një masë që
nuk mund ta përfytyrojmë. Megjithatë, një përmirësim i
thjeshtë nuk është shpengim. Perëndia u bë njeri për t'i kthyer
krijesat në bij; jo thjesht për të bërë njerëz më të mirë të llojit
të vjetër, por për të krijuar një lloj njeriu të ri. Nuk është si
ta mësosh një kalë të kërcëjë sa vjen e më mirë, por ta kthesh

një kalë në një krijesë me krahë. Pasi t'i ketë marrë krahët, ai sigurisht që do të fluturojë mbi pengesat që nuk do të mund t'i kalonte kurrë, duke e mundur kështu kalin e natyrshëm në sportin e tij. Por mund të ketë një periudhë, kur krahët sapo fillojnë të rriten, kur nuk mund ta bëjë këtë. Madje në atë fazë, gungat në shpatulla—që askush nuk mund t'i dallojë se do të bëhen krahë—mund edhe të japin një paraqitje të sikletshme.

Por mbase kemi kaluar shumë kohë tashmë me këtë pyetje. Nëse ti kërkon një argument kundër krishterimit, (dhe më kujtohet sa me zell kërkoja argumente të tilla kur po frikësohesha se mos ishte i vërtetë), mund të gesh lehtësisht ndonjë të krishterë injorant dhe zhgënjyes e të thuash: “Ç’njeri i ri qenka ky? Më mirë i vjetri.”. Por, sapo ta shohësh që mbi baza të tjera krishterimi mund të jetë i vërtetë, do ta dish në zemër se kjo është thjesht shmangie e çështjes. Çfarë mund të dish në të vërtetë për shpirtrat e njerëzve të tjerë—për tundimet, mundësitë, sfidat e tyre? Një shpirt njeh ti në të gjithë krijimin: dhe vetëm fatin e atij e ke në duart e tua. Nëse ka Perëndi, ti je vetëm me Të, në njëfarë kuptimi. Nuk mund ta shmangësh me spekulime për fqinjët e tu apo me kujtime të atyre që ke lexuar nëpër libra. Çfarë vlere do të kenë gjithë fjalët e kota e thashethemet (a do të arrish edhe t'i mbash mend?) kur ajo mjegull anestezie, e quajtur “natyrë” dhe “botë reale” venitët dhe Prania ku ke qëndruar gjithnjë bëhet e dukshme, e menjëhershme dhe e pashmangshme?

NJERËZIT E RINJ

Kapitullin e kaluar e krahasova veprën e bërjes së Njerëzve të Rinj prej të Krishtit me procesin e kthimit të kalit në krijesë me krahë. Këtë shembull ekstrem e përdora për të theksuar idenë që nuk po flasim thjesht për përmirësim, por për një Shndërrim. Gjëja më e përafërt me të në botën natyrore gjendet në shndërrimet e mahnitshme që mund të shohim tek insektet kur hedhim rreze të caktuara mbi to. Ka disa që mendojnë se në këtë mënyrë funksionoi evolucioni. Ndryshimet e krijesave mbi të cilat varet ai mund të jenë prodhuar nga rrezet nga hapësira. (Sigurisht, pasi ndodhin ndryshimet, e ashtuquajtura “përzgjedhje natyrore” nis të veprojë në ta: domethënë ndryshimet e dobishme mbijetojnë ndërsa të tjerat humbasin.)

Mbase njeriu modern mund ta kuptojë më mirë idenë e krishterë nëse e lidh atë me evolucionin. Të gjithë e dinë se çfarë është evolucioni (megjithëse ka sigurisht disa njerëz të arsimuar që nuk e besojnë atë): të gjithëve u është thënë se njeriu ka evoluar nga forma më të ulëta të jetës. Dhe, si rrjedhojë, njerëzit shpesh pyesin “Cili është hapi i radhës? Çfarë do të jetë ajo gjëja përtej njeriut që do të shfaqet?” Shkrimtarët kreativë përpiquen ta përfytyrojnë këtë hap të radhës—“mbinjeriun”, siç e quajnë. Mirëpo zakonisht ia dalin

vetëm të imagjinojnë dikë shumë më të keq se njeriu që njohim ne, dhe përpiqen ta kompesojnë këtë duke i ngjitur këmbë e krahë shtesë. Po sikur hapi i radhës të jetë diçka krejt ndryshe nga sa mund të imagjinohej prej hapave të mëparshëm? Dhe a nuk ka shumë gjasa të ndodhë kështu? Mijëra shekuj më parë, krijesa masive, me mburojë shumë të trashë, evoluuan. Nëse dikush do ta ndiqte rrjedhën e evolucionit, ai me siguri do të priste të shihte diçka më të madhe me mburojë edhe më të rëndë. Por do ta kishte pasur gabim. E ardhmja kishte një letër nën mëngë që askujt në atë kohë nuk ia priste mendja. Ajo do të nxirrte një kafshë të vogël, lakuriqe e të pambrojtur që kishte një tru më të mirë: me anë të të cilit ajo do të zotëronte të gjithë planetin. Ata nuk do të kishin thjesht një fuqi më të madhe se përbindëshat parahistorikë; ata do të kishin një lloj të ri fuqie. Hapi i radhës nuk do të ishte diçka ndryshe, por ndryshe me një lloj të ri ndryshimi. Rrjedha e evolucionit nuk do të shkonte në drejtimin që pritej: në fakt do të merrte një kthesë shumë të papritur.

Tani mua më duket se hamendësimet më të shpeshta për Hapin e Radhës janë duke bërë të njëjtin lloj gabimi. Njerëzit e shohin (ose mendojnë se po e shohin) se njeriu po zhvillon një tru edhe më të madh dhe po e zotëron edhe më shumë natyrën. E ngaqë rrjedha po shkon në këtë drejtim, ata përfytyrojnë se do të vazhdojë të shkojë në atë drejtim. Kurse unë nuk mund të mos mendoj se Hapi i Radhës do të jetë diçka vërtet e re; do të shkojë në një drejtim që ne as që mund ta ëndërrojmë. Nëse nuk e bën këtë, vështirë ta meritojë emrin “Hap i Radhës”. Unë pres, jo thjesht një ndryshim, por një lloj të ri të ndryshimit. Jo thjesht një dallim, por një metodë të re të krijimit të dallimeve. Ose, nëse më ndjeni për guximin, unë pres që faza e radhës së evolucionit të mos jetë fare një fazë

evolucioni: pres që evolucioni vetë si metodë për të krijuar ndryshimet t'i hapë rrugë diçkaje tjetër. Dhe së fundmi, nuk do të ishte për t'u habitur nëse, ndërkohë që kjo gjë ndodh, shumë pak njerëz e vënë re se është duke ndodhur.

Tani, nëse dëshiron të flasim në terma të tillë, pikëpamja e krishterë thotë pikërisht se Hapi i Radhës tashmë është shfaqur. Dhe është vërtet i ri. Nuk është një ndryshim nga njerëz me tru në njerëz me më shumë tru: është një ndryshim i një drejtimi krejt tjetër—një ndryshim nga të qenit krijesa të Perëndisë në të qenit bij të Perëndisë. Rasti i parë u shfaq në Palestinën e dy mijë vjetëve më parë. Në njëfarë kuptimi, ndryshimi nuk është fare “evolucion”, sepse nuk lind si pasojë e proceseve natyrore, por diçka që i vjen natyrës nga jashtë saj. Por kjo është pikërisht ajo që pritej. Idenë tonë për “evolucionin” e krijuam duke studiuar të shkuarën. Nëse ka risi të vërteta që na presin, sigurisht që ideja jonë e bazuar në të shkuarën nuk mund t'i tregojë ato. Dhe faktikisht ky Hap i Radhës ndryshon nga të mëparshmit jo vetëm ngaqë vjen nga jashtë natyrës, por edhe në disa mënyra të tjera gjithashtu.

(1) Ai nuk vazhdohet përmes riprodhimit seksual. A duhet të na habisë kjo gjë? Ka pasur një kohë përpara se të shfaqej seksi; në të cilën zhvillimi kryhej nga metoda të tjera. Rrjedhimisht, mund të presim që do të vijë një kohë kur seksi të zhduket, ose një kohë (që në fakt është duke ndodhur) kur seksi, edhe pse ekziston ende, do të pushojë së qeni mënyra kryesore e zhvillimit.

(2) Në fazat e mëparshme, organizmat e gjallë kishin pak ose aspak zgjedhje në bërjen e hapit të radhës. Progresi ishte diçka që, kryesisht, u ndodhte atyre, jo që e bënë ata. Por hapi i ri, hapi i të kaluarit nga krijesa në bij, është i vullnetshëm. Të paktën është i vullnetshëm në një kuptim. Jo në

kuptimin që ne do të mund ta zgjidhnim vetë atë, madje as ta imagjinonim. Por është i vullnetshëm në kuptimin që, kur na ofrohet, ne mund ta refuzojmë atë. Ne mund të tërhiqemi pas nëse duam. Mund të ngulim këmbët e ta lëmë Njerëzimin e ri të vazhdojë pa ne.

(3) Krishtin unë e quajta “rasti i parë” i njeriut të ri. Por sigurisht që Ai është më shumë se kaq. Ai nuk është thjesht një njeri i ri, një kampion e llojit, por Njeriu i ri. Ai është origjina dhe qendra e jetës për të gjithë njerëzit e rinj. Ai erdhi në gjithësinë e krijuar, me vullnetin e Tij, duke sjellë me Të Zoe-n, jetën e re. (Domethënë të re për ne, sigurisht: Zoe ka ekzistuar në vendin e saj përgjithmonë.) Dhe Ai e transmeton atë jo përmes trashëgimisë, por përmes asaj që unë e quajta “infeksioni i mirë”. Të gjithë ata që e kanë, e kanë marrë përmes kontaktit personal me Të. Njerëzit e tjerë bëhen “të rinj” duke qenë “në Të”.

(4) Ky hap hidhet me një shpejtësi të ndryshme nga të mëparshmit. Krahastuar me zhvillimin e njeriut mbi këtë planet, shpërhapja e krishterimit mbi racën njerëzore duket se ndodh si një vetëtimë—pasi dy mijë vjet nuk janë gati asgjë për historinë e gjithësisë. (Mos harroni se ne akoma jemi “të krishterët e hershëm”. Ndasitë e liga e të pamenda të kohëve tona janë një sëmundje e fëmijërisë: janë dhimbje të daljes së dhëmbëve, le të shpresojmë. Padyshim që bota jashtë mendon të kundërtën. Ajo mendon se ne po vdesim nga plakja. Por këtë e ka menduar edhe shumë herë të tjera më parë. Ajo ka menduar për shumë kohë se krishterimi është duke vdekur; nga përndjekjet e jashtme dhe korrupsionet e brendshme, nga rritja e muhamedanizmit, e shkencave fizike, e lëvizjeve të mëdha revolucionare anti-kristiane. Por në çdo rast bota është zhgënjyer. Zhgënjimi i parë ishte kryqëzimi. Ai Njeri u

kthye sërish në jetë. Në njëfarë mënyre—dhe e marr me mend se sa tmerrësisht e padrejtë duhet t’u duket atyre—kjo gjë nuk ka pushuar së ndodhuri që atëherë. Ata vazhdojnë të vrasin atë që nisi Ai. Dhe çdo herë, sapo ata bëhen gati të hedhin dheun mbi varrin e saj, befas dëgjojnë se ajo është ende gjallë dhe po shpërthen diku në një vend të ri. S’do mend që na urrejnë.)

(5) Rreziqet janë më të mëdha. Duke u tërhequr në hapat e hershëm, krijesat e shkuara rrezikonin, në rastin më të keq, të humbnin ato pak vite jete mbi tokë: shpesh as këtë nuk e rrezikonin. Duke u tërhequr në këtë hap, ne humbasim një çmim që është (në kuptimin më strikt të fjalës) i pafundëm. Pasi tani mbërriti çasti kritik. Perëndia e ka drejtuar për shekuj me radhë natyrën në prodhimin e krijesave që do të mundeshin (nëse do të zgjidhnin) të nxirreshin nga natyra, të ktheheshin në “perëndi”. A do ta lejojnë veten të nxirren? Në njëfarë mënyre, është si kriza e lindjes. Deri në çastin që ngrihem i ndjekim Krishtin, ne jemi ende pjesë e Natyrës, ende në barkun e nënës sonë të madhe. Shtatzënia e saj ka qenë e gjatë, me ankthe e dhimbje, por tani arriti kulmin. Erdhi çasti madhështor. Gjithçka është gati. Mjeku ka mbërritur. A do të shkojë lindja me “çdo gjë në rregull”? Por kjo lindje dallon nga ajo e zakonshmja në një mënyrë shumë të rëndësishme. Në lindjen e zakonshme, foshnja nuk ka shumë mundësi zgjedhjeje: kurse këtu ka. Pyes veten se ç’do të bënte një foshnjë nëse do të kishte mundësi zgjedhjeje. Ajo mund të preferonte të qëndronte në sigurinë, errësirën dhe ngrohtësinë e barkut të nënës. Pasi ajo do të mendonte padyshim që barku i nënës është i sigurt. Ky do të ishte gabimi i saj më fatal: pasi, duke qëndruar aty, ajo do të vdiste.

Sipas këtij këndvështrimi, gjëja tashmë ka ndodhur: hapi i

radhës është hedhur dhe po hidhet. Njerëzit e rinj po gjenden tek-tuk në të gjithë tokën tashmë. Disa, siç e kam pranuar, janë ende të padallueshëm: por të tjerët dallohen qartë. Ata hasen gjithnjë herë pas here. Vetë zërat dhe fytyrat e tyre janë ndryshe nga tonat: më të forta, më të qeta, më të lumtura, më rrëzëllitëse. Ata nisin aty ku shumica prej nesh përfundojmë. Ata, po them, janë të dallueshëm; por duhet ta dish ku ta kërkosësh dallimin. Ata nuk do të ngajajnë me idenë e “njerëzve fetarë” që ke formuar nga leximi yt i përgjithshëm. Ata nuk i japin vëmendje vetes. Ti mund të mendosh se po tregohesh i mirë me ta kur në fakt ata po tregohen të mirë me ty. Ata të duan ty më shumë se njerëzit e tjerë, por kanë më pak nevojë për ty se njerëzit e tjerë. (Duhet ta hedhim pas krahëve dëshirën për të qenë të nevojshëm për të tjerët: për njerëzit që janë si të mirë, veçanërisht femrat, ky është një nga tundimet më të vështira.) Ata zakonisht duket se kanë shumë kohë: ti pyet veten se nga e gjejnë atë. Pasi ke dalluar një prej tyre, tjetrin mund ta dallosh më lehtësisht. Dhe më thotë një mendje (megjithëse ku ta di unë?) që ata e njohin njëri-tjetrin menjëherë dhe pa gabim, përtej çdo pengese të ngjyrës, seksit, klasës, moshës apo edhe veçantive të besimit. Shenjtërimi në këtë mënyrë i ngjason anëtarësimit në një shoqëri sekrete. Duhet të jetë, të paktën, diçka mjaft *argëtuese*.

Por nuk duhet të imagjinosh se njerëzit e rinj janë të gjithë njësoj, në kuptimin e zakonshëm të fjalës. Një pjesë e mirë e asaj që thashë në këtë libër të fundit mund të të shtyjë të supozosh se duhet të jetë kështu. Për t'i bërë njerëz të rinj, na duhet ta lëmë pas atë që tani e quajmë “vetja jonë”. Duhet të dalim nga vetja jonë dhe të hyjmë në Krishtin. Vullneti i Tij duhet të bëhet i yni dhe mendimet e Tij tonat; siç thotë Bibla, “kini mendjen e Krishtit”. Dhe nëse Krishti është një,

dhe nëse Ai do të jetë “në” ne të gjithë, a nuk do të jemi të gjithë ne të njëjtë? Vërtet kështu tingëllon, por faktikisht nuk është kështu.

Është e vështirë të gesh një ilustrim të mirë për këtë; sepse sigurisht që nuk ka dy gjëra të tjera që ndërlidhen me njëra-tjetrën siç lidhet Krijuesi me një nga krijesat e Tij. Por unë do të provoj dy ilustrime shumë të pamjaftueshme që mund të na japin një ravijëzim të së vërtetës. Imagjinoni një numër të madh njerëzish që kanë jetuar gjithnjë në errësirë. Ti mund të shkosh e të përpiqesh t’u shpjegosh se si është drita. Mund t’u thuash që nëse vijnë në dritë, ajo dritë do të vijë mbi ta, duke u reflektuar tek ata dhe duke i bërë ata të dukshëm, siç do t’i quanim ne. A nuk është mjaft e mundur që ata do të imagjinonin, meqë do të merrnin të gjithë të njëjtën dritë dhe do të reagonin të gjithë në të njëjtën mënyrë ndaj saj (domethënë, duke e reflektuar atë), se të gjithë ata do të dukeshin njësoj? Ndërkohë që unë e ti e dimë që në fakt drita do të nxjerrë në pah se sa të ndryshëm janë ata. Ose përfytyroni sërish dikë që nuk di asgjë për kripën. Ti mund t’i japësh një majë gishti për ta shijuar dhe ai do të ndiejë shijen e fortë e të ashpër të saj. Ti më pas i thua se njerëzit në vendin tënd e përdorin atë në të gjitha gatimet e tyre. A nuk mund të përgjigjet ai, “Atëherë supozoj se të gjitha gatimet tuaja kanë pa dallim të njëjtën shije: sepse shija e kësaj që më dhe ti është kaq e fortë saqë do të vriste shijen e gjithçkaje tjetër.” Mirëpo ne të dy e dimë që efekti i vërtetë i kripës është krejt i kundërti. Jo vetëm që ajo nuk e vret shijen e vezës, kukurecit apo sallatës, por në fakt e nxjerr në pah atë. Shija e tyre nuk mund të dallohet vërtet nëse nuk i shton kripë. (Sigurisht që ky nuk është një ilustrim mjaft i mirë, siç ju paralajmërova, sepse është vërtet e mundur ta vrasësh shijen e gjërave të

tjera duke hedhur kripë së tepërmi, ndërkohë që shijen e personalitetit njerëzor nuk mund ta vrasësh duke i hedhur më shumë prej Krishtit. Por unë po bëj më të mirën që mundem.)

Rasti ynë me Krishtin është diçka e ngjashme. Sa më shumë e mënjanojmë atë që tani e quajmë “vetja jonë” dhe e lejojmë Atë të marrë kontrollin, aq më shumë do të bëhemi vetja jonë e vërtetë. Ka aq shumë në Të saqë miliona e miliona “Krishtë të vegjël”, secili të ndryshëm, nuk mjaftojnë aspak për ta shprehur Atë plotësisht. Ai i bëri ata të gjithë. Ai i shpiku—siç shpik shkrimtari personazhet e një romani—të gjithë njerëzit e ndryshëm siç duhet të ishim unë dhe ti. E parë në këtë kuptim, vetja e vërtetë e secilit prej nesh është duke na pritur në Të. Është e kotë të përpiqemi të “jemi vetvetja” pa Të. Sa më shumë i rezistoj Atij dhe përpiqem të jetoj me forcat e mia, aq më shumë sundohej nga trashëgimia, rritja, rrethanat dhe dëshirat e mia natyrore. Ajo që unë me krenari e quaj “vetja ime” është në fakt thjesht vendtakimi i trenave të ngjarjeve që unë kurrë nuk i nisa e që nuk mundem t’i ndaloj. Ato që unë i quaj “dëshirat e mia” janë thjesht dëshira të nxitura nga organizmi im fizik, ose të futura në mua nga mendimet e njerëzve të tjerë apo edhe të sugjeruara nga djajtë. Vezët, alkooli dhe gjumi i mirë i mbrëmjes do të jenë origjina e vërtetë e asaj që mburrem ta quaj vendimi im tepër personal dhe i gjykuar për të bërë dashuri me vajzën përballë meje në kabinën e vagonit të trenit. Propaganda do të jetë origjina e vërtetë e asaj që unë e cilësoj si ideja ime personale politike. Në gjendjen time natyrore, unë nuk jam aq shumë person sa do të doja të besoja: pjesa më e madhe e asaj, që e quaj “uni”, mund të shpjegohet mjaft lehtësisht. Por kur kthehem te Krishti, kur i dorëzohem Personalitetit të Tij, atëherë filloj të kem një personalitet të vërtetë timin.

Unë thashë në fillim që në Perëndinë ka Personalitete. Tani do të shkoj një hap më tej. Nuk ka personalitete të vërteta askund tjetër. Pa ia dorëzuar veten tënde Atij, nuk do të kesh një vete reale. Njëjtësia gjendet më së shumti në njerëzit që janë më “natyrorë”, jo në ata që i dorëzohen Krishtit. Sa të ngjashëm deri në monotoni janë të gjithë tiranët dhe pushtuesit e mëdhenj: sa lavdishëm dallojnë shenjtorët.

Por duhet një dorëzim i vërtetë i vetes. Duhet ta hedhësh tutje, si të thuash, “pa kthyer kokën”. Krishti do të të japë vërtet një personalitet të ri: por nuk duhet të shkosh tek Ai për hir të kësaj. Për aq kohë sa shqetësimi yt qëndron në personalitetin tënd, ti as që po i afroresh Atij. Hapi i parë i vërtetë është ta harrosh veten fare. Vetja e re e vërtetë (që është e Krishtit dhe e jotja gjithashtu, dhe është e jotja për shkak se është e Tija) nuk do të vijë për sa kohë je duke e kërkuar atë. Do të vijë kur je duke kërkuar për Atë. Ju tingëlloi e çuditshme? E dini, ky parim vlen edhe për gjëra më të përditshme. Edhe në jetën shoqërore, nuk lë asnjëherë mbresa të mira te të tjerët nëse nuk pushon së menduar për mbresat që po u lë atyre. Edhe në letërsi e art, askush që shqetësohet për origjinalitetin nuk do të jetë origjinal: ndërkohë që nëse thua thjesht të vërtetën (pa u shqetësuar asnjë thërrime se sa herë të tjera është thënë më parë) në nëntë nga dhjetë raste do të bëhesh origjinal pa e vënë re këtë. Ky parim e përshkon gjithë jetën fund e krye. Hiq dorë nga vetja dhe do të gjesh veten tënde të vërtetë. Lëre jetën tënde dhe do ta shpëtosh atë. Nënshtroju vdekjes, vdekjes së ambicieve dhe dëshirave të tua të preferuara çdo ditë dhe vdekjes së gjithë trupit tënd në fund: nënshtroju me çdo fije të qenies sate dhe do të gjesh jetën e përjetshme. Mos mbaj asgjë. Asgjë që ke mbajtur nuk do të mbetet vërtet me ty. Asgjë në ty që nuk ka vdekur nuk

THJESHT KRISHTËRIM

do të ringjallet. Kërko veten tënde dhe do të gjeshe në fund vetëm urrejtje, vetmi, dëshpërim, tërbim, rrënim dhe kalbje. Kërko Krishtin dhe do ta gjeshe Atë, dhe me të, edhe gjithçka tjetër.

Fund

NGA I NJËJTI AUTOR

LETRAT E HIRZIUT

DREJTUAR NJË DJALLI TË RI,
NGA XHAXHAI I TIJ I MOSHUAR

———— *C. S. Lewis.* ————

Kjo kryevepër e satirës, të cilën autori ia dedikon mikut të tij J. R. R. Tolkien, ka tërhequr dhe ndikuar miliona lexues me portretizimin dinak e ironik të jetës së njeriut nga pikëpamja e djallit Hirzi. E pakrahasueshme për sa i përket komikes dhe originalitetit, korrespondenca e mprehtë e djallit plak të përbotshëm, me nipin e tij Krimbaqin, nxjerr në pah anën më të errët e më argëtuese të autorit C. S. Lewis. Ky botim përfshin edhe Hirziu ngre një dolli, ku famëkeqi Hirzi u jep këshilla dajve të rinj në një darkë me rastin e diplomimit të tyre në Shkollën e Trajnimit të Tunduesve.

“Duhet të përfshihet patjetër te klasikët.”

— Gazeta GUARDIAN

“Është një fishekzjarr, me një humor ngacmues që të emocionon teksa e lexon.”— Gazeta SUNDAY TIMES

“I shkëlqyer, tronditës, sfidues, provokues.”

— Gazeta OBSERVER

